

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

**BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave shoqërore**

**Viti XLVII i botimit**

**Nr. 67**

Shkodër, 2017

## **REDAKSIA**

*Kryeredaktor - Prof. dr. Artan HAXHI*  
*Sekretar shkencor - Prof. as.dr. Nevila DIBRA*  
*Anëtarë - Prof. dr. Mimoza PRIKU,*  
*prof. dr. Tomor OSMANI – Profesor Emeritus,*  
*prof. dr. Alfred ÇAPALIKU, prof.as.dr. Alma HAFIZI*

**DREJTOR I REVISTËS**  
*Prof. dr. Adem BEKTESHI*

**Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami**

---

***Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

---

Adresa e redaksisë:      Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e Buletinit Shkencor  
Seria e Shkencave Shoqërore  
Tel/fax: ++399 22 43747

## PASQYRA E LËNDËS

- **Gjuhësi**

**Bardhyl DEMIRAJ**

Vincenzo Basile SJ “*Diftova mjaft dashtniin qi kam per juu; tash ju perket me pergjegj mue.*” (1811-1882) (Basile 1845 5)  
“*I showed a lot of love for you*” *Now it is your turn to answer me*.....7

**Artan HAXHI, Tefë TOPALLI**

Terminologjia si sistem  
*The Terminology as a system*.....27

**Evalda PACI**

Visari i Kongregacionit (1930), një dëshmi vlerash dhe tekstesh të vyera në gjuhën shqipe  
*Visari i Kongregacionit (1930), a testimony of values and precious texts in Albanian*.....37

**Rrezarta DRAÇINI**

Abstragime psikolinguistike në perceptimin poetik tek “me mujt me fjet’... me kthimin e shpendve”, të Ledia Dushit  
*Psycholinguistic abstractions in the poetic perception of “being able to sleep... with the return of the birds”, of Ledia Dushi*.....47

**Merita HYSA**

*Struktura rrokjesore e ndajshtesave trajtëformuese*  
*Syllabic structure of formative affixes*.....53

**Aida URUÇI**

Format kohore sintetike të përdorura nga A. Xanoni  
*The synthetic time formats used by A. Xanoni*.....65

**Elvis BRAMO**

Vështrim analitik sintaksor i gjuhës së përkthimit të Dhiatës së Re nga Vangjel Meksi

*Syntactic analytical review of the New Testament translation language by Vangjel Meksi*.....77

**Karmen LAZRI**

Terma eufemistikë në “Fjalorin e emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip” të prof. Xhevat Lloshit.

(Logos-A, Shkup-Prishtinë, 2010)

*Euphemistic terms in “The vocabulary of flora & fauna albanian - italian languages”*..... 95

**Gani PLLANA**

Probleme të standardit në terminologjinë teknike

*Problems of Standard in the Technical Terminology*.....105

**Anejda RRAGAMI**

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj

*The Albanian word instead of the foreign one*.....113

• **Letërsi**

**Fatbardha HOXHA**

Leximi në shqip i lirikave të Sándor Petöf-it

*Reading Sándor Petöf's works in Albanian*.....123

**Arben PRENDI**

“Visaret e kombit” dhe dijetarët françeskanë për afirmimin e eposit shqiptar të kreshnikëve

*The "Visaret e kombit" and the Franciscan scholars for the affirmation of the Albanian epos of the Kreshniks*.....133

### **Gëzim PUKA**

Drama dhe teatri i Stefan Çapalikut si dialog plot ndriçim e identitet  
*Drama and theater of Stefan Çapaliku as a dialogue full of illumination and identity*.....151

### **Ndoj MHILLI**

Drama “Loja e mbasdrekës” e M. Camajt dhe novela “Gjaku”e  
E. Koliqit: afri dhe dallime  
*Drama “Play of afternoon” M. Camaj’s and novels “Blood” of  
E. Koliqi: affinities and differences*.....165

#### • **Histori**

### **Rokin DABERDAKU**

Institucionet qeverisëse në qytetet shqiptare, gjatë Mesjetës  
*Governmental Institutions of Albanian Countries During the Medieval  
period*.....177

### **Anelmo SPAHIJA**

Luftërat turko-malazeze dhe rajoni i Shkodrës (1852-1856)  
*Turko-Montenegrin wars and the region of Shkodra(1852-1856)*.....185

#### • **Gjeografi**

### **Sokol AXHEMI**

Impakte të burimeve të energjisë në zhvillimin e popullsisë së Shqipërisë  
dhe elementeve sociale të saj (1990-2016)  
*Impact of energy resources on the development of Albania's population and its  
social elements (1990-2016)*.....197

### **Flora GJONI, Ermal MLIKA**

Globalizimi dhe vendi që zë Shqipëria në këtë proces.Ndryshimet  
strukturele që ka pësuar ekonomia e vendit tonë gjatë tranzicionit  
*Globalization and the place of Albania. Structural changes that  
Albanian economy has undergone during transition*.....209

- **Gazetari**

**Isida HOXHA**

Riprezantimi i gruas në diskursin mediatik, mars, 2017

*Representation of the women in the mediadiscourse, march 2017.....221*

**KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI**

**RECENSIONE**

**Tomor OSMANI:** Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*

*Justin Rrota, Written Language or grammatical remarks.....231*

**Artan HAXHI, Mimoza PRIKU:** Një jetë në shërbim të dijes. “Rezultate të kërkimeve të prof. Luçia Nadin të 20-të viteve të fundit për Shqipërinë e Shkodrën, nga shekulli XV-XVIII” .....

*A life on knowledge. The research results on Albanian and Shkodra from XV – XVIII centuries from the last 20 years of Prof. Luçia Nadin .....245*

**Zija VUKAJ:** Lumi i melodisë. (Shënime për librin “Danub”, të autorit Klaudio Magris, sjellë në shqip nga përkthyesja Alma Hafizi).....

*Remarks on Danubi book wriiten by Kaludio Magris, trasnalated by Alma Hafizi..... 251*

**JETA SHKENCORE**

I. Veprimtari shkencore  
*Scientific activity.....255*

II. Promovim libri  
*Promotional books.....260*

III. Botime të reja të Universitetit tonë  
*New editions of our University Publications.....262*

**Bardhyl DEMIRAJ****VINCENZO BASILE SJ**  
(1811-1882)

*“Diftova mjaft dashtniin qi kam per  
juu; tash ju perket me pergjegj mue.”*  
(Basile 1845 5)

**Fjalë hyrëse**

Le të kumtojmë diçka më shumë për Vincezo Basile-n (= shq. *Vinçenc Bazile*), anipse nuk e kemi lënë pa i lakuar emrin sadopak në një studim të paradokohshëm, bash kur morëm në analizë prurjet e sivëllait të vet, Giuseppe Ignatio Guagliata-s SJ (= shq. *Zef Ign. Gualiata*), në kulturën e shkrimit shqip të shek. XIX në arealin e Veriut. (Demiraj 2015 24vv.) Aty kemi vënë oroe, ndër të tjera, se të dy ndajnë së bashku ato të mira e të liga që u preu fati, kur i zbriti në Shkodër në vitet 1841-1843 me mision për të ngritur tëbanat e para të Urdhërit Jezuit, sikurse – siç edhe pritej (!!!) – të hapnin po aty shkollat e para për carrokët e besimit katolik në atë qytet. Këtyre të mirave lejohemi t’u shtojmë tash pa rudhur buzë e mbledhur vetulla edhe botimin e njëkohshëm dy vjet më vonë (1845) në Romë, të dy librave të tyre shqip, me të cilët të dy rihapën njëherësh siparët e pluhurosur të kulturës së shkrimit shqip në Shqipërinë e Veriut në shek. XIX.

Prashtu nuk i shtëmangemi dot, përkundrazi vetëm saktësojmë me një detaj shtesë synimin e këtij shkrimi modest, duke mëtuar tash, se ishin pikërisht këto dy botime, të cilat u bënë shkas për shkruesin e këtyre radhëve me u marrë konkretisht e në vazhdimësi edhe me jetën e aktivitetin fetar si edhe me angazhimin e tyre social-intelektual në Shqipëri. Veçse një ndërmarrje e tillë përcjell vetiu thjesht dhe vetëm ato të liga që u desh të përjetonin këtu të dy këta barinj shpirtërorë, sikurse i gjithë misioni jezuit në fazën e tij të parë, i cili nuk zgjati më shumë se dy vjet, shi kur u desh të iknin turravrap vet’ i tretë, bashkë me Salvatore Bartoli-n, duke i lënë përfundimisht Dheut të Shqipës pendlat e korbit të bardhë. (Murzaku 2006 212vv.) Por jo vetëm kaq dhe jo vetëm atëbotë: zezonën e dytë, shpirtërisht po aq të dhimbshme, e përjetuan të dy këta autorë duke e parë nga lart, bash në gjysmën e dytë të shek. XX, kur – edhe pse citohen ashtu rrallë e për mall (Shuteriqi 1976 245) – linçohen keqas si pjesëtarë të ‘urdhrit famëkeq’, që vjen me thashunë shqip të Urdhrit Jezuit me ngulim në Shqipëri. Dhe ishte pas gjase ky vlerësim paraparak që i ndërkaloi këta emra

përfundimisht në indeksin e autorëve të ndaluar si fazë nismëtare e atij procesi afatgjatë që përkon në kohë me galvanizimin e trurit intelektual-akademik shqiptar, një dukuri kjo sa e natyrshme aq edhe e neveritshme e dhunës strukturore informale të kohës, të cilën jemi mësuar ta ngjerojmë ndërkohë si *damnatio memoriae* ase në emfazë si *shpëlarje e trurit*. Suksesi i këtij procesi është bërë më se i dukshëm dhe po aq i prekshëm në kohën tonë të të ashtuquajturit *tranzicion kulturor shqiptar*, i cili përkon jo rastësisht me zezonën e tretë të radhës që përjetojnë ndërkohë të dy këta autorë sikurse shumë e shumë e shumë sivëllezër të vet, të fshirë tashmë (pa)vetëdijshëm, por thuajse njëherë e përgjithmonë nga kujtesa historike-intelektuale shqiptare, bash ashtu siç i vuajmë sot e gjithë ditën, kur shfletojmë do doracakë ase vademekume zyrtare-akademike shqip të natyrës së “Fjalor Enciklopedik Shqiptar”, sidomos në ribotimin e tij (ASHSH, Tiranë 2008/9), me redaktor përgjegjës filologun tashmë në pension Emil Lafe, pas gjase edhe në cilësinë e njohësit të thelluar të kulturës së shkrimit shqip në kohë e hapësirë.<sup>1</sup>

Dhe është më se e kuptueshme, që këto rrethana aspak fatlume të kenë ndikuar si efekt domino edhe në mungesën e interesimit për një lexim kritik-filologjik sado të përciptë të veprës së tij: “Ruga e Parrisit. Calzuem kersctënvët Arbniis prei P. Vincenzit Basile t’ Sciochniet Jesus” (= shq. let. *Rruga e Parajsës. Kallëzuar të krishterëve të Arbërisë prej At Vinçenc Baziles të Shoqërisë së Jezusit*), e cila pa dy herë dritën e diellit në Romë si botim i Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s (1845, 1873) e që e kemi bërë objekt vëzhgimi në këtë shkrim. Sfondi historik-kulturor, në të cilin u përftua vepra, paraqitja dhe përshkrimi i saj sado i thukët, sikurse edhe ndonjë vërejtje e natyrës kritike-filologjike mbi tekstin e rrjedhshëm shqip përbëjnë gjithsesi së bashku qëllimin e tij kryesor, i cili si i tillë nuk mëton aspak të rrokë përmasa ballore.

Përmblodhëm kështu objektin dhe synimin tonë modest në këtë studim, duke shprehur njëherësh dëshirën dhe shpresën e mirë se mund të nxisim dikur, në një të ardhme mundësisht të afërt, kërkime të mirëfillta arkivore lidhur me rrethanat e përftimit të veprës, sikurse edhe me aktivitetin kulturor-intelektual të autorit të saj në Shqipëri. Por le të ndalemi fillimisht në do grimca të natyrës biografike mbi vetë autorin.

<sup>1</sup> Të dyja këto faza i përjetojmë qartë në dy botimet e këtij fjalori: a) i pari (ASHRSH, Tiranë 1985) si pjesë përbërëse e procesit të shpëlarjes së trurit; ndërsa b) i dyti (ASHSH, Tiranë 2008/9) si pjellë e suksesit të atij procesi. (hollësisht Demiraj 2016a/b) Lidhur me atributet që i vesh vetes redaktori përgjegjës i FESH 2008/9, lexuesi mund të konsultojë vetë laudation e tij në këtë fjalor (bl. II, f. 1448v.: Lafe, Emil: 40 rreshta).



### Grimca biografike mbi Vincenzo Basile-n

Burime të sigurta mbi personin në fjalë mundësojnë në radhë të parë aktet *Annali siculi* (bl. IV: 1840-1844; Palermo 1908, f. 34vv.; 81v., 116v.; 160, 224) e sidomos një studim i mirëfilltë bio-bibliografik me autor Mijo



Korade-n SJ (1982 106vv.),<sup>2</sup> historian i mirënjohur i Kishës Katolike në Kroaci dhe sivëlla jezuit i autorit tonë, i cili mbështetet në dokumentacion të pasur arkivor që e citon në fusnota, madje një pjesë sish e boton në shtojcë të punimit. Lidhur me aktivitetin e Basile-s si drejtues (= “superior”) i misionit jezuit në Shqipëri (Shkodër: 1841-1843), për këtë fazë, aq sa dimë, i detyrohemi sigurisht punës së ngulmët të Ines Murzakut (2006 67vv.; 108vv.) dhe Markus Peters-it (2007 51v., 64, 297), ndërkohë që ndonjë të dhënë shtesë mbi familjen dhe vitet e tij të fëminisë kemi

mundur t’i fiksojmë në ndonjë faqe interneti, pra pa mundur të verifikojmë në detaj saktësinë e kumtit elektronik në kohën tonë.<sup>3</sup>

Asgjëmangut, Korade (1982 106) na mëson që në hyrje të punimit të tij datën e saktë të lindjes, ndërkohë që vendlindja dhe familja përkojnë në disa burime bashkë.<sup>4</sup> Prashtu, sipas tij, Vincenzo Basile lindi më 28 dhjetor 1811 në Siculiana të dioqezës së Agrigenti-t (deri më 1927: <Girgenti>) në Sicili, në një familje vendase me nënë Vita Schembri Volpe-n dhe baba Pasquale Basile-n me profesion administrator tokash. Familja dhe fati i saj janë të fiksuara njëherë e mirë në kumtin siculian të kohës: “Ni la casa di Vasili tutti monaci e parrini, missionari Gesuiti e Liguorini, ci nni fu unu spiziali ca nun si vosi maritari” (: “Në shtëpinë e [Pasquale] Basile-s të gjithë murgj e priftërinj, misionarë jezuitë dhe liguorinë; na ishte dhe një farmacist që nuk donte të martohej.”) Dhe është fakt që kjo familje e madhe nuk mundi të degëzojë dot lirin e vet të gjakut, edhe pse në të u lindën plot pesë djem. Ndër ta, tre vëllezër: Onofrio, Salvatore dhe Vincenzo ynë, përjetuan qysh në moshë të re Thirrjen Hyjnore, ndërsa dy më të rinjtë Giuseppe (mjek i Garibaldi-t) dhe Luigi iu përkushtuan qysh në të ri sipas rastit vetëm mjekësisë, politikës dhe farmacisë.

<sup>2</sup> Falënderoj me këtë rast mikun dhe kolegun tim Joachim Matzinger që më vuri në dispozicion një kopje të skanuar të këtij punimi.

<sup>3</sup> Khs. ndër të tjera: <<http://www.metesiculiana.org/2013/08/basile-vincenzo-1811-1882.html>>

<sup>4</sup> Ndër të tjera: *Annali siculi*, bl. IV 35.

Dëshira dhe synimi i të atit ishte që edhe Vincenzo të bëhej mjek. Por ja që hesapet i kishte bërë pa hanxhinë, meqë ky djalë ‘kryeneç’ u dorëzua në moshën 16 pa lejen e tij në Urdhrin Jezuit, duke u regjistruar rishtar më 14 qershor 1827 pranë Casa Professa në Palermo. Aty studioi me pasion vite të tëra filozofi (1831-1833) e në Marsala teologji (1836-1839), duke u thelluar edhe në zotërimin dhe perfeksionimin e latinishtes. Pas fitimit të një përvoje solide në mësimdhënie dhe predikim në misione të ndryshme të provincës amë (Alcamo, Marsala, Palermo etj.) si edhe gjatë disa udhëtimeve në vende të ndryshme pelegrinazhi ai vihet në dispozicion të Urdhrit si misionar i Eërve Jezuitë.

Me këtë funksion do ta ndeshim Basile-n së pari, në fillim të vitit 1841, në Shkodër – i ftuar zyrtarisht prej ipeshkvit të asaj dioqeze, Imz. Luigi Guglielmi –, ku vendoset në krye të misionit të parë jezuit në Shqipëri si “superior” i grupit të përbërë prej tre vetësh, pra së bashku me dy sivëllezërit e vet që përmendëm më lart: P. Giuseppe Ign. Guagliata dhe P. Salvatore Bartoli. Në kuadër të këtij misioni fillon e zhvillohet aktiviteti i tyre disadrejtimësh: a) arsimor: me synimin farëmirë të themelimit të një kolegji me (konvikt dhe) kapacitet deri në 200 rishtarë; b) meshtarak: me mbarështimin e besimit në bashkësinë e krishterë të qytetit, dhe c) social: me përkujdesjen shëndetsore të popullsisë së gjithë qytetit. Por siç e kemi cekur dikur gjetkë: “... ishte bash kjo ndërmarrje fanmirë që iu kthye vetë misionit si bumerang ogurzi: Jo më larg se gushti i vitit 1843, pra diçka më shumë se dy vjet pas ngulimit të tij të parë në Shqipëri, duke përfshirë këtu edhe gjashtë muaj ngujimi në ambientet e banimit të zëvendës-konsullit austriak, Vincenzo Ballarini-t – për t’i shpëtuar së ashtuquajturës “revoltë popullore”, e cila përjetoi si pikë kulmore shkatërrimin në themel të ndërtesës së porsapërfunduar që ishte parashikuar si seminar jezuit – [...]” misioni detyrohet të mbyllë paraprakisht dyert e veta në Shkodër,<sup>5</sup> ndërkohë që anëtarët e tij u shpërndanë: Guagliata dhe Bartoli u vendosën fillimisht në Romë, por dikur më vonë i pari u rikthye me lang e me plang në Palermo/Sicili, ndërsa të dytit i ra fati me marrë rrugën e misionarit përtej detit, drejt e në Guatemala,<sup>6</sup> ku i humbi nami e nishani. Vetë Vincenzo Basile u transferua fillimisht – deri në vitin 1845 – në Ragusa (= sot <Dubrovnik>) me kërkesë të ipeshkvit të atyshëm Tomo Jederlinić.

Në vitet 1845-1852 Basile-n e ndeshim si meshtar në Gradac të Hercegovinës e më pas, deri më 1859, edhe si “superior” i misionit jezuit

<sup>5</sup> Hollësisht Murzaku 2006 67vv.; 108vv.; Peters 2007 51v. Për riardhjen e Urdhrit Jezuit në Shkodër në vitin 1856, shih së fundi Peters 2007 53.

<sup>6</sup> Annali siculi, bl. IV, f. 224 (§ 106).

në Trebinje, ku mbarështoi – duke lëvizur gjithëherë kaluar mbi mushkë – një famulli të shtrirë në plot 28 fshatra. Më 1865 emërohet visitator apostolik me funksion ipeshkvi në atë dioqezë, ku administron një bashkësi të krishterë me mbi 3000 frymë. Pas një qëndrimi të shkurtër në Sicili (1859-61) për arsye shëndetësore rikthehet përsëri në tokë të krishterë kroate si at shpirtëror (Požega), si edhe konsulent dhe drejtues kongregacionesh të ndryshme fetare (Malpaga dhe Zemunik pranë Zarës). Më 1872 ishte Imz. Domenico Turano, arqipeshkvi i Agrigento-s që iu drejtua me një kërkesë në formë lutjeje me shkrim Padre Generale-s së Shoqërisë së Jesus-it me seli në Romë për ta transferuar Padre Basile-n në dioqezën e vendlindjes. Kërkesa iu miratua. Aty Basile vijoi të predikojë vite me radhë, duke zhvilluar ushtrime spirituale sidomos në kohën e kreshmëve në misionin e Agrigento-s, sikurse edhe në ato të Siracusa-s, Palermo-s dhe Trapan-it. E vijoi këtë aktivitet edhe më 1880, me rastin e pelegrinazhit në Tokën e Shenjtë në Seminarin e Jerusalemit.

Basile ndërron jetë më 3 mars 1882 në Pia Casa del Bocone del Povero të Shën Markut në Palermo. Korpi i tij gjen prehjen e fundit në varrezën familjare të Santo Spirito di S. Orsola në Palermo. Me rastin e mortit gazeta “*Sicilia Cattolica*” e dt. 6/7 mars 1882 shkruan, sa vijon: “*Col più grande dolore si è intesa nella nostra città la morte del carissimo e santo missionario, il Padre Vincenzo Basile, tanto caro a quanti lo conobbero, tanto benemerito della Chiesa e decoro dell’Ordine cui apparteneva e che fu un vero apostolo nel corso della sua vita esemplare [...]*”. Për kohë të gjatë u ruajt në kujtesën kolektive sikuliane kandi i pazakonshëm i predikimit të tij që përqasej shpesh me atë të një shenjtori: “*La predicazione del Padre Basile non è comune, ma è come quella di un santo.*”

### **Vepra në sfondin e saj kulturor-historik**

*Sa i përket botimit të tij shqip:* <Ruga e Parrisit. Calzuem kersctënvët Arbniis prei P. Vincenzit Basile t’ Sciochniet Jesus. N’ Rom, te Stampùemin t’ Scëitit Cuvèn de Propaganda Fide. 1845> (144 f.), sigurisht që në këtë rast nuk kemi të bëjmë aspak me një lule të parë dhe të fundit që solli beharin e kulturës shqiptare në shek. XIX. Ky libër rezulton gjithësesi të jetë i vetmi në gjuhën shqipe që mban firmën e tij, anipse përjetoi si i tillë edhe një herë të dytë dritën e botimit në shtypshkronjën e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s (Romë 1873 118 f.). Përndryshe titujt e botimeve të tjera që mëtojnë autorësinë e tij i ngjerojmë vetëm në kroatisht, ndër to do libra të natyrës asketike dhe syresh lutjesh, khs.: “*Razmišljaj ovo dobro*” (1844 me tri botime, si përkthim në kroatisht i Bartol Baudrand “*Pensez y bien*”), “*Molitvenik za katolička poslanstva*” (= “*Libër lutjesh për misionin katolik*”, 1861 – katër botime), “*Važni uzroci*”

(= “Arsye të rëndësishme”, 1864 – me autor Antun Kanižlić) etj. Hollësi për këta tituj<sup>7</sup> mësojmë sidomos prej Korade-s (1982: 154), i cili mëngon të kumtojë gjithashtu se shi ideja nismëtare e Basile-s ishte ajo që nxiti kardinalin Juraj Haulik, arqipeshkëv i Zagrebit, të themelojë më 1867 Shoqatën Letrare të Shën Jeronim-it, e cila ka mbështetur mbi 1000 botime kroatish.

Këtë vend të bekuar që gëzon me kohë dhe ndërkohë autori ynë në historinë e letërsisë dhe të kulturës së shkrimit kroat në gjysmën e dytë të shek. XIX na mbetet ende sot e gjithë ditën detyrë me e gjurmuar e qëmtuar nëpër ata shpërgënje të shkelur e të tretur (pa)vetëdijshëm në historinë e kulturës së shkrimit shqip për këtë periudhë. Me këtë rast lejohemi vetëm të ricitojmë konstatimin e mësipërm se është pikërisht ky libër, së bashku me katekizmin e vogël shqip të Guagliata-s, njëri ndër ato dy botime solide që rihapën në shek. XIX, shi më 1845, siparët e kulturës së librit shqip me destinacion arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar. (Demiraj 2015: 24vv.) E për të dyja këto botime na bëhet pas gjase sebeb, pra jo rastësisht, vetëm një emër: autori ynë dora vetë, kur ndodhej atëbotë në Romë, e ku përgatitej për të hapur misionin jezuit në Trebinje. (sh. më lart) Këtë nismë fanmirë e ngjerojmë në modestinë e pendës së vetë Basile-s, pra me dhimbje, bash ashtu siç e kumton ai në fjalën hyrëse të veprës së vet (f. 3-5), të cilën po e riprodhojmë të plotë, si vijon:

**/T’ mirvet kershtënvat Arbnīs.**

O t’ kershtent e mī, dashtnushm n’ Jesu Krishtin!

Nonse une me shoqt e mī jam largue, tash jan dy vjet, prej jush e prej Arbnīs, pro nuk kam harrue njimen as jū, as nevojt tuja. Oh! se mujshni me dit sa kam lut, tuj kjā perpara Jesu Krishtit e Zojes e bēkueme per me lyp shka ju dishironi per t’ mir shpirtnavet tuj e per mā t’ madhen lumnīn [e] Zotit! Por n<sup>n</sup>eri tash Zoti nuk ka fal hirin [e] dishiruem; do me than qi mkate ~tona jan shum e fort~ rana. Adhrojm prā me t’ pervūjt t’ shpirtit, mshehen e t’ pā-sosmen vulnesen e tī; e thona shpesh e me gjith zember: *U bāft vulnesa* [e] *Tinzot!* Por mos tretni shpnesen: lutni, ah! lutni shpesh e me fē. Ka me ardh n<sup>n</sup>e mram koha [e] gzimit; perse Zotyn sakt ka premtue, qi tuj lut gjithmon, xiret shka lypet.

Per me iu ngushlue edhe prej s’ largut, n’ at ças qi kam mri ktu n’ Rom, men<sup>n</sup>ova shpejt me bā me shtampue dotrinën e kershten,

<sup>7</sup> Shkruesi i këtyre radhëve nuk ka pasur rastin dhe fatin të shfletojë ndonjërin ndër këto botime (tashmë të rralla) kroatish të autorit.

aq dishirue prej jush e q' ishte shkrue me shum dashtnī prej shokut tem P. Zefit Ign. Guagliata. Marova at pun, por zembra eme nuk ishte hoshnut mjaft; dishirojshe une pos mpsimit~ kti librit edhe me ju kalxue si me lut Tenzon n' nadje e n' mramje, shka me than tuj pā mesh, si m' u rfy e m' u kungue mir; me nji fjal une dojshe me ju diftue rugen e parrīzit per sebet t' lutunavet. Me hir Tinzot marova edhe ket pun e tash me t' madhe dashtni iu çoj e t' parin e t' dytin librin. O t' kershtent e mī, t' dojte Zotyn, qi une tuj ju pñ per rug t' parrīsit, mujshni ju, si shpnesoj edhe per mue, me mñ aty n' parrīs!

Diftova mjaft dashtnīn qi kam per jū; tash ju perket me pergjegj mue, tuj lut Tenzon per t' mir tem e t' shoqvet e mī. Men<sup>n</sup>oni n<sup>n</sup>e mram qi une jam [...]

Prej Roms,  
N' dit 25 t' Marcs, n' vjet 1845.

Miku juj besnik e i vertet  
P. Vinçenc Basile  
T' Shoqnijet Jesus./

*Siç mësojmë edhe nga paragrafi i dytë i kësaj fjale hyrëse, autori ynë, dikur i dëbuar me dhunë nga Shqipëria, i kumton besimtarit shqiptar, ndër të tjera, rolin e tij vetë në botimin e dy librave të parë shqip në shek. XIX e që kishin për destinacion arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar. Ky areal ishte ngërthyer atëbotë në radiusin e përkujdesjes së ashtuquajturit Protektorat i Kultit (= "Kultusprotektorat"), e që jسته si i tillë nën autoritetin e Derës së Habsburgut si edhe nën ndikimin e fuqishëm të Kurisë së Shenjtë.<sup>8</sup> Parë nga kjo perspektivë e në mungesë të dokumentacionit arkivor, lejohemi të përsiasim gjithashtu se këto dy botime ishin pas gjase pjesë e atij programi formues-arsimor – në zanafillë afatgjatë (!!!) – të misionit të parë jezuit për mbarështimin e grigjës së besimtarëve të krishterë në Shqipëri. Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi, kur autori ynë kumton në këtë paragraf se të dy librat u botuan së bashku për të plotësuar njëri-tjetrin. Dalja në dritë e të dy librave në të njëjtin vit (Romë 1845), sikurse një ribotim i tyre po të njëjtin vit (Romë 1873)<sup>9</sup> e tumirin pa vrasamendje këtë përsiatje, anipse hetimi i kronologjisë së hartimit dhe përmbarimit të njërit apo tjetrit tekst nuk mund të vështrohet assesi si çështje e mbyllur njëherë e mirë. Le të ndalemi pra në*

<sup>8</sup> Shih së fundi për këtë çështje me letërsinë shkencore përkatëse në Demiraj 2012 3vv.

<sup>9</sup> Kërkimet tona lidhur me një ribotim të mëparshëm të kësaj vepre, sikurse në rastin e doktrinës së Guagliata-s (Romë 1856 – bot. i dytë) nuk kanë pasur sukses.

*vijim sado përciptas në këtë çështje, ku do të përqendrohemi kryesisht në historikun e veprës, përshkrimin, përmbajtjen dhe strukturën e organizimit të saj.*

### **Dy fjalë mbi historikun e veprës**

*Kur e hartoi tekstin Basile? Një pyetje kjo e vetvetishme, e nxitur deri diku edhe nga rrethana që Basile – ndryshe nga sivëllai i vet, Guagliata – nuk rezulton të ketë pasur ndonjë dell ase damar gjaku të shprishur arbëresh e si i tillë të kishte pasë njohur e mësuar qysh në fëmëni arbërishten si gjuhë e nënës. Përndryshe moti i misionimit, sikurse edhe koha e shkurtër e angazhimit të tij aktiv në Shkodër mund të shoqërojnë me pikëpyetje ngjërimit e tekstit, nëse është hedhur vërtet në letër prej pendës së tij. Gjithsesi, përderisa nuk kemi ndonjë arsye të fortë e të faktësuar me dokumentacion arkivor, por sidomos të nxitur nga prurjet e tij të pazakonshme në gjuhën kroate, nuk kemi përse të relativizojmë assesi autorësinë e vetë tekstit, duke bërë hasha emrin e P. Vincenzo Basile-s.*

*Në këto rrethana lejohemi të rrudhim problematikën editoriale vetëm në kronologjinë e hartimit, përkatësisht të dorëzimit të tekstit në shtyp. Asgjëmangut, fillimisht mjafton një përjasje e parë, e bërë me librin e Guagliata-s edhe nga kjo perspektivë, duke hedhur kështu në debat kronologjinë e hartimit të tekstit bashkë me procedurën e vetë botimit. Kështu, siç kemi vënë oroe më parë në studimin tonë mbi doktrinën e krishterë të Guagliata-s, viti i botimit të këtij katekizmi: Romë 1845, nuk korrespondon aspak me atë dritë jeshile (= nihil obstat) që dhanë atëbotë e japin zakonisht sot e gjithë ditën cenzorët përkatës këso rasash. Në rastin e Guagliata-s feks p.sh. në fund të tekstit (f. 296) emri i provikarit të përgjithshëm të Dioqezës së Shkodrës, Don Pal Ramadanit dora vetë, i cili hyn dorëzanë për vërtetësinë dhe pastërtinë e tekstit më 10 dhjetor 1842, bash në Shkodërloce.*

*A ishte përfunduar edhe teksti i Basile-s para 10 dhjetorit të këtij viti? Këtë detaj nuk kemi të drejtë ta mëtojmë hëpërhë, përderisa autori ynë firmos fjalën e tij hyrëse: /N' dit 25 t' Marcs, n' vjet 1845/ (f. 5), ndërsa nihil obstat është firmosur pa shënuar vend e datë nga dy emra të latinizuar shqipfolësish: <Marcus Galata / Augustinus Radovani> e që të dy në cilësinë: <Alunni S. C. de Propaganda Fide> (: “Nxënës të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s”, f. 144). Siç na rezulton në shënimet e mbledhura dikur në Arkivin e Kolegjit Urban (Romë, shtator*

2016) kemi të bëjmë këtu me dy seminaristë të mirëfilltë<sup>10</sup> shqiptarë, që ishin thuajse në përfundim të studimeve teologjike në atë kolegji e si të tillë gëzonin pas gjase edhe të drejtën e dorëzimit në gjykimin e një teksti si censorë të institucionit të Propaganda Fide-s.<sup>11</sup> Ky konstatim është hëpërhë i vetmi që lejohemi të fiksojmë me siguri lidhur me historikun e botimit të tekstit,<sup>12</sup> i cili me sa duket ka marrë formë e hedhur shtat pas 10 dhjetorit të vitit 1842, kur katekizmi i Guagliata-s kishte fituar ndërkohë lejen e botimit prej instancës zyrtare përkatëse në Dioqezën e Shkodrës.

Se në ç'masë është njohur, përhapur dhe shfrytëzuar vepra në qëllimin e vet zanafillës në Shqipëri, as kësaj pyetjeje derivate nuk jemi në gjendje sot për sot t'i japim përgjigje bindëse, sa kohë që mungon informacioni dokumentar. Megjithatë shpresojmë të mos jemi shumë larg ndaj së vërtetës, në rast se mëtojmë që edhe kjo vepër, së bashku me doktrinën e Guagliata-s, erdhi e u përdor në funksionin e vet burimor si tekst mësimor menjëherë pas rishfaqjes së etërve jezuitë në Shkodër (1856) dhe hapjes zyrtare të seminarit fetar në vjeshtë të vitit 1859. Këtë përsiatje e nxit gjithsesi edhe fakti që vepra ka përjetuar edhe një ribotim në vitin 1873.

Sigurisht që zhvillimet e përshpejtuara që përjetuan në vazhdimësi (edhe) në Shqipërinë e Veriut, institucionet e kultit e sidomos themelimi dhe aktiviteti i suksesshëm i Kolegjit Saverian (Shkodër më 17 tetor 1877) bënë t'i përcaktohej një tjetër pozicion kësaj vepre në çerekun e fundit të shek. XIX. E me këtë rast lejohemi vetëm të përsërisim të njëjtin vlerësim që kemi kumtuar dikur ndaj prurjeve të Giuseppe Guagliata-s në kulturën e shkrimit shqip të kohës, duke insistuar që "[...]as qesëndisim dhe as lëndojmë pendën dhe autoritetin e autorit tonë, në qoftë se mëtojmë që në hyrje të këtij studimi, që në shumë pamje ky botim mund dhe duhet vështruar

<sup>10</sup> E theksojmë këtë fakt, meqë emërtimi <Alunno S. C. de Propaganda Fide> përdorej atëbotë shpesh edhe si ofiq ndër barinj të shpirtërorë shqiptarë, të cilët kishin studiuar dikur në Itali në kolegjet që ndodheshin në varësi të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s.

<sup>11</sup> Archivio del Collegio Urbano, Sec. VI, Dosja 1/3, fol. 27-35. Emrat e censorëve tanë janë regjistruar në fol. 34 me këto të dhëna personale: Nr. 83 Galata, Marcus (= shq. *Mark Gallata*): Dioq. e Lezhës; riti latin; lindur më. 15 maj 1810; regjistrimi në kolegji më 17 mars 1836; betimi më 2 shkurt 1841, largimi nga kolegji më 8 qershor 1846 si misionar në atdhe; dhe Nr. 91 Radovani, Augustinus (shq. *Agustin Radovani*): Dioqeza e Shkodrës, riti latin; lindur më. 15 shkurt 1819; regjistrimi në kolegji më 9 shkurt 1836; betimi më 2 shkurt 1841, largimi nga kolegji më 22 prill 1847 si misionar në atdhe.

<sup>12</sup> Që teksti është përfunduar, përkatësisht përgatitur për shtyp si i tillë, këtë përfundim e nxjerrim tërthorazi nga një përllogaritje e thjeshtë e të dhënave kohore që jep vetë autori në tekst, kur përshkruan kultin e Zojës së Shkodrës. Shih shën. 16.

tashmë i kapërcyer në funksionin e vet zanafillës si një libër mësimi [...]” (Demiraj 2015 25), ndërkohë që vendi i tij në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip ndodhet ende në shpërgënjtë e huluntimit.

Dhe është fakt që në studimet e derisotme të natyrës bibliografike vepra dhe (shumë më rrallë) autori i saj citohen ashtu kalimthi me do të dhëna që në shumësinë e rasteve vetëm sa përsëriten të njëri ose tjetri studiues. Kështu p.sh. ndeshim vetëm titullin e kësaj vepre, pra pa emër autori, së pari te Vincenzo Dorsa (1847 132) e më pas edhe te Gustav Meyer (EWA 521) e si të tillë me radhë edhe te Manek-Pekmezi-Stotz (1909 27), Rrota (1935 9 v.), ndërkohë që vetëm Camarda (1866 19), ndonëse nuk citon emrin e autorit, është i vetmi që i përcjell lexuesit të kohës dy pasazhe teksti nga botimi i parë (Romë 1845): 1. kulti i Zonjës së Shkodrës (f. 52), dhe 2. ndodhitë në qytetin e <Surite> (f. 59). Shuteriqi (1976 245) plotëson i fundit rrethin e historianëve të derisotëm në kulturën e shkrimit shqip, duke theksuar se ka kaluar nëpër duar vetëm një ksombël të ribotimit të veprës (Romë 1873).

#### **Përshkrimi, përmbajtja dhe struktura e tekstit**

Të dyja botimet janë në të njëjtin format (me tekst: 6,5 x 11 cm) dhe variojnë prej njëri-tjetrit vetëm sa i përket numrit të faqeve (1845 144 f. vs. 1873: 118 f.). Ky variacion nuk ka të bëjë aspak me tekstin, i cili riprodhohet si i tillë i plotë e me të njëjtin kod alfabetik edhe në botimin e dytë,<sup>13</sup> por thjesht me tipin pas gjase më modern të shkronjave të shtypit, sikurse edhe me mënjanimin e ilustrimeve që shoqërojnë tekstin në botimin e parë.<sup>14</sup> Të dyja botimet i bashkon me njëri-tjetrin edhe një mungesë, që rezulton të jetë krejt e pafavorshme për do njohës të përciptë të letërsisë ekleziastike. I tillë është edhe shkruesi i këtyre radhëve, i cili e ka të vështirë të bëjë një përshkrim në detaj të përmbajtjes së tekstit, meqë libri nuk është parashikuar të ketë një pasqyrë të lëndës me/ose një indeks përkatës të çështjeve të ndryshme të ngërthyera në të.

I vetmi kumt informativ, i cili mëton deri diku saktësi në përshkrimin e veprës është paragrafi i dytë në fjalën hyrëse të autorit, ku, siç vumë oroe më lart, ai ngulmon se: /dishirojshe une pos mpsimit~ kti librit [= Doktrinës së Guagliata-s – B.D.] edhe me ju kalxue si me lut Tenzon n’ nadjë e n’ mramje, shka me than tuj pā mesh, si m’ u rfyë e m’ u

<sup>13</sup> Një përjasje sado e përciptë e dy botimeve me njëri-tjetrin të lejon të fiksosh shtimin e numrit të gabimeve ortografike në botimin e dytë, të përfuara këto pa dyshim prej radhitësit në shtypshkronjë.

<sup>14</sup> Këto sidomos në ilustrimet e parashikuara në kreun e fundit “Udha Kryqs” (1845 129 vv.) që pasqyrojnë stacionet e pasioneve të Krishtit.



kungue mir; me një fjalë une dojshe me ju dftue rugen e parrizit per sebet t' lutunavet./ Kemi të bëjmë pra në thelb më një libër mësimi shoqëruar së Doktrinës së Krishterë e që lidhet drejtpërdrejt me praktikën e jetës së përditshme të besimtarit, bash ashtu siç e kërkojnë rregullat që mbarështon institucioni i kultit të Kishës Katolike-Romake. Në to vend qendror zënë sidomos lutjet dhe radha e tyre përgjatë ditës, mënyra e pjesëmarrjes aktive në celebrimin e meshës, sikurse sjellja gjatë dhurimit të sakramenteve të Kungimit e të Rrëfimit, pra gjithçka që e orienton besimtarin në rrugën e amshuar drejt Parajsës.

Prashtu, siç edhe pritet, libri hapet me kreun e mëvëllimshëm /T' Lutuna/ (f. 6-56), që fillon: A) me lutjet që duan thënë në mëngjes, ku përpos sjelljes ndaj virtyeteve teologjike, si: *Feja, Shpresa, të Dashurit, Pendesa, Premtimi, Falënderimi*; kemi edhe lutjet ndaj *Zonjës së Shenjtë dhe Engjëllit të Tinëzot* (f. 6-19); në vazhdim: B) lutje që duan thënë në mbrëmje, si p.sh. *Rruzarja* bash sipas radhës së përcaktuar gjatë ditëve të ndryshme të javës, ku janë fiksuar edhe radha dhe numri i lutjeve themelore: *Ati Ynë, Falemi Mri* si edhe *Lumni Atit* (f. 20-34); e më tej: C) lutje që duan thënë para se të shkohet në shtrat (f. 35-40). Në këtë kuadër rroken edhe lutjet që ndërliken në vështrim retrospektiv me veprimet e kryera ndërkohë në jetën e përditshme: /Kujtimi t' mramevet tona/ (f. 40-56); e që ndjekin një radhë të caktuar ditët e javës, ndër to *Shëlbimi i Shpirtit* për ditë të diel, *Mëkati mortar* për ditë të hënë, *Morti* – të martën, *Gjyqi i fundit* – të mërkurën, *Ferri* – të enjten, *Parajsa* – të premtën, ndërsa si përkujtim për të shtunën autori përzgjedh bash *Zonjën e Shkodrës*, përkatësisht kultin e saj, ashtu siç nderohet e lutej atëbotë ndër të krishterët e qytetit.

Kreu i dytë /Shëjtia Mesh/ (f. 56-81) i përkujton besimtarit si me marrë pjesë në mënyrë aktive gjatë celebrimit të meshës, përkatësisht radhën e lutjeve përkatëse gjatë gjithë meshës, ndërsa kreu pasues /Mnyr m' e shëjtnue punt e soçme/ (f. 81-124) përshkruan në nënkrerë e rubrika të veçanta hollësi mbi gjithë atë procedurë që duhet të mbajë parasysh besimtari para, gjatë dhe pas dhurimit të sakramenteve të Rrëfimit dhe të Kungimit (/Eukaristisë).

Librin e ndjekin së fundi dy krerë të shkurtër që u kushtohen: D) falënderimit ndaj Zotit që i mundëson besimtarit të përjetojë dhe gëzojë jetën e krishterë si dhuratë hyjnore: /Kunora n' n'ner/ (: *Kurora në nder*, f. 124-128) dhe E) /Udha Kryqes/ (: *Udha e Kryqit*, f. 129-143) ku përshkruhen thukët stacionet e fundit jetës së Jesu Krishtit, duke filluar prej gjykimit kapital ndaj tij e deri në prehjen e përkohshme të korpit të tij në varr. Libri përfundon me fjalën përmbyllëse: /Një fjalë knuosit/ (: *Një fjalë lexuesit*, f.

144), ku përpos kujtesës mbi thënien e do lutjeve shtesë, autori i lejon vetes kërkuesin e vet legjitime ndaj lexuesit: /Mos harro n<sup>e</sup> mram me than një *Falemi Mrī* për shpirt atij qi t' ka shkruar ket libr./

Siç cekëm shkurt më lart vepra mbyllet në po këtë faqe (f. 144) me shënimin *nihil obstat* të censorëve, të sigluar prej Mark Gallatës dhe Agustin Radovanit; si edhe me lejën e shtypit (: *Imprimatur*), të sigluar prej Fr. Dominicus Buttaoni dhe Joseph Canali. Janë këto të dhëna sikurse edhe fjala hyrëse e autorit që i japin vetë tekstit formën e duhur të një pune ndërkohë të përfunduar e të dorëzuar si të tillë për botim.

***Veçori të kodit, të normës ortografike dhe të gjuhës së autorit në tekst***

*Duke e orientuar lexuesin që në fillim në ato vëzhgime të bëra dikur në detaj lidhur me tekstin e katekizmit të sivëllait të vet, Giuseppe Guagliata-s, kursejmë njëherësh përsëritje të tepërta, meqë: “[...] përditësimi me shkrimet shqipe bash në këtë periudhë (Basile 1845; Radoja 1862; 1876), në të cilat mungojnë tërësisht vëzhgimet hyrëse të kësaj natyre, na lejojnë të mëtojmë, qoftë edhe *ad hoc*, emrin e Guagliata-s, si dorëzanësin më të parë të atij kodi alfabetik dhe norme ortografike, që dëshmojnë thujse përgjithësisht botimet, qofshin këto edhe ekleziastike, në gjysmën e dytë të shek. XIX në Shqipërinë e Veriut. Afria dhe ndryshimet e këtij kodi dhe të kësaj norme me simotrat e veta në shekujt e pararendës duan kuptuar në këtë mënyrë për arealin në fjalë thjesht dhe natyrshëm si vijim i traditës, përkatësisht si risi të shek. XIX në kulturën e shkrimit shqip.” (Demiraj 2015 37)*

Në këtë hulli ecën pra i dyti i radhës, që vjen me thënë autori ynë, në veprën e të cilit përjetojmë të njëjtin kod alfabetik e në thelb të njëjtën paketë rregullash të natyrës ortografike, që shfaqen së bashku qoftë si vijim i traditës së shkrimit shqip në këtë areal kulturor, ashtu edhe si risi të ndërmarra vetëdijshëm:

- a) në kod, si p.sh.: normalizimi i theksit të rëndë për të nxjerrë në pah rrokjen nën theks së bashku me përdorimin e theksit majërrethor si mjet grafik për shënjimin e hundorësisë e sipas rastit edhe të gjatësisë së zanoreve (khs.: <Te Stampùemin t Scëitit Cuvèn> f. 1); përkatësisht i vizës së gjatë mbi zanore (krahas dyfishimit të zanores) për të shënuar gjatësinë e saj (khs.: <iū> pranë <iuu> “ju”); dhe
- b) në normë, duke iu përshtatur plotësisht ligjërimin të përditshëm në të folmen e (bashkësisë katolike të) Shkodrës, si p.sh. asimilimi thujse i plotë grupeve /nd/, /mb/ në /n<sup>n</sup>/, /m<sup>m</sup>/ (: <nn>, <mm>), që sipas Guagliata-s: “dikush bën të dëgjohet pas së parës një tingull i lehtë si *d*” dhe *mm* “që bën të dëgjohet pas së parës një tingull si *b*.” (Demiraj 2015 39) e sidomos rrëgjimin e plotë të zanores qendrore të patheksuar

/ə/, përkatësisht kalimin e saj në fushën fonetike të zanores së mesme të përparme /e/. (Demiraj 2015 *op. cit.* 39vv.)

Në tekst vërejmë gjithsesi anomali të shpeshta në pasqyrimin grafik të bashkëtingëlloreve /q/, /gj/ pranë /k/, /g/ (sidomos në bashkëlidhje me /j/ para një zanoreje), meqë autori ynë përdor pa shpërndarje alografike sekuencën grafike <ch(i)> pranë <k(i)> dhe sidomos <gh(i)> çka lejon leximin e dyfishtë të strukturave fonetike përkatëse, si p.sh.: <chi> = /qi/, <chiorvet> = /qorvet/, <chioft> pranë <kioft> = /kioft/, <chiain> pranë <kiain> = /kajin/ dhe <k i v s c > = /qysh/, <kieif> = /qeif/ (: shq. let. *që, qorrave, qoftë, qajnë, qysh, qeif*), sikurse: <ghiç> = /gjith/, <g h i v g h i > = /gjygi/, <perghiegh> = /pergjegj/ pranë <rugh> = /rug/ (: shq. let. *gjithë, gjegji, përgjigj, rrugë*).

Një pjesë të këtyre anomalive në lexim e shton padyshim edhe perceptimi deri diku i vështirë i dikotomisë së tingujve vibrantë dhe lëngëtorë shqipes (: /r/ vs. /rr/ dhe /l/ vs. /ll/) në ndërgjegjen gjuhësore të autorit tonë që nuk është folës natyror i shqipes, çka ka ndikuar rregullisht edhe në shmangiet grafike në tekst, khs.: <populit> = /populit/, <perziel> = /percjel/, <s c t v l > = /shtyl/, <chilue> = /qilue/ pranë <chieλ> = /qiell/, <i zilī> = /i cilli/ etj. (: shq. let. *popullit, sjell, shtyllë, qëlloj, qiell, i cili*), sikurse <rugh> = /rug/ kundrejt <parrîsi> = /parrîzi/, <ferri> = /ferri/ etj. (: shq. let. *rrugë, parajsë, ferri*).

Mbështetja në ligjërimin e përditshëm të së folmes së Shkodrës (pas gjase me bazë dialektore të përzier) ka ndikuar në paraqitjen në tekst të varianteve të ndryshme dialektore. I tillë është p.sh. pasqyrimi konsekuent në fjalë dhe fjalëforma që përmbajnë togzanorin zanafillës \*/uo/, i cili sipas mundësive dhe rastit, por gjithnjë me rregullsi marramendëse, konkurren variantin dyzanor /ue/ pranë atij të asimiluar plotësisht në /u/. Kështu p.sh. edhe në tekstin që ndjek paragrafin në vazhdim, vërejmë se si në pozicion tejet fundor ndeshim rregullisht variantin /ue/, khs.: <mennue> = /men<sup>n</sup>ue/, <cuitue> = /kujtue/, <chilue> = /qilue/, <nneerue> = /n<sup>n</sup>ēruē/, <mcatnue> = /mkatnue/, <chindrue> = /qindrue/; ndërsa në trup të fjalës në rrokje të hapur apo të mbyllur ndeshim sipas rastit edhe variantin arkaik /uo/, por edhe /u/, khs. më /ue/: <εoja e beecueme> = /zoja e bēkueme/, <kan sckuem> = /kan shkuem/, <kan pusciuem> = /kan pushuem/ kundrejt togut /uo/: <kisc tasc e rennuome> = /kish tash e renuome/, <figuren e mreculuoscme> = /figuren e mrekuuoshme/, <duor> = /duor/ (: shq. let. *duar*), <i malcuom mcati> = /i malkuom mkati/, e më tej gjegjësin e asimiluar në /u/ ~ /ū/: <scēitnushmes Mrii Virghin> = /shejtnushmes Mri Virgjin/, <nanen e dasctnūscme> = /nanen e dashtnushme/, <t' scūmt iu> = /t' shūmt ju/ (= shq. let. *të shuarit ju!*) etj.

Shtëmangie të kësaj natyre ia rrisin edhe më shumë rëndësinë tekstit, duke e bërë atë objekt hulumtimi të mirëfilltë në studime të natyrës dialektologjike historike, përkatësisht të përshkrimit të së folmes së Shkodrës si qendra kryesore urbane në Veri të hapësirës kompakte shqipfolëse në gjysmën e shek. XIX, nga ku mund të nxirren përfundime me vlerë edhe sa i përket atij qerthulli problematik të kulturës së shkrimit shqip, me të cilin u përballën këtë periudhë autorët e këtij areali.

***Epilog: Zoja e Shkodrës në pendën e Basile-s***

Sigurisht që do të ishim të paplotë, sikur të linim pa përmendur, të paktën në mbyllje të punimit tonë atë vlerë unike që bart dhe përcjell penda e Basile-s me /Rugen e [tij t'] Parrizit/ në trashëgiminë e vyer të arealit kulturor të Veriut, më saktë në përkatësinë e tij të patjetërsueshme në historinë e kulturës shqiptare e evropiane në përgjithësi. Kështu nuk bëjmë aspak çudi përse autori ynë (1845 52-56 vs. 1873 44-47) ia kujton dhe bën të qartë grigjës së lexuesve se kjo rrugë nuk i anashkalon, përkundrazi parakupton mirëfilli mirënjohjen dhe mbarështimin shpirtëror të kultit të Zojës së Shkodrës, andaj do medituar gjithherë me devocion për të, të paktën një herë në javë, bash ditëve të shtuna, si vijon:

**/Men<sup>n</sup>im per t' shtunen**

***Zoja e Shkodres***

N' Arbnī āsht devocion fort e madhe per Zojen e Shkodres; sa āsht bukur prā n' ket dit, konsakruem laudit e n<sup>n</sup>ērīt~ shējtnushmes Mrī Virgjin me men<sup>n</sup>ue t' dalunit zot asaj? Sa āsht mir, tuj njoft perse Zoja [e] bēkueme iku prej Shkodres me kujtue mnyren me e bā me ardh prap n<sup>n</sup>opak n' zembrat tona? Kalxojm prā m[ā] para si ka qilue t' ikunit Zojes e Shkodres e masan<sup>n</sup>ej men<sup>n</sup>ojm me dobī t' shpirtit si me e sbut per me pas mishirier.

Njat Shkodres āsht nji kish tash e renuome, ne t'cillen ishte n<sup>n</sup>ērue nji figure e buker shējtnushmes Mrī. Por masi forti i fōrt Shkanderbek diq, Shkodra rā n<sup>n</sup>er duor turqvet e kie vum n<sup>n</sup>en haraç. At'her bāni vakī e tash kan shkuem treqin e shtatdhet e tet vjet qi Zoja e bēkueme tuj ik prej asaj kish, shkoi afer Roms ne nji t' vocerr katun qi thohet *Genazzano*; atje kie, edhe āsht n<sup>n</sup>ērue prej gjith popullit, perse ka bām e bān deri sot shum mrekuļī. T' lumt ato dy konaqe Gjergjit e [De] Sclavis, qi paska nafake me perciel figuren e mrekuļuoshme Zojes e bēkueme, prūm prej nji shtyl zjermit naten e prej nji shtyl erējet diten? Por t' shūmt ju, o t'

kershtent e mī, qi m<sup>m</sup>etni pā nanen e dashtnushme! ... E pse o nana e dashtnushmeja, pse braktise jetimat e tū, pā n<sup>n</sup>im kundra anmiqvet, pse s' kē sevap per birt tuj, qi kjajn, qi gjimojn t[a]sh gadi per kater shekull pā ty? *Ah, m' duket, qi Zoja bēkueme m' pergjegj; ah! une ika prej Shkodres per mkatet; e s' jam njit alā, perse s' kan pushuem alā mkatet; t' pushojn mkatet e une kam per me njit prap!*

1. Prā aq i madh t' keq āsht i malkuom mkatit, qi bān me ik prej nēsh jo veç gjygtārīn e n<sup>n</sup>ērshīm, do me than Tenzon, por edhe pajtoren e sevapshme Zojen e bēkueme. Oh mkat i malkuom per gjithmon! Une t' braktisi, une t' largoj prej mejet per gjithmon!
2. Ah!, tash di fort mir, qi mā e verteta, e mā e mira divocion n<sup>n</sup>er Zojen e bēkueme āsht me lān mkatit, me kput sixhirt e djallit, m' u largue edhe prej sebetesh. Se Zoja e bēkueme nuk āsht n' Shkoder, por munet me nkthye n' zembrat atynet qi jan pā mkat, o n<sup>n</sup>opak qi jan gadi me l[ā]n mkatit, qi jan gadi me mos mkatnue mā kurr. Ah, i mjeri une se nryshej due me qindrue n' mkat!
3. Jo, jo o Zoja [e] bekueme ma kurr me qindrue n' mkat! Po t' lus me fialt e shējtes kish.  
Sgjidh, o Zoja, sgjidh sixhirt mkatnorvet; na jep driten qorvet; largo prej nesh t'kqiat e mkatit; na jep t' mirat e parrīzit. Diftou qe ti jēsh nana; t' begenis per ty t' lutunat kush per nē lēm duroi me ken yti. O Virgjina pā mkat, n<sup>n</sup>er t' gjith e bāt na bān t' but e t' dlirt e na sgjidh prej mkatesh; na jep jeten e dlir, na difto t' verteten udhen e parrīzit, abola tuj pā Jesu Krishtin birin tan, gazmohena per gjith<sup>~</sup> mon e jets. Amen, ashtu kioft./

Do njohēs sado të pērciptē të fushēs dhe sosh të letrave shqip nuk do ta kenē aspak të vēshtirē ta cilēsojnē këtë paragraf si dēshminē deri sot më të hershme në hapēsirēn kompakte shqipfolēse që na kumton shqip mitin historik të 'Fugurēs së Zojēs së Shkodrēs' me rrugētimin e saj hyjnor drejt Genazzano-s (Itali), ku iu shfaq popullit më 25 prill 1467, sikurse gjithçka shqiptare që bashkēlidhet me të, ndër të tjera: a) fiksimin e këtij miti në kujtesēn historike-intelektuale e, pse jo (!), edhe të bashkēsīsē katolike

shqiptare të kohës,<sup>15</sup> përkatësisht b) ndërthurjen e tij të natyrshme me ngjarjet historike të kohës, si p.sh.: vdekja e Skënderbeut, pushtimi osman i vendit, eksodi tragjik i shqiptarëve drejt Perëndimit etj.;<sup>16</sup> dhe sidomos c) atë detyrim shpirtëror të bashkësisë katolike shqiptare në shek. XIX për të vazhduar me përkujdesur e mbarështuar me devocion kultin e ‘Zojës së Shkodrës’, të cilën bota e krishterë e mirënjeh dhe nderon sot e gjithë ditën në emrat e dhjetëra e qindra kishave e kapeleve, sikurse në mijëra e mijëra riprodhime, veçse ashtu thjesht e ‘ripagëzuar’, si: shq. *Zoja e Këshillit të Mirë*, (it.) *Madona del Buon Consiglio*, angl. *Mother of Good Council*, gjerm. *Mutter vom Guten Rat*, sp. *Madre del Buen Consejo*, port. *Mãe do Bom Conselho* etj., etj. etj.

Parë nga kjo perspektivë ‘Fugura e Zojës së Shkodrës’ është një thesar i vyer dhe i patjetërsueshëm në trashëgiminë e kulturës shpirtërore shqiptare që e bashkëlidh atë natyrshëm me vlerat e patundshme të trashëgimisë kulturore-kristiane të Perëndimit, pra më se i krahasueshëm me vendin e heroit kombëtar shqiptar në historinë e Shqipërisë dhe persepsionin e tij në kujtesën historike-intelektuale të Perëndimit. Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që në fund të shek. XIX, në Koncilin e Tretë të Arbënit (Shkodër, maj 1895) – bash kur Lëvizja e Rilindjes Kombëtare Shqiptare kishte ngjitur ndërkohë një pikë kulmore (!!!) – ‘Zoja e Shkodrës’ shpallet si *Pajtorja e Shqipërisë*.<sup>17</sup>

Ndodhitë e mëpasme historike-kulturore në Shqipëri, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XX, rrodhën ashtu si rrodhën, thënë më saktë ashtu siç nuk duhej të rridhnin: ‘Zojës së Shkodrës’ si *Pajtorja e Shqipërisë* sistemi në fuqi i preu aortën kryesore të parës, sikurse gjithë institucioneve të kultit në vend, ndërkohë që me dhunën e vet strukturore informale e orientoi politikën e formimit intelektual drejt njëanshmërisë largvajtëse, sidomos sa i përket mbarështimit të kujtesës historike-intelektuale në vend. Është pikërisht kjo kujtesë që vuan thujtë të njëjtën situatë – mos edhe më keq (!) – në kohën tonë, pra edhe pas 25 vjetësh (1991-2016) *tranzicioni*

<sup>15</sup> Për pronësinë e këtij miti historik në bashkësinë katolike shqiptare dëshmon pas gjase ‘pozitivisht’ asociacioni kausal – si transformim ‘faktikisht i pavërtetë’ – në mendësinë e mëvonshme popullore, i bashkëlidhur me vdekjen e Skënderbeut (Lezhë: 17.01.1468), e cila nuk i priu aspak në kohë fluturimit hyjnor të ‘Fugurës së Zojës’ (Genazzano: 25.04.1467), sikurse edhe me dorëzimin e qytetit/kalasë së Shkodrës trupave osmane, që ndodhi vite më pas (25.04.1479).

<sup>16</sup> Duke u orientuar në këtë mot bashkë me ndërhyrjen e autorit se, /tash kan shkuem treqin e shtatdhjet e tet vjet qi Zoja e bëkueme tuj ik prej asaj kish/, jemi në gjendje të përlllogarisim edhe vitin 1845, si vit i hartimit, përkatësisht i redaktimit përfundimtar të tekstit prej pendës së autorit. Shih shën. 12.

<sup>17</sup> Hollësisht Kamsi 1997.

*kulturor*, kur në bordet drejtuese dhe redaksitë përgjegjëse të veprave enciklopedike me rëndësi kombëtare gjëllinë ende pjella hibride të atij orientimi intelektual-ideologjik dështak. Andaj nuk kemi përse bëjmë sot aspak çudi që ‘Zoja e Shkodrës’ dhe ‘Fugura’ e saj nuk figurojnë si zëra të veçantë sado minorë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, qoftë në botimin e parë (Tiranë 1985), por sidomos në ribotimin e tij në tri vëllime (Tiranë 2008/9); një zë i veçantë për autorin tonë, Padre Vincenzo Basile-n, jo se jo.

#### BIBLIOGRAFI

- Annali siculi: Annali siculi della Compania di Jesu. Compilati dal P. Alessio Narbone d.O.d.G. dall’ anno 1805 al 1859. Pubblicati e continuati sino a giorni ostri dal P. Gaetano Filiti D.M.C.; vol. IV: Deca quarta - II<sup>o</sup> Quinquennio. 1840-1844. Palermo 1908.
- Archivio del Collegio Urbano: Sec. VI, Dosja 1/3.
- Basile, Vincenz
  - ✓ 1845: Ruga e Parrisit, calzuem kersctënvet Arbnis, prei P. Vincènzit Basile t’Sciochniet Jesus, N’Rom te Stampuemin t’ Scèitit Cuvèn de Propaganda Fide.
  - ✓ 1873: Ruga e Parrisit, calzuem kersctënvet Arbnis, prei P. Vincènzit Basile t’Sciochniet Jesus, N’Rom te Stampuemin t’ Scèitit Cuvèn de Propaganda Fide. (botim i dytë)
- *Camarda, Demetrio*
  - ✓ 1866: Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese per Demetrio Camarda, Prato.
- *Demiraj, Bardhyl*
  - ✓ 2012: Shkodra - një qendër albanologjike në prag të pavarësisë, në: “Hylli i Dritës” 4 [2012] 3-15, Shkodër.
  - ✓ 2015: “*Dotrina e Kershten*” (1845) e P. Zef Guagliata-s dhe vendi i saj në kulturën e shkrimit shqip, në: “Buletin shkencor” (Seria e shkencave shoqërore), Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Nr. 65 [2015] 24-45. Shkodër.
  - ✓ 2016: Damnatio memoriae vs. laudatio funebris – dy shfaqje të ‘tranzicionit’ intelektual në Enciklopedinë Shqiptare, në: “Milosao” – Supplement i “Gazeta shqiptare” nr. 239 (26.06.2016), f. 1-5; dhe nr. 240 (03.07.2016), f. 2-5
- Dorsa, Vincenzo
  - ✓ 1847: Su gli albanesi. Recherche e pensieri. Napoli.
- *FESH*
  - ✓ 1985: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar, ASHRPSSH, Tiranë.*
  - ✓ 2008/9: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar (ribotim – red. përgjegjës Emil Lafe) bl. I-III, ASHSH, Tiranë. (ribotim)*
- Kamsi, Willy
  - ✓ 1997: Shëjtnorja e Zojës së Shkodrës. Shenime historike, Përpunue nga Willy Kamsi. Shkodër.

- Korade, Mijo SJ
  - ✓ 1982: Misionar i kulturni radnik isusovac Vinko Basile (1811. – 1882.), në: “Vrela i prinosi”, Fasc. nr. 13 [1982] 106-155. Zagreb.
- Manek, F. – Pekmezi, G. – Stotz, A.
  - ✓ 1909: *Albanesische Bibliographie, Wien.*
- Meyer, Gustav
  - ✓ 1891: *Etymologisches Wörterbuch des Albanesischen. Straßburg.*
- Murzaku, Ines A.
  - ✓ 2006: Catholicism, Culture, Conversion: The History of the Jesuits in Albania (1841-1946), në serinë: “Orientalia Christiana Analecta” nr. 277, Roma.
- Peters, Markus W. E.
  - ✓ 2007: Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur. Die “Buchdruckerei der Unbeflecten Empfängnis” zu Shkodra (1870-1945), Hamburg. (përkthyer shqip: Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën. Tipografia e Zojës së Papërlyeme në Shkodër (1870-1945), Tiranë 2016.
- Rrota, Justin
  - ✓ 1935: *Për historinë e alfabetit shqyp. Shkodër.*
- Shuteriqi, Dhimitër
  - ✓ 1976: *Shkrimet Shqipe në vitet 1332-1850. Tiranë 1976.*

### SUMMARY

This paper is dedicated to a little known or unknown personality in the history of Albanian culture and writing, Vincezo Basile SJ, who led the first mission of the Jesuit Order in Albania (Shkodër, 1841-1843). The paper is mainly focused on his social engagement as the founder of the first Ground School for children belonging to the Catholic faith in this city, on his activities as writer of a prayers' book in Albanian to meet the religion education needs for the Catholic believers. This prayers' book, published twice (in 1845, 1873), together with the catechism book by his fellow believer Giuseppe Guagliata SJ (1845, 1856, 1873) are considered the first Albanian books in the Northern Cultural Area in the 19th century. The second part of the paper deals with the presentation of the book, the author's language characteristics, concluding with the great cognitive values of the text as regards to the cultural-religious reality in Shkodra in the middle of the 19th century, when the Catholics of Shkodra commemorated with special dedication the *Lady of Shkodra* as the patron of the city and the whole Albania.



## Faksimile nga vepra: Zoja e Shkodrës (f. 52-56)

— 52 —

durgnâ , e me gjuhë Eotin per  
ghiçç mon e iets n' parris . . . !

VII. MENNÏM PER T' SCTUNEN.

*Ëoia e Sckodres.*

N' Arbnii âsct devoziòn fort  
e maçe per Eoien e Sckodres ; sa  
âsct bucur praa n' ket dit consa-  
crùem làudit e nèerit scèitnusc-  
mes Mrii Virghin me mennùe  
t'dalùnin-cot assai ? Sa âsct mir,  
tui gnoft persè Eoia beecùeme  
icu prei Sckodres , me cuitùe  
mnsren me e bâ me arç prap  
anopàk n' cembrat tona ? Cal-  
zòim praa ma para si ka chilùe  
t'icunit Eoies e Sckodres , e ma-  
sannèi mennòim mme dohii t'  
scpirtit si me e sbutt per me  
pas miscirier.

Gnat Sckòdres âsct gni kisc  
tasc e rennuòme , nne t'zi.èn iscte

— 53 —

nneerùe gni figùre e bùker scèit-  
nuscmes Mrii. Por masi for-  
ti i fòrt Sckanderbèk dich, Scko-  
dra raa nner duor turchvet e kiè  
vùm nnen haracc. At her bânì  
vakii , e tasc kan sckuem tre  
chin e sctat çèt e tèt vièt chi  
Eoia e beecùeme tui ik prei as-  
sai kisc , sckoi afer Roms nne  
gni t' vozzer catùn chi ççohet  
*Genazzano* : atiè kiè , eçè âsct  
nneerùe prei ghiçç pòpùlit, persè  
ka bâm , e bân derl sot scium  
mrecalii. T' lumt atò ds Co-  
nâchie Ghièrghit e Sclavis , chi  
pas kan nafake me perzièl figù-  
ren e mreculòscme Eoies e be-  
ecùeme , prùm prei gni sctùl  
sièrmit naten , e prei gni sctùl  
eréiet diten ! Por t' sciùmt iu ,  
o t' kersctènt e mii , chi mme-  
tni pà nanen e dasctnùscme ! ...  
E pse o nana dasctnùscmeia, psé  
braktise ietimat e tuu, pà nnjra

— 54 —

cundra anmichvet, psè s' kee sevàp per birt tui, chi chiain, chi ghimòin tasc gadi per catter scecul pà tɜ? Ah! m' duket, chi Eoia beecùeme m'perghiègh; ah! une ica prei Skodres per mcatet; e s' iam gnit allàa, persè s'kan puscüem allàa mcatet; t' puscüoin mcatet e une kam per me gnit prap!

1. Praa ach i maz t' kech àsct i malcùom mcati, chi bân me ik prei neesc jo vec ghisghtàarin e nneerscm, do me ɜɜan Tensòn, por ezè paitòren e sevàpscme Eoien e beecùeme. Oh mcat i malcùom per ghiɜɜ mon! Une t' bractisi, une t' largòi prei meiet per ghiɜɜ mòn!

2. Ah! tasc di fort mir, chi mà e verteta, e mà e mira divozion nner Eoien e beecùeme àsct me làn mcatin, me kput sigirt e dialit, m' u largùe ezè

— 55 —

prei sebetesc. Se Eoia e beecùeme nuk àsct n' Skoder, por munet me nkɜɜde n' sembrat atànvèt chi ian pà mcat, o nno-pàk chi ian gadi me lan mcatin, chi ian gadi mos me mcatnùe mà curr. Ah i mieri une se nràscei due me chindrùe n' mcat!

3. Jo, jo o Eoia beecùeme ma curr me chindrùe n' mcat! Po t' lus mme fialt e scéites kisc.

« Sghiɜ, o Eoia, sghiɜ sigirt » mcatnòrvet; na iep driten » chiorvet; largò prei neesc t' » kchiat e mcatit; na jep t' mi- » rat e parrisit. Distòu che ti » ieesc nana; t' beghenis per tɜ » t' lùtunat cusc per nee leem » duròi me ken sti. O Virghina » pà mcat, nner t' ghiɜɜ e büt » na bân t' but e t' dlirt e na » sghiɜ prei mcatesc: na iep ie- » ten e dlir, na distò t' vertè- » ten uɜen e parrisit, abolà tui

— 56 —

» paa Jesu Cristin birin tan,  
» gae mòhena per ghiɜɜ mon e  
» iets. Amen, ascù kioft.

**Artan HAXHI, Tefë TOPALLI**

## **TERMINOLOGJIA SI SISTEM**

*Gjuhët speciale* (të njohura ndryshe edhe si “*ligjërim special*”, “*mikrogjuhë*”, “*nënkod*” apo “*gjuhë sektoriale*”) janë një varietet diafazik i gjuhës, që përdoret nga specialistët e një fushe të caktuar për të plotësuar nevojat e komunikimit dhe të kuptuarit të saktë në nivelin e specialistit apo të rrethit të personave që marrin pjesë në një veprimtari të dhënë. Ato janë tërësia e mjeteve leksikore, morfologjike, frazeologjike dhe sintaksore, që përshatën në mënyrë konvencionale dhe konsensuale nga këta individë. Shërbejnë për ta bërë më të qartë, më të shpejtë, më të saktë dhe më efektiv komunikimin midis anëtarëve të një grupi të caktuar shoqëror, duke realizuar një komunikim më special, më të qartë dhe të privuar nga dykuptimshmëria që shpesh karakterizon të folurin e zakonshëm, lidhur me argumente që i përkasin një fushe të caktuar. *Gjuhë speciale* janë të folmet profesionale, gjuhët e disiplinave të ndryshme akademike, shkencore dhe teknike, si dhe të gjitha gjuhët e komuniteteve që ndajnë ndonjë dije apo ndonjë aktivitet të veçantë.

Një nga karakteristikat e tyre është të zotëruarit e një leksiku “*të pastër*” dhe aq të veçantë, i cili është specifik për fushën e argumenteve ose të aktivitetit të cilit i referohen. Ai është i panjohur dhe shpesh i vështirë për t’u kuptuar nga individët që nuk i përkasin atij lëmi studimor. Fjalët e këtij leksiku quhen *teknicizma* ose *terma teknike* (ose edhe vetëm *terma*). Me studimin e tyre merret një degë e veçantë e gjuhësisë së aplikuar, terminologjia, e cila është një disiplinë formale, që studion në mënyrë sistematike konceptet dhe emërtimet e tyre (domethënë termat), të përdorura në gjuhë të specializuara të një shkence, të një fushe teknike, të një veprimtarie profesionale apo të një grupi shoqëror. Ajo ka si qëllim të përshkruajë dhe/ose të përcaktojë përdorimin e duhur e korrekt të tyre<sup>18</sup>, si dhe synon standardizimin e sistematizimin e leksikut të specializuar me qëllim që të lejojë një kuptueshmëri dhe qartësi sa më të mirë të mesazheve që individët kërkojnë të përcjellin.

Sipas përcaktimit të Riediger terminologjia ka këto funksione:

- *të bëjë përshkrimin sistematik të termave* që u përkasin sektorëve qartësisht të përcaktuar, pra, të fjalëve, të lokucioneve, të shprehjeve

<sup>18</sup> Riediger, Hellmut (2014), *Lessicologia vs terminologia, Cos'è la terminologia e come si fa un glossario*, Laboratorio Weaver, f. 4.

dhe të simboleve të përdorura në sektorë të mirëpërcaktuar, në një ose më shumë gjuhë;

- të transmetojë dhe të shpërndajë njohuritë teknike nëpërmjet krijimit të burimeve koherente dhe të njohura terminologjike, të tilla si: të dhënat terminologjike, fjalorët dhe bazat e të dhënave;
- të përcaktojë normat për përdorimin e termave dhe të standardizojë përdorimin e tyre me qëllim nxitjen e transmetimit të vazhdueshëm të mesazheve të specializuara.<sup>19</sup>

Me zgjerimin e thellimin e njohurive në sektorë të ndryshëm të dijës e të shkencës terminologjia e fushës përkatëse është zgjeruar e zhvilluar më tej. Të rejtat e shkencës apo të teknikës, objekte apo koncepte qofshin, kanë nevojë për emërtime mundësisht sa më të qarta, domethënëse dhe të njëkuptimshme, prandaj në shumë prej *gjuhëve speciale* ka lindur nevoja që leksiku i fushës të zgjerohet. Për ta realizuar një gjë të tillë ato përgjithësisht përdorin të njëjtat mënyra fjalëformimi si gjuha e përbashkët, si:

- prejardhja: *jokalimtare, pashquarsi, fundore, funksional*;
- përbërja: *bukurtingëllim, buzoprapaqiellzore, buzodhëmbore, tingullimitues*;
- huazimi: *afazi, diglosi, dikotomi, emfatik, emetim, kakuminal, kiazëm*;
- kalkimi / përkthimi: *kryefonemë, koartikulim, këpujë*;
- reduktimi: *P.K.B. (Parim i kategorisë boshe), I.P.A. (International Phonetic Alphabet), V.O.T. (Voice onset time)*;
- lokucionet terminologjike: *motor kërkimi i specializuar, gramatikë gjenerativo-transformacionale, teoria e komunikimit, ngjarje komunikative, ngjarje gjuhësore*;
- terminologjizimi (kur një fjale të gjuhës së përbashkët i caktohet një domethënie e re e veçantë), p.sh.: “*kujtesë*”: 1. (e përgjithshme) aftësia për të kujtuar; 2. (në kompjuter) pajisje të aftë për regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit.

Zhvillimi i shkencës sot është kaq i vrullshëm dhe i shpejtë saqë shpesh e vë në krizë komunikimin shkencor (përhapjen e informacionit rreth të reja më të fundit të shkencës). Kështu, ata që janë të “huaj” në një sektor të veçantë të saj, ndonjëherë nuk janë në gjendje të komunikojnë (ose të kuptojnë) saktë me ata që i përkasin atij sektori. Shkak kryesor është prania në një masë të madhe e leksikut të specializuar të fushës, i cili krijon

<sup>19</sup> Riediger, Hellmut (2014), *Lessicologia vs terminologia, Cos'è la terminologia e come si fa un glossario*, Laboratorio Weaver, f. 4.

vështirësi në të kuptuar, por edhe në përdorimin e mjeteve të ndryshme teknike. Prandaj është e domosdoshme që ky leksik të shpjegohet sa më qartë e sa më saktë. Për këtë arsye është i domosdoshëm hartimi i një fjalori terminologjik i tipit shpjegues të termave të fushës, i cili do të merrej me analizën dhe shpjegimin e termave të përdorur në një sektor të caktuar të dijes, duke nënkuptuar me këtë analizën e përdorimit të gjerë të koncepteve, termave dhe shprehjeve të pranuar ndërkombëtarisht, në rastin tonë në fushë të gjuhësisë.

Gjuhësia, e parë si shkencë e ligjërimit, bashkëndan mjaft nocione dhe terma me shkencat e tjera që merren me problemet e komunikimit, të tilla si: logjika, matematika, psikologjia, neurofiziologjia, sociologjia etj.. Nga shkenca gjuhësore këto koncepte dhe terma janë marrë dhe mirëpritur gjerësisht në përdorimet e tyre specifike dhe në domethëniet e tyre teorike. Përkufizimet e termave të veçantë nuk përmbushin vetëm funksion informativ, por janë të lidhura pothuajse gjithmonë me drejtime të veçanta kërkimore dhe janë të konceptuara në mënyrë problemore.

Në fushë të gjuhësisë deri më sot në Shqipëri janë hartuar dy fjalorë terminologjikë, njëri nga Akademia e Shkencave titulluar “*Fjalor i termave të gjuhësisë*”<sup>20</sup> dhe tjetri nga G. Belluscio & Sh. Rrokaj, “*Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*”<sup>21</sup>, të cilët përbëjnë një prurje mjaft të mirë albanologjike, por ato nuk përmbajnë shpjegime terminologjike. Studiuesi Shezai Rrokaj, pasi vlerëson rolin dhe rëndësinë e fjalorit të termave të gjuhësisë, shtron domosdoshmërinë e hartimit të një fjalori shpjegues të këtyre termave në gjuhën shqipe, sepse një zë i tillë mungon në filologjinë tonë. Ai shkruan se pas viteve ’60, “*shkenca dhe teknika, në përgjithësi, dhe ajo gjuhësore, në veçanti, morën një zhvillim të hovshëm, i cili pati edhe prurjet e veta në lëmin terminologjik ... Në qoftë se deri më sot Fjalori i termave të gjuhësisë i është përgjigjur deri diku mirë shkencës së gjuhësisë dhe kërkesave të përdoruesve, tanimë po lind nevoja e ngutshme për hartimin e një fjalori të ri, jo thjesht terminologjik, që t’i përgjigjet nivelit të shkencës së sotme gjuhësore. Termave të rinj që po i shtohen në mënyrë të vrullshme korpusit të deritanishëm të tyre, u lind padyshim e*

<sup>20</sup> Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i Terminologjisë, *Fjalor i termave të gjuhësisë: shqip, rusisht, frëngjisht, anglisht, gjermanisht e italisht*, Tiranë, 1975.

<sup>21</sup> Belluscio, G. & Rrokaj, Sh., *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë: shqip-italisht-frëngjisht-anglisht*, Arbëria, Tiranë, 2011.

*drejta të përfshihen dhe të përdoren prej studiuesve, përdoruesve dhe lexuesve.*<sup>22</sup>

Prandaj punimi ynë përbën një sprovë për të shpjeguar disa terma nga fusha e gjuhësisë. Duhet të theksojmë se në rastet kur është ndërhyrë në këto pak terma të paraqitur, është synuar që të ruhen karakteristikat e veçanta që shpesh pasqyrojnë përpunimin origjinal ose ripunimin që shkenca gjuhësore shqiptare u ka bërë dhe po u bën koncepteve sipas teorive të ndryshme gjuhësore.

### A.

#### *abesive*

*Abesive* (nga lat. *abesse* – me qenë larg, lat. *abessivus* – i papranishëm) është një rasë morfologjike, që shërben për të shprehur mungesë apo mosprani. Ndeshet e përdorur kryesisht në gjuhët *ungro-fine*. Mund të quhet edhe rasë privuese dhe ka kuptimin e parafjalës *pa* apo të parashtesës *pa-*, *jo-*, *mos-* të shqipes. Me anë të kësaj rase shprehet kryesisht mungesë e referentit të emrit që shënon (p.sh. finl. *syyttä - pa faj*).

Në disa tradita gramatikore, sidomos të gjuhëve të Kaukazit, është quajtur ndryshe edhe rasë *karitive* (nga lat. *carēre - me mungu*).

#### *ablative*

*Ablative* (nga lat. *ablativus – me largu*) është një rasë morfologjike (e njohur ndryshe edhe rasi rrjedhore) që shpreh një shumëllojshmëri kuptimesh, duke përfshirë:

- mjet (letra bëhet prej drurit),
- shkak (xhami u thye prej erës, plasa vape)
- vend (lëvizën prej vendlindjes, shkonte udhës)
- burim (Drini rrjedh prej maleve)
- kohë (po prisnin prej një ore, verës këtu bën shumë nxehtë),

si dhe kuptimin e prejardhjes dhe të largimit (prej nga e ka marrë edhe emrin kjo rasë).

Shërben gjithashtu:

- për të treguar të përkatur (një zemër malësori),
- për të karakterizuar një send (mban erë pranverë),
- për të shprehur raporte midis pjesës dhe së tërës (gjysmë buke, grumbull ushtarësh),

<sup>22</sup> Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Shtëpia Botuese “Shkronjë pas Shkronje”, Tiranë 2009, f. 81.

- për të treguar lëndë (*lugë druri - lugë prej druri*).

Funksioni kryesor është ai vendor i tipit dinamik relativ ose i lëvizjes prej një vendi.

Termi *ablativ* është përdorur kryesisht në gramatikën latine, nga gramatikani i periudhës bizantine Maximus Planudes; kështu, për shembull, ablativi i latinishtes shihej edhe si rasa që shprehte origjinën, burimin. Ndeshet e përdorur edhe në paradigmen rasore të protoindoevropianishtes. Në shumë gjuhë të vjetra indoevropiane ajo mungon fare. Funksionet e saj i kryen ndonjë rasë tjetër, kryesisht gjinorja e dhanorja (greqisht, gjermanisht). Në raste të tjera është pikërisht kjo rasë që mbulon disa funksione gramatikore të rasave të tjera (p.sh. në latinisht). Në gjuhë të tjera të privuara nga fleksioni rasor (në gjuhët romanze) funksionet tipike të rrjedhës shprehen përmes përdorimit të parafjalëve.

Kjo rasë merr një valencë të veçantë në sistemet e ashtuquajtura orientative, në të cilat lëvizja mund të jetë shprehur në raport me kundërvënien mes “*jashtë*” e “*brenda*” një vendi (finl. *talolta - nga shtëpia* (në drejtimin *jashtë*), *talosta - nga shtëpia* (në drejtimin *brenda*)).

### ***Ablative absolute***

***Ablative absolute*** (lat. *absolutus~absolute “i pavarur”*) është një strukturë sintaksore e nënkuptuar në një fjali të varur me valenca semantike dhe sintaksore të ndryshme (kohore, shkakore, mënyrore etj). Është karakteristike për gjuhën latine. Emërtimi i referohet mënyrës së ndërtimit gramatikor (autonomisë gramatikore të këtij ndërtimi) në lidhje me fjalinë kryesore.

*Ablative absolute* në gjuhën latine ndërtohet duke vendosur në rasën rrjedhore (ablativ) si pjesoren e foljes, ashtu edhe emrin apo përemrin të cilit i referohet (lat. *militibus convocatis - “ushtarëve të mbledhur”*, *aversante natura - “me natyrën e kundërt”*).

Prania e foljes nuk është përherë e domosdoshme, përderisa një *ablativ* rrethanor (i varur nga rrethanat, jothelbësor) paraqet tashmë një *ablativ absolut*. Në këtë rast ndërtimi sintaksor shndërrohet në një ndërtim emëror, duke qenë i përbërë nga një emër dhe një mbiemër, nga një përemër dhe një emër, ose nga një emër tjetër me funksion cilësor (kallëzuesi emëror), p.sh.: lat. *Cicerone consule - nën konsullatën e Cicetronit*, *te comite - me ty si shok*, *tranquillo mari - me qenë deti i qetë*), shqip p.sh. “*me ty si shoqe*”.

Ablativi në gjuhën latine shpreh funksionet e tri rasave që dikur kanë ekzistuar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, d.m.th. të *ablativit* të mirëfilltë (që tregon vendin nga ku ndodh lëvizja ose largimi), të *lokativit*

(vendores, që tregon vendin e kryerjes së veprimit) dhe të *instrumentalit* (që tregon mjetin me të cilin kryhet veprimi).

Tendenca e ndërtimeve sintaksore absolute të tipit pjesor (prejpjesor, participial), me modalitete analoge përdorimi dhe kufizime të ngjashme, duhet të jetë karakteristikë e gjuhëve indoevropiane. Me shumë mundësi ky tip ndërtimi duhet t'i përkasë edhe protoindoevropianishtes<sup>23</sup>.

#### *ablaut*

Termi gjermanik *ablaut* (nga greq. *apó* “prej” + *phoné* “tingull” - *këmbim zanor*) është përdorur për të shënuar një rast të veçantë alternimi vokalik që dallon zëra semantikisht të lidhur të formuar nga e njëjta rrënjë. Ky term u përdor së pari nga J. Grimm (rreth vitit 1820) në një kuptim pak më të ndryshëm nga ai i sotmi.

Njihet ndryshe edhe si *apofoni* dhe është ndërrimi i rregullt i zanoreve të caktuara në fjalë apo forma që lidhen me njëra-tjetrën. Si dukuria më e njohur e ndërrimeve të zanoreve në gjuhët e vjetra, *ablauti* (apofonia) dëshmohet në të gjitha gjuhët e familjes indoevropiane, por në disa prej tyre, si: në *indishte*, *greqishte*, *gotishte* etj., ka qenë më e zhvilluar, duke luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e eptimit, kurse në disa gjuhë të tjera dëshmohet në masë më të vogël dhe roli i saj ka ardhur duke u zbehur. Edhe në gjuhën shqipe shfaqjet e *apofonisë* (*ablautit*) janë shumë më të pakta sesa në gjuhët e tjera, gjë që shpjegohet me veprimin rrafshues të analogjisë.

Në një gjuhë të dhënë mund të jenë në alternancë apofonike forma fleksive të së njëjtës paradigme (angl. *to drive* - *drove* - *driven* - “me drejtu”) ose forma të derivuara të dallueshme (p.sh. lat. *tēgo* - *tōga* - “mbuloj”).

Atje ku diferenca midis alternantëve (e quajtur edhe shkallë apofonike) është e timbrit vokalik apofonia quhet *kualitative* (cilësore), ndërsa atje ku është e gjatësisë vokalike quhet apofoni *kuantitative* (sasiore).

1. Apofonia është *kualitative* (cilësore) kur dy fjalë a forma gramatikore kanë zanore të ndryshme në temat e tyre. Ndërrimi më i njohur ka qenë kundërvënia /e/ ~ /o/, p.sh. *tēgo* “mbuloj ~ *tōga* “mbulesë, veshje e romakëve”. Në gjuhën shqipe paraqitet si /e/, /je/, /ie/ ~ /a/, meqenëse zanorja /e/ ka dhënë /e/, /je/, /ie/, kurse zanorja /o/ ka evoluar në /a/. Kështu, foljet *vjerr* e *var* i përkasin së njëjtës rrënjë dhe dikur mund të kenë qenë dy forma të një paradigme të vetme, por më vonë kanë dalë si fjalë më vete.

<sup>23</sup> Watkins, C. (1993), *Il proto-indoeuropeo*, në A. Giacalone Ramat e P. Ramat, *Le lingue indoeuropee*, il Mulino, Bologna, fq. 43-93.



*Apofonia kuantitative* është shndërrimi i kuantitetit (gjatësisë) të zanoreve në fjalë a forma gramatikore që kanë lidhje ndërmjet tyre. Këtë dukuri gjuhëtarët e kanë lidhur me veprimin e theksit dinamik, që ka krijuar zanore të shkurtra e të gjata, të theksuara e të patheksuara, p.sh. lat. *venĭo* “vij” ~ *vēni* “kam ardhur”. Në gjuhën shqipe apofonia kuantitative në zanoret e theksuara me kundërvënien zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë, del kryesisht në sistemin foljor, në kundërvënien paradigmatiche e tashme ~ e kryer e thjeshtë. Por, meqenëse zanoret e gjata të periudhës indoevropiane e kanë humbur gjatësinë e tyre, duke u shndërruar gradualisht në fonema të tjera, apofonia kuantitative e indoevropianishtes në gjuhën shqipe del si apofoni kualitative, ku zanoret kanë të njëjtën gjatësi, por ndryshojnë në timbrin e tyre. Më e shpeshtë në gjuhën shqipe është apofonia në zanoren /e/ (/e/ ~ /ē/)<sup>24</sup>

#### absolut

1. Ablative absolute (shih ablative absolute).
2. Thuhet për një mbiemër që është absolut ose ka kuptim absolut, kur parimisht ai nuk është i aftë të marrë kategorinë e shkallës. Në pjesën më të madhe këtu përfshihen mbiemrat që tregojnë cilësi në mënyrë të ndërmjetuar, të cilët e japin cilësinë e sendit që karakterizojnë nëpërmjet emërtimit të marrëdhënies të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim apo me një numër. Pra, drejtpërsëdrejti me anë të kuptimit të tyre leksikor këta mbiemra emërtojnë marrëdhëniet e mësipërme. Kurse në mënyrë të ndërmjetuar ata nuk tregojnë thjesht marrëdhëniet, por i japin këto si karakteristika cilësore të sendeve, si veti tipike e të qëndrueshme të tyre. Kështu, mbiemri gjeografik nuk e ka kategorinë e shkallës, ai nuk mund të jetë në shkallën krahasore apo në atë superlative.
3. Quhen *kohë absolute* tërësia e formave foljore që shprehin kohë në raport me momentin e të folurit; nga ana tjetër, kohët relative shprehin një aspekt të kryer në raport me kohët absolute. Kështu, e ardhmja e përparme dhe më se e kryera shprehen si të kryera në raport me të ardhmen ose të kryerën.

<sup>24</sup> Kolec Topalli (2007), *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Dituria, Tiranë, fq. 197 – 204).

## absolute

Në këtë formë (*absolutivus*) është përdorur si term gramatikor nga Diomèdi në veprën e tij “*Ars Grammatica*”,<sup>25</sup> në kuptimin "jokalimtare".

Absolute (nga lat. e vonë *absolutivus*, që rrjedh nga *absolvère* “me krye”) është edhe një rasë morfologjike e pranishme në disa gjuhë (gjuhët ergative-absolute), që përgjithësisht shërben për të treguar vepruesin apo atë që kryen një veprim të shprehur nga një folje. Ajo është përdorur për të shënuar kryesisht subjektin e foljeve jokalimtare, por edhe objektin e foljeve kalimtare.

Për shembull, në gjuhën baske, emri *mutil* (“*djalë*”) merr mbaresën e rasës absolute *-a* qoftë kur përdoret si kryefjalë (subjekt) në fjalinë jokalimtare *mutila etorri da* (“*djali arriti*”), qoftë kur përdoret si kundrinor (objekt) në fjalinë kalimtare *Irakasleak mutila ikusi du* (“*mësuesi e pa djalin*”), në të cilën kryefjala (subjekti) merr mbaresën *-ak* të rasës ergative. Në këtë sistem gjuhësor rasa *absolute* i kundërvihet formalisht rasës *ergative*, e cila është rasa e emrave që në përgjithësi janë subjekt i foljeve kalimtare. Në këto gjuhë rasa *absolute* merr funksionet e një rase të pamarkuar, shpesh të privuar nga kuptimi i veçantë morfologjik (siç ngjet me emëroren e sistemit emëror indoevropian). Së bashku me rasën *ergative*, kjo rasë shfaqet në shumë gjuhë që nuk lidhen gjenetikisht me njëra-tjetrën, si: në gjuhën *gjeorgjiane*, *baske*, *tonga*, *çeçene*, *hindi*, *inuktitut*, *eskimeze*, *navajo*, *dijari*, *dirbal* etj.

**abstrakt**

*Abstrakt* (nga lat. *abstractus* - i ndarë nga) është një term i cili përdoret në disa kuptime:

1. *Emër abstrakt*: në gramatikën tradicionale kështu quhet një emër jokonkret. Një emër abstrakt është një emër që shënon diçka të parë si referent jomaterial. Në kundërvënie me një emër konkret, forma abstrakte semantikisht është përcaktuar si një klasë emrash që shënon koncepte (psikika, mendimi), karakteristikë (përtesë), marrëdhënie (lidhje farefisnie), institucion (martesë), veprime (lëvizje, vrapim), gjendje (durim), cilësi (bukuri, egërsi), veçori të abstraktuara (trimëri, mendjemadhësi) ose nocione abstrakte (kujtesë, liri) etj.<sup>26</sup>
2. *Folje abstrakte*: Në gramatikën gjenerativiste thuhet që një folje është abstrakte kur është teorikisht e nënkuptuar nga transformimi

<sup>25</sup> Diomèdi, “*Ars Grammatica*”, I, 373, 14 ds TLL, 182, 42.

<sup>26</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Morfologjia, Tiranë, 2002.

që pëson gjatë procesit të emërzimit apo të mbiemërzimit, po që nuk merr një realizim morfofonologjik. Kështu, emri axhustim tregon një emërzim (fjalë e prejardhur nga folja axhustoj); mbiemri i dëgjueshëm që tregon prejardhje mbiemërore, duke u nisur nga një folje me rrënjë dëgjo-j.

3. *Fraza abstrakte*: Në gramatikën gjenerativiste, përkundër frazave efektivisht të shqiptuara nga folësi i një gjuhe (ose frazave konkrete), quhen fraza abstrakte ato fraza që kanë strukturë të thellë të formuar nga simbole nga më të përgjithshmet (SN - sintagmë nominale; SV - sintagmë verbale etj.).

4. *Kuptim abstrakt*: i referohet një ideje, diçkaje që nuk mund të shihet ose preket. Ajo i referohet një mendimi që perceptohet nga mendja. Ai nuk përshkruan diçka konkrete, por një karakteristikë ose cilësi të saj. P.sh.

*Kam bërë një kurs kuzhine.*

- Këtu emri *kuzhinë* është përdorur në një kuptim abstrakt, i cili ka të bëjë me artin e gatimit (artin kulinar), një koncept jo i kapshëm me sy të lirë.

#### ***abstraktësi***

*Abstraktësi polemike* (e mosmarrëveshjes). Në fonologjinë gjenerative, ky term ka të bëjë me çështjen se sa larg nga forma sipërfaqësore (forma realizuar në të vërtetë) është forma themelore, domethënë se sa abstrakte është ajo.

#### ***ad sensum***

Ad sensum (nga lat. constructio ad sensum - *ndërtim sipas kuptimit*) është term i përdorur për një ndërtim sintaksor, i cili është bërë në shkelje të rregullave të harmonisë formale gramatikore, por që nga ana kuptimore është i saktë.

Ndërtimi sipas kuptimit ndodh, ndër të tjera, në qoftë se gjinia gramatikore e një fjale ndryshon nga gjinia natyrore e objektit të emërtuar (ose e personit) ose nëse numri i përemrit dhe i foljes (zakonisht në shumës) ndryshon nga ai i emrit me cilin lidhet drejtpërsëdrejti (zakonisht një emër kolektiv në njëjës). Një fenomen të tillë e ndeshim shpesh në letërsinë artistike, ku ai është më shumë mjet stilistikor, se sa gabim.

E gjithë *turma* nxitoi mbas tij. Ata *e kapën dhe* e hodhën në katranin të nxehtë (gramatikisht saktë do të ishte: “*Ajo (turma)* e kapi dhe e hodhi në katranin e nxehtë”).

#### ***adesiv***

*Adesive* (nga lat. *adesse* – me qenë i pranishëm) është një rasë morfologjike me funksion vendor statik, që shënon një gjendje të afërt, jashtë një momenti të caktuar referimi. Mungon në gjuhët indoevropiane dhe është e pranishme në ato të familjes uraliko-jukaghir (dega e gjuhëve uralike). Mund të ketë si valencë hapësinore, ashtu edhe valencë kohore, p.sh. në finl. *talolla* – afër shtëpisë, *kesällä* – në verë, në hung. *szobornál* – pranë monumentit etj..

Normalisht rasa adesive i kundërvihet rasës inezive (lat. *inesse* – me qenë në, me u gjetë) që shënon një gjendje në brendësi të një vendi ose të një kohe të caktuar. Edhe rasa inezive është e pranishme në gjuhët e degës uralike, p.sh. në finl.

Suomessa – në Finlandë, päivässä – brenda një dite, në hung. szobában - brenda një dhome.

(vijon)

#### BIBLIOGRAFI

- AAVV (2002), *Manuale di terminologia-Aspetti teorici, metodologici e applicativi*, Hoepli: Milano.
- Auger, P. (1988), *La terminologie au Québec et dans le monde, de la naissance à la maturité*. In: *Actes du sixième colloque OLF-STQ de terminologie. L'ère nouvelle de la terminologie*. Gouvernement du Québec: Québec.
- Beccaria, G. L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj. Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë, Arbëria, Tiranë*.
- Cabré, M. T. (1999), *Terminology: theory, methods and applications*. John Benjamins: Amsterdam / Philadelphia.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN: 2-03-532047-X.
- Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Riediger, H. (2014), *Cos'è la terminologia e come si fa un glossario*, Laboratorio Weaver.
- Wüster, E. (1979), *Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie* (the general introduction to terminology and terminological lexicography lesson), 3<sup>rd</sup> Edition, Romanistischer Verlag, Bonn 1991, ISBN 3-924888-48-5.

### The Terminology as a system

#### ABSTRACT

Special languages are a diaphasic variety of a language which are used by specialists in a specific field in order to meet the needs of accurate understanding at the level of a specialist or a group of people who participate in a certain activity. They are characterized by the presence of a "pure" and specific lexicon, the study of which is dealt by a particular branch of the applied language, "the terminology", which intends to describe or determine their correct use.

The development of science today is so rapid that it often puts the science of communication into crisis. The main cause is the large presence of the lexicon of the specialized field. Therefore it must be explained as clearly and accurately as possible. For such a case, an explanatory terminology vocabulary should be developed which will deal with the analysis and explanation of the terms used in a given sector of knowledge, in our case the linguistics. In this regard, the article is a test which explains some of the terms.

Evalda PACI

**VISARI I KONGREGACIONIT (1930),  
NJË DËSHMI VLERASH DHE TEKSTESH  
TË VYERA NË GJUHËN SHQIPE**

Në historinë e shkrimit të gjuhës shqipe renditen dhe vepra të një vëllimi modest por që vijojnë natyrshëm një traditë botimesh që synojnë kah praktika e liturgjisë së përditshme dhe në veçanti në drejtim të asaj pjese që lidhet me festa të rëndësishme kishtarë, të luajtshme dhe të paluajtshme. Vëllimthe që përmbajnë tekste të rëndësishme, dëshmi e një tradite me origjinë popullore janë realizuar dhe në shekullin e nëntëmbëdhjetë e më tej në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë. Në disa pikëpamje një pikë e rëndësishme referimi ndaj tyre mund të konsiderohet në veçanti Doktrina e Kërshtenë e Gjon Nikollë Kazazit(1743), një *compendium* në kuptimin e mirëfilltë të fjalës që në përbërje të vet pasqyron dhe një sërë përdorimesh sa të veçanta, aq dhe të krahasueshme me sprova të tjera pasardhëse me destinacion të ngjashëm.<sup>27</sup> Konsiderojmë gjithashtu të një rëndësie jo të vogël realizimet e varianteve doktrinare të mëvona e që kanë parë dritën e shtypit falë vëmendjes së Kongregacionit të Propaganda Fides. Të tilla botime përveç se përfaqësojnë në vetvete realizime të rëndësishme për historinë e shkrimit shqip dhe për konsolidimin e traditës shkrimore në gjuhën tonë, pasurojnë natyrshëm një panoramë botimesh dhe arritjesh që dhe sot e kësaj dite ofrojnë material të vlefshëm për vjelje dhe vëzhgime në disa fusha të gjurmimeve gjuhësore dhe filologjike.<sup>28</sup>

<sup>27</sup> Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006.

<sup>28</sup> Citohej më tej në këtë shkrim tonin dy variante të rëndësishme doktrinare të botuara pas Doktrinës së Gjon Nikollë Kazazit, përmbajtja e të cilave është shtysë për të kryer përjasje dhe me përdorime të veçanta nga kjo vepër e sipërcituar e përpiluar nga Atë J.Jung S.I. Me shumë vlerë në këtë drejtim paraqitet dhe përmbledhja me titull *Lumnit e Zojës së bekueme të Shëjtit Sh'Alfons M.De'Liguori* ; *Pjesa e parë : Falemi Rregjinesha*, Shtypshkroja Zoja e Paperlyeme, Shkodër, 1929.

*Visari i Kongregacionit*, botim i përpiluar nga Atë Jung S.I.<sup>29</sup> dhe i përkujdesun prej D.N. Mjedës (Shkodër, 1930), përbën një libërth të pasun në pikëpamje të përmbajtjes dhe të dhënave gjuhësore që përcjell për lexuesin e ditëve të sotme.

Në të gjurmohen një sërë përdorimesh që qëndrojnë mes periudhash të rëndësishme për historinë e shkrimit të shqipes, dialektologjinë historike, por dhe emërtesat e një regjistri të rëndësishëm për shkrimin e shenjtë dhe gjuhën e praktikës së liturgjisë.

Pasqyrë e një sërë trajtash që të shtyjnë t'u referohesh si veprave të mëparshme me destinacion të ngjashëm në pikëpamje përdorimi, por dhe veçantive që dhe sot e kësaj dite mbijetojnë në shqipe e veçanërisht në gegnishte, ky libërth bashkë me botime të tjera të afërta në kohë përbën një kontribut modest në pikëpamje të vëllimit fizik, por serioz në drejtim të ruajtjes së një tradite shkrimore dhe kishtarë që zë fill me realizime më të hershme e që mbijetojnë dhe në këtë opusculum të Atë Jungut.

Variantet e lutjeve themelore në liturgjinë e orëve janë shkruar në një gegnishte të pastër, që rezultoi e ruajtur dhe në formën në të cilën të njëjtat lutje u soll në fillim të viteve '90, në proces të rikthimit të praktikës fetare në Shqipëri. Një konservim i tillë mbetet dëshmi e një kulture të ngulitur dhe e një besimi solid që gjeti shprehje dhe në variante të tilla të karakterizuara nga qartësia dhe hijeshia gjuhësore, nga përdorime stilistikore që i bëjnë të tilla tekste të krahasueshme me forma më të hershme në letërsinë e shkruar shqipe, përfaqësuar që në fillimet e dokumentimit të saj me të tilla premisa.

Nga ana tjetër, pikërisht për arsye të pranisë së elementeve leksikore që përfaqësojnë orientalizma e që ndeshen në këtë traditë shkrimore të sipërcituar, duhet menduar që autori njëjtte variante doktrinare të mëparshme, pas gjase dhe atë të vitit 1845, të shqipëruar nga Atë Guagliata S.I., e të sjellë për lexuesin dhe për misionarin në dy gjuhë: në italisht dhe në shqipe të kohës. Përdorime të caktuara që ndeshen dhe në *T'mledhunit e Dotrins Kshten*, prej mesctarit D.A. Ferrari, shqipëruar prej D.N. Logorecit

<sup>29</sup> Atë Jak Jung S.I. (1837-1899), përfaqëson figurën e një meshtari të përkushtuar që shërbeu për vite të tëra në qytetin e Shkodrës. Njihet si autor i disa vëllimeve, ndër të cilët përmendim sprovë mbi elemente të gramatikës së shqipes (Shkodër, 1881); Jeta e Sc' Luigit Gonzaga: yrneku e paitori i t'riive (Romë, 1889), si dhe i një fjalori dygjuhësh (Fialuur i voghel scc8 p e Itiniscet. - mledhun prej P. Jak Junkut, Shkodër, 1895); ndër të tjera përpilues dhe i këtij vëllimthi me titull *Visari i Kongregacionit*, (botim i tretë i përkujdesun prej D. Ndre Mjedës), Shtypshkroja Zoja e paperlyeme, Shkodër, 1930.

(Shkodër, 1886) na bëjnë të mendojmë se në këtë drejtim ka patur vijimësi të natyrshme sa u takon trajtave dhe elementeve kryesisht leksikore që gjurmohen në botime të kësaj natyre.<sup>30</sup>

Veçanti në këtë vëllimth të Atë Jungut paraqesin dhe disa emërtime të shenjtoreve, formë kjo pothuaj permanente gjatë gjithë përmbajtjes së tij. Ndeshen trajta e përdorime, si: Shëjti Shë Luigj, Shëjti Shë Jozef,<sup>31</sup> Shëjti Sh'Injac<sup>32</sup>; Shëjti Shë Nëkollë<sup>33</sup>; Shëjtja Shë Tereze e Foshnjës Jezu;<sup>34</sup>

<sup>30</sup> Në disa elemente tekstore dhe të përmbajtjes së tekstit, ky botim i sipërcituar (Shkodër, 1886) në përmasat e një compendiumi afron me variantin doktrinar të Atë Guagliatës S.I.(1845), megjithëse shfaqet më modest në pikëpamje të vëllimit dhe përmbajtjes. Ndeshen raste përdorimesh të njëjta si në pikëpamje fjalësh të veçanta, ashtu dhe ndërtimesh sintagmatike që dëshmojnë qartë vijimësi në këtë drejtim. Do të citonim kështu rubrikat kushtuar trinisë shenje, emërtimet e sakramendeve e emërtime specifike që i përkasin përditshmërisë së praktikës së liturgjisë. *Trinija Shëjte* trajtohet dhe në *Visarin e Kongregacionit*(f.11), duke u afruar kështu dhe me manualët kateketike që kemi cituar dhe në këtë punim tonin.

<sup>31</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, (botim i tretë i perkujdesun prej D. Ndre Mjedës)*, Shkodër, Shtypshkroja “Zoja e papërlyeme”, 1930, f.83: Edhë tÿ po të lutem, o i madhi Pajtuër e Át i êm, Shëjti Shë Jozef, me i qitë para të lumit Jezu Krisht falnderimet e të lutunat të tua per mue. Zojës së békueme e tÿ s’ mund të ju mohojn gjâ kurr Jezu Krishti; e prandej mbáj uzdajë se ká me u ndigiuë lutja e ême. Shih gjithashtu, po aty, f.86: Shëjti Shë Jozef, qi jé i dashtuni pajtori i êm; Ejëlli i Tenzot, qi jé Rojsi i êm; e ju të gjith Shëjtnit e Parrizit, lutn’ju per mue.

<sup>32</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, (botim i tretë i perkujdesun prej D.Ndre Mjedës)*, Shkodër, Shtypshkroja “Zoja e papërlyeme”, 1930, f.219-225, me lutjet kushtuar këtij shenjtori (i referohemi nandçes së Shëjtit Sh’Injac) e në veçanti, po aty, f.222: 8.O zelltar i páshoq, **Shëjti Sh’Injac**, ti prej zëllit qi kishe me i shëlbue shpírtent e njerzvet, temelove nji Shoqëni, qi tui u hapë neper botë perkujdeset per shëlbim të njerzve, na xier së Tenzot hírin qi tui shëlbue shpírtin t’onë, të mundohena edhë me shëlbue shpírtent e gjith shokve. 9.O i lumnueshmi **Shëjti Sh’Injac**, me mend e me zemrë i ndigiove e ju binde gjithmonë Veqilit të Jezu Krishtit Shëjtit Atë Papë, e u mundove me gjith fuqí tande me sjellë ndë ndigiesë të tij gjith boten; deh! po të lutena, ne xier edhë né ketë hír, qi me i ndigiuë per herë fjalvet e mësimet të tija, porsí Veqilit të Jezu Krishtit e mjeshtrit t’onë të págabueshem.

<sup>33</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit*, f.262-263: O Shëjti Shë Nëkollë, drita e të rijvet, ndëra e Meshtarvet, luzimi i Ipeshkvíjvet; ti qi shperdan me duer plot të mirat e qiellës, ti qi Zotynë të ká shndritë me gjith farë mrekuillish, na u bân ndimë e krah nder sá rreziqe të shpirtit e të korpit, e me të pushtueshmen ndermjetsí tande bân qi të kena prej së Tenzot të falunit e mkatevet, e të pshtojmë prej zjermit të fundit të férrit; e kështu të víjmë nji ditë në Parríz, kù jé tui lumnuë e tui gëzue bashkë me Jezu Krishtin per gjithmon’ e jetës. Ashtú kjoftë.

<sup>34</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.226-227.

Shêjti Shë Françesk prei Asssit<sup>35</sup>; Shêjti Shë Njon<sup>36</sup> etj.

Tekste përbërëse të këtij vëllimi mbeten dhe psalme të caktuara, për të cilët ashtu si dhe për pjesë të tjera (veçanërisht lutje/orationes) jepet dhe një variant gjegjës në gjuhën latine.

Prei pshtierit çova zânin te ti, o Zot: O Zot, ndigiò uraten t'ême. Ven'ja veshin zanit të lutjes s'eme.

Në paç me kqyrë padrejtsinat, o Zot: kush ka me qindrue?

Por te ti asht mëshrierja; e neper ligjë tande shpresova ne tý, o Zot.

Shpirti i em u pshtet në fjalë të tij; shpresoi shpirti i êm në Tenzonë.

Prei agimit e deri në muzg, shpresoftë Izraeli në Tenzonë.

Sepsë në Tenzonë asht mëshrierja, e shperblimi i plotë te ai.

E ai ká me shperblye Izraelin prei pádrejtsinavet të tija.<sup>37</sup>

Në veçanti sa u takon teksteve që vihen përballë me gjegjësit e tyre në gjuhën latine, mund të veçohen disa prej tyre, ndër të cilat lutje drejtuar Ejëllit Rojs, Ati ynë<sup>38</sup>, Besojme<sup>39</sup>, Falemi Mrí<sup>40</sup> e jo pak tekste të tjera:

Angele Dei, qui custos es mei, me tibi commissum pietate superna, hodie illumina, custodi, rege et gubernana. Amen.

Ejëlli i Tenzot, qi jé Rojsi i êm, mbassi Zotynë per mëshrier të vet më ká lânë nen rojë tande, ti sod më shëndrit, më ruej, më mba e më sundò. Ashtù kjoftë.<sup>41</sup>

<sup>35</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.227-229.

<sup>36</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.237: Po të lutem, o fort i zëllshmi Shêjti Shë Njon, per atë zëll qi pate per lumní të Tenzot, e per të mirë të shokvet të tú, qi të shtyete në çdo rasë me ju sjellë ndo'j dobí të shpírtit, me më xjerrë aq një zëll e një dishír veprues per shêjtnim të shokvet të mí, qi une vetë të mundohem sod e mbrapa me shembuj të mí, e kú të mundem, edhe me fjalë të mija me ju sjellë dobí shpírtit të tyne.

<sup>37</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.23. Shih dhe gjegjësin në latinisht të këtij psalmi(n.129) dhënë po aty(f.22-23), para shtjellimit të tekstit të sipërcituar në gjuhën shqipe: De profunde clamavi ad te, Domine: Domine, exaudi vocem meam. Fiant aures tuoe intendentes in vocem deprecationis meae. Si iniquitates observaveris, Domine, Domine, quis sustinebit? Quia apud te propotiatio est: et propter legem tuam sustinui te, Domine. Sustinuit anima mea in verbo ejus: speravit anima mea in Domino. A custodia matutina usque ad noctem speret Israel in Domino. Quia apud Dominum misericordia, et copiosa apud eum redemptio. Et ipse redimet Israel ex omnibus iniquitatibus ejus. Requiem æternam dona eis, Domine: et lux perpetua luceat eis. Për një variant të krahasueshëm të këtij psalmi shih dhe *Meshari, botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.29/a-b.

<sup>38</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.6-7.

<sup>39</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.8-9.

<sup>40</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.7: Falemi Mrí, hírplote, Zotyn me tý, békue jé mbi gjith grá e békue fryti i barkut t'yt Jezus. Shêjtja Mrí, Ama e Tenzot, lutu per né mkatnorët, tash e ne fill te mordes s'onë. Ashtù kjoftë.



Lutjet që shoqërojnë shtjellimin e këtij vëllimthi i kushtohen figurave qendrore në liturgjinë e orëve. Përmbajtja e tyre, elemente dhe detaje tekstore të veçanta janë një premisë për të realizuar qasje mes variantesh të tjera të disponueshme.

Bashkë me *Falemi Mrí, Falemi Rregjinesha* inicion në njëfarë mënyre lutjet e himnet që i kushtohen Zojës, e cila mbetet dhe në këtë rasë një prej figurave më të lakuara dhe nëpërmjet figuracionit stilistikor që i përshkon këto tekste. Ky tekst paraqitet në një variant mjaft interesant, për disa elemente të krahasueshëm me ato gjegjëset në veprat paraardhëse, duke qenë ky i fundit gjithashtu një himn që përshkon jo rrallë dhe faqet e Offices së Mesharit të Gjon Buzukut:

Falemi Rregjinesha, Ama e mishrirshme, jeta, amencimi, e shpnesa e jonë, falemi. Tý te thrrasim na të shkretët birt e Evës, tui fshâ, tui gjimue e tui kjâ në ket shekull plot me lot. Deh, prá, Pajtorja e jonë, atâ sý të mishrirshmit t'u silli prei nesh. E Jezu të bekuemin frytin e barkut t'yt, né mas kso shkretijet na kalxò, o e dhimshmja, o e buta, o e âmla Virgjina Mrí. Ashtû kjoftë.<sup>42</sup>

Ky variant i këtij himni pasqyron gjithashtu përdorimin *pajtore*, që e ndeshim dhe në variantin doktrinar të përpiluar nga Atë Guagliata S.I. (Romë,1845).<sup>43</sup> Në tekstet e këtij vëllimi do të ndeshet disa herë dhe mashkullori gjegjës *pajtuër/pajtor*, me referim ndaj disa shenjtoreve që përmenden në të.<sup>44</sup>

Në këtë vëllimth do të gjurmohen disa lutje drejtuar Zojës, me një rregullsi rimarrjeje që bie në sy në çdo rubrikë të tij. Në tekstin e mëposhtëm gjejmë një prej modeleve të këtyre lutjeve:

Zojës së békueme, me pasë prej Sajë vertytin e pastrís shêjte:

O e kullueshmja Zojë, Virgjina Mrí, Nana e ême e dashtuna, une due me kênë gjithmonë i Jezu Krishtit e i gjithmonë i yti. Qe pra se une tesh po të

<sup>41</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.11.

<sup>42</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.9-10. Vërej dhe variantin latin që i prin tekstit gjegjës në shqip në këtë vëllimth, po aty, f.9: Salve Regina, Mater misericordiae, vita, dulcedo et spes nostra, salve. Ad te clamamus exules filii Hevae. Ad te suspiramus gementes et flentes in hac lacrymarum valle. Eia ergo, advocata nostra, illos tuos misericordes oculos ad nos converte. Et Iesum, benedictum fructum ventris tui, nobis post hoc exilium ostende. O clemens, o pia, o dulcis Virgo Maria.

<sup>43</sup> *Dottrina Cristiana tradotta da G.Guagliata*, Romë, 1845, f.77. Mund të vërehet një ngjashmëri e qartë mes varianteve në fjalë, atij të G.Guagliatës dhe variantit gjegjës në këtë vëllimth të vitit 1930.

<sup>44</sup> Shih pikërisht dhe përdorimin *pajtuër* në Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.237-238: ..me bâ qi edhë une ta mbaj gjithmonë Luigjin per *pajtuër* të posaçëm e per pasqyrë...

fali ty syt' e mi, veshët, giuhen, zemren e gjithë vetëvehten. Ki kujdes per mue, o Nan' e dashtun, e më ruej prei çdo mkatit, por sidomos prei mkatesh kundra pastrís.

Ma nep békimin tand, o e Bija e Atit të pushtueshem, qi mos t'i fyej të dashtunit Zotit t'ëm me mëndime të këqija. *Falemi Mrí.*

Ma nep békimin tand, o Nana e të Birit të Tenzot, qi mbas sodit mos t'i fyej të dashtunit Zotit t'ëm me fjalë të këqija. *Falemi Mrí.*

Ma nep békimin tand, o e dashtuna e Shpirtit Shëjt, qi mbas sodit mos t'i fyej Zotit t'ëm me vepra të këqija. *Falemi Mrí.*<sup>45</sup>

Duke qenë pa dyshim një prej figurave më të trajtuar në këtë vëllim, siç dhe vërehet nga pjesë të veprës që posaçërisht dhe i janë kushtuar, tërheqin vëmendjen lutje të dhëna me variantin në latinisht përkrah, përfshirë këtu dhe tekstin e njohur *Regina Coeli*:

Rregjinesha e qiellës, ngushllou, Aleluja./ Regina coeli laetare, alleluja,

Se ai qi meritove me bájhtë, aleluja,/ quia quem meruisti portare, alleluja,

U njall, si pat thanë, aleluja./ Resurrexit sicut dixit, alleluia,

Lute per ne Tenëzonë, aleluja./ ora pro nobis, Deum, alleluia.<sup>46</sup>

*Mesha Shëjte* zë një vend të konsiderueshëm në përbërje të këtij vëllimthi. Shpjegimet përkatëse të meshës shoqërohen me tekste lutjesh të veçanta, përmbajtja e të cilave lidhet drejtpërdrejt me momente të rëndësishme të zhvillimit të meshës. Këto lutje, përveç notave përmbajtësore të qarta poetike, pasqyrojnë po aq qartë dhe natyrshëm prurje të leksikut të krishterë në gegnishte, elemente që paraqiten me modifikime të qarta në përbërje të tyre, por dhe që na kujtojnë përdorime paraardhëse të autorëve të mëparshëm.<sup>47</sup>

Paragrafe për t'u veçuar përbëjnë Urdhënimet, përkatësisht Urdhënimet e Tenzot dhe Urdhënimet e Shëjtes Kishë. Në të parat mbizotëron përdorimi i urdhërores si mënyrë kohore, ndër ato pasueset vihet re një përfshirje mbizotëruese e infinitit analitik të tipit me+pjesore.<sup>48</sup>

<sup>45</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.10-11.

<sup>46</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f. 18-19. Shih dhe variantin përkatës të *Regina Coeli* te *Dottrina Cristiana tradotta da G. Guagliata*, Romë, 1845, f.75.

<sup>47</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.45-83. Shpjegimet përkatëse shoqërohen me sigla të gjuhën latine, elemente tipike të meshës në këtë gjuhë. Shtjellohet në mënyrë didaktike në hyrje të këtij paragrafi pothuaj e gjithë mesha në gjuhën latine, siç dhe duhet të ketë qenë praktika e kohës në të cilën përdoret ky vëllim.

<sup>48</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.12-13: Urdhënimet e Shëjtes Kishë: 1. Me pá Meshë ditën e diele e ditën festë. 2. Me njinue krezhmit e mënjillet, e kater kohët; e mos me hangrë mish të prënden. 3. M'u rrfye sadopak nji herë në vjetë, e m'u kungue per Pashkë. 4. Mos me bâ darsen në mot të lidhun. 5. Me lá hakun e Kishës si âsht zakoni.

Vetë emërtimet e sakramendeve në këtë vepër modeste në pikëpamje vëllimi dhe ndonjë përdorim që ruan qartë lidhje formimi me emrin *sakramend*, dëshmojnë shkallën e konsolidimit të këtyre përdorimeve në këtë praktike e kryesisht në këto botime që e pasqyrojnë këtë të fundit.<sup>49</sup>

*Udha e Krygjës*, siç dhe vijon të emërtohet dhe sot e kësaj dite përbën një prej pjesëve më interesante të vëllimit, duke qenë se pasqyron dhe krijime të një natyre mirëfilli letrare<sup>50</sup> që shtjellohen ndërmjet lutjeve dhe zërave antifonare që shoqërojnë këtë rrugëtim të besimtarëve në vigjilje të Pashkës.<sup>51</sup>

Përveç se në tekstet e sipërcituara që përmbahen në hyrje të këtij vëllimi, figurës së Zojës do t'i kushtohen paragrafe të tëra e mjaft specifike që kanë të bëjnë dhe me Liturgjinë e Pashkëve, dhe me vetë devocionin ndaj kësaj figure femërore mjaft të lartësuar në tekste dhe himne.<sup>52</sup>

Modele të formimit të disa emrave nënvizojnë më tej rëndësinë e studimit të këtij vëllimthi. Përveç disa trajtave analitike mirëfilli të veçanta në pikëpamje të tipologjisë së tyre, bie në sy edhe përdorimi i emrit të prejardhur *pastrí*, në shembuj të tillë, si në rastin e kësaj lutjeje drejtuar Shën Luigjit: o Shëjti Shë Luigj, pasqyra *e pastrís* shëjte, Ejëll në shpirt e në korp, e pajtori i ëm fort i dashtuni, une i divoçmi i yt i pádëjë po të bij nder kambë, e me gjithë zëmrë po ta porosis të dlírtit e shpirtit t'ëm. Per *atë pastrí* të mrekullueshme qi pate prej të madhit Zot, e per atë rojë të madhe

<sup>49</sup>Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.223: Uji i Sh'Injacit: Sikurse nder Sakramende të Kishës epet hiri i Tenzot tui perdorë do sende qi shifen me sy, n'at mënyrë qi ka urdhënuë Jezu Krishti; ashtu gjithmonë kështenimi ka perdorë do sende të bekueme, qi dijetarët e fës ju thonë *të sakramendshme*, e qi premtion Zoti, e shum herë sjellin dobina shpirtit e korpit. Nder këto sende të bekueme asht edhe uji qi bekohet me Relike e medajë të Shëjtit Sh'Injac, me ato sjellje e uratë qi ka da Kisha shëjte.

<sup>50</sup>Shih ndër të tjera këto vargje që përkojnë me tekstin në latinisht të *Stabat Mater*, tekst që evokon liturgjinë e Pashkëve(po aty, f.124): Rrite Zoja tuj lotue/ Afer Krygjet tui shikjue/ Krishtin pezull kryqezue... dhe më tej(f.125), i njëjti motiv, në një krijim tjetër e në një përmasë tjetër, që vijon të këndohet dhe në ditët e sotme: Heshta zëmrën pei trishtimit/Prei ezgjetit,prei idhnimit/Zojës pershkue ja kishte shqimit./Nana e dashtun, tý të kam rá/ Varrët e të Birit tand pá dá/ gjurma në zëmrë me m'i bā.

<sup>51</sup>Jung J. S.J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.124-139.

<sup>52</sup>Shih në veçanti Uratë Zojës së bekueme(f.163-164; Shëjet e mundimit, f.165-166; Shëjet e lumnís(f.166-167); Litanít e Zojës(në latinisht, f.167-170); Nandcja e Zojës Nuncjatë (f.171-172); Divocjoni ndej Zojen me shtatë haxharë (f.173-178), Nandcja e Zojës së Kshillit të mirë (të Shkodrës), f.178-182 etj. Përmbajnë këto paragrafe një sërë përdorimesh dhe ndërtimesh unike që i kushtohen kësaj figure: O Fort e lumnueshmja Nana e jonë, e Ndimtarja jonë, Zoja e békueme..(f.186); O fort e dashtuna Nana e jonë e Pajtorja e jonë Virgjina Mrí..(f.187); O Virgjin e pánjollë, Zoja e békueme..(f.189); O zamak pastroje, Zoja e békueme(f.190);O lule Parrízit, Zoja e békueme(f.190) etj.

qi i pate vû védit per mos me e pelqye kurr me çdo njollë sá do të voglë, ban qi të hitas edhe une per ketë vertyt; ban qi të kém mâ të madhin kujdes per ketë stolí të shpirtit.<sup>53</sup>

Elemente të një leksiku të posaçëm që lidhet me sferën e liturgjisë përbëjnë përdorime të njohura dhe të pranishme dhe në veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Do të ndeshen në vijimësi përdorime si sakrific, lter,<sup>54</sup> mëshier/mëshrirë/mëshir, i mëshriershem,<sup>55</sup> Parriz, i kështenë, Unjill, shembues, shembim<sup>56</sup>, korp, vullëndesë<sup>57</sup>, krygjë<sup>58</sup>, fugure, shuguroj, i shugurueshëm/e shugurueshme, sakramend, rruzare, oste, uratë, divocjon/devocjon etj.

Vetë ndërtimi e konceptimi i këtij vëllimi përgatitur nga Atë Jung S.I., me gjithë elementet e qarta të një manuali që mund të përdoret dhe në praktikën e liturgjisë së përditshme, apo me tekstet që i shërbejnë dhe praktikës kateketike, dëshmon qartë një lloj veçantie dhe specifike sa u përket mjaft detajeve që sillen në të: tekste lutjesh, Litani të caktuara dhe më tej dhe figura shenjtoreësh që përmenden e trajtohen më në veçanti në pjesë të caktuara të veprës. Elementet leksikore që gjurmohen në vepër bashkë me përdorime tipike të një regjistri gjuhësor të veçantë, janë dëshmi e ndikimit të autorit nga e folmja geqe që ai njihte më mirë.

<sup>53</sup> Jung J. S.J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.15.

<sup>54</sup> Të vërehet dhe përdorimi i mbiemrit *shêjt, shêjte* në sintagma të tilla si: Mesha shêjte(f.50 v; lterit shêjt, fé shêjte; pervujtní shêjte(f.213); vertyt shêjt(f.213), méní shêjte(f.215); trimní shêjte(f.215); dashtëni shêjte(f.232).

<sup>55</sup> Jung J. S.J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.175: O Zot i *mëshriershem*, bân qi të mendojmë e të ndijmë në zëmrë t'onë Varrët e shejtnueshmë të Lumit Jezu Krisht Shelbuesit t'onë, e të dhimbtunat e Zojës, Nanës s'onë; pse mbájmë uzdajë se ne e shkoshim jeten tui kujtue, e tui kjá Varrët e Jezu Krishtit e haxharët e Zojës, neper meritime e neper të lutuna të tyne, kena mbërrí nji ditë në lumní të pásosme. Ashtë kjoftë.

<sup>56</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.55: O i lumi Jezu Krisht, qi erdhe ndë shekull *per shembim* të gjithve, bân qi Unjilli i yt të ju diftohet gjith të páfévet; bân qi të mbahet prej gjith të kështênëvet, e sidomos prei mejet; ashtë qi tui të marrë mbrapa tý, o Jezu Krisht i dashtun, ndë ketë dhé, të vîmë të gjithë me të gëzue mbë qiell.Ashtë kjoftë.

<sup>57</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar*, f.172: O Virgjin e ndigjushme, qi porsá ndjeve prei gojës s'Arkangjelit Gabriel vullëndesën e Tenzot, me të shpejtë ju shtrove, me gjith se e dijshe se sá të vshtira e të dhimbtuna do të kishe tui u bâ e Ama e Jezu Krishtit, bân qi une t'i shtrohëm në çdo rasë vullëndesës së Tenzot, e të ju ndigioj me gjith zëmrë atyne qi kanë të drejtë me m'urdhënuë e me më sundue.

<sup>58</sup> Jung J., *Visari i Kongregacionit, botim i cituar, Shêjet e mundimit*, f.165-166: Në të pëstin shêj të mundimit të mendojmë si Jezu Krishti, mbassí mbërríni në mal të Kalvarit kje zhdeshtë, e kje gozhdue *në krygjë*, kû dha shpirtin tui pasë afer të dhimbshmen Nanen e vet.

**BIBLIOGRAFI**

- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI*, Tiranë, 2002.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell: Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*, Botime Çabej, Tiranë, 2014.
- Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Dizdari T., *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- Guagliata G. S.I., *Dottrina cristiana del Card. Bellarmino tradotta in albanese*, Romë, 1845.
- Ismajli R. *Tekste të vjetra*, Dukagjini-Pejë, 2000.
- Jung Giovanni, *Cenni biografici del P.Giacomo Jung S.J. da Trento*, 1907.
- Jung J. S.I., *Visari i Kongregacionit, (botim i tretë i perkujdesun prej D.Ndrë Mjedës)*, Shtypshkroja "Zoja e Paperlyeme", Shkodër, 1930.
- Maisano R., *Filologia del Nuovo Testamento*, Carocci editore, Romë, 2014.
- Murzaku I., *Catholicism, Culture, Conversion*, në *The History of the Jesuits in Albania (1841-1946)*, në *Orientalia Christiana Analecta*, n.277, Romë, 2006.
- O'Neill Ch.S.I., Dominguez J. S.I.; Infante de Santiago-Piatkewicz, *Diccionario histórico de la Compañía de Jesus (biográfico-temático III)*, Romë-Madrid, 2001.
- Paci E., *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.

**Visari i Kongregacionit (1930), a testimony of values and precious texts in Albanian**

***ABSTRACT***

Visari i Kongregacionit (Scodra, 1930) prepared by Jung S.I. constitutes a high value edition in many ways. It includes new entries in the field of liturgical vocabulary. It also has a rich usage of the language contained therein. This is set of texts not only with liturgical character, but with visible marks a clear literariness which complements the image of a complete work in this point of view. Even though it is a work of the

twentieth century, it reflects usages of similar previous editions, which are very important for the linguistic register of liturgy.

## Rrezarta DRAÇINI

### ABSTRAGIME PSIKOLINGUISTIKE NË PERCEPTIMIN POETIK TEK “ME MUJT ME FJET’... ME KTHIMIN E SHPENDVE”, TË LEDIA DUSHIT

Në një analizë psikolinguistike shihen bashkë dhe gërshetohen mesazhet, informacionet, mjetet gjuhësore që përdor folësi apo shkruesi me forcën ndikuese që kanë të gjitha këto tek marrësi i mesazhit. Mes lexuesit si dekodifikues i mesazhit dhe shkrimtarit krijohet një lidhje e padukshme, pasi në momentin e leximit ata bëhen një, hyjnë në botët e njëritjetrit. Shkrimtari duhet të ketë aftësinë që në kohë të ndryshme dhe në lexues të ndryshëm, vetëm me anë të fjalës së tij të provokojë ndjesi dhe emocione, të nxisë imagjinatën e lexuesit dhe ta çojë atë pikërisht aty ku do autori. Sigurisht që kjo nuk është e lehtë, përkundrazi. Ky është kufiri që ndan një autor të suksesshëm me një tjetër. Jo vetëm kaq, por shkrimtari duhet të gjejë gjuhën që i lejon lexuesit të lexojnë mendjen e tij, të hyjnë në botën e tij. Nëse mes marrësit të mesazhit, lexuesit, dhe prodhuesit të mesazhit, autorit, krijohet kjo lidhje e brendshme me dy kahe, atëherë kemi një vepër të suksesshme dhe një autor që do t’i rezistojë viteve.

Çfarë mund të thuhet për poezitë e Ledia Dushit, nëse e analizojmë në këtë linjë?

Po shkëpusim nga libri poezinë nga ka marrë edhe titullin libri:

*me mujt me fjet’ me kthimin  
e pemëve t’ mbytuna  
e thirrmat e mija shpendve  
zotnuesa t’ trishtimit t’ paqiell  
kasolle t’ lëshueme e barka mejtimi  
pluskojnë e cekin  
flamë buzësh e kurrja s’ ashtë n’ stinë...  
me mujtë me kthimin e pemëve me fjetë  
n’ mos n’ Shpirt Dimni diku asht<sup>59</sup>*

<sup>59</sup> L., Dushi, “*me mujt me fjet’... me kthimin e shpendve*”, Tiranë, 2009, f. 6.

Një libër botohet sepse autori ndien nevojën me komunikimi me të tjerët. Kur vepra nuk botohet atëherë komunikimi mbetet i brendshëm: autori me vetveten. Nëse kalohet ky cak dhe shkohet përtej komunikimit të brendshëm, pra autori vendos të botojë krijimet e tij, atëherë mund të themi se kemi nevojën e autorit për me komunikimi me të tjerët, për ta ba të zashëm mendimin e tij. Po ashtu botimi tregon se autori është i kënaqur me atë që ka shkruar, pra prodhimi i tij gjuhësor, konkretja është afër abstraktes që është rrit në shpirtin e tij.

Duke lexu librin e Ledias shtrihet pyetja: Sa afër është konkretja, pjesa e dukshme pra libri **“me mujt me fjet”... me kthimin e shpendve** me abstrakten në mendjen e autores?

Barazi absolute mes tyre nuk ka. Është i suksesshëm ai shkrimtar që i afron sa më shumë këto të dyja dhe arrin që të përpunojë lexuesin dhe ta fusë në kurthin e tij, pra ta fusë në abstrakten e mendjes së tij dhe të dy bashkë të përjetojnë emocione, pse jo edhe të ndryshme në varësi të kompetencave gjuhësore që kanë gjithsecili.

Një vepër është e suksesshme nëse arrihet komunikimi, nëse autori ka ditë me gjetë rrugën drejt lexuesit të tij.

Si e ka realizuar Ledia një gja të tillë?

Si vjen libri për lexuesin?

Mendoj që Ledia ndoshta në pavetedije ka seleksionu lexuesin e saj duke shkuar drejt lexuesit elitë, me një inteligjencë gjuhësore dhe intuitë perceptivë drejt perfeksionit.

Pse e them një gjë të tillë?

Në të gjithë librin nuk kemi asnjë shenjë pikësimi: pikë, presje, pikëpyetje etj. Në pamje të parë kjo duket si “lojë” e autores për të shprehur abstrakten sa më mirë. Për këtë duhet përgëzuar autorja, sepse kështu besoj se ka arritur që të pazashmen, të padukshmen, mendimin abstrakt ta afrojë shumë me pjesën e zashme, me pjesën e dukshme, pra me rreshtat e shkruar. Kjo afërsi (që nënkupton sukses) ka bërë që të mos ketë shenja pikësimi, pasi mendimi abstrakt, ajo çka realisht përjetohet emocionalisht në bordinë tonë organizohet e tillë: nuk funksionojnë shenjat e pikësimit në gjuhën e mendimit.

*za kreje ka me ra ndër gurë*

*para Mordjes*

*me ujë deti ndër shkarpa*

*shtri*

*me faculetë t' bardhë n' fytirë*



*me nji sy t' nxjerrë  
si prej ma t' hershmes  
kënaqësi t' humbun*<sup>60</sup>

Por a është i përgatitur lexuesi ynë për një mesazh të tillë? A është i gatshëm me ba dekodifikimin e një mesazhi të paraqitur ndryshe, pra të realizojë komunikimin?

Lexuesi ynë tradicional ka një etalon, zbaton skema të cilat i ka mësu dhe kultivu gjatë rritjes së tij intelektuale. Skema shabllon për një poezi bie fjala është e tillë: gjithçka fillon me një titull. Ky është kontakti i parë që ka lexuesi me poezinë. Në këtë moment lexuesi përgatitet se çfarë do të ketë në vazhdim p.sh., një titull poezie: “Vjeshta” Kontakti i parë: Poezia do të jetë për vjeshtën. Kjo e bën lexuesin të fokusohet rreth saj dhe të përgatitet që dekodifikimi i mesazhit do të shkojë në këtë zonë dhe automatikisht në tru, në zonën e ruajtjes së fjalëve nis aktivizmi përhapës që ndihmon lexuesin në dekodifikim, ndalet tek vjeshta dhe leksiku që ka lidhje me të.

Në librin e Ledia Dushit nuk ka tituj, pra lexuesi nuk përgatitet se çfarë do të gjejë mes rreshtash. Ky është momenti i parë që Ledia “luan” me lexuesin, por ama ajo që ka rëndësi është fakti se ajo i qëndron besnike vetvetes, pasi ndjen nevojën me nxjerrë jashtë atë përjetim të brendshëm abstrakt dhe të çlirohet prej tij pa pasë idenë se ai përjetim duhet me pasë një qendër orientimi, pra titullin.

Ndalemi tek shenjat e pikësimit. Pjesë e skemës etalon të poezisë, por jo vetëm të saj, por edhe të perceptimit gjuhësor në përgjithësi janë shenjat e pikësimit. Janë pikërisht këto shenja pikësimi që vendosin kufijtë, që organizojnë thanien dhe orientojnë lexuesin në dekodifikimin e mesazhit. Pauzat që realizohen falë këtyre shenjave nuk shërbejnë për gja tjetër veçse me i dhanë kohë marrësit të mesazhit të bëjë përpunimin e tij në zonën e Vernikut ku ndodh ky proces.

Të perceptosh një gjuhë (si koncept i përgjithshëm) do të thotë të ndërmarrësh veprime të tilla psikolinguistike, si: izolimin, segmentimin e fjalëve, të frazave dhe të thënieve të gjata. Procesi i përpilimit të tyre e ndjek marrësin e mesazhit kudo. Lexuesi ballafaqohet që në momentin e parë me dy probleme perceptuale. Fillimisht ai kërkon të lokalizojë kufijtë dhe së dyti ai bën identifikimin e fjalëve si dhe të bashkimeve të ndryshme që variojnë sipas sinjaleve, pra shenjave të pikësimit. Në mungesë të tyre lexuesi mbetet si në ajër, pasi nuk ka pikë ku të mbështetet,

---

<sup>60</sup> L., Dushi, “*me mujt me fjet'... me kthimin e shpendve*” , Tiranë, 2009, f. 3.

të ndalet dhe të bëjë segmentimin e thanies. Në këtë pikë hyn si rregullator inteligjenca gjuhësore dhe perceptivë e gjithsecilit. Në këto kushte ajo që përjetohet prej këtyre rreshtave është e ndryshme për lexues të ndryshëm sepse edhe segmentimet gjuhësore të domosdoshme për me realizu kumtimin bahen në varësi të individëve. Një lexues me një përgatitje mesatare këtë nuk mund ta kapë. Mendoj se ai thjesht lexon fjalët të shkëputuna apo grupe fjalësh pa arritë në një thanie të vetme dhe lodhet prej kësaj skeme të re për të cilën nuk është i përgatitun. Ndryshe ndodh me një lexues të pëpunuar i cili rreshtat pa shenja pikësimi i sheh si një botë pa kufij dhe është i lirë të bëjë “lojën” e tij me fjalët, i shpëton skemave shabllon dhe shkon përtej tyre. Në një situatë të tillë edhe përjetimi është më i mirë, lexuesi i kultivuar mund ta ndiej që s’ka kufij dhe hyn drejtpërdrejt në të pazashmen e autorit.

*ky shpirt që zhgulet me u shlirue kocash  
asht zogu që ndrin i qiellit ndër duer  
e nata nata që bahet frymbjerrëse  
asht ferri i ndezun që na e ban mirë  
koha asht e prekshme e matet me flutura...<sup>61</sup>*

Kategorinë e kohës e përdor për të fiksuar momentin e ngjarjes nëpërmjet tri ndryshoreve. E para është ngjarja që shënon vendin e saj në kohë. E dyta është origjina a koha e ligjërimit që përkufizohet si pikë në boshtin kohor nga nisemi për përcaktimin e kohës së ngjarjes dhe e treta është pikëreferimi që përcaktohet si pikë nëpërmjet së cilës mendja e lexuesit e kundron ngjarjen.

Distanca kohore nuk ndihet: mund të lexoni dhe aty gjeni dilemat e sotme, dramet, qëllimin e jetës. Simbolika që përdor autorja, motivet dhe mënyra sesi shtjellohen ato bëjnë që poezitë me mesazhet e tyre të jenë aktuale dhe lexuesit të gjejnë veten në to.

Gjuha është një grumbull organik elementesh fonetike, morfologjike e sintaksore, të cilat mes simbolesh marrin një forcë të veçantë. Forca e simbolit ndikon tek lexuesi me lidhjen dyshe mes mesazhit të fshehur dhe krahasimit që bëhet.

Ledia Dushi si një njohëse shumë e mirë e gjuhës dhe leksemës në veçanti arrin të bëjë suksesshëm lojën e simboleve duke vënë kështu fort në lëvizje mendjen e lexuesit.

<sup>61</sup> L., Dushi, “*me mujt me fjet’... me kthimin e shpendve*”, Tiranë, 2009, f. 17.

Është kjo arsyeja që autorja nuk ka nevojë për rreshta pa fund të shkruar në shkëmbim të një ideje. Jo, Ledia Dushit i mjaftojnë pak fjalë pasi kap domethënin e tyre, dhe ato i vë përballë për të bërë kontrastin.

Fjala është shenja e kuptimit, e idesë. Ka fjalë që e dëftojnë plotësisht një ide, ndërsa të tjera nuk e japin mjaftueshëm atë. Çdo ide ka një fjalë të vetme që e përfaqëson e që mund ta rrëfejë të plotë. Vetëm një shkrimtar i mirë arrin:

- ta bashkojë idenë e tij me fjalën e duhur,
- ta veshë atë plotësisht nga ana gjuhësore.
- dhe bën që lexuesi pa vështirësi të dekodifikojë mesazhin.

Këtu identifikohet veçantia e shkrimtarit, forca e fjalës së tij.

Nëse lexojmë poezitë e Ledia Dushit shohim se nuk ka fjalë të tepërta, shumë mbiemra apo ndajfolje. Fraza nuk vuan nga proliksiteti<sup>62</sup>, ashtu siç zakonisht bëjnë shkrimtarët e rinj, të cilët përdorin mbiemra pa fund në shërbim të një sugjestionit poetik. *“Shkrimtarët e lindur, të vërtetë, të rinj a të vjetër qofshin janë të kursyer në përdorimin e tyre. Ata flasin duke përdorur ma fort emna e folje, që formojnë eshtëninë e të folurit edhe e tregojnë idenë e parafytyrimit në të gjithë kuptimin e fuqinë e tij.”*<sup>63</sup>

---

<sup>62</sup> \*paraqitja e mendimit me fjalë të tepërta e të gjata.

<sup>63</sup> A. Xhuvani, K., Cipo, *Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme*, f. 38, Rilindja, 1982.

**BIBLIOGRAFI**

1. Dushi, L., “ *me mujt me fjet’ ... me kthimin e shpendve* ” , Tiranë 2009, f. 3.
2. Field, J., *Psycholinguistics*, London, 2002.
3. Cacciari, C., *Psicologia del linguaggio*, il Mulino, 2001.
4. Chomsky, N., *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Tiranë, 2008.
5. Chomsky, N., *New Horizons in the study of Language and Mind*, Cambridge, 2002.
6. Traxler, J.M., & Gernsbacher, M., *Handbook of Psycholinguistics*, Oxford, 2008.
7. Xhuvani, A.; Cipo, K., *Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme*, Rilindja, 1982.

**Psycholinguistic abstractions in the poetic perception of “being able to sleep... with the return of the birds ” of Ledia Dushi*****ABSTRACT***

This goal of this work is to make a psycholinguistic analysis of the book “me mujt me fjet’ ... me kthimin e shpendve” ( “being able to sleep ... with the return of the birds”) of Ledia Dushi, to identify the writer’s features. In a psycholinguistic analysis the messages, information and linguistic means that the speaker or writer uses are observed and intertwined with the influencing power they have for the receiver of the message. An invisible bond is created between the reader as the decoder of the message and the writer, because in the moment of the reading they become one, enter each others’ worlds. The writer must possess the ability only through his words to provoke sensations and emotions in different readers in different times and provoke the imagination and shape it to the authors. Starting from this viewpoint we have analysed Ledia Dushi’s work, which as a very good knower of the language and lexeme in particular, manages to successfully play the game of symbols by placing thus the reader’s mind in motion.

**Key words:** psycholinguistic analysis, poetic perception, Ledia Dushi, writer, reader.

Merita HYSA

## STRUKTURA RROKJESORE E NDAJSHTESAVE TRAJTËFORMUESE

Duke folur për bashkëveprimin mes nënsistemeve gjuhësore, na duhet të ndalemi në mënyrën se si veprojnë rregullat e proceset fonologjike mbi strukturën e temave morfologjike dhe të ndajshesave, qofshin ato trajtë- apo fjalëformuese gjatë proceseve të eptimit e të fjalëformimit.

Struktura e ndajshesave është më e thjeshtë se e rrënjëve, pasi ato rrallë i kalojnë kufijtë e dy rrokjeve, dhe kjo e bën më të lehtë për t'u përshkruar. Përshkrimi i veçorive të strukturës rrokjesore të tyre është i nevojshëm për të kuptuar më mirë organizimin metrik të fjalëve morfologjike. Zbulimi i strukturave rrokjesore na lejon të zbulojmë jo vetëm kombinimet e mundshme të segmenteve (zanore dhe bashkëtingëllore), por edhe përcaktimin e strukturave nistore dhe fundore të fjalëve në shqipe.

Në këtë punim do të ndalemi në zbërthimin e strukturës rrokjesore të morfemave ndajshesore trajtëformuese.

Përpara se të analizojmë strukturën rrokjesore të morfemave, duhet të kemi parasysh jo vetëm pozicionin e tyre në fjalë (nëse shërbejnë si elemente nistore apo fundore), por edhe përbërjen e tyre fonemore, pra do të vërejmë se cilat janë kombinimet e mundshme të segmenteve zanore dhe bashkëtingëllore brenda strukturave rrokjesore që formojnë fjalët.

Sipas përbërjes fonemore, ndajshesat trajtëformuese do t'i ndajmë në tri grupe:

(1) ndajshesa njëfonemëshe, që u shtohen temave morfologjike ose si segmente fundore (-s, -t), ose si pjesë e rrokjeve të veçanta që krijohen nga bashkimi i tingujve kufitarë (si p.sh.: -i, -u, -e, -ë, -a);

(2) ndajshesa dyfonemëshe, që u shtohen temave morfologjike si struktura të plota rrokjesore, si në rastin e -ja, -je, -ës, -së, -ën, -në, -in, -në, -ut, -un për numrin njëjës; dhe -at, et, -it, -të, -ët, -ve, -ish, -ësh për numrin shumës.

(3) ndajshesa dy ose më shumëfonemëshe, që lidhen kryesisht me format e shumësit, kryesisht si prapashtesa shumësi, por edhe si mbaresa, si p.sh.: -enj, -inj, -ër, -ra/-na, -llarë, -lerë dhe -ëve.

Më poshtë do të shohim se si realizohen strukturat rrokjesore të temave morfologjike që marrin këto trajtëforma. Ajo që duhet të veçojmë,

së pari, është se këto formante janë në pozicion fundor, si rrjedhim dalin si rrokje më vete ose si pjesë fundore të rrokjeve, d.m.th. si bërthama kur janë zanore ose si koda kur janë bashkëtingëllore.


Ndajshitesat trajtëformuese të numrit njëjës tek emrat janë kryesisht mbaresa njërrrokëshe. Struktura e tyre rrokjesore në pjesën më të madhe është e përbërë nga bërthama vokalike, e cila ka vetëm një element satelitor ose në pozicion të onsetit (fillimit të rrokjes), ose në pozicion të kodës (bishtit të rrokjes).

Në temat morfologjike që mbarojnë me zanore, ndajshitesa mund të jetë një bashkëtingëllore e vetme, një rrokje që nis me bashkëtingëllore, ose një zanore. Efektet e veprimit të saj mbi strukturën rrokjesore të fjalëformës janë të ndryshme. Këto formante ndikojnë pjesërisht në strukturat fundore të temave morfologjike. Duke shërbyer si bisht i rrokjes, këto segmente konsonantike nuk kushtëzojnë përbërësit e tjerë rrokjesorë dhe dalin thjesht si struktura plotësuese për të shprehur kategori të caktuara gramatikore. Skemat e pemës metrike të këtyre fjalëve do të jenë:

### 1. Ndajshitesa njëfonemëshe

#### (a) temë me zanore + prapashtim konsonantik





Kur prapashtesa trajtëformuese ose mbaresa është bashkëtingëllore, ajo i bashkangjitet temës a fjalëformës si strukturë fundore (si kodë), si në rastet: *tokë-s* [to-kēs], *tokë-n* [to-kēn], *mendje-s* [me-ndjes], *mendje-n* [me-ndjen], *male-sh* [ma-lesh], *ulli-nj* [ullinj], *pu-noj* [pu-noj] etj.



Siç shihet në (1a) e (1b), numri i rrokjeve të fjalëformës nuk ndryshon, ndërsa struktura e rrokjes fundore po, duke u kthyer nga rrokje e hapur në rrokje të mbyllur.

**(1b) temë më zanore + prapashtim vokalik**



Kur është zanore, prapashtimi vokalik shkakton rënien e zanores fundore të temës kur kjo është *ë*; ndërsa kur tema mbaron me zanoren *e* të patheksuar, ka raste kur kjo bie para mbaresës vokalike. Nëse tema mbaron me zanoren *ë*, atëherë prapashtimi vokalik zë vendin e saj pa ndryshuar strukturën rrokjesore të fjalëformës, d.m.th. rrokja e fundit mbetet e hapur, por bërthamë e saj bëhet zanorja që shtohet, p.sh.: *punë* [pu-në], por *pun#-a* [pu-na], *pun#-e* [pu-ne]. Në temat që mbarojnë me *-e* të patheksuar, kjo bie kur u shtohet mbaresë-nyja *-a*. Para kësaj mund të shtohet ose jo një bashkëtingëllore kundër hiatit: kur zanorja fundore *-e* është element i diftongut *ie*, atëherë *a*-ja i shtohet *i*-së drejtpërdrejt, duke formuar diftongun *ia*: *arterie* [ar-te-rie] dhe *arteri#-a* [ar-te-ria], *medie* [me-die] dhe *medi#-a* [me-dia]; por nëse para zanores *e* është një bashkëtingëllore, atëherë para mbaresës *a* shtohet një *j* kundërhiatizuese: *lule* por *lul#-ja* [lul-ja], *perde* por *perd#-ja* [per-dja].



Sikundër shihet nga pemët e rrokjeve, struktura rrokjesore e fjalëformës në rastin e parë (2a) nuk ndryshon, as numri i rrokjeve, ajo që ndryshon është vetëm bërthama e rrokjes së dytë, që bëhet *e/a*; e njëjta gjë

vlen edhe për rastin (2b); edhe në pemën (3c) në krahasim me (3a) struktura rrokjesore e fjalëformës mbetet po ajo, por ndryshon onseti, që zëvendësohet me një grup bashkëtingëlloresh, dhe bërthama, e cila nga *e* bëhet *a*.

Por nëse pas fundores *e* të patheksuar nuk vjen mbaresa shquese *a*, po një zanore tjetër, atëherë midis zanores fundore dhe mbaresës vokalike shtohet një bashkëtingëllore kundër hiatit: *arterie-je* [ar-te-rie-je], *me-die-je* [me-die-je]. Këta tinguj kundërhiatizues shtohen edhe kur temës që mbaron me një zanore të patheksuar (veç *ë*-së dhe *e*-së) ose me një zanore çfarëdo të theksuar, i shtohet një prapashtim vokalik, p.sh., *grua-j-e* [gru-a-je], *grua-j-a* [gru-a-ja], *rádio-j-e* [ra-dio-je], *radio-j-a* [ra-dio-ja]; *asgjë-j-e* [as-gjë-je], *asgjë-j-a* [as-gjë-ja], *rrufë-j-e* [rru-fe-je], *rrufë-j-a* [rru-fe-ja], *kalá-j-e* [ka-la-je], *kalá-j-a* [ka-la-ja], *metró-j-e* [me-tro-je], *metró-j-a* [me-tro-ja], *bambú-j-e* [ba-mbu-je], *bambu-j-a* [ba-mbu-ja], *aveny-j-e* [a-ve-ny-j-e], *aveny-j-a* [a-ve-ny-ja]; *la-v-a* [la-va], *la-h-u* [lahu], *mëso-v-a* [më-so-va], *mëso-h-u* [më-so-hu] etj.




Nga sa shihet prej pemëve të rrokjeve të këtyre fjalëformave, mbaresat *-je*, *-ve*, *-ja* *-va* e *-hu* nuk e ndryshojnë strukturën rrokjesore të rrokjeve fundore të temave me zanore të cilave u shtohen, ato vetëm shtojnë numrin e rrokjeve.

Jo vetëm emrat femërorë mund të mbarojnë me zanore, ka edhe emra mashkullorë që dalin me temë në zanore, si: *atdhe*, *barí*, *baba*, *krua*, *hero*, *Jezu* etj., të cilët marrin mbaresë ose mbaresë-nyja vokalike. Por, ndryshe nga emrat femërorë në zanore të mësipërm dhe foljet me temë në zanore, në



këta emra mashkullorë para mbaresës vokalike nuk del ndonjë bashkëtingëllore kundër hiatit: *judé-u* [at-dheu], *barí-u* [ba-riu], *babá-i* [ba-bai], *krúa* – *kró-i* [kroi], *heró-i* [he-roi], *Jezú-i* [je-zui]. Si rrjedhim, nga bashkimi i zanores fundore me mbaresat *u* ose *i*, të cilat janë të patheksuara, përftohen diftongje, çka do të thotë se nuk ndryshon as numri i rrokjeve, as struktura rrokjesore e fjalëformës, vetëm se në to pozicionin e bërthamës së rrokjes së dytë e zë një diftong (5b).




### (1d) temë më bashkëtingëllore + prapashtim konsonantik

Prapashtimet konsonantike mund t'i bashkohen temës drejtpërdrejt, duke mos ia ndryshuar strukturën rrokjes së fundit të temës, veç duke krijuar një kodë dybashkëtingëllorëshe, si p.sh. *miq-sh*, *kap-sh*, *hapsh*, *punof-sh*, *vën-ç* (6a) ose mund të kërkojnë shtimin e një zanoreje epentetike për të shmangur grupe të vështira bashkëtingëlloresh, si *net-ë-t*<sup>64</sup>, *desh-ë-sh*, *të folur-i-t*, *krushq-i-t*, *bujq-i-t*, *peshq-i-sh* etj. Me shtimin e zanores epentetike, rritet numri i rrokjeve të fjalëformës, ndryshon edhe natyra e dy rrokjeve të fundit, duke u bërë rrokja e parafundit e hapur dhe e fundit e mbyllur, por dhe e onseteve dhe e kodave të tyre, pasi bashkëtingëllorja a bashkëtingëlloret fundore të temës kalojnë me zanoren epentetike. Rrokja që ndodhet para rrokjes së fundit, mund të mbetet e mbyllur vetëm në rastet


<sup>64</sup> Në gramatika e fjalorë shumësi i *lot* jepet diku me *ë* e diku pa *ë*. Në rast se se do të prananim shumësin pa prapashtesën *ë*, atëherë edhe *lotët* do të analizohej si *netët*, d.m.th. me një *ë* anapitetike.

kur tema mbaron me një grup konsonantik të ndashëm (me të cilin nuk nisnin fjalë të shqipes), por koda e saj do të jetë njëkonsonantike (6b), (6c).




### (1d) temë më bashkëtingëllore + prapashtim vokalik

Kur një teme që mbaron me bashkëtingëllore i shtohet një prapashtim vokalik, fjalëformës i shtohet një rrokje, preket edhe struktura rrokjesore e rrokjes së fundit të temës, e cila hapet meqë koda bëhet onset i rrokjes që si bërthamë ka mbaresën, p.sh.: *mal-e* [ma-le], *mik-u* [mi-ku], *kap-a* [ka-pa], (të) *hap-ë* [ha-pë], *dit-i* [di-ti] etj. (6a). Por kur tema mbaron me një grup bashkëtingëlloresh, atëherë dy rrokjet e fundit do të kenë struktura që varen nga natyra e grupit konsonantik: nëse grupi konsonantik nuk mund të ndahet në dy rrokje, atëherë rrokja fundore e temës do të bëhet e hapur, meqë grupi konsonantik del në rolin e onsetit të rrokjes fundore të fjalëformës, e cila ka si bërthamë prapashtimin vokalik, si p.sh. *fund-i* [fu-ndi], *humb-i* [hu-mpi] etj. (6b); por nëse grupi konsonantik është i ndashëm, atëherë rrokja e parafundit e fjalëformës do të mbetet e mbyllur nga një bashkëtingëllore e vetme, ndërsa rrokja fundore do të jetë e hapur me onset një ose dy bashkëtingëlloret e grupit dhe me bërthamë prapashtimin vokalik, p.sh. *mars-i* [mar-si], *kopsht-e* [kop-shte], *mbart-i* [mbar-ti] etj. (6c)



Prapashtimi vokalik mund të shkaktojë rënien e zanores *ë* pastheksore jofundore, si në rastet *vegël – veg#l-a* [ve-gla], *kodër – kod#r-e* [ko-dre], *kokërr – kokr#rr-a* [ko-krra], *krikëll – krik#ll-a* [krik-lla], *i sotëm – e sot#m-e* [sot-me] etj. Në këto raste, numri i rrokjeve mbetet i njëjtë, por grupi i përfutur nga bashkimi i onsetit me kodën e rrokjes që rrëgjohet mund të shërbejë ose jo si onset i rrokjes me bërthamë prapashtimin vokalik, në varësi të asaj nëse me të fillojnë fjalë të shqipes. Kur grupi konsonantik është i ndashëm, atëherë rrokja parafundore bëhet e mbyllur me kodë bashkëtingëlloren e parë të grupit, ndërsa bashkëtingëllorja e dytë del si onset i rrokjes së hapur fundore (7a); kur grupi konsonantik është i pandashëm, atëherë ai bëhet onset i rrokjes fundore dhe kështu dy rrokjet e fundit të fjalëformës bëhen të hapura (7b).




## 2. Ndajshtesa dyfonemëshe

Ndër prapashtimet trajtëformuese dyfonemëshe dallohen dy grupe ndajshtesash; ndajshtesa të tipit zanore + bashkëtingëllore dhe ndajshtesa të tipit bashkëtingëllore + zanore, që u shtohen temave morfologjike si rrokje të mëvetësishme.

### (a) temë + prapashtime të tipit VC


Ndajshtesa të tipit bashkëtingëllore + zanore janë *-ën, -ës, -it, (ecur-it), -ij, -inj, -enj, -ër, -ët, -ish, -ësh; im, -in, -it, -ëm, -ët, -ën, -ësh, -im, -in, -ur, -em, -esh, -ej, -et dhe -en*. Këto ndajshtesa u shtohen temave që mbarojnë me bashkëtingëllore, rrokja fundore e të cilave është e mbyllur. Si rrjedhim, shtimi i ndajshtesës që nis me zanore jo vetëm që i shton fjalëformës një rrokje, po edhe ndryshon strukturën rrokjesore të temës, meqenëse bashkëtingëllorja fundore ose grupi konsonantik i pandashëm nga kodë bëhet onsets, dmth. rrokja parafundore bëhet e hapur, ndërsa rrokja fundore e mbyllur, p.sh.: *mbret-ër* [mbre-tër], *i keq – këq-ij* [kë-qij], *kap-im* [ka-pim], (të) *hap-ësh* [ha-pësh] *prind – prind-ër* [pri-ndër], *vegël – vegël-ën* [ve-glën] etj. Nuk prishet struktura e rrokjes së parafundit kur grupi konsonantik që del si fundore e temës është i ndashëm, si p.sh. *dhelpër – dhelpër-ës* [dhel-prës], *mbart – mbart-im* [mbar-tim], *çart – çart-ur* [çar-tur], etj., ku rrokja fundore e temës mbetet e mbyllur, por nga një bashkëtingëllore e vetme, meqë bashkëtingëllorja tjetër e grupit bëhet kodë e rrokjes së fundit të fjalëformës.



### (b) temë + prapashtime rrokje e hapur (C)CV

Prapashtime trajtëformuese me strukturë rrokjesore (C)CV janë: *-në, -së, -ri, -ra, -na, -ve; -çi, -më, -jmë, -të, -mi, -në, -jnë, -ni, -ja, -je, -te, -nte, -va, -shë, -ve, -më, -të, -në, -jë, -rë, -të, -ke, -ka, -të, -rë, -në*. Prapashtimet emërore e foljore të tipit CV u shtohen një pjesë temave që mbarojnë me zanore dhe pjesa tjetër temave me bashkëtingëllore. Në të dy rastet prapashtimi nuk e ndryshon strukturën e rrokjes fundore të temës, as vetë nuk e ndryshon strukturën rrokjesore, p.sh.: *liri-në* [li-ri-në], *fre-ri* [fre-ri], *arne-ni* [ar-ne-ni], *fshat-ra* [fshat-ra], *dhi-të* [dhi-të], *miq-ve* [miq-ve], *do-ja* [do-ja], *vën-çi* [vën-çi] etj. Kurse prapashtimet e tipit CCV (*-jmë, -jnë e -nte*) e ndryshojnë strukturën e rrokjes fundore të temës, pasi grupet bashkëtingëllore të tyre ndahen midis dy rrokjeve, duke e bërë të mbyllur paraprijësen: *bë-jmë* [bëj-më], *la-jnë* [laj-në], *tha-nte* [than-te].

Në pak emra mashkullorë njërrrokësh me temë në bashkëtingëllore që e bëjnë shumësin me *-ra*, para kësaj prapashtese shtohet për lehtësi shqiptimi një *-ë* mbështetëse: *bar-ë-ra, brum-ë-ra, djath-ë-ra, drith-ë-ra, dhjam-ë-ra* dhe *uj-ë-ra*. Shtimi i kësaj zanoreje anaptiktike modifikon strukturën rrokjesore të temës së njëjësit, duke e kthyer rrokjen e mbyllur në të hapur, që ka si onset bashkëtingëlloren fundore të temës<sup>65</sup>: (9c).




### (c) temë më zanore + rrokje e mbyllur CVC


<sup>65</sup> Për ne *-ja* fundore e emrave mashkullorë tipit *brumë, djathë, drithë, dhjamë* dhe *ujë* është thjesht një grafemë që shkruhet sipas parimit etimologjik, d.m.th. nuk shqiptohet.

Prapashtimet me strukturë CVC -zër; -hen, -nim, -nit, -nin, -kam, -kan, -kësh/-kej, -hem, -het, -hej, -hesh, u shtohen temave si rrokje të veçanta, duke shtuar numrin e rrokjeve të fjalëformave, po pa e prekur strukturën e rrokjes fundore të temës eptimore: *vëlle-zër* [vë-lle-zër], *la-hen* [la-hen], *tha-nim* [tha-nim], *hap-nim* [hap-nim], *qen-kësh* [qen-kësh], *kthe-hej* [kthe-hej]. Siç mund të vërehet, prapashtesa -zër dhe mbaresat foljore që nisin me -h u shtohen temave që mbarojnë me zanore, ndërsa të tjerat u shtohen si temave që mbarojnë me zanore dhe atyre që mbarojnë me bashkëtingëllore.

(10a)



(10b)



### 3. Ndajshitesa dyrrrokëshe

Haset edhe një numër prapashtimesh trajtëformuese dyrrrokëshe, me rrokje të hapura që nisin me zanore ose me bashkëtingëllore: (a) -ërinj, -emi, -eni, -esha, -eshe, -eshim, -eshit, -eshin dhe (b) -llarë, -lerë; -kemi, -keni, -kësha, -këshe, -këshim, -këshit, -këshin, -kemi e -keni; -hesha, -heshe, -heshim, -heshit e -heshin. Prapashtimet e grupit të parë, duke u bashkuar me tema që mbarojnë me bashkëtingëllore, shkaktojnë ndryshime të strukturës së rrokjes fundore të tyre, duke i kthyer nga rrokje të mbyllura në të hapura, për shkak se bashkëtingëllorja a grupi bashkëtingëllor i bashkohet si onsets në një rrokje me zanoren e prapashtimit, p.sh.: *zot-ërinj* [zo-të-rinj], *priфт-ërinj* [pri-ftë-rinj], *gisht-ërinj* [gi-shtë-rinj]; *hap-emi* [ha-pe-mi], *hap-eshim* [ha-pe-shim] etj. Prapashtimet e grupit (b) nuk shkaktojnë ndryshime të strukturës rrokjesore të temave të cilave u shtohen. Për sa u përket temave të cilave u bashkohen, këto ndajshitesa nuk sillen të gjitha njëjloj. Kështu, ndërsa prapashtesa -llarë u shtohet

temave që mbarojnë me zanoren *-a* (*aga-llarë* [a-ga-llá-rë], *hoxha-llarë* [ho-xha-llá-rë]); *-lerë* u shtohet temave që mbarojnë me *-e ose -i* të ndjekur nga një bashkëtingëllore (*bej-lerë* [bej-lé-rë], *sheh-lerë* [sheh-lé-rë], *dervish-lerë* [der-vish-lé-rë]), duke ruajtur kështu përndarjen që kanë në gjuhën e burimit. Këto prapashtesa marrin mbi vete edhe theksin e fjalëformës. Mbaresat foljore të së tashmes dhe të së pakryerës së habitores u shtohen si temave që mbarojnë me zanore dhe atyre që mbarojnë me bashkëtingëllore, pa prekur strukturën e rrokjes fundore të tyre (*punua-kemi* [pu-nu-a-ke-mi], *hap-kemi* [hap-ke-mi]). Ndërsa mbaresat e së pakryerës së dëftores u shtohen temave që mbarojnë me zanore. Për të shmangur takimin e zanores fundore të temës me zanoren nistore të mbaresës, është shtuar bashkëtingëllorja *h* si tingull kundërhiatizues: *la-hesha* [la-he-sha], *kthe-heshit* [kthe-he-shit] etj.

Natyrisht ky parashtrim është pjesë e një korpusi të gjerë strukturash rrokjesore, të cilat prekin të gjitha tipet e morfemave, si ato trajtëformuese (i pamë më lart), ashtu edhe ato fjalëformuese, të cilat do të jenë subjekt i punimeve të mënvonshme.

Nga parashtrimi i hollësishëm teorik, vërejmë se kushtëzimet fonetike të kombinimeve të segmenteve, varen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga struktura fonologjike e gjuhës, si rrjedhojë shohim që përcaktimi i kufijve rrokjesorë përligjet nga kombinimet fonotaktike, duke iu shmangur shpeshherë përkimit temë/morfemë (pra kufijve morfemorë), si dhe përcaktimit të kufijve morfemorë.

## BIBLIOGRAFIA

- Anderson, S., *The Organization of Phonology*, New York: Academic Press, 1974.
- Anttila, A., *Morphologically conditioned phonological alternations*, NLLT 20.1, 2002.
- Aronoff, M., & Fuhrhop, N., *Restricting Suffix Combinations in German and English*, Closing, 2002.
- Blaho, S., *Syllabic consonants in strict CV*. MA thesis, Pázmány Péter University at Piliscsaba, 2004.
- Blevins, J., *The syllable in phonological theory*, in “The handbook of phonological theory”, Oxford, Blackwell, 1995.
- Dardano, M., *Costruire parole*, Bologna, 2009.
- Dodi, A., *Ë-ja mbështetëse dhe problemet e drejtshkrimit të saj*, SF, 1981, nr. 3. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
- Dhrimo, A., *Për shqipen dhe shqiptarët*, I, II Tiranë, 2008.
- Goldsmith, J., *Autosegmental and metrical phonology*, Cambridge, 1990.
- Kager, R., *On a allomorphy and syllable counting*, in U. Kleinhenz (ed.) “Interfaces in

- phonology”, *Studia grammatica*, 41, 1996.
- Kostallari, A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
  - Lieber, R., *English Word-Formation Processes* në “Handbook of Word-Formation”, Dordrecht, 2005.
  - Memushaj, R., *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989; 2012
  - Memushaj, R., *Fonetikë e shqipes standarde*, Tiranë, 2014.
  - Plag, I., *Word formation in English*, Cambridge University Press, 2002.
  - Spencer, A., *Phonology*, Blackwell Publishers, Oxford, 1996.
  - Spencer, A., *Meaning and Words, Allomorphy*, 2005.
  - Trask R. L., *A Dictionary of Gramatical Terms in Linguistics*, Routledge Publishers, New York, 1993.
  - Trask, L. R., *A Dictionary of Phonetics and Phonology*, Routledge Publishers, London, 1996.
  - Trubeckoi, N. S., *Parimet e fonologjisë*, Prishtinë, 1985.

### **Syllabic structure of formative affixes**

#### ***ABSTRACT***

In this article we will talk about the syllabic structure of the affix morphs, the paradigmatic suffixes and the word endings.

Further, in the article there is a grouping of formative affixes as well as identifying their position within the syllabic structure of the words in the morphological themes. The affix system of Albanian language is based on the phonotactic combinations of the sound segments, thus gaining a rich system of word forms.



Aida URUÇI

## FORMAT KOHORE SINTETIKE TË PËRDORURA NGA A. XANONI

Kategoria e mënyrës luan një rol të rëndësishëm në sistemin foljor të shqipes, pasi ajo është një ndër mjetet kryesore për të shprehur modalitetin, d.m.th. qëndrimin e folësit ndaj asaj që kumton. E gjitha kjo realizohet nëpërmjet një larmie formash polisemantike, të cilat i kundërvihen njëra-tjetrës edhe nga pikëpamja e modalitetit. Format e mënyrës dëftore dallohen nga mënyrat e tjera si për nga ndërtimi, ashtu edhe nga kuptimi modal i vërtetësisë, d.m.th. që e paraqet si të vërtetë kryerjen e një veprimi në të tashmen, në të shkuarën e në të ardhmen.

Në këtë punim jemi fokusuar kryesisht tek disa struktura sintetike të foljeve të mënyrës dëftore, duke u mbështetur në veprën gjuhësore “Gramatika shqyp” (Shkodër, 1909). *Kjogramatikë*, - pohon studiesi T.Osmani, - *vjen pas Shkronjëtores së Sami Frashërit, Gramatikës së P.Jungut dhe Folmarmjes së shoqënisë “Bashkimi” (të dom Dodë Kolecit, shën. ynë), të cilat autori i ka pasë parasysh.*<sup>66</sup> Dhe tek vepra “*Prësi n’Lâmë t’Letratyrës* (Shkodër, 1912), e cila është përcaktuar si një traktat i vogël stilistik dhe metodik.<sup>67</sup>

Xanoni e përkufizon në këtë mënyrë dëftoren: “*Diftoria tregon domethanien e verbit me një mënyrë t’shkputun e pa u pshtetë ndoi fiales tjetër.*”<sup>68</sup>

Përveç kohëve bazë të dëftores, të cilat shprehin veprime të së tashmes, të së shkuarës dhe të së ardhmes, në veprat e Xanonit paraqiten edhe disa kohë të tjera të mbipërbëra të së shkuarës. Këto kohë janë karakteristike e gegërishtes, si: e kryera e dytë (*kam pasë këndue*), e kryera e tejshkuar e dytë (*kishin pasë thanë*).

Mënyra dëftore shfaqet me një larmi formash sintetike dhe analitike, si:

- 1- Koha e tashme (*dalim, kaa, kundron, janë*)
- 2- Koha e pakryer (*kishte, nepet, kallxoin*)

<sup>66</sup> T.Osmani, *Traditja dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, 4, Anton Xanoni personalitet i nderuar i kulturës shqiptare, Shkodër, 2014, f. 189.

<sup>67</sup> Po aty, f. 197.

<sup>68</sup> A.Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909, f.91.

3- Koha e kryer e thjeshtë ( *leu, bane, pata, u rreit, dha* )  
 4- Koha e kryer ( *kam kën, kee bâa, kaa dhanë* )  
 5- Koha Më se e kryer ( *kishin dhanë, kishite paa, kishin muet* )  
 6- Koha e kryer e tejshkuar ( *pata me kënë, pat me i lumnue* )  
 7- Koha e ardhme ( *do t'a keet, do t'i perciellin* )  
 8- Koha e ardhme e përparme ( *do t'a keet bain* )  
 9- koha e ardhme e së shkuarës ( *do të kishite me kënë, kishite per t'viefhtë* )  
 Xanoni kur bën klasifikimin e kohëve të mënyrës dëftore ai rendit tetë kohë të cilat janë: *kohën e qetashen, t'pakryemen, ngiatkaluemen, largkaluemen, ngiatteikaluemen, largteikaluemen, fieshtpertardhmen, parandeipertadhme*.<sup>69</sup> Lidhur me kategorizimin e trajtave foljore gjuhëtari T.Osmani pasqyron edhe disa qëndrime të prof. S.Rizës ai pohon se *dhe Riza ndalet në kohët dhe mënyrat e foljeve, duke veçuar se cilat forma foljore janë në vazhdim nga Samiu apo nga Kristoforidhi dhe cilat janë risi të Xanonit, që Riza i sjell me shembuj konkretë*.<sup>70</sup>

**Koha e tashme.** Kuptimit themelor i saj është kryerja e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin eligjërimit. Foljet e zgjedhimit të parë<sup>71</sup> dalin në të gjitha vetat me temë të pandryshueshme. Mbaresat e kësaj kohe janë: **-i, -n, -n**, (v.I, II, III, njëjës) **-im, -ni, -in** (v.I, II, III, shumës). Veçojmë mbaresën **-i** (veta e parë, numri njëjës), pasi krahasuar me standardin foljet e këtij zgjedhimi marrin mbaresën **-j**. P.sh.: ( *Un levdoi vedin. f.86 (G.Sh); (...e përfshin t'gjitha njoftime. f.1 (P.L.L); (N'ligjeratë përdoroim ndand fara fialësh. f.21 (G.Sh); ( ...vierrshetorët e mirë e pelqein fort e e perdoroin...f.73 (P.L.L); ( ...s'po i ban t'gjallta e s'po i rregullon... f.15 (P.L.L).*

Foljet e zgjedhimit të dytë, klasa e parë dalin me mbaresë zero, por vihet re prania e metafonisë **-a:-e-**, në vetën e dytë e të tretë njëjës. Ndërsa në rastet e foljeve, si: *bërtas*, shohim ndërrimet fonetike **-a-, -e-** në vetën e dytë e të tretë njëjës dhe **-a:- -i-**, në vetën e dytë shumës, po ashtu në vetën e parë njëjës kemi praninë e spirantizmit, pra ndërrimin fonetik të bashtingëllore **-s:-t-** :

( *bërtas, bërtet, bërtet, bërtasin, bërtitni, bërtasin* ).  
 ( *Sustantivin pullaz ti e merr vesht. f.154 (G.Sh); ( Kshtu: ju pigni. f.126 (G.Sh); (...a provë qi dalin prej s'paamit. f.1 (P.L.L); ( Per kta po flasim n'peremra pvetës. f.82 (G.Sh).*

<sup>69</sup> A.Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909, f.91.

<sup>70</sup> T.Osmani, *Traditja dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, 4, Anton Xanoni personalitet i nderuar i kulturës shqiptare, Shkodër, 2014, f. 199.

<sup>71</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f. 279.

Në zgjedhimin e tretë foljet dalin me temë në zanore, por në dy vetat e para të numrit njëjës kemi ndryshim të gjatësisë së zanores, pasi ajo shërben për të bërë dallimin e formave foljore. Këto folje në vetën e tretë, numri njëjës marrin mbaresën **-n**, mendoj se ky është një tipar i gegërishtes, sepse ndeshet edhe tek autorë të tjerë veriorë dhe është përfutur në analogji me zgjedhimin e parë. (*Emnat e fisit i veim gjithmoon... f.48 (G.Sh.)*)

Foljet e parregullta supletive edhe ato josupletive paraqiten si më poshtë:

Tema e foljes **kam** (*kam, kee, kaa, kena, keni, kan*) paraqet këto ndërrime fonetike: **-a-:-e-** në vetën e dytë njëjës dhe vetën e parë e të dytë shumës, por kemi edhe dyfishim të zanoreve në vetën e dytë e të tretë (*ee, aa*). (...*vedi kah kam vleren e poeziis. f.7 (P.L.L)*); (...*Shka kee zog. f.68 (P.L.L)*); (...*e kena edhe një tieter fieshtë Italian. f.12 (P.L.L)*).

Tema e foljes **jam** (*jam, jee, âsht / â, jena, jeni, janë*) në vetën e dytë njëjës dhe dy vetat e para të shumësit pësojnë ndërrim nga **-a,-e** (*jam, jee, je-na, je-ni*), ndërsa veta e tretë njëjës del me ndryshim teme *jam* : *âsht / â*. Ndërrimi */-a~/ -e/* te *jam* e *kam* është shpjeguar nga disa gjuhëtarë si shfaqje metafonie, por prof. Sh. Demiraj shprehet se këtu kemi të bëjmë me ndikime analogjike të ndërsjellta midis foljeve *jam* e *kam*.<sup>72</sup> (...*t'knaqin kuer jee n'shpii. f.7 (P.L.L)*); (...*kuer jena me artikull.f.46 (G.Sh)*); (...*Jam këtu mrëndë si rob i lidhun. f.68 ( P.L.L )*); (...*Jee per shatë. f.65( P. L.L )*); (...*E permendum âsht e thanuna e Fenelonit f.5 ( P. L.L )*).

Tek folja e parregullt josupletive **them**: *tham, thue, thoot, thona, thoni, thoon*. Diftongimi i zanores **-a-** në **-ue** në vetën e dytë, numri njëjës mbetet i paqartë,<sup>73</sup> ndërsa për të dalluar vetën e tretë njëjës përdoret gjatësia e zanores **-oo-**. (*S'po tham se tii kee lueit die gjith ditën e lume. f.69 (P.L.L)*); (...*e ç'ka m'thue per te? f.60 ( G.Sh)*); (...*M'i thuei do substantiva ... f.29 (G.Sh)*); (...*prandei thohet njeis... f.79 (G. Sh )*); (...*e thohen harte t'bukura a t'liirta. f.3 (P. L.L )*).

Tema e foljes **dua** në vetën e parë njëjës del me togun zanor **-ue-**, të cilin në vetat e tjera e monoftongon në **-o-**, pra **-ue-:-o-**. (*due; don/do, don/do, dona, doni, doin*). Diftongimi i */-o/-së* në *-ue* gegërisht, burimisht ka qenë një dukuri thjesht fonetike, në shumë raste ka marrë vlerë morfologjike në sitemin foljor e emëror.<sup>74</sup>

<sup>72</sup> Sh.Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, f. 266.

<sup>73</sup> Po aty, f. 268.

<sup>74</sup> Po aty, f. 46.

**Zgjedhimi jovepror.** Kjo kohë e ndërton zgjedhimin e saj duke i bashkangjitur temës së foljes mbaresat *-(h)em, -(h)esh, -(h)et, -(h)emi - (h)eni, -(h)en / -em, -esh, -et, -emi, -em, -eni, -en.*

Po i shohim më konkretisht tek Xanoni këto përdorime foljore, të cilat janë më të larmishme për sa i takon përdorimit të saj krahasuar me kohët e tjera.

*(...kû rrahen e persajaten punë shkencore, letrarishte e hartistike, botohen e peshohen shkrimet qi dalin n'dritë, e mbahen e hapen neper komb parimet e t'vertetes, t'mires, t'bukuriis e t'vieftes. f.8 ( P.L.L ).<sup>75</sup>*

Dallimet e kësaj forme në krahasim me gjegjësen e saj veprare janë:

-Foljet e zgjedhimit të parë nuk pësojnë ndryshime në temë, nëse në trup të tyre nuk kanë grup zanor, si: *perdoroi-perdorohem, difton-diftohe.*

-Foljet e zgjedhimit të parë me grup zanorësh në temë e bjerrin këtë grup krahasuar me formën veprare, pra e monoftongojnë, si **-ye-, -ua-, -ie-**, të cilat dalin si në standard: *thyej: the-hem.* ( përdorime të Xanonit)

*(Mica e ndyme bâhet drangue. f.22( P. L.L ); (... fiala nji perdorohet me substantiva njejës. f.59 ( G. Sh ); (...na t'rritun gadis kuitohena. f.30( P. L.L ; ) (...e n't'afermin t'onë e mrekullohena nder atributa e nder vepra t'tija. f. 25( P. L.L ).*

- Foljet e zgjedhimit të dytë me temë në bashkëtingëllore pësojnë ndryshime brenda saj, si **-a- :-i-, -o- :-i-** dhe të bashkëtingëlloreve **-s-: -t-** në foljet: si vras-vritesh.

-Foljet e këtij zgjedhimi nuk marrin alomorfet me **-h-**, por dalin me mbaresat, si **-em, -esh, -et** në tri vetat e njëjësit dhe **-eshim, -eshit, -eshin** për tri vetat e shumësit. *(U falem me shnet atyne... f.66 ( G. Sh ); (...i tha nana e s'mundesh me ndêjë... f.38( P. L.L ); ( Ktu tfaqet, thotë Tolomei... f.22( P. L.L ); ( ...qi njiiten n'fund t'substantivave. f.44 ( G. Sh ).*

-Foljet e zgjedhimit të tretë, me temë në zanore, pësojnë ndryshime në temë **-ë-: -i-** ( vë: *vi-hem* ), ndërsa mbaresat vetore të këtij zgjedhimi janë analoge me ato të foljeve të zgjedhimit të parë.

*(...me kto ngrehet e diftohet qytetria e kombeve....f.6 ( P. L.L ); ( kuer janë t'paskajuem xêhen.. f.69 ( G. Sh ).*

<sup>75</sup> A.Xanoni, *Prësi n'Lâmë t' Letratyrës*, Shkodër, 1912, f.8.

Veta	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
	Forma veprore	Forma veprore	Forma veprore	Forma joveprore	Forma joveprore	Forma joveprore
Unë	bâ-i	dal <sup>76</sup>	dii <sup>77</sup>	perdoro-hem	lyp-em	xê-hem
Ti	bâ-n	del	dii	perdoro-hesh	lyp-esh	xê-hesh
Ai/a jo	Bâ-n/bâa-n	del	di-n	perdoro-het	lyp-et	xê-het
Ne	bâ-im	dal-im	di-na	perdoro-hena	lyp-ena	xê-hena
Ju	bâ-ni	dil-ni	di-ni	perdoro-heni	lyp-eni	xê-heni
Ata/ato	bâ-in	dal-in	di-n	perdoro-hen	lyp-en	xê-hen

**Koha e pakryer.** *Koha e pakryer shpreh parakohësi në lidhje me ligjërimin. Ajo s'është gjë tjetër veç një e ardhme e së shkuarës*<sup>78</sup> Në gjuhën letrare të gjitha foljet në të pakryer marrin mbaresat: *-ja, -je, -nte(-te), -nim, -nit, -nin*<sup>79</sup>, ndërsa në veprat e analizuara të Xanonit mbaresat e kohës së pakryer janë: *-she, -she, -te, -shim, -shi, -shin*. Në dialektin verior gjatë shekujve të fundit janë shfaqur edhe mbaresa vetore të reja të së pakryerës të zgjeruara me *-sh ose- jsh*, të cilat janë përfutur nën ndikimin analogjik të së pakryerës të foljeve *ja-m e ka-m: ish-a, ish-e etj.*<sup>80</sup>

Gjatë analizës të kësaj kohe kemi vënë re se, një numër i konsiderueshëm i foljeve në kohën e pakryer kanë temë të njëjtë me ato të kohës së tashme: *doshe, doshe, dote, doshim, doshi, doshin*.-Foljet e zgjedhimit të parë dalin me tema të njëjta gjatë gjithë paradigmës: *laj-lajshem; veproj-veprojshem*. (Un mënde lehti *kuitoshe se pshatit...* f.73 ( P. L. L ); (...Kingjat i vêshe n'giasë ; i *krahasoishe*. f.77 ( P.L.L );( ...i cilli nuk *dote* kurr me u la... f.42 (P.L.L); (...Faqet e duet i *laate* shpesh e i kishte... f.41 (P.L.L) etj. -Foljet e zgjedhimit të dytë në vetën e parë pësojnë ndërrimin e **-a-:i-**

<sup>76</sup> A.Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909, f.116.

<sup>77</sup> Po aty, f.116.

<sup>78</sup> Sh.Demiraj, *Morfologji historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1985, f. 740.

<sup>79</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f.287.

<sup>80</sup> Sh.Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, f. 274.

( *flas:flitshem* ) -**a-:-e-** ( *marr-merrshem* ). (... *Per çka ti zotat e zymnueme i klithshe...* f.77 ( P.L.L ); (... *Tefa merrte ngrykë.* f.41 ( P.L.L ); (... *Fialet e tija ulshin dheen.* f.62 ( P. L.L ).

-Foljet e zgjedhimit të tretë nuk paraqesin ndonjë ndryshim në temën e tyre nëse i krahasojmë me ato të kohës së tashme ( *di-dishem* ). (... *E diite ajo se veprore keq.* f.35 ( P.L.L ); (... *E kuei n'lis t'vet i lêishe varun mollat..* f.77 ( P.L.L ).

Koha e pakryer paraqet interes, sepse ka tipare dialektore, mbase edhe individuale. E them individuale, sepse në vepra të tjera të shkruara në gegërisht veta e parë gjendet me formatin

-**shem**, (tek Xanoni), konkretisht tek gramatika e tij ai e paraqet me mbaresën -**she**, të njëjtë me vetën e dytë njëjës. Pra, veta e parë dhe e dytë e së pakryerës dallohen nga konteksti në të cilin përdoren. Veta e tretë njëjës e kohës së pakryer merr mbaresën -**te** tek të gjitha foljet: zgjedhimi i parë, i dytë, i tretë apo tek foljet e parregullta. Tek shumësi kemi mbaresat: -**shim**, -**shi**, -**shi**.

Veta	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
<b>Unë</b>	laa-she	merr-she	dii-she
<b>Ti</b>	laa-she	merr-she	dii-she
<b>Ai/ajo</b>	laa-te	merr-te	dii-te
<b>Ne</b>	laa-shim	merr-shim	dii-shim
<b>Ju</b>	laa-shi	merr-shi	dii-shi
<b>Ata/ato</b>	laa-shin	merr-shin	dii-shin

Me interes janë foljet **jam**, **kam**, **them**, pasi këto pësojnë ndryshime të dukshme gjatë paradigmës.

\* *kam/kishem, kee/kishe, kaa/kishte, kena/kishim, keni/kishi, kan/kishin*

\* *jam/ishem, jee/ishe, â/âsht/ishte, jena/ishim, jeni/ishi, janë/ishin*

\* *tham/thoshe (thoshem), thue/thoshe, thoot/thote, thona/thoshim, thoni/thoshi, thoin/thoshin*

-Për sa i takon ndërrimit të -**e-:-i-**, që foljet **kam** dhe **jam** kanë pësuar në kohën e pakryer, ata janë përfutur më parë në vetën e tretë shumës e që këtej është shtrirë për analogji edhe në veten e tretë njëjës e më pas në të gjitha vetat e tjera.<sup>81</sup>

<sup>81</sup> Sh. Demiraj, *Morfologji historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f.745.

(...n't cillen vertyti s'ishte një ...f.5 (P.L.L); (...Petkat i kishte gjithmonë dëliirt... f.41(P.L.L); (... n't'cillen vertyti s'ishte një êmen i mrazhtë...f.5( P. L.L ); (...molla ishte e çartun. f.41( P. L.L )

-Edhe tek tema e së pakryerës së foljes **tham(them): thoshe** ka vepruar analogjia (-a-:-o-). Këtu kemi edhe ndërrimin e -ue-:-o- , ndërsa /-sh/ është shtuar nën ndikimin analogjik të së pakryerës së foljes jam: jesh-ë dhe të kam: kesh-ë.<sup>82</sup>

Veta	Folje të parregullta supletive	Folje të parregullta supletive	Folje të parregullta josupletive
<b>Unë</b>	Ki-she/ki-shem	ishem	tho-shem
<b>Ti</b>	ki-she	ishe	tho-she
<b>Ai/ajo</b>	ki-shte	ishte	tho-te
<b>Ne</b>	ki-shim	ishim	thoshim
<b>Ju</b>	ki-shi	ishi	tho-shi
<b>Ata/ato</b>	ki-shin	ishin	tho-shin

**Koha e kryer e thjeshtë.** Prof. Sh. Demiraj mendohen se kjo kohë për nga kuptimi i përgjigjet aoristi ( e kryera e thjeshtë) e gjuhëve i.e. Ai thekson se edhe për nga ndërtimi, format foljore të kësaj kohe e kanë ruajtur deri në një farë mase kundërvënien e hershme mes aoristit sigmatik dhe aoristit asigmatik<sup>83</sup>: jap-dhashë, ha-hangri etj.

(...qytetnore raan posht' e jau muerne kamben... f.5 (P.L.L); (Eva u rreit prei shpirtit t'mallkuem e e hangri mollen... f.35 (P.L.L).

Në veprat e Xanonit tek kjo kohë vërejmë ndryshime të karakterit fonetik e morfologjik, si tek temat, ashtu edhe tek mbaresat përkatëse.

-Foljet e zgjedhimit të parë me temë me tog zanoresh -ua-, -ye- e mbledhin këtë tog në -o-, -a-, -e-, p.sh.; shkruaj-shkrova, thyej-theva.

<sup>82</sup> Sh.Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, f. 267.

<sup>83</sup> Sh.Demiraj, *Morfologji historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 778.



-Foljet e këtij zgjedhimi në vetën e parë dhe të dytë njëjës përpara mbaresës **-a, -e** marrin një-**v-** antihiatizuese.<sup>84</sup> P.sh. *bisedo-n : bisedo-v-e*.

-Foljet e po këtij zgjedhimi në vetën e tretë njëjës mund të dalin me trajta të ndryshme, sipas klasave. Pjesa më e madhe e tyre dalin me mbaresën **-i**, por edhe me mbaresën **-u**: *ban-i, le-u, mrapshto-i. etj.*

-Po këtu, shohim se tri vetat e shumësit e zgjerojnë përsëri temën me togun zanor, përkatësisht

**-ue/-ua-, -ye- : kallxueme**. Mbaresat vetore të këtyre tri vetave janë; **-me -të, -n/-ne**.

-Foljet e zgjedhimit të dytë e ndërrojnë tingullin në temë, si: **-e:-i-, -a:-o-, -e/-je:-o-** në të gjitha vetat e kësaj kohe, si *pres/prita, marr/mora, djeg/dogja* etj., pra kemi shfaqjen e apofonisë. Këtu përjashtohet veta e tretë njëjës, por tek Xanoni e ndeshim edhe në vetën e tretë shumë: *marr-mora -muer -muerne*.

-Po në temë identifikohen edhe qiellzorizimi **-k:-q:-gj-** në të gjitha vetat e foljes tek foljet e tipit *djeg:dogja*.

-Foljet e zgjedhimit të tretë e formojnë këtë kohë me zgjerim teme me **-n** (*vu-n-a*) ose **-t** (*di-t-a*).

-Mbaresat për foljet e zgjedhimit të tretë janë: **-ta, -te, -ti** (numri njëjës), **-tme, -t/-të, -tne** (numri shumë). *Prapashtesa -t-, -shprehet studiuesi Sh.Demiraj, - ndeshet si tek autorët e vjetër të Veriut ashtu edhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë dhe të Italisë, kjo është shfaqur qysh shumë kohë përpara shekujve XIV-XV.*<sup>85</sup>

-Ajo që bie në sy është përdorimi i disa foljeve të zgjedhimit të dytë si *djeg* (me diegë), *marr* (me marrë), *vras* (me vraa), etj., të cilat autori në gramatikën e tij i merr si folje të parregullta.

-Në disa folje të parregullta autori zëvendëson prapashtesën temëformuese **-sh-** me **-ç-** psh. *kieshë/kieçë, thaçë, laçë*.

-Folja e parregullt **them** pëson këto ndryshime gjatë zgjedhimit në kohën e kryer të thjeshtë: veta e parë, e cila ka në temën e saj **-a-** në e zgjeron togun në **-ae-** në vetën e dytë, ndërsa në vetat e tjera e monoftongon përsëri në **-a-** (*thaçë, thae, tha, thame, thaat, thane*).

-Folja *ishte-kieshe/kieçë* e monoftongon edhe kjo ashtu si folja **them** togun **-ie-** në **-e-** në vetën e dytë (*kieçë-kiee*), por në vetat e tjera diftongohet përsëri në **-ie-** (*kie, kiemë, kietë, kienë*).

<sup>84</sup> Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia Shqiptare III*, E folmja e Kelmendit, Tiranë, 1975, f.53.

<sup>85</sup> Sh.Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, f. 280.



-Folja **kam-pata në** vetën e parë dhe të dytë njëjës del me mbaresat **-a, -e**, ndërsa në vetën e tretë me mbaresë zero, kurse mbaresat e shumësit i ka të njëjta me foljet e tjera.

Veta	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë	Folje të parregullta supletive/josupletive
Unë	fillo-v-a	mor-a	dit-a	Raash/thaçë
Ti	fillo-v-e	mor-e	dit-e	Rae/thae
Ai/ajo	filloi	muer	dit-i	Raa/tha
Ne	fillu-me	muer-me	dit-me	Rame/thamë
Ju	fillu-t	muer-t	ditt	Raat/thaat
Ata/ato	fillu-ne	muer-ne	dit-ne	Rane/thane

Këto folje formën joveprorë e ndërtojnë me pjesëzën **u**, e cila paravendoset para formave vetore të foljeve të po kësaj kohe në dëftore<sup>86</sup> (...t'cillave u bânhet lindsija fëmnore. f.51 ( G. Sh ).

-Në vetën e tretë njëjës pjesëza **u** i paravihet temës së foljes pa mbaresën vetore **-i**, si: *bâni- u bân, rreiti- u rreit* etj.

-Foljet me temë më **-o-** ose **-e-**, me përjashtim të foljes **blej**, në vetën e tretë njëjës e zërthejnë zanoren fundore të temës në **-ua** përkatësisht **-ye**, si: *shkroi- u shkrua, ktheu- u kthye* etj.

**Koha e ardhme.** *Kuptimi themelor i të gjitha kohëve të së ardhmes është të tregojë një veprim që pritët të kryhet pas çastit të ligjërimit.*<sup>87</sup> Për të shprehur kuptimin e të ardhmes, me të gjitha kohët e saj A.Xanoni përdor pak kohën e ardhme të ndërtuar nga pjesëza **do** + **lidhore**, pasi fut në funksion dy trajta të tjera për të shprehur këtë veprim që do të kryhet pas çastit të ligjërimit, të cilat janë:

**-kam + paskajoren gege me pasë** ( *ka me thanë, keni me kenë* etj.)

**-kam + paskajoren standarde për t'ardhë** ( *kee për t'ardhë, kaa për t' mueit*. etj )

**-do + paskajore gege**<sup>88</sup> ( *do me thanë, do me kenë* )

*Kjo formë e fundit,- shprehet studiuesi Gj.Shkurtaç, -edhe pse mund të përdoret, e ka zbehur kuptimin e saj volitiv.*<sup>89</sup>

<sup>86</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f.303.

<sup>87</sup> Po aty, f.316.

<sup>88</sup> A.Haxhi, *Proza e Fishtës në pamje gjuhësore*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2003, f.124.

<sup>89</sup> Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia shqiptare*, III, E folura e Kelmendit, Tiranë, 1975, f.55.

E ardhmja e tipit **do + e tashme e lidhore**, është formuar me paravendosjen e pjesëzë **do** me origjinë foljore, formave vetore të foljes në kohën e tashme të mënyrës lidhore, psh. *Do t'jeet, do t'a perciellin* etj. “Kjo formë e së ardhmes duhet të jetë formuar shumë shekuj para fillimit të shqipes, sepse del e konsoliduar si formë që tek dokumentet e para shkrimore, atë e gjejmë që prej fjalorthit të Arnold Fon Harfit, në formën *dotaple*, për “*do ta blej*”, ndeshet vetëm një herë tek Buzuku, *a nuk do të pi këlqinë që më urdhënoi ati?*, megjithatë përdoret kryesisht në toskërisht e më pak në të folmet gege.”<sup>90</sup>

Veta	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
Unë	Do t' synoi	Do t'vras	Do t'xaa
Ti	Do t'synosh	Do t'vrasesh	Do t'xaash
Ai/ajo	Do t'synoin	Do t'vrasin	Do t'xaan
Ne	Do t'synoim	Do t'vrasim	Do t'xaaim
Ju	Do t'synoni	Do t'vrisni	Do t'xaani
Ata/ato	Do t'synoin	Do t'vrasin	Do t'xaan

Format joveprore e kësaj kohe i përket grupit të formave foljore të zgjedhimit me anë të mbaresave: -em/-hem, -esh/-hesh, -et/-het, -emi/-hemi, -eni/-heni, -en/-hen, të cilat i marrin këto mbaresa kur foljes i paravendoset pjesëza **do + e tashme e lidhore**.

(*Fiala do t'jeet veç per sherbim t'mendimit , e mendimi s'do t'jeet per tieter veç per t'vertetën e per vertytin. f.5 (P.L.L.);(Tui pezuullumun n'shkamb:s'do t'këndoi mâa.. f.79 (P.L.L ); (Mëndia e tii do t'jeet e zoja. f.9(P.L.L); Do t'ngulna e nder britan kreit daa prei botet. f.78 ( P.L.L ); Qellimi ku do t'synoin ç'do ndertim. f.33(P.L.L)etj.*

Koha e ardhme e së shkuarës. *Kuptimi themelor i kohës së ardhme të së shkuarës është të tregojë një veprim, që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës.*<sup>91</sup> Kjo kohë në veprat e autorëve veriorë ndërtohet me anë të pjesëzës **do + e pakryera e lidhore** (*do të shkojshe*). Në veprat e analizuara të Xanonit nuk kam gjetur ndonjë rast të përdorimit të kësaj të ardhmeje, konkretisht kjo e ardhme ndërtohet nga folja ndihmëse **kam+**

<sup>90</sup> M. Priku, E. Koperaj, *Foljet ndihmëse në gegërisht dhe roli i tyre në ndërtimin e kohëve analitike të shqipes*, Studime shqiptare, 15, Shkodër, 2010, f. 85.

<sup>91</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002 , f.317.

**paskajore** (*kishte me kënë, kishin per t'i dhan etj* ), me kuptimin e së ardhmes të së shkuarës.

(*kishin per t'i shkue kundra... f.13(P.L.L)- (për do t'i shkonte); (...s'kishin per t'bâa dâm... f.27(P.L.L).*)

Si përfundim, mund të themi që Xanoni në veprat e tij përdori larmishmëri formash sintetike tek foljet e mënyrës dëftore. Ai shfrytëzoi jo vetëm lëndën gjuhësore të pasur që ofronte gegërishtja, por edhe risitë dhe vendimet që merreshin gjatë asaj periudhe nga gjuhëtarët më të mirë për pasurimin dhe njësimin e dialekteve të gjuhës shqipe. Mjeshtëria dhe lirshmëria e përdorimit të këtyre formave tregojnë edhe një herë pasurinë e madhe që posedon vetë ky dialekt.

#### **BIBLIOGRAFIA:**

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f.279.
2. Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, f.46.
3. Demiraj Sh., *Morfologji historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1985.
4. Priku M., Koperaj E., *Foljet ndihmëse në gegërisht dhe roli i tyre në ndërtimin e kohëve analitike të shqipes*, Studime shqiptare, 15, Shkodër, 2010.
5. Haxhi A., *Proza e Fishtës në pamje gjuhësore*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2003.
6. Shkurtaj Gj., *Dialektologjia Shqiptare III*, E folmja e Kelmendit, Tiranë, 1975.
7. Xanoni A., *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909, f.136.
8. Xanoni A., *Prësi n'Lâmë t'Letratyrës*, Shkodër, 1912.

### **The synthetic time formats used by A. Xanoni**

#### **ABSTRACT**

The mode category plays an important role in the Albanian verbal system, as it is one of the main means of expressing modality, that is, the speaker's attitude towards what he says. All this is accomplished through a variety of polysemantic forms, which contrast each other even from the point of view of modality. Forms of the indicative differ from other ways, both for construction and the modal meaning of authenticity. The way it stands is manifested with a variety of synthetic and analytical forms.

In this paper we have focused mainly on some synthetic structures of the verbs in the indicative mode, relying on the grammatical work

“Grammatika shqyp” published in 1909 and in "The Pride in the Literature of Literature, Shkodër, 1912". The author used not only the rich linguistic content offered by gegely, but also the novelties and decisions taken during that period by the best linguists for the enrichment and unity of the dialects of the Albanian language. The craftsmanship and the freedom to use these forms show once again the great wealth that this dialect posed.

Elvis BRAMO

## VËSHTRIM ANALITIK SINTAKSOR I GJUHËS SË PËRKTHIMIT TË DHIATËS SË RE NGA VANGJEL MEKSI

### Hyrje

Na vjen përnderim që brenda kësaj hyrjeje të këtij shkrimi për rrafshin sintaksor të përkthimit të Vangjel Meksit e me redaktim të Grigorit të Gjirokastrës, në nivelin e njësisë së frazës, të sjellim një pasazh nga vepra në dorëshkrim e prof. Kolë Ashtës,<sup>92</sup> për leksikun historik të

<sup>92</sup> Fragmenti i studimit të pabotuar të prof.K.Ashtës, u mor nga biblioteka e T.Topallit, një ndër redaktorët e opusit të serisë prej 7 vëllimesh “**Leksiku historik i gjuhës shqipe**”. (shënimi im, *E.Bramo*)

*Për sintaksin. Sintaksi i foljes. Kur kryefjala është emër kolektiv në njejës, por që kuptimi i tij jep idenë e shumësit, atëherë kallëzuesi është një folje, që Vangjel Meksi e përdor në shumës duke e lidhur në këtë mënyrë me kryefjalën: «u çuditë llaoi në dhidhahi të tij» M 7, 28; «bota çuditë shinë e thoshnë» M 12, 23.*

*kallëzuesi është një folje, që Vangjel Meksi e përdor në shumës duke e lidhur në këtë mënyrë me kryefjalën: «u çuditë llaoi në dhidhahi të tij» M 7, 28; «bota çuditë shinë e thoshnë» M 12, 23.*

*Sintaksi i emrit me parafjalë. Plotësorët mund të jenë të thjeshtë ose të përbërë morfologjikisht nga një parafjalë dhe një emër, pra të dy së bashku japin një njesi sintaksore. Ka parafjalë të lidhura sintaksisht me një emër të një rase të caktuar, por pastaj shkojnë me një rasë tjetër të emrit. Parafjala nga përkon me një emër të rasës emërore, kurse Vangjel Meksi e lidh me atë të rasës rrjedhore: një herë thotë «kree atë e shtjere ngaha teje» M 5, 29 që ndryshej mund të shprehet: hiqe ate e largoje prej teje. Parafjala tek përputhet me emrin e rasës emërore, kurse në tekstin del përpara rasës rrjedhore të emërit: «ti vjen tek meje» M 3, 14, ti vjen tek unë; «ajo bëri punë të mirë tek meje» M 26, 10, ajo bëri punë të mirë tek unë.*

*Fjalja mohore. Lidhëza, e cila shërben për të lidhur fjalën ose fjalinë me një tjetër, mban një kuptim. Përdoret as si lidhëzë me kuptim mohues e fjalja mohore, që lidhet me të, kërkon edhe një pjesë tjetër mohuese s ose nuk; dy fjalë mohuese në fjalinë shqipe nuk japin pohim si në ndonjë gjuhë tjetër. Përkundrazi ai shkruan «as fotinë e dhezjënë e e venë ndënë modh, po e venë mbi samdan, e ndrit gjithë ata që janë në shtëpi» M 5, 15, as kandilin nuk e ndezin e nuk e venë nën shinik (një lloj bobinie e madhe), po e venë mbi shalldan e ndrit mbi gjithë ata që janë në shtëpi.*

*Fjalja e bashkërenditur. Punimi i Vangjel Meksit është përkthim nga greqishtja në shqipen kështu që është bashkërenditja e fjalive i përket për një pjesë të madhe origjinalit, por sadopak edhe përkthimit. Fjalitë e bashkërenditura këtu janë të shumta,*

gjuhës shqipe; këtu: për përkthimin e Dhiatës së Re, që tashmë është në proces botimi. Që në fillim duhet pohuar se nuk ka ngjarje kulturore, gjuhësore dhe botuese të kësaj periudhe në vendin tonë, që të mos lidhet me emrin e madh të atij që u vetëquajt dhe u quajt prej bashkëkombësve “babai i gjuhës shqipes”, K. Kristoforidhi. Me studimet e thella për gjuhën shqipe, që në rini, Kristoforidhi arriti të imponohej si njohësi më i mirë i shqipes në kohën e vet,<sup>93</sup> për të cilin Tomsoni do të shkruajë: “*E kam përmendur shpesh se z. Kristoforidhi është pa dyshim studiuesi më i aftë i kombit për gjuhën amtare, e mund të them se pas vdekjes së të ndjerit prof. Kupitor në Athinë verën e kaluar, është i vetmi studiues i mbaruar i shqipes.*”<sup>94</sup> Ky rilindës i madh ka dëshmuar se jo vetëm e njëj gjuhën amtare në nivele të larta shkencore, por është edhe një zotërues i thellë e dy kryedialekteve të saj, edhe pse deklaronte se dallimet dialektore të shqipes janë tepruar.<sup>95</sup>

### Parime të përkthimit të veprave liturgjike

Në historinë e lëvrimin dhe mbrojtjes së gjuhës sonë, me germa të arta ka hyrë dhe mbetur në jetësinë e shqipes memorandum i këtij njeriu të shquar të kulturës sonë kombëtare, dokument që sot do të mund të quhej “normë e përdorimit të gjuhës së folur e të shkruar shqipe.” I paraqitëm më lart parimet, të cilat i kishte kthyer në kanone të pashkelshme vetë Kristoforidhi këtu e 150 vjet më parë, gjatë punës me gjuhën, kanone që ai vetë i zbatoi me përpikëri në punën me gjuhën, si të ishin Urdhrat e Moisiut. “Nenet” e eptalogut siç e quajtëm më sipër, na kanë shërbyer edhe për një analizë të strukturës së njësive sintaksore të përkthimeve biblike, jo vetëm ato të K. Kristoforidhit, por edhe të paraardhësve e pasardhësve të Babait të shqipes.<sup>96</sup>

Është vendi të rikujtohet se, pothuaj të gjitha letërsitë e mëdha evropiane kanë zënë fill me përkthimet biblike, të cilat kanë qenë baza edhe të gjuhëve letrare, siç ka ngjarë me gjermanishten, pas përkthimit të Biblës

---

*ku përdor më tepër lidhëzën e se sa edhe.*<sup>92</sup> «vurri (fitepsi) një vesh të e e thuri atë me gardhe e rëmoi» M 21, 33.

<sup>93</sup> Lloshi, Xh. Kristoforidhi përmes dokumentimit, Bota Shqiptare, Tiranë, 2005, f. 16

<sup>94</sup> Po ai, po aty, f.16. (Më gjerë, studiuesi i mirënjohur ka dhënë edhe përcaktimin. “Vangjel Meksi e ka përfunduar përkthimin brenda afërsisht pesëmbëdhjetë muajsh. E vlen ta ritheksoj se kjo ndodhte në një kohë kur nuk kishte as alfabet të caktuar, as shkolla për të mësuar shqipen. Një punë të tillë, që nuk e realizuan gjithë shekujt e mëparshëm, munda ta bënte për kaq kohë vetëm një njeri, që kishte menduar me kohë për shkrimin e shqipes e ndoshta kishte fituar përvojë...”

<sup>95</sup> Lloshi, Xh. Mbështetje për gjuhën letrare, Toena, Tiranë, 1997, f. 18.

<sup>96</sup> Kristoforidhi, K. Vepra I, Silver, Elbasan, 2001, f. 282-283.

nga latinishtja prej Martin Luterit,<sup>97</sup> për të vijuar se në armenishten e vjetër daton shekullin V, e më tej dokumentet më të hershme të gjuhëve sllave janë përkthimet e teksteve biblike nga Cirili e Metodi.<sup>98</sup> Përkthimet dhe botimet e Biblës në gjuhën shqipe, qoftë edhe në fragmente të saj, siç kanë nisur shekuj më parë për çdo gjuhë, për secilin komb, janë ngjarje e dorës së parë, jo vetëm fetare, por më së pari kulturore, sidomos për popullin tonë, sepse gjuha, tradita e kultura shqiptare janë të dokumentuara me tekste biblike, saqë pa teprim mund të pohojmë edhe kështu: historia e përkthimeve, e motiveve biblike, liturgjike dhe katekistike është po ashtu edhe historia e shkrimit e leximit shqip.<sup>99</sup>

Tërë biblistët shqiptarë (nëse mund t'i quajmë kështu të gjitha ata që u përpoqën ta kthejnë në gjuhën amtare këtë libër),<sup>100</sup> me vepra të përkthyer ia arritën të komunikojnë shqip, që nga kumti bisedor deri tek ligjërata teologjike, nga lutja e të meshuarit shqip, deri tek filozofia. Për të ardhur te puna me gjuhën nga Kristoforidhi, studiuesit arrijnë në përfundimin se tashmë e kemi të pranishëm në gjuhën shqipe stilin biblik,<sup>101</sup> gjë që e gjejmë edhe si shfaqje stilistike me përsëritjen e mjeteve të lidhjes sintaksore midis përbërësve të njësive të ndryshme ndërtimore. Filologët, shkruan Xh. Lloshi, kanë përcaktuar se Dhiata e vjetër ka 5640 njësi leksikore dhe 35.543 herë të përsëritur lidhëzën **dhe**. Në Dhiatën e re janë 4800 fjalë dhe lidhëza **dhe** është përsëritur 10.648 herë.<sup>102</sup>

### ***Për gjuhën e përkthimeve biblike***

*Parë historikisht, ajo që bie në sy tek sintaksa e të gjitha përkthimeve biblike, edhe te Ungjilli i Mateut i V. Meksit (me redaktim të G.Gjirokastritit), janë bashkimet me parataksë. Kjo ngjet sepse strukturat me hipotaksë në njësitë e mëdha ligjërimore, si njësitë-fraza, dalin më të vona se ato me parataksë, mbasi shënojnë edhe një zhvillim psikolinguistik të gjuhës, si prirje drejt abstragimit dhe shprehjes së mendimeve më të*

<sup>97</sup>Dhima, Th. "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", UP-Fak.i Filologjisë, 27/1, Prishtinë, 2008, f.213.

<sup>98</sup> Topalli, K. QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010, f. 57.

<sup>99</sup> Gjergji, dr. Dom Lush. QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010, f. 92.

<sup>100</sup> Për Biblën, Shtjefën Gjeçovi thoshte se është libri më i përkthyer, më i botuar dhe më i lexuar në botë ose, është "*lashtësia e lashtësisë dhe risia e risisë për mbarë njerëzimin.*", sipas dr. Dom Lush Gjergjit, QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010, f. 92.

<sup>101</sup> Lloshi, Xh. QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010, f. 38.

<sup>102</sup> Po ai, po aty, f. 38.

*ndërlikuara; për shembull: “E ju qas edhe së ditit, // e i tha edhe atij, // ashtu e ai ju përgjigj // e i tha: // Unë zot, e nuk vate.” (f. 292)*

*Profesor E. Çabej, kur analizon sintaksën historike të gjuhëve indoevropiane (paralelizma me shqipen), vëren se “lidhur me bashkërenditjen dhe me nënrenditjen duhet të themi se në periodat e para mbizotëronte bashkërenditja, koordinimi, kur kemi të bëjmë me disa fjali. Fjalitë e koordinuara, të bashkërenditura, kanë mbizotëruar mbi fjalitë e subordinuara, të nënrenditura. Nënrenditja e fjalisë paravendon, presupozon një zhvillim mendor mjaft të përparuar. Që të lidhen fjalitë, domethënë një kryesore, të tjerat të varura prej saj, kjo supozon një zhvillim mendor që ka shkuar përpara. Mentaliteti primitiv do bashkërenditje, atë që W. Haversi e quan “mënyra numëruese, enumerative”. Mentaliteti primitiv nuk është në gjendje të gjeneralizojë, të nxjerrë gjenetiken, të përgjithshmen në dukuritë e veçanta. Për shembull, te përralla “Maro Përhitura” që ka mbledhur Holger Pedersen në anët e Çamërisë, kur pyetet heroina e përrallës si punohet liri, ajo e shtjellon procesin e punës, e zbërthen me këto folje: “ne e punojmë dhen, pa e kthejmë, pa e mbjellëm, pa e mbledhim, pa e lidhim, pa e shtipim, i marrëm farën, pa e ngarkojm, pa e shpiem në lum, pa e vulisim, pa e lëmë dhjetë dit, pa e nxjerrim, pa e ndëjm, pa e thajm, pa e lidhim, pa e ngarkojm, pa e shpiem në shtëpi, pa e manganisëm, pa e helmim me llapar, pa e bim shtëllung, pa e vëm në furk, pa e tjerrim, pa e mbushim boshtin, pa e mbledhëm e e bim lëmpsh, pa endim, pa e veshim”.<sup>103</sup> Pjesa e nënrenditur jepej me anë të pjesores veprore (participit aktiv), për shembull: njeriu që erdhi... njeriu ardhës.*

*Lidhur me këtë çështje Çabej thekson për më tepër, se në historinë e gjuhëve të veçanta i.e. nga koordinimi apo bashkërenditja, me kohë u zhvillua nënrenditja. Pyetja shtrohet: a ka pasur në gjuhët primare i.e. nënrenditje? Ka fillime të nënrenditjes, në gjuhët e dëshmuara shumë heret, shkruan Çabej, “veçse janë fillime shumë modeste. E vetmja fjali që mund të thuhet se në gjuhët e dëshmuara qëmoti del, është fjalia lidhore, fjalia relative. Kjo është mjaft e shpeshtë në fazën e vjetër të greqishtes, të indishtes së vjetër e të latinishtes. Të tjerat fjali dalin me zhvillimet e veçanta të gjuhëve të veçanta”.<sup>104</sup> Për ta përforcuar idenë e Çabejt, mund të sjellim një pasazh gjuhësor prej përkthimit të Dhiatës së Vjetër (Kriesa) nga Kristoforidhi:*

<sup>103</sup> Çabej, E. *Hyrje në indoeuropianistikë* (Leksionet e Prishtinës) Tiranë, 2008, f. 227.

<sup>104</sup> Çabej, E. *Hyrje në indoeuropianistikë* (Leksionet e Prishtinës) Tiranë, 2008, f. 228.



“**Edhe** gjithë dheu kishte një gjuhë e një zâ. **Edhe** kur u nisën prei së lemesë diellit, gjetën një fushë në dhet të Shinarit, **edhe** ndenjën atie. **Edhe** i tha njëni tjetrit: Eni le të bëjmë pëqisa e le t’i {piekim} diegimë në zjarr, **edhe** ata kishin pëqisa në vend të gurëve, **edhe** kishin pisë në vend të baltësë. **Edhe** thënë: Eni le të ndërtojmë për vetë një qytet, edhe një pyrg, të cillit (t’ia mbërrijë) maja deri në qiell; **edhe** le të fitojmë për vetë një emër, druse mos shpërndahemi mbi faqet të gjithë dheut. **Edhe** Zoti sdripi për me pamë qytetin’ **edhe** pyrgunë që ndërtoenë të bijt’ e njerëzëve. **Edhe** Zoti tha: Qe populli tek është një, **edhe** të gjithë kanë një gjuhë, **edhe** filluën me bëmë këtë, **edhe** tashti nukë do t’i ndalet’ atyne gjithë qish kanë ndër mend me bëmë, eni le të sbresimë, e (**dhe**) le të përziem’ atie gjuhën’ e atyne, që të mos i kuptojë fjalën njëni tjetrit. **Edhe** Zoti i shpërndau ata andej mbi faqetë të gjithë dheut, **edhe** (ata) lënë të ndërtoenit’ e qytetit. Prandaj u queit emëri ati Babel [të përziem], sepse atie përzieu Zoti gjuhën’ e gjithë dheut, **edhe** prei andy i shpërndau ata Zoti mbi faqet të gjithë dheut”.<sup>105</sup>

*Janë plot 18 lidhëza që u përkasin bashkimeve të njësisve me parataksë, të cilat sot mund të gjeneroheshin të kombinuara me bashkimet që do të kërkonin edhe lidhëza nënrenditëse. Dhe kjo është e shpjegueshme, duke njohur natyrën e gjuhëve satem, në të cilat u shkruan tekstet biblike e nga përkthehen në gjuhën tonë. Në një fazë shumë të hershme, shpjegon Sh. Demiraj, kur popujt që flisnin gjuhët a dialektet e tyre, ishin në gjendje tepër primitive, mendimi mbi veprimtarinë e tyre jetësore ka qenë përgjithësisht i thjeshtë e, si rrjedhim, edhe fjalitë e periudhat me të cilat shpreheshin këto mendime, kanë qenë fare të thjeshta. Krahas përparimit e zhvillimit shoqëror, erdh e u zhvillua edhe të shprehurit njerëzor me njësi më të gjata e të ndërlikuara, me lidhje parataktike e hipotaktike me disa shkallë. Një hov i dukshëm në këtë zhvillim ka ndodhur gjatë krijimtarisë popullore gojore dhe më vonë me zhvillimin e letërsive të mëdha. Për lëvrimin e mëtejshëm të strukturës së fjalisë e periudhës, në gjuhë të ndryshme janë ndjekur përgjithësisht dy rrugë:*

- a). *shtimi i vazhdueshëm i fjalëzave shërbyese (parafjalë, lidhëza, pjesëza) për të shprehur lidhje sintaksore dhe nuanca kuptimore nga më të ndryshmet;*

<sup>105</sup> Kristoforidhi, K. *Bibla në gegërisht. Kriësa. Të dalëtë*. Shoqëria Biblike, Tiranë, 2009, f. 44 – 49; përgatitur nga Xh.Lloshi).

b). përpunimi i vazhdueshëm i fjalisë dhe i periudhës për të shprehur edhe mendime e ndjenja nga më komplekset e më të ndërlikuarat.<sup>106</sup>

Vetëm duke lexuar pasazhin e mësipërm, vërejmë jo vetëm si shfaqen tipare të gjuhës sonë këtu e **140 vjet** më parë, por edhe kuptojmë se gjuha e përdorur nga shqipëruesi është shqip, e sigurt, e qëndrueshme dhe e arrirë në pikëpamje stili. Në teorinë sintaksore, nga njëra anë, ndërtime të tilla frazore quhen ndërtime të drejta dhe lënë shteg për vijimësi përbërësish predikativë infinitivë, kurse, nga ana tjetër, dëshmojnë një përkatësi të gjuhëve njerëzore/natyrore: mundësinë e ligjërimit të pashtershëm – si kompetencë, që nuk arrin tek performanca.

Në prozën e Dhiatës së Kristoforidhit nuk mungojnë rastet e frazave me strukturë të zhdrejtë, që nisin me njësi të varura funksionesh të ndryshme, të cilat kanë në brendësi të tyre alternime ndërtimesh me bashkërenditje dhe nënrenditje, si: kushtore (me lidhëzën e vjetër “ndë”), të vetme, apo të shoqëruar me mjete këpujore; gjithashtu, aktivizimi i formës të së ardhmes gege “kam me ba”, e cila përmban, përveç nuancës kohore të caktuar, edhe ngjyrimin e detyrimit, për shembull: “*Ndë mos të besofshin, as ndë mos ndigjofshinë zân’ e shenjësë parë, kânë me besuam zanit shenjësë dytë, edhe ndë mos u besofshin’ edhe këtyre të dy shenjave, as ndë mos ndëgjofshinë zânë tand, ke me marrë prei ujit lumit, edhe ke me derdhë mbi tokët, edhe ujëtë qi të marrish prei lumit, ka me u bâmë gjak mbi tokët.*”<sup>107</sup>

## Përgjithësime

Duhet thënë me bindje se te ky përkthim e redaktim, shqipja kishte gjetur pararendësin e denjë të Mjeshtrit të Madh, Kristoforidhit, si vazhdë e punës në lëvrimin e gjuhës sonë, edhe duke iu përmbajtur Memorandumit që kishte hartuar e shpallur rilindësi i shquar më vonë. Pa kërkuar këtu vend për shtjellime teorike të aktit të përkthimit, semiotistë dhe analizues të këtij veprimi gjuhësor, siç është për shembull, U. Eco, kanë nënvizuar se *hera herës amëtarizimet janë të domosdoshme, për arsye se teksti duhet të pajtohet me natyrën e gjuhës së mbërritjes*, pasi përkthimi nuk është thjesht një kalim nga një gjuhë në tjetrën, por edhe një kalim nga një kulturë në

<sup>106</sup> Demiraj, Sh. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985, f. 39 – 40.

<sup>107</sup> Kristoforidhi, K. *Bibla: (në gegërisht) - Kriesa. Të dalëtë*, Shoqëria Biblike, Tiranë, 2009, f. 140.

tjetrën, nga një enciklopedi në tjetrën.<sup>108</sup> Edhe pse jo me modele të shqipes, ky filolog i madh ka sjellë edhe faktin e përkthimeve biblike, për të cilat vë në dukje që *kanë synime arkaizuese dhe hebraizuese njëherazi dhe tentojnë të rikrijojnë atmosferën poetike të tekstit semitik*.<sup>109</sup> Këtij problemi i kanë kushtuar vëmendje edhe linguistë të tjerë si R. Jakobsoni, i cili para më se gjysmë shekulli (1959), ka studiuar aspekte gjuhësore të përkthimit dhe ka vënë në dukje që ekzistojnë tri lloje përkthimesh: *brendagjuhësor* (riformulim, rewording), *ndërgjuhësor* dhe *ndërsemiotik*.<sup>110</sup> Brenda këtyre përcaktimeve duhet t'i shohim përkthimet biblike, përfshirë edhe shqipërimet që kanë arritur të bëjnë përkthyesi e redaktori i Ungjillit pas Mateut, në 27 krerët që kemi bërë këtu objekt të vështrimit gjuhësor, duke u ndalur më së pari në dy njësitë e skajshme sintaksore, siç janë: sintagmat – si njësi ndërtuese për fjalitë dhe frazat – si njësi kumtuuese, që formësohen prej bërthamave predikative, fjalitë. Në shqipërimet Meksi-Gjirokastriti nuk ka ndarje në tekste të lidhura, siç jemi mësuar ta vështrojmë gjininë e prozës, por kufizimet në kapituj (krerë) përbëjnë tekste që copëzohen në fjali e fraza (periudha).

Të bien në sy formulimet ungjillore, se nisin me 2-3 fjali/fraza dhe lidhja apo bashkimet me parataksë arrihen nëpërmjet lidhëzës “e”; për shembull, në Kreun e parë, që ka 25 ndarje të tilla, pas 2 frazave të para, kalohet në paraqitjen e sekuencave dinamike (vepruese) dhe statike (përshkruese), duke përdorur 21 herë, si:

“23. Ja Vashëza do të bënë të me barrë, e do të pjellë djalë edhe do ta thonë emërit’ e tij Emanuel, që do të thotë Perndia me nevet.

“24. E si u ngre Iosifi nga gjumi, bëri si e porsiti Ëngjell’ i Zotit, e muar me vetëhe gruan ‘ e tij.”

“25. E nuk’ e njohu atë fare, gjersa polli djalën’ e saj të parën’ e të vetëminë, e i vuri emërin’ e tij Iusu.”<sup>111</sup> Gjithashtu, ka edhe lidhëza të tjera bashkërenditëse brenda indit të frazave.

Në këto struktura, po sjellim një pamje të ndërtimeve sintagmatike, llojet e tyre sipas kokave, lidhjet e marrëdhëniet dhe mjetet me të cilat realizohen këta tregues.

<sup>108</sup> Eco, U. Të thuash gati të njëjtën gjë (Përvoja përkthimi), Dituria, Tiranë, 2006, f. 193, 196.

<sup>109</sup> Po ai, po aty, f. 196.

<sup>110</sup> Po ai, po aty, f. 240.

<sup>111</sup> Lloshi, Xh. *Përkthimi i V.Meksit dhe redaktimi i G.Gjirokastritit*, Onufri, Tiranë, 2012, f. 254.

### Struktura e frazës dhe marrëdhëniet funksionale sintaksore. Mjetet e lidhjes midis përbërësve

Modeli në vijim, me ndërtim të zhdrejtë,<sup>112</sup> përdorur në një kontekst të caktuar, ka 5 QOS (qendra të organizimit sintaksor), vendosur në rendin e parë të skemës, që vijnë e plotësohen vetëm prej një njësie kallëzuese funksionale kohore, e cila është fjali drejtuese me fjalinë qëllimore që lidhet me të nëpërmjet pjesëzës “të” të lidhore:

*E //si porositi botënë //*

*të rrijnë mbi barëra, //*

*e mori të pesë bukëtë, edhe të di pishqetë//,*

*e vështroi ndë Qiell //*


*e i bekoi, //*

*e i theu, //*

*e u dha mathitivet bukëtë //*

*e mathitejtë i ndajnë ndë botë.*<sup>113</sup>

Nëse kërkojmë çiftëzimin sipas parimit të lidhjes hierarkike “fjali drejtuese/fjali e varur”, frazën<sup>114</sup> e skematizojmë si më poshtë:



Për raste të tilla duhet të mbështetemi te mendimi i gjenerativistit amerikan, N. Çomski, i cili shprehet: “Nëse modelet e strukturës gjuhësore ndërtohen në mënyrë rigoroze, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm, si negativ ashtu edhe pozitiv në vetë procesin e zbulimit.”<sup>115</sup> Me fjalë të tjera, strukturat e gjuhës ndjekin njëkohshëm strukturat e mendimit; për

<sup>112</sup> Quajmë kështu çdo strukturë fraze, me dy a më shumë përbërës predikativë, që nuk nis me fjali drejtuese.

<sup>113</sup> Lloshi, Xh. *Përktimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit*, Onufri, Tiranë, 2012, f. 178.

<sup>114</sup> Po përdorim këtu termin e parapëlqyer nga gjuhëtari M. Totoni në veprën “Sintaksa e gjuhës shqipe -Fraza e përbërë”, Arbëria, Tiranë, 2012.


<sup>115</sup> Çomski, N. *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, 2011, f. 25.

shembull, ndërtimi i frazës më sipër me 5 njësi fjalish drejtuese shfaq argumentimet e njëpasnjëshme që emeton autori i thënies.

**Për të kaluar drejtpërdrejt në nivelin e frazës (periudhës),** përmbledhim qysh në fillim se përgjithësisht, në përkthimin e V. Meksit mbizotërojnë njësitë-fraza, por nuk janë të pakta as strukturat kumtuese-fjali, të cilat dalin si në bashkime me parataksë (në pak lloje, sipas lidhëzave), ashtu edhe me hipotaksë, përqendruar në disa marrëdhënie funksionale, siç janë ato përcaktore, kohore, kushtore, rrjedhimore korrelative e pak të tjera. “Kjo, - sipas Çomskit, - nuk ka asgjë për t’u çuditur që gjuha ka një strukturë hierarkie,... shumë sisteme në natyrë, përfshirë sistemet biologjike dhe sistemet e njohjes, kanë strukturë hierarkie të një lloji apo të një tjetri.”<sup>116</sup>

*E dyta*, mjetet e lidhjes së përbërësve kallëzuesorë në frazë, janë më së tepërmi ato të rrafshit të prozës bisedore dhe të ligjërimin popullor.

*Së treti*, nuk mungojnë në struktura të tilla të frazave edhe bashkime përbërësish me mjete lidhëse zero, siç quhet dukuria pa mjete lidhëse sintaksore, të njohura në sintaksë. Për shembull, në ndërtimin *Eja, edhe Petrua zbriti nga varka, e ecën mbi ujëra të vin nde Jisui* në përbërësin e fundit predikativ (*të vin nde Jisui*) mungon lidhëza a fjala lidhëse apo korrelata, por një rol të tillë e luan pjesëza “**të**” e lidhës. Ndryshe nga marrëdhëniet funksionale përcaktore që krijohen në modelin e paraqitur, në shembullin vijues *Edhe Jisui //si dëgjoi, //iku me varkë, //e ndenji vetëm ndë vënd// që s’qe njeri, //e //si digjuanë bota, //vanë pas sij mbë këmbë nga qutetëtë*,<sup>117</sup> marrëdhëniet sintaksore kohore dhe përcaktore në dy përbërësit kallëzuesorë të *n/r*, përveç kuptimit, kanë edhe treguesit gramatikorë pamorë, lidhëzën kohore të parakohësisë “**si**” = “pasi” dhe fjalën lidhëse (përemrin lidhor “**që**”) = ku, me rol të dyfishtë: si lidhës dhe në funksion gjymtyror rrethanor. Ja dhe pamja skematike simetrike:



<sup>116</sup> Çomski, N. *Gjuha dhe problemet e njohjes* (Leksionet e Managuas), Toena, Tiranë, (2007), f. 48.



<sup>117</sup> Lloshi, Xh. *Përkthimi i V.Meksit dhe redaktimi i G. Gjirakastirit*, Onufri, Tiranë, 2012, f. 278.

Struktura si këto dhe të tjera, janë mjaft të dendura në kapitujt (krerët) që po marrim në analizë, ku gjejmë ndërtime frazash dyshe, bashkuar me lidhëza nënrenditëse, mjaft të qarta nga përcaktimi i marrëdhënieve, si: *E //si lishoi turmat'e njerëzet, //hipi ndë varkë. E ata thoshnë //se nuk muarm bukë. Qish nuk e kuptoni //se nuk' u thaçë juvet për bukë. I lumurë je ti Simon, i biri i Ionait, //se kurmi dhe gjaku nuk i dëftoi nde ti këto. Po //që të mos skandahalisjëmë ata, // hajde ndë det. Ndë mos u kthefi, //do të mos hini ndë mbretëri të Qiellvet. E ai// që të presë një të tillë djalë mbë emër tim, // më pret mua.* Të gjithë këta shembuj e të tjerë, do të quheshin me Gramatikën tonë normative “Periudha me fjali kohore, kundrinore, qëllimore, kushtore”, ku përbërësit janë bashkuar me mjete të lidhjes sintaksore të nënvizuara më sipër.

Ndonjëherë, sidomos në ndërtimet me më shumë se dy përbërës<sup>118</sup> predikativë, dalin marrëdhënie funksionale me strukturë simetrike, si në shembujt në vazhdim:

*E ndë mos digjoftë edhe ata, //  
thuaja qishësë edhe laoit, //e//ndë  
mos digjoftë edhe qishësë, //le jetë tek teje//  
sikundër është Ethnikoi edhe Teloni. (f. 285)*


*U thom me të vërteta, //sa të lidhni mbi dhe, //  
do të jenë lidhur ëndë Qiell, //e//sa të zgjidhni mbi  
dhe, //do të jenë zgjidhurë edhe ndë Qiell. (f. 285)*



Përveç ndërtimeve me parataksë, që vumë në dukje përgjithësisht si veçori të stilit fetar biblik, në shqipërimet e Meksit dalin jo pak edhe struktura të bashkuara me hipotaksë, ose që janë të ndërthurura edhe me bashkime parataktike, ku dalin në dukje marrëdhënie të ndryshme funksionale, si: kohore, kundrinore, shkakore, lejore, që shfaq fraza më poshtë:

<sup>118</sup> Termi “përbërës” u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik”, ILAR, Tiranë, 2012.

E //  
 tek mendonej këto me vetëhe të tij, //  
 na e ju duk atij mbë gjumë Engjëll'i Zotit, //  
 e i tha: //  
 Iosif i biri i Dhavidhit mos u friko //  
 të març me vetëhe gruanë tate Marianë, //  
 se ajo //  
 që u bë, // ndë ajo është nga Shënt Shpirt.<sup>28</sup>



E Josifi bur'i saj //sepse qe i drejtë, //e nukë duaj //ta tregon atë, //vuri ndër mend //ta lij atë fshehura //e të ikën.<sup>119</sup>


“Thyerja” e ndërmjetuar me përbërës kallëzuesorë të fjalës e parë drejtuese vjen mjaft e rëndë, por autori nuk bën rimarrje të referentit “Josifi”, pasi nuk ka kaluar “masa” e gjatësisë sintagmatike që do të kërkonte përsëritjen anaforike të subjektit.

Edhe kur fjalëza “që” del në rol të mjetit lidhës sintaksor, dallohen qartë funksionet sintaksore midis përbërësve, si në ndërtimin tresh më poshtë:

Edhe gjithë këjo u bë //..... fjalës drejtuese  
 që të paguhëtë ajo //..... fjalës e nënrenditur qëllimore  
 që u tha nga Zoti me anë të Profitit //..... fjalës e varur përcaktore  
 që thotë:<sup>120</sup> .....fjalës e varur përcaktore.

Ose, si në dy strukturat vijuese, ku ndërthuren disa marrëdhënie funksionale sintaksore e lidhëza multisemantike “si” prin tek fjalitë kohore të përkohësisë dhe ato mënyrore, ku dhe përsëritet lidhëza bashkërenditëse “edhe” (e, dhe) :

E //  
 si u ngre Josifi nga gjumi, //  
 bëri //  
 si e porositi Engjëll'i Zotit, //  
 e muar me vetëhe gruanë e tij.<sup>30</sup>  
 E //



<sup>119</sup> Po aty, f. 254.

<sup>120</sup> Termi “përbërës” u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 254.


si mbëjodhi gjithë të parët e Priftëret, edhe të Grammatepsurit e laoit, //  
 e i pieti ata //  
 të mpson //  
 ku vallë lehetë Krishti.

Edhe ti Vithleem vënd'i Iudhesë nukë je far e vogël ëndë zotërinj të Iudhesë, //sepse nga teje do të dalë zot, //që ai do të kulotjë laonë tim Israelnë.<sup>121</sup>

Edhe fraza me përbërës fjali nënrednditëse vendore, ndonëse të rralla, gjenden në përkthimin e Meksit, të ndërtuara në bashkëvajtje me përbërës të tjerë funksionalë dhe sipas rregullave normative të sintaksës së shqipes, si ndërtimi më poshtë, me frazën që mbyllet me njësinë e fundit korrelative vendore të nënvizuar:

Edhe ata //si digjuanë fjalët'e Mbretit, //iknë e ja përsëri illi //që kishnë parë ndë Anatoli, //e u shkon përpara ature, //gjer sa zbriti e mbeti atje //tek qe djali sipër.<sup>122</sup>

Bien në sy gjatë leximit të vëmendshëm që përkthimi del me bashkime përbërësish kallëzuesorë me vargje njësisish të lidhura me parataksë, që mbyllin frazat me kombinime njësisish të bashkuara me fjali të nënrenditura, me funksione të ndryshme e hierarki varg, si në dy rastet më poshtë:



Ngreu //e merr djalënë, edhe mëmën' e tij, //e ecë mbë vënd të Israilit, //sepse vdiqën ata //që kërkojnë shpirtin' e djalit.<sup>123</sup>

Ja edhe sopata afër rrëzës lisavet është, // çdo lis //që s'bën pemë të mirë, //pritetë, // e vihet mbë zjar.<sup>124</sup>

<sup>121</sup> Po aty, f. 255.

<sup>122</sup> Po aty, f. 255.


<sup>123</sup> Termi "përbërës" u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën "Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik", ILAR, Tiranë, 2012, f. 255.

<sup>124</sup> Po aty, f. 256.



E u qas<sup>125</sup> tek ai Djalli //e i tha: //Ndë është //që je biri i Perndisë, //thuj të bënë këto gurë bukë.

Vende-vende, përkthimi i Meksit/Gjirokastritit, vjen tepër i ndërlikuar në vështrimin sintaksor, pasi ka “thyerje” të rënda të fjalive drejtuese (të vizuara më poshtë):



Shqipëruesi ynë ka ndërthurur jo vetëm bashkimet me parataksë me ato hierarkike me hipotaksë, por në mënyrë të veçantë, ai arrin edhe kombinimin e lidhjeve sindete (lidhëzore) me ato asindete (jolidhëzore), si në ndërtimin në vijim:

Edhe unë u thom juvet: //të doni hasmëritë tuaj, //të bekonit ata, //që mallëkojnë juvet, //të bëni mirë atyre //që s’u duanë, //edhe të luteni për ata //që u ngasënë, //edhe ju zbojnë juvet.<sup>126</sup>

Këtu marrëdhëniet funksionale sintaksore qëllimore vijnë e krijohen, duke u lidhur kjo frazë me frazën më lart, përndryshe, e shkëputur, ajo do të dilte jogramatikore. (shih: 44/45, f. 260)

**Që** të bëneni bijt’ e jatit suaj //

**që** është ndë Qiell, //

**se** ai ep diellin’ e tij ndë të këqinj, edhe ndë të mirë, //

edhe shinë e ep ndë të drejtë, edhe ndë të shtrëmbërë.<sup>127</sup>

Në të rrallë, proza e përkthyer e Meksit përmban dy mjete të lidhjes sintaksore, që dalin ngjitas, si në ndërtimin më poshtë, duke dalluar

<sup>125</sup> Po aty, f. 257.

<sup>126</sup> Termi “përbërës” u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 260.


<sup>127</sup> Po aty, f. 260.

marrëdhënie të dukshme funksionale, bie fjala: kryefjalore e kushtore (me lidhëzat “se” dhe “ndë”/në)


Vështoni //të mos bëji eleimosinë tuaj përpara njerëzit, për të dukurë nd’ata //se// **ndë** bëfçi ashtu //nukë keni ndonjë pagë nga jati juaj i Qiellvet.<sup>128</sup>

Po kur të bëç eleimosinë, mos digjoneç përpara vetëhesë, siundrë bëjnë Ipokritetë brënda ndë Sinagogë, edhe mb’udhëra, që të mburenë nga njerëzitë.<sup>129</sup>

Natyrshëm që gjuha dhënëse (greqishtja) do të linte gjurmë aty-këtu edhe në strukturën e frazës, si në modelin poshtë:



Gjithë fraza këtu sipër, ka 3 QOS (njësitë e vizuara), tek të cilat ka në varësi simetrike nga një e dy fjali të varura me funksione kohore e përcaktore. Kurse një skemë tjetër del nga struktura e frazës në vijim, ku 2 njësi mbështesin fjalinë drejtuese (të vizuar), ndërsa të tjerat vijnë me hierarki varg:




<sup>128</sup> Po aty, f. 261.

<sup>129</sup> Po aty, f. 261.

Janë një varg frazash që nisin me lidhëzën bashkërenditëse kundërshtore (*po, por*), për të kundërvënë pohimet e mëparshme, që dëshmojnë të keqen, për të ndërruar regjistrin më pas, si në pasazhin në vijim, nr. 17/18, f. 262:  
Po ti //kur do t'agjëroç, //liej krietë tat, // edhe laj faqet' e tua.

Në fragmente të përkthimit, shfaqen mjaft thyerje të vijës ligjërimore, sidomos në ato raste kur ndërmjetohen fjalitë drejtuese qoftë me një, apo me disa vargje njësisish kallëzuesore, si në ndërtimin më sipër; kurse këtu poshtë, fraza me ndërtim të zhdrejtë, fjalia drejtuese (e vizuar) “thyerhet”, duke u ndërmjetuar me një bërthamë predikative, madje me një fjali përcaktore dhe mbyll frazën, që është e lidhur logjikisht me thënien sipër të kësaj faqeje, po ashtu që “thyerja” ngjet edhe tek fjalia nistore qëllimore, sipas skemës:

Që të mos duket ndë njerëz //  
se agjëron, //  
po ndë jati it //  
që është ndë të fshehurë, //  
e jati it //  
që sheh edhe ndë të fshehurë, //  
do ta paguajë ti faqeza.



Në Ungjillin e Mateut (ashtu si në Dhiatën e Vjetër të Biblës), ka mjaft fjalë të urta, sentenca dhe maksima të dijetarëve (Etërve të Kishës), të popujve të lashtë të cilat kanë banuar në arealin e ngjarjeve që përshkruajnë librat e shenjtë, përkthyer nga Mexi/Gjirokastriti, si thënia e mëposhtme, e cila ngjet si një proverb popullor yni, dhënë në përbërës simetrikë: 2 fjali drejtuese me 2 fjali të varura me funksion të njëjtë përcaktori.

Nukë pëgën njerinë ajo //që hin mbë gojë, //po ajo //që del nga goja, //ajo pëgën njerinë.<sup>130</sup>

<sup>130</sup> Termi “përbërës” u përdor në kuptimin që i jep gjuhëtari Mehmet Çeliku, në veprën “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik”, ILAR, Tiranë, 2012, f. 262.



## PËRFUNDIME

Studiuesit kanë vënë në dukje se përkthimet biblike, me shqipërimin e bërë nga Dhiata e Re të V.Meksit e me redaktim të Grigorit të Gjirokastrës, kanë njohur një ngritje cilësore si në planin e leksikut, ashtu edhe në atë të sintaksës.

1. Meksi shquhet për përpjekje të dukshme në zgjedhjen e fjalës sipas kontekstit të thënies dhe përdorimin e shprehjeve shqipe.
2. Lidhur me frazën, gjuha e Meksit (edhe e redaktorit të tij), dallohet brenda stilit biblik, për strukturën e periudhave sipas natyrës së gjuhës sonë, sa ka qenë e mundur larg ndikimeve të greqishtes, si gjuhë e origjinalit nga vinte shqipërimi.
3. Në punën e tij, Meksi është në vazhden më të mirë të përkthyesve të Biblës nga pararendësit e tij në shekujt e mëparshëm.
4. Në prozën e shqipëruar të Meksit gjenden si ndërtime fraze me përbërës të bashkuar me parataksë, ashtu edhe me hipotaksë, edhe me kombinime të ndërsjellta nga të dyja llojet.
5. Gjithashtu, njësitë frazore të prozës së Meksit dëshmojnë bashkime përbërësish me lidhëza, fjalë lidhëze, ashtu edhe në mënyrë asindete, me pauza e intonacion.
6. Në prozën e Meksit mbizotërojnë mjaft trajta që janë karakteristika të gjuhës së folur, pasi vetë libri i Biblës, u drejtohet jo vetëm atyre që dinë të lexojnë e të shkruajnë, por edhe besimtarëve që mësojnë shkrimin shenjt në formë katekizmi.

## BIBLIOGRAFIA

1. Lloshi, Xhevat, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2005.
2. Lloshi, Xhevat, *Mbështetje për gjuhën letrare*, Toena, Tiranë, 1997.
3. Kristoforidhi, Konstandin, *Vepra I*, Silver, Elbasan, 2001.

4. Dhima, Thoma, "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", UP-Fak. i Filologjisë, 27/1, Prishtinë, 2008.
5. Topalli, Kolec QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010.
6. Gjergji, dr. Dom Lush, QSA, *Bibla shqip dhe Filipaj* (Studime), Lezhë, 2010.
7. Çabej, Eqrem, *Hyrje në indoeuropianistikë* (Leksionet e Prishtinës) Tiranë, 2008.
8. Kristoforidhi, Konstandin, *Bibla në gegërisht*. Kriesa. Të dalëtë. Shoqëria Biblike, Tiranë, 2009, f. 44 – 49; përgatitur nga Xh.Lloshi).
9. Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985.
10. Eco, Umberto, *Të thuash gati të njëjtën gjë* (Përvoja përkthimi), Dituria, Tiranë, 2006.
11. Çomski, Noam, *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, 2011.
12. Mehmet Çeliku, në veprën "Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik", ILAR, Tiranë, 2012.

**Syntactic analytical review of the New Testament translation  
language by Vangjel Meksi**

***ABSTRACT***

This writing has as its objective the overview of the syntax framework of the translation of the New Testament by Vangjel Meksi Laboviti, at the phrase level, after being edited by Grigor of Gjirokastra, bringing in the introduction some requests of Albanian translation of biblical works throughout the XIX century. In the beginning, there is a paragraph from the pioneer works of the linguist Kolë Ashta in the full study of the historic Lexicology of Albanian language, exactly the language of V. Meksi. It is further noted the general credo of all the translators of religious works, from the old writers from the North (Buzuku, Bardhi, Budi and Bogdani) and particularly, the qualitative and well-known translations of Konstandin Kristoforidhi. At the core of our work lies the research on phrasal construction, and their components, including mainly tools of syntax connection with each of the structures: directly and indirectly. A particular attention is given to complex constructions of predicate components as well as the syntax functions of the translated prose of the

Testament, without excluding the order of the predicate components and the syntax connecting tools in coordination links.

**Key words:** functional analysis, syntagmatic group, predicate component, inseparable syntactic group, unit direction etc.

Karmen LAZRI

**TERMA EUFEMISTIKË NË  
“FJALORIN E EMRAVE TË BIMËVE DHE TË  
KAFSHËVE SHQIP-LATINISHT DHE LATINISHT-  
SHQIP” TË PROF. XHEVAT LLOSHIT**

(Logos-A, Shkup-Prishtinë, 2010)

Në Fjalorin terminologjik të botës bimore dhe shtazore të prof.Xhevat Lloshit, dallojmë edhe një linjë të përdorimit si terma të mjaft emërtimeve të botës së gjallë me tabu dhe eufemizma, të cilat në vepra të tilla leksikografike, siç është kjo që po marrim në shqyrtim, mbeten vetëm terma, por në kontekste të caktuara dhe në situata të ndryshme ligjërimore, duke u përdorur në njësitë kumtuese, si fjali e fraza, ato kalojnë nga përdorimi si terma, në tabu.

Për këto tipare cilësore e të qenësishme, që përmbajnë speciet (zakonisht të formuara me kompozime “emër + mbiemër”), duhet të themi se, ndonjëherë, nuk përputhen a nuk përtakojnë me objektin-bimë/kafshë të karakterizuar, është fjala për rastet kur emërtimet janë “të ndaluara” për arsye jetike a besëtytnie, përndryshe, për atë që në etnolinguistikë quhet *eufemizëm*,<sup>131</sup> si për të treguar *gjarprin*, *ujkun*, *shtojzovallet*. Emërtimet në kësi rastesh nuk bëhen mbi bazën e një a disa tipareve që kanë bimët a kafshët, por nëpërmjet një a disa tipareve që dëshirohet të kenë.<sup>132</sup> Autorët e të vetmit studim të drejtpërdrejtë për tabutë dhe eufemizmat në gjuhën shqipe, T.Osmani dhe S. Pepa, sjellin edhe emërtime të tjera:<sup>133</sup>

- **për gjarprin:** “ai i lleut” (dheut), “ai i tokës”, “ai i nargurit”, “ai i shkëmbit”, “ai i shullanit”, “ai që shkon zhag”, “ai i gardhit”, “ai i ferrës”,  
“laramanlivadhi”.


- **për ujkun:** “ai i malit”, “ai i natës”, “ai që të thanë vathën”.  
Le të krahasojmë si ka ndryshuar rrethi i njohjes shkencore në dy vepra shkencore, që kanë të bëjnë, jo vetëm me tabu e eufemizma, por kanë pika takimi edhe sa u takon termave të botës bimore e në mënyrë të veçantë, asaj

<sup>131</sup> Shih për këtë: T.Osmani & S.Pepa, *Tabu dhe ufemizma në gjuhën shqipe*, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000. (Libri ka 9 kërë dhe 169 faqe).

<sup>132</sup> ASHSH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f. 150.

<sup>133</sup> T.Osmani, S.Pepa, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 125.

shtazore, veprën me bashkautorësi që cituam më lart dhe Fjalorin që kemi në studim gjuhësore. Nga vepra e b/autorëve Osmani & Pepa, për termat “gjarpër” e “ujk”, sjellë në formën e librit të vitit 2000:



Siç shihet, nga termat lart, për gjarprin, janë: 1 fjalë e parme (dheu), 2 fjalë të prejardhura me ndajshitesa- parashtesë dhe prapshitesë (përdheu, tokësi), 2 terma me grup përemëror (ai i ferrës, ai i malit), 2 terma me grup emëror (SE) shpata e Zotit, kumbara i natës, 2 terma me kompozita dypërbërësish (gojëkyçuri, laramanlivadhi) dhe 1 kompozitë me tre përbërës (mbyllzogojën = mbyll (ju) Zot + gojën), me një temë foljore, në analogji me termin tjetër eufemistik nga bota mitologjike “shtozovalle”: shtuju + Zot + vallet”. Lidhur me këto analiza fjalëformuese që po bëjmë këtu, theksojmë se autorët e përmendur të kësaj monografie për tabutë dhe eufemizmat në gjuhën shqipe, pa u ndalur në mënyrë të veçantë për terminologjinë (nuk ka qenë objekt i punës së tyre, *shënimi im*, Karmen Lazri) kanë treguar se efumizmat i gjejmë në struktura:

- fjalë të parme,
- fjalë të prejardhura me prapashtesa,
- fjalë të prejardhura me parashtesa,
- fjalë të prejardhura me anë të parashtesimit dhe nyjzimit (i pagoji),
- në fjalë të formuara me anë të parashtesimit dhe prapashtesimit (përdhec),
- në mbiemra të emëruar njëjës e shumës (e bukura, bukuroshet),
- emra në rasën gjinore (i tokes),
- efemizma togfjalësha (sintagma të ndryshme)
- eufemizma – fjali ai që çon dhé – urithi,
- eufemizma fjalë të përngjitura,
- eufemizma fjalë të përbëra ose kompozita (gojëqepuri),
- njësie frazeologjike (mos paste pjesi – për ujkun).<sup>135</sup>

<sup>134</sup> T.Osmani, S.Pepa, **Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe**, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 125., f. 58.



Këtë tregues etnolinguistik e ka pasur parasysh edhe autori i Fjalorit, që, për termin “gjarpri” (*Serpens, Ophidia*), krahas kompozitave të tjera terminologjike, ka sjellë edhe terminologjinë eufemistike, e cila përdoret në krahina të ndryshme të vendit tonë, shprehur me fjalë të përbëra dhe me formime para e prapashtesore, si tabelat që kemi ndërtuar më poshtë:

i bekuari (mb/i emërzuar)	dhetokësi
buçi	farkalofshi
dheu	gojëkyçuri
barkaçi (prapasht.)	gojëlidhuri
i ftohti (mb/i emërz.)	gojëmbërthyeri
i gjati (mbi/i emërz.)	gojëngrimi
i helmuari (mb/i emërz.)	gojëngurti
kulaçi (me prapasht.)	gojëqepuri
nëntokës (pa+prapsht.)	
gojëthati	
i përdredhuri (mb/i emërz.)	këmbëfshehuri (që e ka/pastë gojën të fshehur)
përdhesi (p+p)	farëkalofshi (farë + kolofshi)
përdheu (p.)	
përtokësi (p+p)	
përtrollësi (p+p)	

**Së pari**, bie në sy emërtimi eufemistik me kompozitën “dhetokësi”, një formim “emër + emër” me semantikë të njëjtë, plus prapështe-sën – (ë)s; së dyti, 7 emërtimet tjera të përzahësi përbëra, kanë në bazë termin “gojë”

	“gojë” + pjesore të mbiemëruara pa nyje të parme”, si më poshtë:	
rrëshqanësi	- kyçuri	(që e ka/pastë gojën të kyçur)
sfurkthi	- lidhuri	(që e ka/pastë gojën të lidhur)
shpërdheci(p+p)	- mbërthyeri	(që e ka/pastë gojën të mbërthyer)
shqanësi	- ngrimi	(që e ka/pastë gojën të ngrirë)
shpërdhesi	- ngurti	(që e ka/pastë gojën të ngurtë)
tokësi	- qepuri	(që e ka/pastë gojën të qepur)
zhagësi	- thati	(që e ka/pastë gojën të tharë)

Emërtimet këtu arrihen me anë kompozitave përcaktore.

Veçse në Fjalor ndodh edhe ajo që, jo të gjitha termat shoqërohen apo dalin me eufemizma, për shembull, emërtimi “nepërka” (*Vipera berus*), nuk

<sup>135</sup> T.Osmani, S.Pepa, **Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe**, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 125., f. 62.

shoqërohet gjithnjë me terma-tabu; autori ka mbledhur në hapësirat shqiptare sa më poshtë:

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Kompozita	Sintagma
- astriti	- gjarpërushja	- bishtcungu	- gjarpri i bokës
- fjora		- bishtdunga	- gjarpri me brirë
- buça			-gjarpri me hajmali
- fjera			- gjarpri me hundë
- rrëshaja			- gjarpri me kaçulitë
- shlliga			- gjarpri larisk
- shullani			- gjarpri me nuska
			- gjarpri i shullërit

Janë gjithsej: 7 fjalë të parme: 5 nga ato ngjajnë me emërtime sinonimike, vetëm termi “shullani” është emërtim sipas vendit ku qëndron ky rrëshqanor i rrezikshëm; 1 fjalë-term e prejardhur me ndajshesë (prapashtesën – **ushë**), dy kompozita përcaktore dhe 8 sintagma me përbërës E + E2; E + E4; E + Mb i panyjshëm. Nga termat, 9 prej tyre janë emërtime pa eufemizma. Arsyeja e këtyre termave mendoj se vjen nga ndryshimet që pësojnë edhe termat prej një krahine në tjetrën, që e bën këtë variacion fjalësh-terma; për më tepër edhe eufemizmat e tabutë janë qëndrime psikologjike e sociale që nuk mund të jenë uniforme jo vetëm në popuj e kultura të ndryshme, por as edhe në hapësira të banuara a krahinave.

Në këtë mënyrë autori ka sjellë edhe eufemizmat për termin “**bukla**” (Mustela nivalis, M. vulgaris), por që nuk kanë asnjë term-fjalë të parme:

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Kompozita	Sintagma
-	<b>bukëlza</b>	<b>bishtafurka</b>	<b>e bukura e minjve</b>
-	<b>bukërza</b>	<b>bishtfurkabukura</b>	<b>e bukura e zogjve</b>
-	<b>bukëza</b>	<b>furrëbubëza</b>	<b>nusja e djemve</b>
-	<b>bulgëza</b>	<b>kulkuqja</b>	<b>nusja e lalës</b>
-	<b>bungëlza</b>	<b>larakuqja</b>	<b>nusja e minjve</b>
-	<b>buqëza</b>	<b>nusebukura</b>	<b>bukuria e minjve</b>
-	<b>burbuqja</b>	<b>nuselala</b>	
-	<b>e bukura</b>	<b>nusemira</b>	
-	<b>nusëla</b>	<b>shtatpikaloshja</b>	
-	<b>pikaloshja</b>		

Të gjithë termat eufemistikë janë fjalë të prejardhura, kompozita përcaktore (disa të emëruara (larakuqja); shumë prodhimtare del prapashtesa – **z**

(prap.zvogëlimi); tek shtyllae fjalëve me ndajshesa bie në sy ndajshesa e rrallë –I (nusë-l-a); kështu do parë edhe fjala me kompozim me 3 përbërës “bishtfurkabukura” (emër + kompozitën “furkabukura”. Termat me sintagma kanë si përbërës të parë: 2 – mbiemra të emëruar (e bukura, që del dy herë), të tjerat janë SE (E1 + E2). Këtu është mirë të shënojmë se nga përvoja e krijuar gjatë studimit tim modest, lidhur me paraqitjen e termave të botës bimore e shtazore, Fjalori duhet parë e vështruar në mënyrë korrelative, fjala vjen, termi “bukla”, I f. 50 që gjendet tek germa “B”, përmban sinoniminë e emërtimeve të kësaj gjallese, por ai (termi) duhet kërkuar edhe tek germa “N”, f. ku gjejmë termat eufemistikë: *nusebukura, nuselala, nusemira, nisëza, nusja e djemve, nusja e lalës, nusja e minjve, nusla*. Të njëjtin term e gjejmë në fjalorin e veprës së gjuhëtarëve T.Osmani e Simon Pepa “Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe”<sup>136</sup> si më poshtë:

- nusebukur..... (shprehur me kompozitë),
- nuse e djemvet..... (me sintagmë emërore E1 + E2),
- nusël ..... (me fjalë të parme),
- nusëza ..... (me fjalë të prejardhur, - me prapashtesë),
- nusja..... (me fjalë të parme),
- nusja e mive..... (me sintagmë emërore E1 + E2),
- nusjelala. .... (me kompozitë),
- nuslala..... (me kompozitë),
- nusmira.....( me kompozitë).<sup>137</sup>

Autorët Pepa & Osmani, në Kapitullin VIII, “Struktura e eufemizmeve” kanë shprehur mendimin e tyre: “Ashtu si onomastika që ruan fazat më të vjetra të zhvillimit të gjuhës, edhe eufemizmat mund të shfrytëzohen dhe të studiohen edhe nga pikëpamja e ndërtimit, duke na dhënë një material të vlefshëm për shumë tipa dhe mënyra fjalëformimi të gjuhës shqipe, si dhe për mjetet ndajshesore. Sa më të hershme të jenë ato – shkruajnë autorët –

<sup>136</sup> Tomor Osmani e Simon Pepa, **Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe**, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 130-131.

<sup>137</sup> Po ata, po aty, f. 130-131. Më tej, në f. 69, autorët tanë Osmani e Pepa, theksojnë se *...një prapashtesë e lashtë e shqipes që dokumentohet që tek autorët e vjetër, me të cilën janë formuar disa eufemizma, është prapashtesa – zë, si nusëzë, bukrëzë, buklëzë, për nusen e lalës; ...etj.* Me këtë kuptim nga tema emërore ose foljore janë formuar eufemizmat *pulash*, (dhelpra) dhe *larosh* (gjarpri) etj.

*aq më e madhe është vlera edhe nga pikëpamja gjuhësore. Jo të gjitha mënyrat e fjalëformimit mund të ilustrohen me anë të eufemizmeve.*<sup>138</sup>

Po kështu, nga Fjalori i Xh.Lloshit, do të paraqesim edhe fjalën-term “ujku”, e cila bën pjesë në eufemizmat (nga greq. e vjetër *eu* “mirë” + *phemi* “them”, flas), janë fjalë që përdoren për të emërtuar sende dhe objekte, emrat e të cilave për arsye të ndryshme janë shmangur nga përdorimi. Pra, kemi të bëjmë me njësi ekzistuese të leksikut që shënojnë një referent të ri.<sup>139</sup> Eufemizmat, në thelb, janë mbartje të emërimit nga një objekt mbi një tjetër, janë kalime të figurshme të kuptimit.

Në njëfarë kuptimi, këto përdorime janë **tabú** (nga fjala polineziane “ndalim”). Tabu janë emërtimet edhe për **ujkun**, për të cilin autori i Fjalorit, ka dhënë: **ujku** (*Canis lupus*); gjithsej **31** emërtime eufemistike (tabu), prej të cilave 3 janë fjalë të parme (*bisha, shpendi*); 4 janë emërtime me sintagma (*bisha e pagojë, sendi i malit, kumbara i natës*), 7 dalin fjalë të prejardhura me formime prapashtesore, 7 formime me ndajshtesa e me paranyjëzim (*i pagoji, i papjesi, i paqeni*), kurse 17 terma njihen emërtime me kompozita, të ndara si vijon:

<u>Fjalë të parme /</u>	<u>Fjalë të prejardhura /</u>	<u>Terma me sintagma/</u>	<u>Kompozita</u>
	<u>me ndajshtesa</u>		
bisha	egërsira	bisha e pagojë	bishtgjati
shpendi	egërtia	sendi i malit	bishtzdrugani
ungri	i pagoji	kumbara i nates	gojëfarkuemi
	i paqeni	ujku i hirtë	gojëkyçuri
	ulëritësi		gojëlidhuri
	zdrugoni		gojëmbërthyeri
	i papjesi		gojëmylluri
			gojëmshelmi
			gojëngriri
			gojëqepuri
			gojëthati
			gojëzëni
			këmbëlehti
			largneshi
			qafëtrash
			qafëthyeri
			bishtverdhi

### UJK

<sup>138</sup> Po ata, po aty, f. 67.

<sup>139</sup> Rami Memsushaj, **Hyrje në gjuhësi**, Dituria, Tiranë, 2002, f. 196.

Ndër të gjithë këto terma, 12 prej tyre kanë njërën temë fjalëformuese emrin “**gojë**”, pikërisht organin me të cilin bisha dëmton bagëtinë. Në një vështrim tjetër, të gjithë këta janë hiponime (gr. *hypo* “nën” + *onima* “emër” të emrit-term “ujku”, që është emër i përgjithshëm gjenerik i quajtur hyperonim (gr. *hyper* “mbi” + *onyma* “emër”). Në të gjitha këto raste kjo dukuri njihet si lidhje kuptimore paradigmatiche midis një termi të përgjithshëm (ujk) dhe një a disa termash të veçantë të nënrenditur (diku kemi thënë edhe të hierarkizuar – *shënimi im, Karmen Lazri*). Kështu kemi parë se fjala “lule” është hiperonim i fjalës “trëndafili”, që është hiponim. Midis dy veprave që kemi përpara: Fjalorit terminologjik të X.Lloshit dhe monografisë “Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe” të autorëve Osmani-Pepa nuk mund të heqim pika paralele, pasi në vështrimin leksikor të termave, fjala-skaj merret e veçuar, thjesht si emërtim i një specieje bimore a shtazore, kurse libri studimor i bashkautorëve të mësipërm, ka dorë të lirë dhe vend për kontekste dhe veshje me ngjyrim të lemave të sjella: në bashkëvatje me emra, mbiemra dhe sidomos folje, për të gjeneruar fali a thënie të ndryshme. Bie fjala, për eufemistikën, vjen natyrshëm prurja në studim e sintagmës-fjali “**bleta vdiq**”- *përdoret në vend të fjalës ngordhi cofi, sepse bleta në malësitë veriore nderohet shumë. Thuhet edhe ka dekë bleta.*<sup>140</sup>

Për më tepër është e nevojshme edhe gjetja në një kontekst letrar, siç kanë bërë dy studiuesit tanë, duke shënuar një pasazh gjuhësor e letrar nga shkrimtari Martin Camaj:

*“Babai më ka bërtitë sot se më shpëtoi nga goja e thashë se në këtë dimen kanë cofë shumë bletë. E dij se asht keq me thanë kështupse bletët nuk cofin, por vdesin, por mue më shpëtoi goja.”*<sup>141</sup> (M.Camaj, Vendi që i përngjante një zgjoni bletësh, “Shejzat” nr. 1-2, 1965. F. 15).


Por Fjalori terminologjik ka tjetër synim dhe normë shkencore të paraqituri të lemave-terma, siç është vepruar me skajin “**bleta**”: termi në gjuhën latine, radha e sinonimeve dhe emërtimet terminologjike me kompozita dhe ato dyfjalëshe; kështu lexojmë në Fjalor:

<sup>140</sup> Tomor Osmani e Simon Pepa, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 141.

<sup>141</sup> Po ata, po aty, f. 142.

**bleta** *Apis mellifera* & arëza, arëza e butë, arëza mjalcore, arza e mjaltit, e bekuara, miza e bukur, miza e mjaltit, mizarja, mjalca, mjaltëza.

Sinonimet e mësipërme nuk mund të quhen eufemizma (siç kemi quajtur sinonimet për buklën apo ujkun e gjarprin – si tabu për të mos i thirrur sipas fjalëve-terma), por janë si emërtime të hyjnizuara; ky insekt i shenjtëruar nga njeriu, ka edhe skaje të tjera, që Fjalori duhet t'i pasqyrojë, siç i ka listuar më poshtë autori, pasi i ka mbledhur në treva:



Në mbyllje të kësaj përjasjeje, themi se në vështrimin eufemistik, përdorimi i vetëm është “bleta vdes” është i natyrshëm, por asnjëri prej sinonimeve apo termave me sintagma më sipër, nuk vjen i drejtë për gjuhën shqipe; krahasojmë: vdiq bleta karpentiere, vdiq bleta gjigante, apo prej sinonimeve që ka mbledhur autori: “vdiq mizarja”, apo “vdiq e bekuara” etj., që do të shkaktonin ambiguitet gjatë kumtimit. Gjithashtu, edhe për eufemizmat në gjuhën shqipe, qoftë edhe në përmasat e monografisë që përmendëm disa herë këtu, mund të bëhen hulumtime për fjalëformimin dhe pasurinë leksikore që sjellin ato në dialektet e në të folmet e vendit tonë. Mjafton të sjellim këtu kompozitat që formohen me temën “gojë” dhe me mbiemra prejpjesorë (pa nyje) të emëruar, si:

gojëfarkuesi (ujku),  
 gojëmbyllëti (ujku),  
 gojëfërkuemi (gjarpri),  
 gojëkyçuri (ujku),  
 gojëlidhuni (ujku),  
 gojëmbylluni (ujku),  
 gojëmbërthyeri (ujku),  
 gojëmbërthyera (milingona),  
 gojëmshelni (ujku),  
 gojëngrimi (ujku),  
 gojëqepuri (gjarpri),

gojëthati (ujku)<sup>142</sup>..

Fjalëformi për tabutë dhe aufemizmat, mund të shtrihet edhe në terma e emërtime të sëmundjeve të ndryshme, si dhe pjesëve të trupit të njeriut, të cilat kanë një sinonimi të pasur sipas të folmeve të shumta dialektore në gjuhën tonë, por që sigurisht nuk kanë qenë objekt as yni, as edhe i autorit të Fjalorit.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. T.Osmani & S.Pepa, **Tabu dhe ufemizma në gjuhën shqipe**, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000.
2. Rami Memsushaj, **Hyrje në gjuhësi**, Dituria, Tiranë, 2002, f. 196.
3. ASHSH, IGJL, **Gramatika e gjuhës shqipe I**, Tiranë, 1995, f. 150.

---

<sup>142</sup> Tomor Osmani e Simon Pepa, **Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe**, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2000, f. 117-118.

**Euphemistic terms in "The dictionary of plants and animals Albanian-Latin and Latin-Albanian" of prof. Xhevat Lloshit  
(Logos-A, Skopje-Pristina, 2010)**

***ABSTRACT***

In the following article, I have explored a source of terms and names of plants and animals from the Latin-Latin and Latin-Albanian terminology dictionary of the well-known linguist Xhevat Lloshi. I have shown that in the composition of the work these are purely terms, while in phrase phrases, they are called euphemisms. Even taboo words, as they appear in the word of flora and fauna, are terms such as: a snake, a wolf, a muselala, a fox, a wolf, a defining term for a bee. In the paper there are also syntagmatic forms with the euphemisms, as well as the differences they have, with terminological synonyms, which belongs to only a certain linguistic area and not to all the Albanian speaking mass, as it is with euphemistic terms. It is important to note that a classification of denominations with euphemisms has been achieved according to their structure.



Gani PLLANA

## PROBLEME TË STANDARDIT NË TERMINOLOGJINË TEKNIKE

### Gjendja e standardit në terminologji

Shumë ndryshime në nivel konceptesh e termash në terminologjinë teknike pasqyrohen në kundërvënien e termave në raport me konceptet, ku të parat mbeten prapa, kurse të dytat zhvillohen nga ana e vet, duke krijuar probleme serioze në standardin dhe normën terminologjike<sup>143</sup>.

Kështu, termat: *disketë, dritare* kanë dalë jashtë përdorimi dhe në vend të tyre shfaqen termat: *flesh, kompakt-disketë* shënojnë konceptet e tyre përkatëse. Një pjesë prej tyre zhduken bashkë me konceptet, kurse një pjesë mbeten; ndonjëri *vishet edhe me ndonjë koncepti të ri*. Nga ana tjetër konceptet *zgjerohen*, duke prishur caqet ndërmjet tyre dhe termave që i shënojnë. Lindin me shumicë terma të rinj, si: *mi (maus), fjalëkalim* etj.

Konceptet, nga njëra anë diferencohen, duke diferencuar edhe termat përkatës, por, nga ana tjetër, *integrohen në fusha të ndryshme*, si *tretje, tretës, djegie* (nga kimia në mekanikë, në metalurgji), duke sjellë pështjellim në përcaktimin e kufijve të prerë ndërmjet vetë termave etj. Në kushtet e zhvillimit të terminologjive të fushave të ndryshme të dijes në Shqipëri, sidomos në periudhën 1970-1990, përpjekja e madhe për shqipërimin e tyre, çka mund të pranohet si lëvizje gjuhësore në fushën e terminologjisë shqipe<sup>144</sup>, ka çuar në një “ndeshje” ndërmjet *termave të huaj* (një pjesë e madhe të cilëve janë në përdorim edhe sot) dhe termave të shqipëruar ose shqip të gjetur në gjuhë si të tilla.

Zhvillimet në rrafshin e përmbajtjes dhe përzierjet e termave në rrafshin e formës, kanë krijuar në ditët e sotme një *gjendje jostandarde në terminologji, ku është vështirë të vendoset kufiri ndërmjet vetë normës dhe jo normës*.

Po sjellim një varg shembujsh në ballafaqimet e termave njëri me tjetrin, jo vetëm në kundërvënien term i huaj/ shqip, por edhe në atë shqip/shqip.

<sup>143</sup> J.Thomai, “LIGJËRATA PASUNIVERSITARE (leksikologji, semantikë, leksikologji)”, Korçë, 2015, f. 24-31.

<sup>144</sup> A. Duro, “Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përpunimit të saj në ligjërim”, në “SEMINARIN XX NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE”, nr. 20, Prishtinë, 2001.

a) **Terma me caqe konceptore të përcaktuara, që shfaqen si dysorë, por që mbingarkojnë sistemet terminologjike me emërtime që shënojnë të njëjtin koncept, duke krijuar pështjellim në të kuptuarit e përmbajtjes konceptore<sup>145</sup>:**

*ekuilibër – balancë – baraspeshë*  
*kofano – kapotë – mbulesë*  
*kambio – shpejtësindërrues*  
*mi – maus – miush*  
*ndemje – sforcim – tension*  
*ndërprerës – interuptor*  
*ndërprerje – interuptim*  
*ndikim – influencë – impakt*  
*njehsor – sahat – kontator*  
*prapaveprim – lidhje e kundërt – fidbek*  
*preciz – i saktë – ekzakt – i përpiktë*  
*prift – baballëk – cungal*

**b) Terma si dysorë në kuptime të veçanta:**

*denduri<sub>1</sub> – dendësi – densitet*  
*denduri<sub>2</sub> – shpeshtësi – shpeshti – frekuencë*  
*aplikoj<sub>1</sub>(metodën) – zbatoj – implementoj*  
*aplikoj<sub>2</sub>(forcën) – zbatoj – ushtrij*

**c) Terma me caqe të papërcaktuara si pseudodysorë, ndërmjet të cilëve duhen vendosur vijat ndarëse konceptore:**

*ajrim – ventilim – erim*  
*gërryerje – brejtje – erozion – korrozion*  
*gyp – tub*  
*lëshim – riardhje*  
*model – gjedhe – kampion – mostër*  
*model → gjedhe → kampion → mostër*  
*pluskues – notues – galexhant*  
*qëndrueshmëri – qëndresë – stabilitet – rezistencë*

<sup>145</sup> E. Lafe, “Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar”, në: GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE-PROBLEME DHE DETYRA”, Tiranë, 2009, f. 53-62.

*shpejtim – përshpejtim – nxitim – akselerim*  
*trysni – shtypje*

**d) Terma me kuptime që kalojnë tek njëri tjetri**, ku fjala shqipe merr mbi vete kuptimet e shënuara nga termat e huaj: *gërryerje* zëvendëson në mënyrë të ndërsjellët *erozion- korrozion* dhe *abrazion*, çka çon në pëstjellim të madh në përcaktimin e kufirit të koncepteve të shprehura nga termat e huaj përkatës; po kështu *bosht* për *bosht* dhe *aks* (si vijë imagjinare), *prerje* për *prerje* dhe *seksion*.

### **Norma në procesin e përpunimit të terminologjisë**

Çështjet e zbatimit të normës në terminologjinë teknike duhen zgjedhur në lidhje me dy dukuritë kryesore semantike, siç janë sinonimia dhe polisemia (homonimia). Të dyja këto dukuri semantike edhe në fushën e terminologjisë teknike duhen vështuar në aspektin e veçorive të shfaqjes së tyre, ndryshe nga gjuha e përgjithshme. Nga ana e veçorive të shfaqjes si dukuri semantike në terminologji sinonimet paraqiten si dysorë (çift apo varg njësisht që shënojnë të njëjtin koncept, si: *paraveprim – lidhje e kundërt – fidbek*), ose si pseudosinonimi (çift apo varg njësisht konceptualisht të ndryshme, por të pranuar si të njëjta: *denduri – densitet – dendësi*), kurse polisemia si homonimi (krahaso njësi të njëjta si forma, por konceptualisht të largëta: *krah* (vinçi) → *krah* (aeroplani).

Gjatë hartimit të terminologjive teknike, me qëllim që të vendoset një normë e njësuar, synohet për mënjanimin e sinonimeve dhe thyerjen e homonimisë, duke krijuar, sipas rastit, për çdo njësi homonimike një shenjë të re, siç kemi përmendur *sharrë*<sub>1</sub>(vegël) dhe *sharrë*<sub>2</sub>(sharruese=makinë). Këto procese janë parësore sidomos gjatë punës për hartimin e teksteve mësimore, hartimin e fjalorëve dygjuhësh etj., ku krijimet e reja rëndojnë terminologjinë me sinonime (dysorë), duke e shndërruar sinoniminë në një dukuri shumë të dëmshme.<sup>146</sup> Siç u nënvizua më sipër, edhe përpjekja për të minimizuar poliseminë (homoniminë) çon në krijimin e termave të herë të suksesshëm, herë të pasuksesshëm, të cilët shtojnë ngarkesën shënjore të gjuhës. Megjithatë, sinonimia, ashtu edhe homonimia ndihmojnë për zgjedhjen dhe rivlerësimin e termave ekzistues, për futjen e termave më të mirë, më të përshtatshëm, që i përgjigjen koncepteve përkatëse.

<sup>146</sup> J. Thomai, "Fjala, termi dhe norma gjuhësore", në "GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISE SHQIPE-PROBLEMEE DETYRA", Tiranë, 2009, f. 63-72.

### Objektivat e standardizimit të terminologjisë teknike në ditët e sotme

Standardi dhe standardizimi i terminologjisë teknike në kohën e sotme duhen trajtuar në kontekstin e zhvillimeve të reja që po kalon vendi ynë, edhe në këtë fushë:

a) Përfshirja e terminologjisë teknike në rrjetin e lidhjeve të të gjitha terminologjive të fushave të ndryshme të dijes në rrafsh kombëtar, ashtu edhe në atë mbarëkombëtar (aty ku shqipja është gjuhë amtare-në Shqipëri e Kosovë si dhe gjuhë e dytë zyrtare-në Maqedoni) dhe ndërkombëtar, në marrëdhënie me terminologjitë e tjera, sidomos të vendeve të mëdha e në radhë të parë me terminologjinë angleze, që shërben si model standardizimi në rrafsh ndërkombëtar;

b) Trajtimi i terminologjisë në rrafshin e *shumësisë së fushave të ndryshme të dijes*, ku, e konceptuar si nënsistem më vete në kuadrin e sistemit tërësor leksikor të gjuhës, ajo përbën një masë gjigante njësisish (terma fjalë, terma togfjalësha dhe nomenklatura terminologjike) të pafundme, por të fundme në një prerje të caktuar kohore, që shënojnë konceptet e fushave të dijes njerëzore.

c) Trajtimi i terminologjisë dhe i standardit të saj në kushtet e marrjes në të ardhmen e afërt nga gjuha shqipe të statusit të një gjuhe të BE-së me futjen e Shqipërisë në këtë organizëm ndërkombëtar evropian. Lidhur me terminologjinë shqipe dhe standardin e saj kjo do t'i japë një orientim të ri vlerësimit dhe rivlerësimit të standardit, e në mënyrë të veçantë, të termave të huaj në shqipe, qëndrimit ndaj tyre, vendit të tyre në raport me termat e shqipëruar që konkurrojnë me ta, duke përshtatur ndaj tyre një politikë gjuhësore më të liberalizuar se më parë;

d) Zgjidhja e problemeve të standardizimit, të vendosjes së termave standardë dhe normativë mbi bazën e parimeve dhe të kriterëve të rrepta shkencore të terminologjisë si shkencë dhe si veprimtari praktike, siç janë në radhë të parë kërkesat e saktësisë dhe të qartësisë së temave, vendosjen e barasvlerësish term- koncept dhe anasjelltas për të krijuar për çdo fushë dije një sistem terminologjik që t'i përgjigjet mënyrës adekuate sistemit konceptor përkatës.

Në Shqipëri e Kosovë puna e organizuar me terminologjinë ka nisur disa dhjetëvjeçarë më vonë (pas Luftës së Dytë Botërore) në krahasim me vendet e tjera të Evropës Perëndimore, deri diku edhe të Evropës Lindore. Kjo punë është përqendruar kryesisht në hartimin e fjalorëve terminologjikë, mbështetur mbi bazën e terminologjive të krijuara në fusha të ndryshme të dijes në gjuhën shqipe nën ndikimin e kontakteve me letërsinë shkencore-teknike të gjuhëve të huaja (kryesisht të gjuhës ruse), si edhe si rrjedhojë e futjes në Shqipëri

të teknologjive moderne në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, sikurse në çdo vend të botës. Vështruar nga kjo pikëpamje mund të nënvizohet se puna në fushën e praktikës terminologjike i ka paraprirë deri në vitet 80 -të shek. XX punës studimore dhe kërkimore në këtë fushë. Deri në këtë kohë ka vijuar puna për hartimin e fjalorëve të serisë terminologjike, ku si objekt janë bërë fushat e gjera të dijes, midis tyre edhe fusha e mekanikës<sup>147</sup>. Megjithatë parimet dhe metodat, mbi të cilat u hartuan fjalorët u huajtën (u huazuan) nga përvoja e gjuhëve të vendeve të tjera me terminologji të zhvilluara.

Në Kosovë puna në fushën e terminologjisë shqipe, në kuadrin e Federatës së Jugosllavisë, u kufizua më tepër në riprodhimin e fjalorëve terminologjikë, të hartuar në Shqipëri, duke i shoqëruar me terma nga gjuha serbe.

Pas viteve 80-të, krahas hartimit të fjalorëve terminologjikë, jo vetëm të fushave të gjera, por edhe të ngushta, filloi një veprimtari e vullshme për përgjithësimin e përvojës së arritur nga puna për hartimin e fjalorëve të shumtë, e cila u konkretizua fillimisht në trajtimin e një vargu problemesh teorike në artikuj e punime shkencore, kurse më vonë problemet teorike, të përgjithshme e të veçanta, u pasqyruan në punime në nivel monografish. Si objekt studimi<sup>148</sup> u bënë terminologjitë e fushave të dijes si fushat e ekonomisë, e mekanikës, e mjekësisë, e gjeografisë, e kohët e fundit edhe fusha e agronomisë.

Duhet theksuar se në fokusin e vështrimit studiuesit terminologë vunë probleme të terminologjive të fushave pak a shumë të gjera brenda kufijve të gjuhës shqipe. Mund të pohohet se deri më sot nuk është ndërmarrë ndonjë studim për terminologjinë shqipe për ndonjë fushë të veçantë të dijes në rrafshin përqasës me ndonjë gjuhë të huaj në mënyrë të gjerë e të plotë. Për këtë arsye do të dilte si nevojë e domosdoshme trajtimi i një fushe të ngushtë të dijes, sidomos i asaj fushe, e cila ka interes të veçantë nga pikëpamja e problematikës së saj, duke e vështruar në rrafshin përqasës edhe me një gjuhë të huaj (ose edhe me gjuhë të tjera), të cilat shërbejnë si gjedhe standardizimi në rrafsh gjuhësor. Siç është bërë e pranueshme deri më sot, vendin e parë ndërmjet këtyre gjuhëve e zë gjuha angleze, e cila në kohët e sotme ka fituar të drejtën e një gjuhe me shtrirje të gjerë ndërkombëtare. Sigurisht këtu terminologjia e kësaj gjuhe në rrafshin përqasës me një terminologji të shqipes (ose me terminologjinë e saj në përgjithësi) do të hidhte dritë mbi mjaft probleme të terminologjisë shqipe, sidomos për zgjidhjen e

<sup>1471</sup> “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore *TERMINOLOGJIA E MEKANIKËS* 8 (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht)”, Prishtinë, 1970. **2.** “Fjalor i termave themelore të mekanikës”, Tiranë, 2002.

<sup>148</sup> Janë shkruar një varg monografish, të mbrojtura si tema disertacionesh (nga 1983 deri më sot), ndërmjet tyre përmendim: **1.** V. Proko: “Leksiku terminologjik i agronomisë në gjuhën shqipe”, Tiranë, 2006. **2.** S. Pllana: “Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përqasje me gjuhën angleze”, Tiranë, 2010, **3.** A. Shumeli, “Formimi dhe funksionimi i terminologjisë së agromekanikës në shqipe në përqasje me anglishten”, QSA Tiranë, 2013. G. Pllana: “Krijimi i leksikut shqip të terminologjive teknike (Procese të krijimit, të pasqyritit në gjuhë dhe të standardizimit)”, QSA Tiranë, 2016.

çështjeve të sistemimit dhe standardizimit të terminologjisë. Në mënyrë të veçantë në këtë rrafsh përfaqës me gjuhën angleze mund të zgjidheshin edhe probleme të qëndrimit ndaj termave të huaj, si edhe termave të shqipëruar deri më sot.

Ndër terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes, sidomos të shkencave të zbatuara, një leksik me interes të veçantë studimi përbën terminologjia e mekanikës. Kjo lidhet, nga njëra anë, me vetë mekanikën si shkencë bazë teknike me rreze të gjerë zbatimi brendapërbrenda caqeve të veta, kurse, nga ana tjetër, me integrimin e saj në mjaft fusha të tjera të dijes, duke filluar me ato më tradicionale (të elektricitetit, të ndërtimit), si edhe me ato më moderne (të elektronikës, të kompjuteristikës etj). Përveç kësaj, në themel të bazave të saj teorike dhe praktike qëndrojnë konceptet kryesore të të gjitha shkencave themelore si e matematikës, e gjeometrisë, e fizikës dhe e kimisë. Kjo lidhje e gjerë komplekse dhe e shumëfishtë e mekanikës si shkencë me mjaft fusha të dijes bën që edhe leksiku i saj terminologjik të ketë një rreze të gjerë përdorimi dhe, si e tillë, për këtë arsye, ka tërhequr dhe tërheq edhe sot vëmendjen e studiuesve të fushës së terminologjisë. Shumë dukuri që vihen re në të, në rrafshin e fjalëformimit (të termformimit) në atë të semantikës (si sinonimia, polisemia) shërbejnë si model për zgjidhjen e problemeve të ndryshme me vlerë teorike dhe praktike për terminologjinë shqipe në përgjithësi.

## PËRFUNDIM

*Problemet e normës dhe të njësimin e përgjithësisht të standardizimit të njësisive terminologjike, të përfaqësimit të këtij leksiku në gjuhë trajtohen e zgjidhen në kuadrin e problemeve të standardit të leksikut të gjuhës në tërësi, prandaj dhe vështrimi i tij bëhet nga ana gjuhësore e joterminologjike. Fjala e gjuhës së përgjithshme dhe termi si njësi e gjuhës speciale, në këtë nivel futen në rrethin e të njëjtit standard dhe shfaqja e disa tipareve të fjalëve dhe të kuptimeve të tyre gjejnë shprehje edhe në termat dhe konceptet përkatëse. Kjo mund të vërehet në disa raste edhe në të shkruar edhe në të folur, tek disa terma që përdoren edhe si fjalë, sidomos edhe disa fjalë librore si: *nyjë-nyjet*, në vend *nyjë-nyjat* (*nyje betoni* në vend të *nyjë betoni*, *proces* (teknologjik) në vend *proces* (teknologjik)).*

*Përpunimi në terminologji është kryer sipas dy vijave që kanë ecur paralel ose njëra ka paraprirë tjetrën. Vija e parë ka të bëjë me *përpunimin individual* të terminologjisë, që kryhet në mënyrë të përhershme në njësi e forma të caktuara dhe që nga ndryshimet që sjell, ky përpunim mund ta përsosë e çojë më tej terminologjinë ose hallka të veçanta të saj, por edhe mund të çojë atë drejt një zhvillimi të *vetvetishëm*, e të *pa orientuar mirë*. Këtu futet kryesisht puna që kanë bërë e bëjnë *hartuesit e teksteve të veprave shkencore*, hartuesit e *fjalorëve terminologjikë*, por edhe *përdoruesit e terminologjisë* në veprimtarinë praktike-prodhuese, të cilët sipas nevojës që del futin terma të rinj si *krijime vetjake* të tyre (të përshtatshëm e hera herës jo shumë të përshtatshëm ose edhe të *papërshtatshëm*, nëse i vlerësojmë këto ndërtime të reja jo vetëm nga ana*

gjuhësore), por edhe nga pikëpamja e qartësisë edhe përpikërisë së shprehjes së koncepteve.

## BIBLIOGRAFI

1. Berani, Sh: *“Gjendja e terminologjië shqipe në Jugosllavi”* në “GJENDJA E TERMINOLOGJISË SHQIPE NË JUGOSLLAVI”- Punim nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 28 dhe 29 janar 1988, Prishtinë, 1988.
2. Dervishi, V.: *“Termet e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor”* në “Sf”, nr.1, Tiranë, 1991.
3. Duro, A.: *“Fjala shqipe në terminologjinë e mekanikës”*, në “STUDIME FILOLOGJIKE”, nr.4, Tiranë, 1984.
4. Duro, A.: *“Terminologjia si sistem”*, “Panteon”, Tiranë, 2001.
5. Duro, A; Pllana, G.: *“Marrëdhëniet logjike ndërmjet shenjave njëfjalëshe e togfjalëshe në terminologji”* në KONFERENCA SHKENCORE JAVA E ALBANOLOGJISË IAP 6/2015, 15-19 qershor 2015, Prishtinë, 2015.
6. Felber, H.: *“Terminology manual”*, UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.
7. Kostallari, A.: *“Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”*, në “Sf”, nr.4, Tiranë, 1984.
8. Lafe, E.: *“Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar”* në “GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE PROBLEME DHE DETYRA” KONFERENCË SHKENCORE, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2009.
9. Leka, F.: *“Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe”* në STUDIME MBI LEKSIKUN DHE MBI FORMIMIN E FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE III, ASHSH, Tiranë, 1989.
10. Memisha, V.: *“Fjalor i termave themelorë të mekanikës”* në “GJUHA JONË” nr.3-4, Tiranë, 2002.
11. Murati, Q.: *“Për një terminologji më të saktë e më shkencore të gjuhës sonë”* në “GJENDJA E TERMINOLOGJISË SHQIPE NË JUGOSLLAVI”- Punim nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 28 dhe 29 janar 1988, Prishtinë, 1988.
12. Pllana, G.: *“Standardizimi i terminologjisë së inxhinierisë mekanike në gjuhën shqipe nevojë e kohës”*, në ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology, Vol.1, No:1-2/2014, UDK:81, ISSN 1857-9485 (Print) USHT Tetovë, 2014.
13. Pllana, G.: *“The study of mechanics terminology in Albanian language (In comprehensive terminology and in a special subfield)”* në SLATE 2015 The Asian Conference on Second Language Acquisition and Teacher Education August 2-4, 2015, Hiroshima, 2015.
14. Pllana, S.: *“Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përfaqje me gjuhën angleze”* (mbështetur në lëndën e fushave Mekanikë teorike dhe Mekanikë e aplikuar në makina), disertacion Universiteti i Tiranës, FGJH, Tiranë, 2010.

15. Proko, J. V.: “*Probleme të motivimit në terminologjinë e agronomisë*” në “GJUHA SHQIPE” nr.1, Tiranë, 2006.
16. Shehu, H.: “*Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe*” në “SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE”, Prishtinë, 2001.
17. Shumeli, A.: “*Formimi dhe funksionimi i terminologjisë së agromekanikës në shqipe në përqasje me anglishten*”, disertacion, QSA Tiranë, 2013.
18. Thomai, J.: “*Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikografi)*”, UNIVERSITETI “FAN S.NOLI”, Korçë, 2015.
19. Wüster, E.: “*Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie*”, 3. Auflage. Romanistischer Verlag, Bonn, 1991.
20. Xhuvani, A.: “*Vepra I*”, Tiranë, 1991.

### **Problems of Standard in the Technical Terminology**

#### **ABSTRACT**

The standard in technical terminology as a special lexical separate formation, which is in continuous development, is included in the standard of language, especially in its vocabulary, with a range of features specifically related to the nature of concepts and terms. In particular, intensive changes in technical terminology are conditioned by the priorities in terminology of the content before the form, i.e. concepts before terms.

One of the direct ways of standardization of terminology is the unification of the terms in form and content from international terms. Nowadays, the phenomenon of globalization is oriented mainly in this lexical specialized layer, and relates in particular with the flood in it of Anglicisms, mainly in new areas of science, technology (computer science, genetics, biotechnology), which have gained the status of Internationalisms.

**Key words:** foreign terms, Albanian terms, standard in terminology, terminological systems, technical terminology.



## Anejda RRAGAMI

## FJALA SHQIPE NË VEND TË FJALËS SË HUAJ

## I. Hyrje

## I.1 Pak mbi gjuhën shqipe

Shqipja është një gjuhë indoevropiane që flitet në Shqipëri dhe nga shqiptarët etnikë në pjesë të tjera të Ballkanit jugor. Eric Hamp, një ballkanist amerikan më 1974 në një punim botuar në *Encyclopaedia Britannica*, shkruante: “Shqipja është një gjuhë indoevropiane që flitet nga 2 milionë e 500 mijë banorë në bregut lindor të Adriatikut në Shqipëri e po ashtu edhe në Jugosllavinë fqinje, para së gjithash në Kosovë dhe Maqedoni, në Perëndim të vijës së Leskovcit e deri te Liqeni i Ohrit”.<sup>149</sup>

I pari që vërtetoi bindshëm përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoevropiane, ishte gjuhëtari gjerman F. Bopp, që arriti në përfundimin se shqipja i përket familjes indoevropiane, porse “në elementet e saj themelore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite (indoevropiane) të kontinentit tonë”.<sup>150</sup>

Familja e gjuhëve indoevropiane përfshin gjuhët me prejardhje të përbashkët, të cilat janë folur dhe fliten nga India, në lindje, deri në Irlandë, në perëndim, si: sanskritishtja, latinishtja, greqishtja, gjuhët sllave etj. Me gjithë ndryshimet e mëdha që kanë pësuar gjatë zhvillimit të tyre historik, gjuhët e ndryshme indoevropiane kanë ruajtur disa tipare të përbashkëta, që i dallojnë nga gjuhët e familjeve të tjera. Megjithatë, argumenti tjetër i Hamp-it, i përqafuar nga shkenca shqiptare, është se shqipja nuk shfaq asnjë afri të ngushtë të veçantë me ndonjë nga gjuhët indoevropiane; ajo është plotësisht i vetmi i mbijetuar modern nga nëngrupi i saj.<sup>151</sup>

Sipas studimeve të prof. Eqrem Çabejt, numri i fjalëve të trashëguara të shqipes nga indoevropianishtja është mjaft i madh në fjalor. Ato në përgjithësi janë fjalë të një përdorimi të dendur, prandaj dhe i kanë qëndruar kohës. P.sh., shumica e numërorëve janë të fondit indoevropian:

<sup>149</sup> Eric P. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, 2007.

<sup>150</sup> E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 13.

<sup>151</sup> Eric P. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK Prishtinë, 2007, f.103.

një, dy, tre (tri), katër etj. Të trashëguar nga indoevropianishtja janë edhe përemrat: ti, ju; emrat: natë, motër, ditë etj.<sup>152</sup>

Ndërsa në gramatikë sistemi tre gjinish (mashkullore, femërore dhe asnjëanëse) ka qenë një veçori e gjuhëve indoevropiane, i cili si në mjaft gjuhë të kësaj familjeje dhe në gjuhën shqipe është ruajtur edhe sot. Por, duhet thënë se gjinia asnjëanëse sot është kufizuar mjaft. Ajo përdoret ende tek emrat që vinë nga pjesoret e foljeve: të folurit, të menduarit, etj.

Dy dialektet kryesore të gjuhës shqipe janë Gegë në veri dhe Toskë në jug. Gjuha zyrtare, e shkruar me gërma latine dhe që u adaptua në vitin 1909, ishte e bazuar në dialektin e Gegërishtes Jugore të qytetit të Elbasanit nga fillimi i shtetit të Shqipërisë deri në Luftën e Dytë Botërore. Deri në vitin 1968 shqiptarët e Kosovës, Ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi përdorën Gjuhën Letrare Gege si gjuhë zyrtare. Në Shqipëri me hyrjen e komunizmit, gjuha Gege u ndalua institucionalisht nga viti 1944 deri në vitin 1967 dhe nga 1972 deri sot. Gjuha e sotme zyrtare shqipe bazohet në toskërisht, edhe fjalët e shprehjet që huazohen prej gegërishtes konvertohen në morfologjinë, fonologjinë dhe sintaksën e të folmes toske. Megjithatë kushtet e reja shoqërore e politike dhe zhvillimet e brendshme të gjuhës, çuan në lëvrimin dhe zgjerimin e fushave të përdorimit, në përpunimin e stileve e nënstyleve funksionale të publicistikës, shkencës, të veprimtarisë shtetërore, administrative, gjyqësore, diplomatike e tregtare, duke iu referuar modeleve të gjuhëve të tjera evropiane.<sup>153</sup>

## II. Huazimet në gjuhën shqipe

### II.1 Çfarë është “huazimi”?

Tërësia e fjalëve të gjuhës që shërbejnë për t’u marrë vesh me njëri-tjetrin, përbën leksikun e gjuhës. Leksiku i gjuhës shqipe, si çdo gjuhë tjetër, është pasuruar pa ndërprerje gjatë viteve, dhjetëvjeçarëve, shekujve. Ai rritet e pasurohet dhe sot nga vet formimi i fjalëve të reja me parashtesa apo me përbërje si dhe nga huazimi i fjalëve të huaja.

Huazimi është një dukuri që ndodh në të gjitha gjuhët. Ai sjell pasurimin e gjuhës kur lidhet me një objekt a dukuri të re të panjohur, për të cilën gjuha nuk ka fjalët përkatëse. Nga nevoja që ka gjuha disa fjalë shpesh merren nga ndonjë gjuhë tjetër, qëndrojnë aty, por shpesh, me zhvillimin e mëvonshëm të saj edhe mund të dalin nga përdorimi, madje mund të harrohen fare. Kësisoj ka ndodhur edhe me gjuhën shqipe. Historikisht në gjuhën tonë, për shkak të nevojës që kishte, janë futur fjalë

<sup>152</sup> Çabej, Eqrem, *Hyrye në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 59.

<sup>153</sup> Lloshi, Xhevat, *Mbështetje për gjuhën letrare*, Botimet Toena, Tiranë, 1997, f. 108.

të reja nga gjuhë të ndryshme, si nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, anglishtja etj.<sup>154</sup> Por a ishin dhe a janë këto fjalë “huazime”, siç ndeshet shpesh ky term në gjuhësinë shqiptare? Kush i “huazoi” këto fjalë? A mund të huazohet fjala? Çdo folës ka lirinë për të përzgjedhur fjalë që nuk janë pjesë përbërëse e gjuhës së tij dhe t’i përdorë gjatë komunikimit për të përmbushur nevojat që nuk ia jep gjuha shqipe. Megjithatë, gjatë këtij procesi, duhet t’i kushtohet vëmendje saktësisë kuptimore dhe gramatikore të këtyre fjalëve, që do të thotë se nuk mund ta marrim fjalën e huaj pa e përshtatur në kontekstin që duam ta përdorim, dhe pa e përshtatur saktësisht me gramatikën e shqipes. Ndërsa Roberto Gusmani thotë se “*tek huazimet riprodhohen vetëm disa aspekte të modelit e pikërisht referenciale të të shenjuarit*”,<sup>155</sup> pra fjala e huazuar nga gjuha që e marrim mund të mbartë disa kuptime, por në shqipe mund të përdoret vetëm në një kontekst të caktuar.

Në bazë të përkufizimit në fjalorin e gjuhës shqipe fjala huazim përkufizohet “‘‘HUA,-JA’’:

1. Para (të holla) ose diçka tjetër me vlerë që i merret a i jepet dikujt, për një kohë të caktuar dhe i kthehet përsëri.

2. Hua shtetërore, i mori (i dha i kërkoi) hua<sup>156</sup>.

Edhe emri huazim shpjegohet me: "Veprimi sipas fjalëve HUAZOJ, HUAZOHEJ.

1. Huazimi i fjalëve. Huazimi i librit.

2. gjuh. Fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që janë marrë prej një gjuhe të huaj<sup>157</sup>.

Nga shpjegimi që jep fjalori vërehet se huaja përcakton diçka (çfarëdo qoftë ajo) që merret, por që pastaj duhet edhe të kthehet, por në shpjegimin vijues, huazimi i fjalëve tregon që nuk ka kthim mbrapa. Si rrjedhojë, çështja që del këtu është se fjalët nuk kthehen! Duke e thënë këtë, për aq kohë sa një fjalë shkruhet në fjalorin e gjuhës shqipe, ajo fjalë nuk mund të quhet më huazim, ajo fjalë tashmë është pjesë e leksikut standard të gjuhës shqipe.

Deri sot huazimet e fjalëve dhe strukturat e huaja janë në numër të konsiderueshëm, sa mund të themi me siguri se shqipfolësit po përdorin njëkohësisht disa sisteme gjuhësore. Kjo vjen si rezultat i ndikimit të gjuhëve në kontakt për shkak të fqinjësisë, por edhe gjuhës së vendeve të

<sup>154</sup> Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë, 2014, f.23.

<sup>155</sup> Kristina Jorgaqi, *Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde*, SF 1998 1-2.

<sup>156</sup> *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 488.

<sup>157</sup> Po aty, f. 489.

fuqishme ekonomikisht e politikisht. Por tani, pas dy dekadash hapjeje me botën, “...Folësit do të fillojnë të reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes, do të shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre dhe, vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë do të pranojnë t’i përdorin, duke ua nënshtruar sistemit të gjuhës së tyre. Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve”<sup>158</sup>

## II.2 Shkaqet kryesore të huazimit në gjuhën shqipe

Në periudha kalimtare, siç ka qenë dhe vazhdon të jetë gjuha shqipe pas viteve ‘90 e deri sot, trysnia e gjuhëve të tjera për të futur fjalë në gjuhën shqipe është më e madhe, sesa forca e shqipes për t’u bërë qëndresë këtyre huazimeve. “Në këtë fazë folësit e gjuhës, të përballur me realitete të papritura, që lëkundin status quo-në e tyre në kufijtë e mbijetesës, nuk mund të kenë vetëdije të qetë gjuhësore në mbrojtje të gjuhës amtare. Pragmatizmi për mbijetesë rrit nevojën për një komunikim global utilitar që shtrihet përtej caqeve të idiomës kombëtare”<sup>159</sup>

Gjuha shqipe dita ditës po mbushet me fjalë të huaja. Shqipja në të shumtën e rasteve është e detyruar t’i pranojë këto fjalë të huaja. Zhvillimet e mëdha teknologjike, këmbimet marramendëse të informacioneve që kapërcejnë hapësira shumë të mëdha dhe kontaktet gjithnjë e më të zhvilluara të kulturave të ndryshme mes popujve, kanë bërë që edhe në terminologji të ketë shkëmbime të shumta. Prandaj, parë në këtë aspekt, sipas studiuesve është e kuptueshme që edhe terminologjitë profesionale të zhvillohen vrullshëm, e pastaj të ndikojnë në gjuhë të ndryshme. Studiuesit mendojnë se huazimet sa janë të nevojshme, po aq janë edhe të dëmshme.<sup>160</sup>

Është e natyrshme që në periudha ndryshimesh të mëdha politike, ekonomike e sociale, në periudha kthesash historike në jetën e një kombi, të ndodhin edhe zhvillime të shumta në gjuhën e tij, veçanërisht në sistemin leksikor. Pasurimi i leksikut me fjalë e kuptime të reja është një prej ndikimeve pozitive, që vjen si pasojë e kontakteve të shumta e intensive të shqipes me gjuhët e kulturat e popujve të tjerë. Por, këto lidhje mbartin edhe pasojat e tyre negative, ç’ka duket qartë në përdorimin e tyre abuziv

<sup>158</sup> Shezai Rrokaj, *Përse përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe*, 23 tetor 2013. Gazeta “Panorama”.

<sup>159</sup> Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë, 2014, f. 37.

<sup>160</sup> Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë, 2014, f. 36.

dhe të pamotivuar, të një morie fjalësh e ndërtimeve me prejardhje të huaj.<sup>161</sup>

Zhvillimi i gjuhës shqipe ka ecur krahas zhvillimeve shoqërore, ekonomike, shkencore, kulturore etj. Shqipja ashtu si edhe gjuhët e tjera do të vazhdojë të marrë fjalë nga gjuhët e tjera. Huazimi konsiderohet proces i natyrshëm sepse gjuhët, disa më pak e disa më shumë, zhvillohen e pasurohen edhe me fjalë të gjuhëve të tjera për arsye të ndryshme dhe arsyeja kryesore është mungesa e fjalës në shume fusha. Megjithatë, akoma më shumë sot, kur të gjithë shoqërinë e ka përfshirë globalizmi, duhet të punojmë për ta ruajtur dhe pasuruar gjuhën tonë, e cila është dhe një nga elementet kryesore që na ka identifikuar në shekuj dhe do të na identifikojë sot e në të ardhmen. *“Thjeshtësia e pastërtia e gjuhës qëndron në të përdorun t’atyne fjalëve e konstrukteve, të cilat janë të përdorshme e të gjalla në gojë të popullit e që përdoren prej shkrimtarëve të tij të shquem e të përmendun”*, shprehet profesor Aleksander Xhuvani në librin e tij për pastërtinë e gjuhës shqipe.<sup>162</sup>

### II.3 Format e ndryshme të huazimit

Në gjuhën shqipe huazimet janë të termave të ndryshme. Ato janë të plota: fjala ka hyrë si është në gjuhë të huaj, p.sh.: futboll, bursë, adresë, depo, kamion etj. strukturore: fjala në të vërtetë është shqip, por është ndërtuar sipas modelit të një fjale të huaj, duke përkthyer pjesët e saj përbërëse. Këto huazime quhen kalke si p.sh.: bashkëtingëllore, drejtshkrim, ndajfolje, kryevepër, i jashtëzakonshëm, rrënjësisht etj. Janë huazuar gjithashtu edhe prapashtesa a parashtesa, si p.sh.: prapashtesat: -icë, -nik, -kë, -it nga sllavishtja; prapashtesat: -xhi, -çi, -llarë, -lerë, -llëk, nga turqishtja.

Fjalët që merren nga gjuhët e huaja, shkruhen dhe shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit tonë, u nënshtrohen të gjitha kategorive gramatikore dhe rregullave përkatëse: p.sh. në qoftë se janë emra, kanë trajtë të pashquar, të shquar, numrin njëjës a shumës, lakohen etj.<sup>163</sup>

Fjalët e huazuara janë të fushave të ndryshme të jetës:

-të jetës politiko-shoqërore: kushtetutë, parti, diktaturë, demokraci etj.

<sup>161</sup> Lilo, Raul, *Mbi huazimet frënge në gjuhën shqipe*, shkëputur nga Konferenca Shkencore, Kontakte gjuhësore dhe kulturore mes shqipes dhe gjuhëve të huaja në 100 vjet (1912-2012), Tiranë, 2012, f.19.

<sup>162</sup> Emil Lafe, *Puna e profesor Aleksandër Xhuvanit për pastërtinë e gjuhës dhe rëndësia e saj për kohën tonë*, Gjuha jonë 2, 1990, f. 29. dhe *“Mbi thjeshtësinë e gjuhës”*, Vepra I, Tiranë, 1980, f. 18.

<sup>163</sup> E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, në —Studime gjuhësore II, III, Prishtinë, 1976, f. 191-302

-të shkencës dhe teknikës: histori, gjeografi, gramatikë, traktor, telegraf, mikroskop, radio etj.

-të artit: roman, poemë, dramë, komedi, portret, teatër etj.

-të sportit, mjekësisë etj.

Studiuesit dhe lëvruerit e gjuhës shqipe kanë bërë klasifikime të ndryshme për huazimet, kryesisht sipas fushës (morfologjike, sintaksore, leksikore e fonetike); sipas mënyrës së huazimit (të drejtpërdrejta e të tërthorta); sipas ligjëritimit (gojore e shkrimore); sipas shkallës së depërtimit në sistemin e gjuhës (të rrënjësura dhe të parrënjësura); sipas përmbajtjes së huazimeve (të plota, strukturore). Bloomfield-i huazimin gjuhësor e përcaktonte si marrje të elementeve gjuhësore dhe dallonte dy tipa huazimesh: atë kulturor (kur elementet e huazuara vinin nga një gjuhë tjetër e largët) dhe dialektor (kalimi i fjalëve nga një dialekt në tjetrin)<sup>164</sup>.

**III.** Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj në përkthimet letrare nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe

Sipas Umberto Ekos, të përkthesh do të thotë “*të kuptosh sistemin e brendshëm të një gjuhe dhe strukturën e një teksti të caktuar në atë gjuhë, pastaj të ndërtohet një sistem të dyfishtë tekstor, që me një përshkrim të caktuar, mund të shkaktojë pasojë të ngjashme të lexuesi, si në planin semantik e sintaksore, ashtu edhe në atë stilistik e po aq në efektet gjithë pasion që teksti në burim pritej të sillte*”<sup>165</sup>

Më këtë thënie çdo përkthyes nënkuptohet të këtë si “detyrë” që të përpiqet që të përçojë të lexuesi i tekstit të përkthyer të njëjtin emocion që transmeton teksti burimor. Por, të qenurit besnik të transmetimit të emocioneve nuk nënkupton dhe aq më pak justifikon faktin që shumë përkthyes huazojnë shumë fjalë nga teksti origjinal në tekstin e përkthyer, ku në të shumtën e rasteve këto huazime janë të panevojshme, pasi të barazvlefshmit e tyre ekzistojnë në leksikun e gjuhës shqipe.

Më poshtë paraqiten raste nga përkthimi i disa veprave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, dhe nënvizohen huazimet e panevojshme.

-Lamtumirë armë-Ernest Heminguej (Përkthyer nga Vedat Kokona)<sup>166</sup>

**Barmani** veshi xhaketën dhe dolëm. Zbritëm buzë liqenit. Unë vozitja kurse **barmani** ishte ulur prapa...(fq.209) =>në vend të fjalës angleze barman mund të përdorim krejt mirë fjalën shqipe **banakjeri**

**Ruksaku** dhe çantat e mia ishin sipër kokës së tij, në rrjetë. Në korridor, kishte shumë njerëz që rrinin në këmbë dhe ato që ishin në **kompartiment**

<sup>164</sup> Vesel Nuhju, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2013, f. 18.

<sup>165</sup> Eko, Umberto, *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Tiranë, 2006, f.17

<sup>166</sup> Heminguej, Ernest, *Lamtumirë armë*, prkth. Vedat Kokona, *Dituria*, Tiranë, 1998, f.132, f. 209.

na vështruan me kujdes...(fq.132) => në vend të fjalës **ruksaku** që në anglisht është “**rucksack**” mund të përdorim togëfjalëshin shqip **cantë shpine**, dhe në vend të fjalës **kompartment** kemi fjalën **kabinë**.

-Daneil Still(Steel)-Dy jetë (përkthyer nga Çlirim Xhunga)<sup>167</sup>

...pas një pushimi të shkurtër, përpara tyre u shfaq një ujvarë **impresionuese**...të gjithë e dinin se kjo errësirë duhej **evituar**...ishte një vend **perfekt**...(fq.214) => në vend të mbiemrit **impresionues** mund të përdorim të barazvlefshmin e tij në gjuhën shqipe **mbresëlënëse**, në vend të **evituar** mund të përdorim **shmangur** dhe në vend të **perfekt** kemi fjalën shqipe **i përsosur**.

-Emili (Emily) Bronte-Lartësitë e stuhishme (përkthyer nga Amik Kasoruh) <sup>168</sup>

... dhe të veprojë duke u mbështetur mbi përshtypje të rreme, ndaj të cilave është **afeksionuar**...(f.153) => në vend të termit **afeksion** mund të përdorim termat shqip **është lidhur, tërhequr, dhënë**.

-Daniel Still- Premtimi (përkthyer nga Tomi Treska)<sup>169</sup>

...është një vajzë me një bukuri gati **ireale**...(f 212)...shumë i vendosur dhe taman prej **biznesmeni**...(fq.239)..=>në vend të **ireale** mund të përdorim fjalën shqipe **jo e vërtetë** ose **e pabesueshme** dhe në vend të **biznesmeni** mund të përdorim termin shqip **sipërmarrës**.

Këto dhe shumë shembuj të tjerë mund të gjenden në shumicën e veprave letrare të përkthyer jo vetëm nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, por edhe nga shumë gjuhë të tjera. Dukuria e huazimit është e mirëpranuar nga të gjithë dhe shihet shpesh herë si domosdoshmëri në komunikim, por deri aty ku kjo përdoret me logjikë dhe në dobi të komunikimit e pasurimit të gjuhës, pa shkuar në shpërdorim të kësaj lirie që ka secili folës dhe të kalojmë në dëmtim të gjuhës me futjen e fjalëve të huaja vend e pa vend.

#### IV. PËRFUNDIME

Frika nga huazimet dhe a duhen mbështetur ato?

Rritja e përdorimit të gjuhës angleze dhe shumë gjuhëve të tjera të huaja në publik është e dukshme. Në rastin e përdorimit të huazimeve nga përkthyesit në tekstet letrare, fenomeni i huazimit po vihet re gjithnjë e më shumë, por kjo nuk do të thotë që gjuha shqipe po zhduket.

Fakti që huazimet po vihen re gjithnjë e më shumë është sepse në ditët e sotme përkthehen shumë materiale dhe zhvillimet ekonomike e

<sup>167</sup> Still (Steel) Daniel, *Dy jetë*, prkth.Çlirim Xhunga, Uegen, Tiranë, 2004, f. 214.

<sup>168</sup> Bronte, Emily, *Lartësite e stuhishme*, prkth.Amik Kasoruh, Dudaj, Tiranë, 2010, f.153.

<sup>169</sup> Steel, Daniel, *Premtimi*, prkth.Tomi Treska, Redona, Tiranë, f. 212;239.

shoqërore kanë bërë që gjuhët e huaja të kenë një ndikim gjithnjë e më të fortë në gjuhën shqipe.

Megjithatë, në qoftëse gjuha shqipe përmban konceptin apo fjalën brenda fjalorit të saj, atëherë nuk ka asnjë arsye pse të huazojmë fjalë që tashmë ekzistojnë në gjuhën tonë. Fenomenet janë vështirë të përshtaten në gjuhën tonë në qoftë se janë fenomene të cilat janë prezantuar fillimisht në vende të tjera, por mund të bëhen përpjekje për t'u gjetur e barazvlefshmja e tyre në shqip.

Gjuha shqipe nuk mund të qëndrojë në vend. Ashtu si gjuhët e tjera edhe ajo do zhvillohet por siç shprehet edhe profesor Seit Mansaku: *“Mendoj se ka ende mënyra dhe mjete shprehjeje, togfjalësha dhe ndërtime sintaksore të gjuhës popullore a të folmeve dialektore që mund të pasurojnë dhe ta bëjnë më të gjallë, më të zhdërvjellët dhe më të larmishme strukturën sintaksore të shqipes standarde, duke mënjanuar ndërtime stereotipa e klishe që tingëllojnë artificiale”*.<sup>170</sup>

Për pasurimin e leksikut mund të përzgjedhim edhe fjalë shqipe që kanë qenë më parë, por për arsye të ndryshme kanë mbetur mënjanë. Por, e rëndësishme në këtë moment zhvillimi të shqipes, ku e kemi faktuar praninë e shumë huazimeve, është se *“...duhen dalluar mirë ç'janë fjalë të huaja të panevojshme dhe ç'janë huazime a ndërkombëtarizma të pranueshme. Lidhur me këtë, natyrisht, kërkohet shoshitje e mirë e lëndës, maturim e qëndrime të peshuara në mënyrë që të bëhet pastrim i shoqëruar me pasurim të mirfilltë, pa cënuar askund dhe aspak aftësinë shprehëse, përndryshe po të bëjmë pastrim për pastrim do të ishte varfërim i gjuhës”*.<sup>171</sup>

<sup>170</sup> Seit Mansaku, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 25

<sup>171</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Shqipja e sotme*, Tiranë, 2010, f. 210.



**V. BIBLIOGRAFIA**

- Bronte, Emily, *Lartësitë e stuhishme*, prkth. Amik Kasoruh, Dudaj, Tiranë, 2010, f.153.
- Çabej, Eqrem, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 59.
- E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe, në Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 191-302.
- Eko, Umberto, *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Tiranë, 2006, f.17.
- *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 488.
- Hamp, Eric P. *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, 2007.
- Heminguej, Ernest, *Lamtumirë armë*, prkth. Vedat Kokona, Dituria, Tiranë, 1998, f.132; 209.
- Jorgaqi, Kristina, *Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde*, SF 1998 1-2.
- Lafë, Emil, *Puna e profesor Aleksandër Xhuvanit për pastërtinë e gjuhës dhe rëndësia e saj për kohën tonë*, Gjuha jonë 2, 1990, f. 29. dhe “Mbi thjeshtësinë e gjuhës”, *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 18.
- Lloshi, Xhevat, *Mbështetje për gjuhen letrare*, Botimet Toena, Tiranë, 1997, f.108.
- Lilo, Raul, *Mbi huazimet frënge në gjuhen shqipe*, shkëputur nga Konferenca Shkencore, Kontakte gjuhësore dhe kulturore mes shqipes dhe gjuhëve të huaja në 100 vjet (1912-2012), Tiranë, 2012, f.19.
- Mansaku Seit, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 25.
- Memushaj, R, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2002, f.197-201.
- Nuhiu, Vesel, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2013, f. 18.
- Rrokaj, Shezai, *Përse përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe*, 23 tetor 2013. Gazeta“Panorama”
- Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë, 2014, f. 36
- Shkurtaj, Gjovalin, *Shqipja e sotme*, Tiranë, 2010, f. 210.
- Still (Steel) Daniel, *Dy jetë*, prkth. Çlirim Xhunga, Uegen, Tiranë, 2004, f. 214.
- Steel, Daniel, *Premtimi*, prkth. Tomi Treska, Redona, Tiranë, f. 212; 239.

**The Albanian word instead of the foreign one****ABSTRACT**

The Albanian language has been facing various cultural and linguistic models. The language is considered as a living organism, which grows, develops and is enriched daily by speakers who use it. With the development, foreign words have entered the Albanian language, the everyday language as well as the standard one.

In this paper, I want to emphasize the usage of borrowings from English language into the Albanian one, especially in the translation field. During my academic years, I have studied works from different British and American writers and while having great knowledge of the English language, I have noticed that Albanian translators are influenced from the English language and during translation they tend to borrow words from English into the Albanian language. There happens to be cases when these words are needed, but in some other cases, especially when the equivalent terms already exist in the target language, loan words are not necessary. I will further develop this paper in the points to come.

**Key words:** Albanian word, borrowings, Albanian Language, translation, cases of borrowings

Fatbardha HOXHA

## LEXIMI NË SHQIP I LIRIKAVE TË SÁNDOR PETÖF-IT

Para ardhjes së poezisë të Sándor Petöf-it në shqip, në një studim më 1945-ën dijetari shqiptar evropian **Eqrem Çabej** teksa shkruante për lëvizjen romantike në Evropë qe shprehur: “*Me Hungarinë shkelim truallin e Europës Juglindore. Ky popull u mbrujt historikisht në një nacion duke u mbështetur tek kombet fqinj, por njëkohësisht edhe në kontrast me ta. Në këtë truall Perëndimi dhe Lindja janë pjekur qëmoti dhe kanë luftuar njëri-tjetrin. Me hyrjen e hershme të katolicizmit ky çip më verior i Europës Juglindore u bë njëkohësisht e përgjithmonë pjesë e Perëndimit dhe e afirmoi këtë rol historik të tij edhe në luftëra të gjata me turq. Si për viset fqinje dhe më shumë se në këto mori rëndësi këtu humanizmi italian. Ai kontribuoi aq shumë për zhvillimin e literaturës magjare... Shekulli XIX solli si në viset e tjera të Europës Lindore dhe Juglindore zgjimin e ndërgjegjes kombëtare reformën e gjuhës dhe një literaturë të re... Kryengritja frënge, Revolucioni i korrikut me turbullimet e vitit 1848 në Europë ngritën në këmbë edhe këtë komb lirisht. Posaçërisht mundimeve të Kossuth-it u detyrohet kushtetuta e 1867-ës, e cila u dha magjarëve njëfarë mëvetësie brenda suazës së Monarkisë. Në lëmë të gjuhës, rëndësinë e së cilës për gjithë këtë truall të Europës e theksuam më lart, shkrimtari dhe përkthyesi Ferenc Kaszinczy qysh nga mbarimi i shekullit XVIII pat sjellë një përtëritje dhe një pasurim dhe i pat çelur kështu rrugën poezisë romantike që u duk pas pak kohe. Romantizmi, i cili në Hungari për arsye gjeografike filloi herët, dha këtu ashtu si në Poloni pemë të mira”.*

Çabej përmend dhe jep të dhëna për kontributin e Ferenc Kaszinczy, Sándor Kisfaludy, Károly Krisfaludy, József Katona, Mihály Vörösmarty, János Arany, József Eötvös, por veçon “... *Sándor Petöf-in (1823-1849), i cili ra i ri në luftë, më i madhi poet i Hungarisë dhe i pari që merr pjesë në literaturën evropiane*”, (Eqrem Çabej, Romantizmi në Evropën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare tek “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, Tiranë, 1994, f. 85-86).

Përfaqësues nga më të veçantët dhe të rëndësishmit romantikë, të shekullit të madh të romantizmit në Evropë, hungarezi Sándor Petöf, është i njohur botërisht për poemat dhe lirikat që për fat të mirë kanë ardhur në shqip në një përkthim dinjitoz. Në pamundësi për të lexuar të plotë veprën e gjejmë të udhës të shprehim disa mbresa që përfton poezia e tij lirike e përfshirë në vëllimin “Ç’të shkrepri trill i moçëm”, shqipëroi nga origjinali A. Guskiaqi, Botimet Toena, Tiranë, 1997 që përmbledh më shumë se 120 poezi të poetit të njohur.

Lirikat, si gjini e konsideruar nga *zonja De Stal* si “*e vetmja poezi e vërtetë*” dhe që paraqet “*lëvizjen e shpirtit*”, shpërfaqin profilin poetik të hungarezit të madh që dinte të shprehte ndjesitë më të brishta e më delikate të pejzave të shpirtit njerëzor, dhimbjet dhe brengat që ndrydhin dhe vrasin ëndrrat e njeriut dhe të kombit për dritë dhe liri.

E gjithë lirika e Petöf-it ishte frymë e kohës e atmosferës shpirtërore të shekullit XIX, shekullit romantik që do të frymëzonte fort lartësimin e shpirtrave të trazuar libertinë që kërkonin ripërtëritjen e jetës dhe të artit në të gjithë Evropën nga Perëndimi në Lindje.

Lirika e tij e përfutur nga sfida e disafishtë e popullit hungarez në mbrojtje të identitetit kombëtar në perandorinë dualiste danubiane dhe në luftë me perandorinë turke, e ngroh ëndrra për liri, drejtësi dhe jetë më të begatë.

Vepra e tij poetike i ka të gjitha polet dhe performancën e një poezie romantike “par exelence”. Dy polet tipike romantike atdheu dhe dashuria zënë vendin më të madh në lirikën e tij. Atë e shquan fjala e kursyer e plot hapësirë shprehëse, emocionaliteti i ngritur.

Motivin atdhetar qytetar në poezinë e tij e shprehin një varg poezish me një artikulum befasues që u jep jetë ndjeshmërive të thella që s’mund ta përfytyrojnë jetën ndryshe nga ajo çfarë ndodhte në përditshmërinë e një luftëtari që shkon orë e çast drejt realizimit të ëndrrës së lirisë dhe kur ajo kërkon sakrificën sublime.

Në poezitë “Së largu”, “S’mundem pa këto vende”, “Endërra më degdisi drejt betejash”, “Hungaria ime”, “Buka e zezë”, “Jetë dhe vdekje”, “Një liri, një dashuri”, “Luftë më ishte...”, “Për vdekjen e vocrrakut”, janë poezi ku ideja poetike ndrit së brendshmi, ajo nuk zhurmon as nga thirrjet, as nga tam-tamet, as nga trumpetat e luftës. Natyrshëm zbulohet ideja poetike, sepse veç koloritit kombëtar ajo ka edhe karakter universal. Ajo tingëllon e afërt për ne shqiptarët që na lidhin aq shumë me hungarezët historia e shekujve të bujshëm të Mesjetës, heronjtë tanë kombëtarë, dhe dashuria e pakufishme për liri. Teksa lexon këto lirika nuk ke si të mos

sjellësh në mendje fjalët e humanistit shqiptar Marin Barleti për lirinë se “Asnjëherë nuk duhet menduar se për atdheun është bërë shumë, se është derdhur tepër gjak, se dashuria për të ia kalon çdo dashurie tjetër” apo motoja e humanistit arbëresh Mikel Maruli që modestisht shpallte kredon e tij “Duke luftuar kërkoj një vdekje të ndershme për atdhe”, si dhe romantikët tanë që u përgjëruan për atdheun e lirë deri në frymë të fundit.

Duke lexuar lirikat e Petöf-it të ndjera deri në dhimbje, të përfshijnë vargjet “Hungaria ime”: “Atdheu im, i shtrenjti dhé”. Edhe pse peizazhi është shumë i parapëlqyer për romantikët, ideja poetike qytetare është ndërthurur e shkrirë me peizazhin e atdheut të poetit plot ngjyra, nuanca e tinguj që krijojnë parafytyra aq të afërta me gjeokompleksin natyror me fusha e fushëtira, me stepa (mëma stepë e quan poeti) dhe rrafshina me rrjedhën magjepsë të Danubit që ndan e bashkon shumë kombe të Evropës, në brigjet e të cilit shfaqet edhe shtëpiza e fëmijërisë së poetit.

*“Buzë Danubit, ah shtëpizë e vyer  
Kaq e bukur sa s’ka të rrëfyer.”*

Vargjet derdhin si në telajo një peizazh që i jep jetë njeriu i këtyre brigjeve dhe merr nga natyra mirëqenie e begati, por edhe vlera të pafundme njerëzore.

Temës qytetare nuk ka si t’i mungojë silueta e nënës së luftëtarit që gatuan bukën e zezë nga më të ëmblat që gatuan bota. Nëna e subjektit lirik pret me drithërima shpirti lajme nga i biri në fushëbeteja. Përmes vargjeve ai nxiton që të japë porosinë

*“Të m’i thoni drejt me të qeshur  
Fat i mirë të birin e ka ndeshur  
Ah të mos m’i flisni për pësime  
Ndryshe gjallë s’e has më nënën time.”*

Në lirikën: “Luftë më ishte jeta ime” shpërfaqet ashtu pa bujë kredoja e luftëtarit, subjektit të poezisë që për lirinë gjakun s’ka kursyer. Elementi autobiografik e bën edhe më të prekshëm tingullin gjithëkohor dhe gjithëhapësinor përgjithësues që ka poezia. Në strofat e fundit ai prek dilemat drithëruese të njerëzimit në të gjitha kohët dhe sot e gjithë ditën e raportit të luftës dhe të paqes që qëndron si një shpatë e mprehtë në vetëdijen e njerëzimit ndër shekuj, duke i dhënë kësisoj lirikës së vet përmasën edhe të një lirike meditimi, përsiatëse.

Paqe botës! Porse kurrë  
Falë tiranive  
Po prej shpirtrave të pastër  
E prej zemrash trime.

Vetëm paqja si të tërin  
Ta përqaftë planetin  
Atëher armët le t’i hedhim  
Dhe në fund të detit.

Por e keqja gjersa sheshit  
Rreh të bëjë të vetën  
Gjithë në këmb’ e armëngjeshur  
Sa të kemi jetën.

Tabllonë e sakrificave që kërkon liria e japin shumë poezi që vijnë të gjalla dhe sugjestionuese si vetë përvoja jetësore e lirikut të famshëm si “*Dhe për atdhe të vdesësh*”, “*Jetë dhe vdekje*”, apo vargjet:

Të tillë ikje ku ta gjesh, ta puthësh  
Kur atdheu dhëmb porsi shtëpia  
Ndaj fatos pa dredhka re mes gjakut  
Pas të thjeshtës klithmë “Rroftë liria”.

(Për vdekjen e vocrrakut)

Ideja qytetare e lashtë, sa vetë jeta dhe bota, në këto lirika kulmon në poezinë “*Një liri, një dashuri*”, e cila përmes një meditimi proverbial për vlerat e lirisë, raportet e saj me ndjenjën e dashurisë që mban gjallë jetën, e ka bërë poezinë të njohur botërisht shquhet edhe për veskun estetik të mendimit të cilën përkthyesi në shqip na e sjell përmes këtyre vargjeve:

Dy visare kam të shtrenja  
Gjithsesi  
Një liri dhe një të flakët  
Dashuri  
Dashurisë i fal sot jetën  
Dora, dorë  
Për liri dhe dashurinë  
E bëj theror.

Lirikat e Petöf-it sjellin aq shumë tablo, situata, gjendje, përjetime me një pasuri perceptimi të pafundme poetike që përcjellin kumte dhe emocionalitet të thellë. Ndonëse zotimi në luftë ia ndërpreu dhunshëm jetën dhe krijimtarinë, ai përfshiu në fokusin e tij poetik ngjarje dhe gjendje nga më të larmishmet të jetës, harmoninë, të madhërishmen, tragjizmin, si dhe komiken, gëzimin, befasinë dhe mrekullimin nga çfarë i ofronte jeta e njeriut dhe bota.

Përtej mozaikut të kontrasteve që ofronte shoqëria e kohës në atdheun e tij, në tehun e luftërave me perandori, ai zbulon aq shumë dhimbje dhe dilema të bashkëkombësve të vet dhe të njerëzimit, që i ka fiksuar me aq poezi që kanë edhe përmasën e meditimit rreth idesë siç ndodh në poezitë “Ndalur jam në udhëkryq”, “Sa pa fund kjo gjithësi”, “Qysh ndodh të mbeten të pandëshkuar”, “Përgjumësh jam por s’mundem dot të fle”, “Përkundër durimit”, “Botë e fandaksur”, “Bota është e mirë”, “Njeriu”, “Ora e ligë”. Përmes mbresave të përditshmërisë, sfidave që s’i ndahen subjektit të lirikave të Petöf-it, ai arrin të zbulojë shpesh një botë të përmbysur, të kthyer mbrapsht, por poeti asnjëherë nuk e humb besimin edhe kur tronditet, sepse ai thellë-thellë, si për të sfiduar trishtimin ruan

mendimin siç e thotë edhe refreni “Jeta është e ëmbël / Bota është e mirë”. Po ashtu notat sociale aq të pranishme veçmas tek romantikët francezë, janë në poezinë e Petöf-it që pikon dhimbje të thellë njerëzore, për ata që vuajnë varfërinë dhe mjerimin në një botë që subjekti lirik e gjen të ndërtuar keq si e thonë vargjet që shprehin edhe dufin e mospranimit të saj, e kundërshtimit në çdo mënyrë.

Ngrehinë e moçme ky planet  
 Themelet ngjeshur nën batak  
 Në ke ndërmend t’i biesh drejt  
 Për trarësh kryet t’i përgjak!  
 Çkado na qofsh çunak a burrë  
 Unë them më mirë të plas një kokë  
 Se sa ta bëj kurrizin urë.

Shpirt i trazuar, i vrullshëm, vullkanik, mbetur përjetësisht i ri (ai u nda nga jeta në moshën 26- vjeçare), s’kishte si të mos kërkonte t’i merrte jetës atë që e mban gjallë, i jep frymë asaj, dashurinë. Lirikat e Petöf-it jo vetëm që provojnë se kjo botë merr frymë nga dashuria, por se lirikat për të janë ndër gjërat më të bukura që ai ka shkruar. Ky lastar i blertë e plot nuanca ndejsish bulon përmes elementeve personale të subjektit lirik, por edhe përmes fabulave të goditura të dhëna me një tis përrallor sa në një pijetore, sa në një han, përbri vreshtit, në gazullore udhëfshati, apo në një takim të rastësishëm në stepë. Janë situata të pikëzuara me dorë piktori, me miniatura, ku çdo detaj flet për atë ndjenjë që përfton kuptimin dhe bukurinë e kësaj jete.

Poeti është adhurues i bukurisë dhe dashurisë femërore si të gjithë romantikët deri në nënshtrimin ndaj tyre që me nuanca rebelimi shprehin vargjet e tij.

Nëse më je qiell, unë jam ylli  
 Ferr i terë, e tëra të shndroresh  
 Mes për mes mallkimesh do të rënt



Botës poetike të Petöf-it që është mrekullisht e pasur nuk i mungojnë dramat njerëzore që kanë protagonistë fëmijën, ushtarin, artistin, varfanjakun, ciganin, njeriun e thjeshtë, por dhe komponentin humoristik, ironik që ai shfaq në disa poezi veçmas me elemente personale si “Ç’vjen më kruhesh fat i egër?”, “Vargje për verë”, “Ujë dhe verë”, “Të pimë”, “Fatmirosh s’u linda”, “Zanati im dhe i tim eti”. Në këto poezi dhe në poezitë “Epigonëve” dhe “Një poetit të ri” ai i qaset edhe problemit të origjinalitetit të krijimtarisë dhe rolit opozitar të saj në të gjitha kohërat.

Që poezia e tij lirike ka kapërcyer kohën në të cilën është shkruar, gjeografinë e atdheut të poetit dhe ka marrë dimension evropian e dëshmon tërësisht poetike që ofron kjo lirikë e mbase edhe ndonjë lirikë si “Shekuj më parë” që arrin të paralajmërojë paradokset e kontrastet e kohëve moderne, kur vlerat dhe antivlerat tjetërsohen apo për fat të keq ndërrojnë vend.

Shekuj më parë  
Një dijetar  
Ikte kaluar  
Përmi gomar  
Por kohët rrodhën  
Qysh atëherë  
Mbi kuaj hipur  
Sa shumë gomerë  
Ngrekosur, stisur  
E kryeshkëmb  
Teksa dijetari  
Çapet në këmbë.

Teksa varg pas vargu ke lexuar e përjetuar emocionalisht lirikën e poetit të rrallë, të habit fakti se kjo krijimtari e gjerë tejet e pasur u përftua në një hark kohor vetëm brenda 10 vjetëve (1839-1849) të një të riu të përjetshëm që i dha aq shumë gjinisë dhe zhanreve lirike me talentin e papërsëritshëm duke e pasuruar thesarin e lirikës botërore.

Ky dhjetëvjetësh ishte jo vetëm nga më të trazuarit e Evropës, por edhe të atdheut të poetit, kur sfida për mos u nënshtruar i dha impulse qëndrues.

Në mozaikun e jashtëzakonshëm të poezisë së tij lirike shpërfaqet shpirti i lirë i qytetarit hungarez me një histori të bujshme aq dhe të dhimbshme që i fal

lirisë gurrën e ndjenjën më fisnike që me të gjitha fijëzat e zemrës ka ndërtuar arkitekturën e lirisë së brendshme, nga e cila burojnë ide, qëndrime dhe reagime sa ideale aq edhe realiste.

Shpirti i hapur dhe i lirë, kritik e mohues është identiteti i shpirtit hungarez që poeti e mishëron mrekullisht e madhërisht në lirikën e tij.

I ngjashëm me sivëllezërit e tij romantikë, luftëtari i lirisë, subjekt i natyrshëm si dhe vetë poeti është tepër i ndjeshëm për paudhësitë, për padrejtësitë, për pabarazinë sociale që i vrasin shpirtin e tij të lirë. Ai e ka shpallur “çdo këngë e kam një luftëtar” në një poezi – kredo “Zhelanët kurmpërzhitur” që të sjell ndërmend tingujt e korit të skllevërve të operas Nabucco të Giuseppe Verdit. Vargjet e tij janë një hymn për lirinë që tronditën shekullin e madh të drejtave dhe të lirive të qytetarit. Aspirata për barazi sociale është tejet e lexueshme në lirikën e hungarezit të madh, të cilën e jep përmes dramave jetësore, paradokseve historike

Një fill i hollë polemike përshkon lirikën e tij të cilat sjellin dramën e njerëzve të thjeshtë, por edhe të vetë poetit. Jetën ai e kundron me nota humorit, ironie shumë natyrshëm edhe kur flet në vetë të parë.

Një cilësi e shquar e lirikës së tij është thellësia e përjetimeve dhe e përfytyrimeve, hapësira disashtresore e asociacioneve që e përcjellin leximin, çfarë i jep ngjyra dhe nuanca origjinaliteti krijimeve të Petöf-it.

I krahasuar me Beranzhenë, Bernsin nga kritikët me sa kuptohet nga leximi edhe për notat sociale. Me koncentrimin e mendimit dhe të ndjenjës ai do të paralajmëronte poezinë moderne të fundshekullit XIX dhe të fillimshekullit XX.

Poezia e tij lirike nuk u qaset stolisjeve formale të jashtme. Përkundrazi ajo gurgullon së brendshmi nga ndjenja dhe ide që të befasojnë edhe me rrjedhën e intonacionit të vargut, me larminë e strofës që për meritën e përkthyesit kanë ardhur bukur edhe në gjuhën shqipe. Përkthyesi ka kërkuar dhe ka gjetur mjeshhtërisht fjalën, duke qëmtuar fjalë disi të rralla, që japin nuanca kuptimesh të veçanta të tipit, fushëtirë, flakërimë, rrafshinë, fushnajë, çurkajë, lulnajë, ujanë, bornajë etj.

Dukshëm është bërë përpjekje për ta kërkuar e qëmtuar fjalën e bukur e të duhur nga standardi apo dialektet që ruajnë lashtësinë, gjallërinë dhe bukurinë e shqipes. Vëllimi të cilit iu referuam e ka bërë të flasë shqip poetin duke pasuruar bibliotekën shqipe.

- Shpirti i poetit është bërë fjalë, është bërë gjuhë, është bërë poezi që jeton përtej kohës që e përftoi, duke fituar përjetësinë.

Të lexosh poezinë lirike të Petöf-it është si të përvetësosh një thesar vlerash urtësie e bukurie që u përkasin të gjitha kohërave, të gjithë kombeve e njerëzve në planet.

Poezia e tij është pasqyrë e shpirtit të madh dhe të lirë hungarez, ajo është vetë Hungaria, me identitetin, me historinë, me kulturën dhe me qytetërimin e kombit dhe të njeriut të saj.

Poezia e tij është e gjerë si fushat dhe stepat, e shtrirë si Danubi i atdheut të tij, Hungarisë që tejshkon kufij. Është ky hiri poetik i poetëve gjenialë si Petöf-i. Poezi si këto janë padyshim pasuri jo vetëm e atdheut dhe popullit, bir i të cilit është ai, ata i takojnë gjithë njerëzimit.

Vepra të tilla si lirika e Petöf-it, që qëndron përkrah lirikëve të mëdhenj evropianë, ngrenë ura njohjeje dhe miqësie midis popujve të kontinentit tonë, çfarë i shërben të sotmes dhe të nesërmes. Ata i përkasin gjithë botës, janë pjesë e visarit shpirtëror të të gjithë njerëzimit.

## BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, Romantizmi në Evropën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare tek “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, Tiranë, 1994.
- P. (van) Tieghem, La romantisme dans la litterature européenne. Paris, 1969.
- Sándor Petöf “Ç’të shkrepri trill i moçëm”, shqipëroi nga origjinali A. Guskiqi, botimet Toena, Tiranë, 1997.
- Të dhëna nga interneti për personalitetin dhe veprën e Sándor Petöf-it.

### Reading Sándor Petöf’s works in Albanian

#### *ABSTRACT*

Sándor Petöfi(1823-1849) is one of the most outstanding Hungarian writers. His poems and verses, inspired by his people’s fights for freedom and independence, made him be considered as the national poet of the Hungarian people.

The article “Reading SándorPetöfi’s works in Albanian” highlights the values of his lyrics incarnated in his poetry.

He is one of the most important representatives of the great century of Romanticism in Europe and is celebrated at home as well as abroad. He is presented to the Albanian reader in the Albanian language through his work

“Ç’tëshkrepi trill i moçëm” (Stricken by an old whim) that consists of more than 120 lyrics. They are very skilfully translated,

His lyrics are permeated by the romantic spirit of the time and reflect the great soul of the Hungarian people that aspired for freedom. In his lyrics, Hungary prevails with its identity, history, civilization, culture and humane feelings. Petöfi’s work belongs not only to his people but to Europe and the whole world because it constitutes a literary treasure of humankind

Arben PRENDI

## “VISARET E KOMBIT” DHE DIJETARËT FRANÇESKANË PËR AFIRMIMIN E EPOSIT SHQIPTAR TË KRESHNIKËVE

Informacionin e parë me shkrim për ekzistencën e eposit shqiptar e kemi nga autori francez Ami Bue (Boue) i cili në veprën *La Tourqie d'Europe II*, (Turqia e Evropës) Paris 1840, f. 108, shprehet se edhe shqiptarët gjithashtu kanë një poemë epike, po në përgjithësi më të shkurtër se të sllavëve, të cilët këta të fundit thonë se shumica e këtyre poemave nuk janë veç përkthime të eposit sllav.<sup>172</sup> Por i pari autor që boton në veprën “*Studime shqiptare*” në Vjenë, më 1896, f. 52 një këngë kreshnike është Gustav Majer (1850-1900). Megjithëse ajo është vetëm një fragment kënge ka rëndësi të posaçme si e para këngë e eposit shqiptar e paraqitur me shkrim. Kënga e dytë u botua më 1904, nga Gasper Merturi Jakova, në Fraskat të Italisë, i cili në një gramatikë të shqipes përfshiu edhe këngën “Martesa e Mujit” me 124 vargje dhjetërokëshe pa rimë, në të folmen fshatare të Malësisë së Veriut. Ka edhe vargje në nëntë apo tetërokësh që tregojnë për një degradim të vargut më të vjetër dhjetërokësh. Ndërsa në vitin 1905 kemi të botuara dy këngë kreshnike, në Split të Kroacisë, në gazetën “*Shpnesa e Shqypnisë*” nga Nikolla Ivanaj. Fjala është për këngët “*Vuk Harambashi dhe Hajkuna e Dizdar Osman Agës*” me 148 vargje dhe “*Martesa e Halilit të ri me Ruzhën e Galan Kapetanit*” me 217 vargje. Këto këngë tregojnë se kundërshtari i shqiptarëve janë *shkjetë* dhe se rapsodi shqiptar njih mirë vendet e përmendura, si: Jutbina, Klladusha, Senji, Zadri<sup>173</sup> etj. Ndërsa grupi i dytë i këngëve kreshnike botohen pas Luftës së Parë Botërore.

Nga viti 1924, disa rapsodi të kreshnikëve u botuan në vëllimin “*Skandërbegu mbas gojdhanaash*” (1926) të Marin Sirdanit. Sistematikisht janë botuar këngë kreshnikësh në revista, si: “Hylli i Dritës”, në “*Zana popullore*” pastaj edhe në revistat e kohës “*Cirka*”, “*Leka*” dhe “*Edukata e Re*” etj.

Një kontribut të veçantë në këtë drejtim dha edhe seria e botimit “*Visaret e kombit*”, veçanërisht në vëllimet I, II, IV, VII, VIII. Konkretisht

<sup>172</sup> Sejko, V. *Mbi elemente të përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*. Bargjini, Tiranë, 2002, f. 48.

<sup>173</sup> Po aty, f. 52-53.

në vëllimin I ribotohen 15 këngë kreshnikësh, në vëllimin II, 34+2 këngë; në vëllimin IV, 13 këngë; në vëllimin VII, 6 këngë. Gjithsejt afro 70 këngë kreshnike, në periudhën ndërmjet viteve 1937- 1940.

Kështu në vëllimin e parë të “Visaret e kombit” “Kangë kreshnikësh dhe trimnije”<sup>174</sup>, të përgatitur nga Karl Gurakuqi dhe Filip Fishta, në kapitullin “Kangë kreshnike” botohen 21 këngë që nuk janë tekste të reja por vetëm ribotime, ku përfaqësohen tekste të botuara botuar në organe të ndryshme të shtypit të kohës, si: *Edukata e re, Zana Popullore, Leka etj.* Por këngë të mirëfillta të ciklit të kreshnikëve këtu janë vetëm pesëmbëdhjetë. Janë përfshirë te kapitulli “Kangë kreshnike” edhe disa kangë që më vonë janë klasifikuar si balada apo këngë të epikës tjetër legjendare. Me sa shihet, në drejtim të termave në përdorim, kemi ende një përzierje të këngëve kreshnike me këngët e tjera të epikës legjendare. Kjo dukuri na del edhe tek përmbledhja e përgatitur nga B. Palaj dhe D. Kurti. Ajo që bie në sy në këto këngë është prania e fortë e elementit mysliman dhe turk, e përkatësisë fetare në sjelljen e kreshnikëve (*heronjtë marrin abdes, falin sabahin “Lufta e Mujit e Halilit”*<sup>175</sup>, *kundërshtarit shqaun e etiketojnë si “kaurr”*<sup>176</sup>) *aq sa në shumë këngë Muji, Halili apo ndonjë hero tjetër shoqërohet nga cilësimi i shpeshtë turk, që në kohët e reja nënkuptonte shqiptarët e myslimanizuar.* Në këto këngë janë të pranishme kryesisht elemente të kohës së re, si: përdorimi i armëve të zjarrit, pushkë, topa, megjithëse paradoksalisht vijnë të përdoren edhe armët e vjetra, shpata, topuzi, mizdraku; heronjtë pinë vazhdimisht kafe me sheqer<sup>177</sup> etj.

Ndërsa tek vëllimi katërt i *Visaret e kombit*<sup>178</sup>, kemi 13 këngë kreshnikësh të pabotuara më parë dhe të mbledhura nga Hasan Reçi, në Kosovë. Gjithashtu edhe në këto këngë është për t’u vërejtur prania e elementit fetar mysliman dhe turk i një shtrese më të fortë sesa tek Palaj dhe Kurti. Për shembull në këngën “Zuk Bajraktari”<sup>179</sup> heroi shprehet mbasi nuk ka mundësi ta paguajë kalin e blerë: *Tre dorzanë unë po t’i baj/ Të baj një: besn e Zotit/ e të dytin: Ramazanin e burrit/ e të tretin Bajramin e vogël*<sup>180</sup>. Tek kënga “Zana grabitë nusen e Mujos”<sup>181</sup> krahasuar me

<sup>174</sup> Visaret e Kombit. Vëllimi I. Kangë kreshnikësh dhe trimnije. (Prej folklorës së botueme). Zgjedhë e komentuem nga Prof. Karl Gurakuqi e Prof. Filip Fishta. Shtypshkroja Nikaj, Tiranë, 1937.

<sup>175</sup> Po aty, f. 259.

<sup>176</sup> Po aty, f. 260.

<sup>177</sup> Po aty, 266.

<sup>178</sup> Visaret e Kombit IV. Kangë trimnije, kreshnikësh, dashunie, prralla dhe Visari i arbëreshvet të ishujve të Greqisë. Shtëpia botonjese “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939.

<sup>179</sup> Po aty, f. 146.

<sup>180</sup> Po aty, f.147.

përmbledhjen e Palajt e Kurtit kemi ndryshime të rëndësishme që nxjerrin në pah ndryshimin e varianteve, por edhe ndryshimin e thelbit të heroit kryesor, i cili këtu sillet me ashpërsi ndaj qenies mitike Zana, duke e vrarë atë. Tek varianti i Palajt heroit ka nderim për qenien mitike ndërsa në këtë variant Muja ia përdredh kokën pëllumbit ku qëndron fuqia e Zanës, dhe e vret edhe atë me ashpërsi. Tek kënga “Shtatë kralat te Mbreti i turkut” (Kosovë)<sup>182</sup> Muji dhe Halili na dalin si vasalë apo luftëtarë të bindur të Sulltanit, gjë që i zhvesh prej petkut të luftëtarëve të vjetër popullorë, që njohim tek Palaj dhe Kurti: “Ata mbreti nën urdhën i ka”.

Në botimin *Visaret e kombit VII*<sup>183</sup> kemi të botuara gjashtë këngë, të pabotuara më parë, nga At’ Gjon Karma, kryesisht nga zona e Pukës, por që janë variante të njohura në botimet e *Hyllit të Dritës* apo në përmbledhjen e Palajt e Kurtit. Në këngën *Galan kapidani*<sup>184</sup> (këndoi Prendush Gega i Kabash, Pukë), kreshniku sllav Galan kapidani i mburret të shoqes për fuqinë, gruan e pasurinë që ka, por ajo i thotë se nuk ka parë Mujin dhe gruan e tij, se do t’i kishte dalë vetja qejfit. Galani grabit gruan e Mujës dhe ia rrafshon kullat. Muji kur e merr vesh shkon në krajli, por e shoqja e mashtron e deh dhe e burgos. Muji i jep fjalën kralicës se nëse ajo do ta ndihmojë të dalë nga burgu, do ta marrë atë për grua dhe vajzën e saj për Halilin. Muji vret Galanin dhe ia rrafshon kullat duke marrë me vete dy krajlicat. Edhe këtu kemi përdorimin e pushkës me barut në luftime. Kënga *Muji ikë prej krajlit*<sup>185</sup> (Këndoi Kolë Prendi Dush) 26 vargje është ndër këngët më të shkurtra, dhe ndër të paktat që përmendet babai i Mujit. Muji ikën nga frika e kralit dhe kthehet mbas disa vitesh, ndërsa baba shpreh gëzimin e tij që djali iu kthye.

Në *Visaret e kombit VIII, Folklorë III*<sup>186</sup>, kemi edhe artikullin e përkthyer në shqip të Shmausit “Epika popullore e shqiptarvet në Kosovë”. Autori ndjek që në fillim pikëpamjen e Gerhard Geseman se “duhet të lirohet çështja epike serbo-kroate prej izolimit nacional. Hapi i parë në këtë drejtim shihet në përmbledhjen e të gjithë epit jugosllav (sikur të

<sup>181</sup>Visaret e Kombit IV. Kangë trimnije, kreshnikësh, dashunie, prralla dhe Visari i arbëreshvet të ishujve të Greqis. Shtëpia botonjese “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939, f. 151.

<sup>182</sup>Visaret e Kombit IV. Kangë trimnije, kreshnikësh, dashunie, prralla dhe Visari i arbëreshvet të ishujve të Greqis. Shtëpia botonjese “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939, f. 162.

<sup>183</sup>Visaret e Kombit VII. *Folklorë II, Nder malet tona*. Kërkime të A’t Gjon Karmës S.J. ndër male të Veriut. Shtypshkroja “Zoja e papërlyeme”. Shkodër, 1940.

<sup>184</sup>Po aty, f. 41.

<sup>185</sup>Po aty, f. 103.

<sup>186</sup>Visaret e Kombit VIII. *Folklorë III*. Shkodër, Shtypshkroja “Zoja e papërlyeme”. 1940 XVIII, f. 3.

bullgarishtes ashtu edhe të serbo-kroatishtes), “porsi një tansi e pashkëputun”. Hapi i dytë është njohja e epevet të tjerë në Balkan; p.sh. e shqiptarëve, megjithëse do të diktojmë me siguri se këta e huazuan nga serbët. Shmausi flet për përvojën e tij, në dy ekspeditat e gushtit dhe shtatorit 1933 në shqiptarët e Kosovës, në Mitrovicë e Drenicë, duke theksuar ekzistencën e fuqishme të këngës epike në Kosovë veçanërisht në Drenicë. Autori vëren se tek shqiptarët, lahuta që në kohët e vjetra ishte instrumenti kryesor, i ngjashëm me *guslen*, ka ardhur duke u përdorur paralel me tamrren/çiftelinë. Përmenden këtu me emra disa këngëtarë që këndojnë me lahutë këngë kreshnike e balada. Shmausi thotë se të moçmit këndojnë me lahutë disa këngë të quajtura “krajine”. Ky emërtim, shprehet ai, nuk përfshin vetëm këngët me lahutë, mbi kreshnikët myslimanë të Krajinës, mbi *krajishnikët bulykbasho Muji, Zuku bajraktari e Alia, Sokole Halili etj. që këndohen edhe në këngët shqiptare, por përfshihen edhe kangët më të vjetra dhe ato mbi Luftën e Kosovës: mbi Muratin e Milosh Kobiliqin, Musa Kesexhinë e Markun ose Gjure kapidanin*. Megjithë ngjashmërinë me vendin Krajina, Shmausi thekson se fjala *krahinë* është në përdorim edhe ndër shqiptarë dhe se përdorimi i emërtimit *krajina* për këto lloj këngësh, nuk gjendet në këtë kuptim askund në Serbi. Ndër krahina kufitare për këngët e vjetra me lahutë, thotë autori, është në përdorim termi *krajshnica*. *I njëti emërtim është në përdorim për të gjitha këngët epike pa dallim, edhe tek muslimanët edhe te ortodoksët*. Autori është i mendimit se në zonat kufitare qarkullimi i këngëve ka qenë i gjallë. Me këtë rast përmendë me emër e mbiemër edhe disa lahutarë të tjerë që ka dëgjuar në Mitrovicë. Shmausi shënon nevojën e regjistrimit fonografik të disa këngëtarëve, si me lahutë ashtu edhe me çifteli, për studimin muzikologjik të tyre, por sidomos për studimin e metrikës së tyre. Autori në fund të artikullit thekson se do të jenë me interes trajtat e rezultatet e symbiozës mes epikës shqiptare me atë serbe, si edhe çështjen e ndikimit nga epika e shkruar.

Sigurisht vëmendje të veçantë meriton vëllimi II i “*Visaret e Kombit*” *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*” përgatitur nga Atë Benardin Palaj dhe Atë Donat Kurti. Në “*Visaret e Kombit*” *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda* (1937) vëllimi II, janë shënuar si këngë kreshnike 34 këngë, por mund të përfshihen edhe dy këngë të tjera të përfshira në kapitullin *Legjenda: Kotuzi dhe Ager Izvano*, që kanë tiparet artistike dhe tematike të këngëve të tjera të kreshnikëve. Në ribotimin e vitit 2005, botime Françeskane, janë përfshirë në formën e *Shtojcës* edhe këngët e botuara te *Hylli* nga vitet 1938-1944 të mbledhura nga D. Kurti, B. Palaj e K. Miraj,



pra të periudhës mbas botimit të veprës “*Visaret e Kombit, Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*” Vëllimi II (1937).

Shumë shpejt dijetarët françeskanë ia dolën ta kapërcejnë mendimin e shprehun në vitin 1911 në parathanien e *Kangë popullore gegnishte*, se populli shqiptar nuk kishte kangë epike dhe se disa rapsodija e legjenda, na duket se janë përkthye prej sllavishtes dhe sepse ato gjinden në letërsinë popullore të serbëve e kroatëve<sup>187</sup>. Siç vlerëson P. Zef Pllumi, në këtë kohë këngët nuk njiheshin mirë sepse nuk ishin të botuara<sup>188</sup>. P. Zef Pllumi dëshmon se arsyeja e mosinteresimit fillestar për këto këngë, sipas bisedës me At B. Palajn, ishte bindja se ato ishin me origjinë boshnjake: “Ti e din se këto rapsodi këndohen edhe në Bosnjë - Hercegovinë dhe për këtë arsye nuk i ka mbledhë kurrë as i madhi Shtjefën Gjeçovi as nuk u ka dhanë randësi as Atë Gjergj Fishta e tjerë njerëz të mëdhaj. Jo për madhësi por e vërteta asht se unë jam i pari që kam fillue mbledhjen e këtij Cikli legjendar mbasi kam lexue disa copa fragmentare të botueme nga Gaspër Jakova Mërturi. Në to vuna re se spikaste karakteri shqiptar dhe jo ai sllav. Sa ma shumë qe kam punue në mbledhjen e këtij Cikli aq ma tepër kam ardhë tue u bindë se Cikli i Kreshnikëve nuk ka origjinë sllave, por krejt shqiptare. Ky Cikël asht i mbuluem nga një mjegullnajë e shekujve dhe gjatë tyne ka pësue ndryshime e adaptime, sidomos nder emna, që për oportunitizëm janë islamizue, se përndryshej nuk do të mund këndoheshin gjatë regjimit otoman. Të porosis mos të u vejsh randësi emnave, por vetëm do të kqyrish tiparet ose karakterin që çdo popull e ka të veçantë. Edhe doket e zakonet, për oportunitizëm janë ndryshue, disa gjatë shekujsh, dhe në vend të dokeve iliro-shqiptare, janë zavendësue, në shumë raste me doke turke. Simbas mendimet tem ky Cikël Legjendar paraqet luften iliro-arbëre kundër invazionit sllav dhe mendoj se duhet t’u përkasë shekujve 6-7. Gjatë shekujsh ka marrë formën që ka sot: paganizëm ilir ku shartohet islamizmi por nuk shkrihet dot. Në të njajtin drejtim e po nder ato krahina paralelisht, ka punue pa u lodhë edhe frati tjetër At Donat Kurti, i cili ka shfrytëzue të tjerë rapsodë. Nga këto dy koleksione kemi nxjerrë të njajtat tema me variante tepër të larmishme”.<sup>189</sup> P. Z. Pllumi flet edhe për 56 këngë që At Benardini ia dha hua studiuesit e shkrimtarit Ernest Koliqi, me rastin e studimit që ai bëri mbi epikën gojore shqiptare, këngë të cilat ai nuk ia ktheu më kurrë duke shkaktuar edhe një hatërbetje te Palaj.<sup>190</sup> Nga një e dhënë tjetër P. Benardin Palaj nën drejtimin e Atë Sh. Gjeçovit e filloi

<sup>187</sup> Prennushi, V. *Kangë popullore gegnishte*. Sarajevë, 1911, f. IX.

<sup>188</sup> Po aty, *Dy fjalë për ket vepër*.

<sup>189</sup> Pllumi, At Zef. *Françeskanët e mdhaj*. Tiranë, 2009, f. 108- 109.

<sup>190</sup> Po aty, f. 108.

punën për mbledhjen e këngëve që në vitin 1919.<sup>191</sup>

Pra, janë etërit françeskanë që e dëshmuar bindshëm ekzistencën e këtij cikli, dhe nuk ka arsye të etiketohen sikur ata i paskan mohuar në fillim popullit shqiptar këtë pasuri e vlerë artistike kombëtare. Hapi i parë do të bëhet prej tyre në revistën *Hylli i Dritës* në periudhën e parë të daljes (1913-1944) ku nga 88 numra sa kanë dalë gjithsej në 34 prej tyre janë botuar 37 këngë të Eposit heroik shqiptar. Ato janë botuar prej numrit 1-2 të vitit 1924 deri te numri 3- 4 i vitit 1943.<sup>192</sup> Të tilla janë: *Haxhija Probatin*<sup>193</sup>; *Ankimi i plakut Qefanak*<sup>194</sup>; *“Deli Mehmet Aga”*<sup>195</sup>, (të ndara në tri pjesë, secila të shoqëruara me një argument mbi linjat kryesore të veprimit në këtë rapsodi që botohet me vijim në disa numra) *Deli Mehmet Aga*<sup>196</sup>, dhe *“Deli Mehmet Aga”*<sup>197</sup> pjesën e tretë; *Lauta brideshe*; *Vëllavrsi*<sup>198</sup>; *Gjeto Basho Muji. [I.] Martesa*<sup>199</sup>; *Orët e Mujit*<sup>200</sup>, *“Muji tu mbreti”*<sup>201</sup>; *“Martesa e Halilit”*<sup>202</sup>; *“Gjergj Elez Alia”*<sup>203</sup>; *Muji e Behuri. Deka e Dizdar Osman Agës me Zukun Bajraktar*<sup>204</sup>; *Halil Garria*<sup>205</sup>; *Halili merr gjakun e Mujit*<sup>206</sup>; *“Grabija e së shoqes së Mujit”*<sup>207</sup>; këngën *“Ymeri prej Mujës”*<sup>208</sup>; *“Gjeto Basho Muji, Gjogu i Mujit”*<sup>209</sup>; *“Muji i rrethuem në kullë”*, *“Muji i varruem”*, *“Muji mbas deket”* mbledhur në *Curraj t’Eper*<sup>210</sup>; *Ali*

<sup>191</sup> *Visaret e kombit. Vëllimi II. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktueme nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. XI.

<sup>192</sup> Neziri, Z. “Eposi heroik shqiptar nëpër faqet e Hyllit të Dritës”. *Studime Shqiptare* 22, Shkodër 18 dhjetor 2013. Fiorentia, Shkodër, 2015, f.128.

<sup>193</sup> Sirdani, P. M. *Hylli i Dritës*, nr. 3-7, 1939, f. 309-312.

<sup>194</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 10, VIII/1932, f.513-537.

<sup>195</sup> Fishta, P. Antonin. *Hylli i Dritës*, nr. 2. XII/1936, f. 68-72;

<sup>196</sup> Fishta, P. A. *Hylli i Dritës*, nr 5, XII/1936, f. 234-241.

<sup>197</sup> Fishta, P. A. *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, XII, 1936, f. 355-360.

<sup>198</sup> Sirdani, D. Aleksander. *Hylli i Dritës*, nr 6-8, XIX/ 1943, f. 271-275.

<sup>199</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, V/ 1924, f. 33-35; pa emër autori, por siç dihet u mbledhën nga Kurti dhe Palaj.

<sup>200</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, V/ 1924, f. 103-114.

<sup>201</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 5-6, V/ 1924, f. 182-185.

<sup>202</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 5-6, V/ 1924, f. 257-282.

<sup>203</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 9. V/1924, f. 340- 348.

<sup>204</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 10, V/ 1924, f. 414-432.

<sup>205</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 12, V/1924, f. 534-548.

<sup>206</sup> *HD*, nr. 5. 1931, f. 277-290.

<sup>207</sup> Kurti, Donat. *Hylli i Dritës*, nr. 11, 1931, f. 621-634.

<sup>208</sup> Kurti, D. “*HD*”, nr.12, 1931, f. 685-693.

<sup>209</sup> Kurti, D. “*HD*”, nr. 1, 1932, f. 18-29.

<sup>210</sup> Kurti, D. “*HD*”, nr. 4, 1932, f. 195- 202.

*Bajraktari: Besa*<sup>211</sup>; *Martesa e plakut Qefanak*<sup>212</sup>; *Deka e Mujit dhe Halilit* dhe *Deka e Halilit*<sup>213</sup>; *Tbani Zadrili*<sup>214</sup>; *Fuqia e Mujit*; *Omeri i ri*<sup>215</sup>; *Martesa e Halilit me Tanushën*<sup>216</sup>; *Halili i qet bejleg Mujit*<sup>217</sup>; *Muji dhe Jevrenija*<sup>218</sup>; *Deka e Omerit*, *Deka e Omerit*, *Halili mbas deket*<sup>219</sup>; *Filiske-Filiskama*<sup>220</sup>; *Gjeto Basho Muji: Halili i qet bejleg Mujit*<sup>221</sup>; *Bejlegu ndermjet dy vllazenve të panjoftun: Arnaut Osmani e Hysa Radoica*<sup>222</sup>; *Ager Isvan Aga*<sup>223</sup>; *Kangë kreshnikësh: dashtnija vllaznore e smira e grues*<sup>224</sup>.

Interesi i qartë për këngët e ciklit të kreshnikëve dallohet që në nr 1-2 të vitit 1924 të revistës kulturore *Hylli i Dritës*, në të cilën, përmes artikullit *Kangë kreshnikësh*<sup>225</sup> theksohet se *“folklori, posë se asht pasqyra m’ t’ cillen skjyrtohet ma s’ mirit psiha komtare e asht lulishta prej s’ cilles mund të zgidhen lulet ma të bukura të gjuhës e të literatyrës, asht edhe monumenti m’ të cillin dallitet historija e nji komit. Siç asht e nevojshme pra, historija e literatura per zhdrivillim të jetës s’ nji komit, kshtu asht nevojë e domosdoshme, me u mbledhë e me u ruejt folklori e ç’ do popullit”*. Na *Françiskajt e Shqypnisë e kemi pasë pa ket nevojë edhe para se lete “Hylli i dritës”, pse qysh vjetin 1911 kemi fillue me mbledhë e, nen emnin “Visari komtar” kemi botue të parin ble të kangve e të valleve popullore*. Në këtë artikull kërkohen të respektohen disa rregulla elementare gjatë mbledhjes së këngëve kreshnike, si: *“të botohet edhe emni i atij prej të cillit u pershkue kanga”*; *“emni i vendit, ku ku u gjet në popull kjo kangë”*; *“e ma tepër der ku mund të bahet, me e skjarue tekstin me ndonjë koment per shka i përket sidomos mytologis, emnave e dokeve të*

<sup>211</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 5, 1932, f. 237-246.

<sup>212</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 1, 1933, f. 19-23.

<sup>213</sup> *“HD”*, nr. 6, 1935, f. 295-300.

<sup>214</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 10, 1935, f. 492-499.

<sup>215</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 4, 1936, f. 177-184.

<sup>216</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 2-3, 1937, 111-121.

<sup>217</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 5, 1937, f. 225-232.

<sup>218</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 6, 1937, f. 284-288.

<sup>219</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 7-8, 1937, f. 334-344.

<sup>220</sup> Kurti, D. *“HD”*, nr. 11-12, 1939, f. 586-599.

<sup>221</sup> Shajaku, Leonard. *“HD”*, nr. 2, 1932, f. 81-86.

<sup>222</sup> Llupi, B. *“HD”*, nr. 7-8, 1931, f. 410 - 423.

<sup>223</sup> Gurashi, Rr. *“HD”*, nr. 7-8, 1932, f. 362 - 374.

<sup>224</sup> Miraj, K. *“HD”*, nr. 1-2, 1942, f. 65 - 72.

<sup>225</sup> *Hylli i Dritës*, 1-2, 1924, f. 33.

*vendit*<sup>226</sup>. Në këtë numër botohet edhe kënga *Gjeto Basho Muji Martesa*<sup>227</sup>.

Në artikullin “*Kryetari i çetave të vjetra kreshnike*”<sup>228</sup> me inicialet e autorit M. P. i cili merret me shqyrtimin e emrit të kreshnikut Muji, që në këngët e disa zonave, si: Malsi e Madhe, Dukagjin, Nikaj-Mertur thirret “*Gjeto Basho Muji*”, ndërsa në disa të tjera si Malsia e Gjakovës thirret “*Çet-o Bashe Muja*”, ndërsa Rugova, Vuthajt, Plava, Gucia, boshnjakët e thërrasin “*Bylyk- bashe Muja*”. Ndërkohë shpjegohen emërtimi “*çetë*” me një grup luftëtarësh dhe “*bash*”, fjalë turke me kuptimin: “*në krye*”: “*E pra duket lehtë se ky mbiemër përmbledh në vedi shi njat “çetën e vjetër kreshnike” përba prej “Tridhjetë Agve të Jutbinës” të cilët tue pasë për kryetar Mujën, banë në kohët e lashta të gjithë ato trimni qi rapsodit përmendin*”<sup>229</sup>. Më tej në këtë artikull jepet edhe një variant i legendës mbi fuqinë e Mujit dhe çetën e djemve kreshnikë, e treguar në prozë, por e dëgjuar nga një këngëtar.

Ndërsa Atë Gjergj Fishta në artikullin “*Shinime estetike: mbi natyrë t’ Artit*”<sup>230</sup> duke shtjelluar çështje estetike të artit sjell shembuj nga eposi për të ilustruar rolin efektit përrallor në këtë krijim. Gjithashtu në artikullin “*Kanuni i Lekë Dukagjinit*”<sup>231</sup> Fishta paraqet një program kulturor mbi mbledhjen dhe rëndësinë e folklorit në kulturën kombëtare, për ta bërë atë pjesë organike të saj në përcaktimin se “*foklora*” është pasqyra e kthjellët e psikës së kombit, rrasa e mermerit në të cilën gdhendet jeta e popujve, burimi i pashterrshëm i lëndës gjuhësore dhe letrare”<sup>232</sup>. Ai e çmon cilësinë e shprehjes poetike folklorike si konkurrese me atë të poezisë së shkruar, biles më gjeniale se ajo, sikurse shprehet në komentin ndaj përshkrimit të figurës së Tanushës në rapsodinë kreshnike: “*Martesa e Halilit*”. Përshkrim që e krahason me përshkrimin poetik të Laurës tek Petrarka dhe me episodin e ndarjes së Hektorit me Andromaken në *Iliada* të Homerit.

P. Fulv Cordignano S.J. në artikullin “*Kangë kreshnikësh*” në *Shqypnin e verit*<sup>233</sup>, pohon se këngët e kreshnikëve në Shqipërinë e Veriut të kujtojnë “*Chanson de geste*” franceze dhe se prania e tyre është një fakt i pakundërshtueshëm. Sipas autorit, këto këngë njihen edhe si: “*Kangët e*

<sup>226</sup> Po aty, f. 34.

<sup>227</sup> Po aty, f. 40.

<sup>228</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 1, 1938, f. 11.

<sup>229</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 1, 1938, f. 13.

<sup>230</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2, IX/1933, f. 8-12 dhe 67-75.

<sup>231</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 4, IX/ 1933, f. 153-163.

<sup>232</sup> Po aty, f. 153.

<sup>233</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 3-5, XVII/1941, f. 147-154.

*Mujit e të Halilit*”, për shkak të dy personazheve kryesorë, por që njihen më shumë si: “*Kangë kreshnikësh*”. Autori sjell si argument punën e studiuesit gjerman M. Lambertz i cili në “*Die Volkspoesie der Albaner*” (Sarajevë 1927) ndërsa analizon aspekte të poezisë popullore shqiptare të Veriut flet edhe për ciklin e kreshnikëve dhe këngën e Garentinës. Cordignano, njofton me këtë rast, se ka përgatitur një përmbledhje me këngë kreshnike dhe një studim mbi to. Në artikullin tjetër “*Vasha n’epopën kombtare të popullit shqiptar Tringa e Malcis*”<sup>234</sup> ai trajton çështjen e ndikimit të poezisë popullore mbi “*Lahutën e Malcis*” të Atë Gjergj Fishtës.

Gjithashtu edhe P. Marin Sirdani, në punimin “*Shqyptarët e hartet. IV. Poezija*” botuar në *Hylli i Dritës* nr. 11, të vitit 1922, me vijim në disa numra, është i mendimit se poezia popullore shqiptare është shumë e vjetër, përkundër letërsisë së shkruar e cila për shkak të robërisë është ende pas. Por poezia popullore është mjaft e pasur me gojëdhana, legjenda, këngë popullore, një pjesë e të cilave thotë autori janë botuar ndërkohë<sup>235</sup>. Sirdani vlerëson trajtën “genuine” të këtyre këngëve, strukturën, përmbajtjen, praninë e figurave e besimeve mitike, dragoj, kulshedra, zana, ora, vampira, lugeten, kshete, shtriga etj., që i cilëson si “*metza mitologie iliro-elene*”<sup>236</sup>. Ai vlerëson se disa valle e rapsodi u përkasin kohëve shumë të vjetra e disa shek. XV-XVI. Në këtë punim autori jep dy shembuj vajtimesh, ndërsa çmon bukurinë e shprehjes poetike dhe ndjenjat e shprehura në to. Për disa rapsodi e legjenda, si kënga e Mujos e Halilit, e Halil Garris, e Regios, e Aga Imerit etj., që gjenden edhe në folklorin serbokroat, Sirdani është i mendimit se ato janë ndikim nga folklori shqiptar. Ndërsa në veprën tjetër *Skanderbegu mbas gojëdhanash* (1926) Sirdani botoi të paktën shtatë këngë nga cikli i kreshnikëve: “*Kotuzi*” “*Gjergj Elez Alija*”, *Muji e Behuri*” (këto këngë janë të njëjtat me ato të përfshira te vepra e Palajt e Kurtit) “*Hyseni i vogël*”, “*Gjeto Basho Muja*”, “*Ali Begu*”, “*Arnaut Osmani*”<sup>237</sup>.

Mbështetur në botimet sistematike të revistës *Hylli i Dritës* vjen për herë të parë në mënyrë të plotë eposi i kreshnikëve shqiptarë, rreth 34 këngë, kur botohet përmbledhja e tyre në “*Visaret e Kombit Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*” vëllimi II, (1937) nga Atë Benardin Palaj dhe Atë Donat Kurti. Ndërkohë te “*Visaret e Kombit*” I (1937) nga prof Karl Gurakuqi dhe Filip Fishta, botohen edhe disa kangë kreshnike të botuara në revistat *Zana Popullore*, *Leka*, *Edukata e re* etj. Shquhen në këtë kohë për

<sup>234</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, XVI, 1940, f.11-27.

<sup>235</sup> *Hylli i Dritës*, nr. 11, III, 1921, f. 540.

<sup>236</sup> Po aty, f. 541.

<sup>237</sup> Sirdani, At Marin. *Skanderbegu mbas gojëdhanash*. Ribot. Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f. 189-226.

trajtimin e çështjeve të folklorit studiues e folkloristë, si: Bernardin Palaj dhe Donat Kurti, Gjergj Fishta, Pashk Bardhi, Viktor Volaj, Klement Miraj, Rrok Gurashi etj.

Në “*Visaret e Kombit*” *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda* (1937) vëllimi II, janë shënuar si këngë kreshnike 34 këngë por mund të përfshihen edhe dy këngë të tjera të përfshira në kapitullin *Legjenda: Kotuzi dhe Ager Izvano*, që kanë tiparet artistike dhe tematike të këngëve të tjera të kreshnikëve. Në ribotimi e vitit 2005, botime Françeskane, janë përfshirë në formën e *Shtojcës* edhe këngët e botuara te *Hylli* nga vitet 1938-1944 të mbledhura nga D. Kurti, B. Palaj e K. Miraj, pra të periudhës mbas botimit të veprës “*Visaret e Kombit, Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*” Vëllimi II (1937).

Që në *Parathënje* të kësaj vepre autorët janë shprehë tërthorazi për origjinalitetin dhe përkatësinë shqiptare të ciklit të kreshnikëve kur duke diskutuar rreth teorive folklorike mbi rrugët e mundshme të qarkullimit të krijimeve folklorike e vunë në dyshim teorinë e burimit të tyre nga vendet e Lindjes e sidomos nga kontakti i evropianëve me botën myslimane: “*E njimend, kush mund të besojë ashtu lehtas, se popujt e Europës, mos tjetër, tue u gjetë gjithmonë në luftë me muhamedanë t’Azis, të kën marrë prrallat e legendat e ktyne e jo veç marrë, por mâ tepër bâ të vetat në mënyrë qi nëpër to me u argtue në qetsí të votrës s’vet. Ndër të cilat shpija a shkolla franceze kalxohet sod prralla a legenda germane?*”<sup>238</sup> Nënkupto pra, se, pavarësisht fqinjësisë dhe ndikimeve reciproke të eposit serbo-kroato-boshnjak me atë shqiptar, nuk ishte logjike pikëpamja se shqiptarët e kishin kopjuar prej tyre këtë epos dhe kishin bërë të tyren një këngë të huaj, e cila sado artistike të ishte, reflektonte botën e dikujt tjetër. Sikurse shprehen Palaj e Kurti në *Hymje* të vëllimit: “*Shpirti i rapsodive âsht fjesht shqiptár, pse paraqet kjartë të gjitha karakteristikat e Shqiptarit e vetëm të Shqiptarit: besa e zânavet, e orvet dhe e kreshnikvet; burrnija e trimnija e tyne edhe me anmiq: me slavë; bestytnít e popullit t’onë, doket, miku, dashtnija e ndera e familjes, trimnija e ndera e gravet etj: shprehen ndër kângë në mënyrë të gjallë, e janë ngjyrat e ndryshme, me të cillat rapsodët e maleve t’ona paraqesin fytyrat e herojve në ket duel*”<sup>239</sup>

Në *Hymje* që paraqet këto *kangë* bëhet një parashtrim, i pari i kësaj natyre, i cilësive artistike, konfliktit themelor, gjeografisë e toponimisë ku

<sup>238</sup> *Visaret e kombit. Vëllimi II. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktuem nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. VII.

<sup>239</sup> Po aty, f. XI.

ndodhë veprimi i kreshnikëve. Ky parashtrim është i një rëndësie të dorës së parë për studimet mbi eposin legjendar, dhe sigurisht ky botim konfirmoi përfundimisht ekzistencën e këtij eposi edhe tek shqiptarët, pavarësisht marrëdhënieve që kishte me ciklin serbo-kroato-boshnjak. Në fakt shihet se këngët e mbledhura më vonë nga studiues të tjerë edhe përgjatë shek. XX shpesh janë variante të këtyre këngëve, çka do të thotë se paraqitja e tyre kishte rrokur bërthamën e vërtetë të këtij eposi, bërthamë e cila edhe përgjatë gjysmës së dytë të shek. XX kishte vijuar të rrezatonte mijëra vargje të tjera, por vetëm si variante të saj.

Me këtë rast janë bërë disa karakterizime mbi emërtimin dhe natyrën e këngëve. Ato janë emërtuar si: “kângë kreshnikësh, kângë të moçme, kângë lahute”. Është përdorur edhe termi i saktë “epos” për këto këngë si edhe përcaktuar personazhi kryesor: *Gjeto Basho Muji*, cilësitë që ka heroi i një eposi: *nji kreshnik i fuqishëm, i pathyeshëm dhe i pavdekshëm*. Gjithashtu janë identifikuar edhe personazhet e tjera si edhe gjeografia ku ata veprojnë: Kotorri, Lugjet e Verdha, Kunora e Bjeshkës, Tuna, Jutbina, Krahina, Budina, Zahara, Bjeshka e That etj. Është përcaktuar gjeografia se ku këndoheshin këto këngë, deri në këtë kohë: *Malci e Madhe, Dugagjin, në Kosovë, në Pukë, në Dibër, në Ljare e në Shestan*. Është përcaktuar konflikti kryesor: *gjithkund del në shesh lufta e fiseve shqiptare të blokut Mal i zî- Shqipni kundra Slavit, qi tue kapërcyem Danubin, msyn qëndrën e këtyne fiseve: Jutbinën*<sup>240</sup>. *Ktu sigurisht nuk këndohet myslimanizmi si në luftë me kristjanizëm; por këndohet fuqija e njëj rrace rreth njeriu, qi ka punë me zâna shqiptare, kundra fiseve slave, qi duen me i dërmue trojet e tija; kështu qi mbas shpirtit t’edave shqiptarë është personifikimi i luftës ndërmjet rracash*. Autorët bëjnë hipotezën se ndoshta kemi të bëjmë me një qerthull kangësh rreth ndonjë Troje shqiptare të rrënuar përgjatë sulmeve sllave që edhe pas metamorfozës së fiseve ilire në sllavizëm kanë ruajtur, kujtimet e asaj kohe kreshnike. Për autorët e përmbledhjes emrat myslimanë të personazheve nuk përbëjnë ndonjë problem vetëm se dëshmojnë për dukuri që kanë ndodhur edhe në këngë të tjera që gjenden edhe te arbëreshët e Italisë, siç është rasti i këngës Kostandini i vogël, që në variantin shqiptar ka ndërruar emrin në Halil Garria.

Ky vëllim përshkohet nga teza se këngët kanë lidhni me njëra-tjetrën, prandaj ato janë përzgjedhur me kujdes prej përgatitësve të tij nga

---

<sup>240</sup> *Visaret e kombit*. Vëllimi II. *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktueme nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. IX.

një koleksion prej 342 këngësh, gjë e cila mund të vështrohet si një “e metë” e punës, por që në fakt nuk është e tillë duke pasur parasysh qëllimin e autorëve që këngët të kenë lidhje mes tyre, çka përputhet me natyrën e një eposi, si edhe këngët të jenë me nivel të lartë estetik. Pra, kjo përmbledhje nuk do të ishte thjesht një grumbull variantesh, por përmbledhja që do të bindte opinionin shkencor brenda e jashtë vendit se populli shqiptar kishte krijuar në shekuj eposin e tij legjendar: “*jemi mundue me zgjedhë rapsodit mâ typike, si për kah esthetika e gjuha, si për kah lidhnija me ciklin e këngvet në fjalë. Motërzimet e panjehuna të coptueme, të mangta e të zdashuna prej veshës poetike na kanë dhânë rasë me pá evolucionin e bâm gjatë moteve në gojë të këngtarvet, të cilët, tue mos pasë parasysh një epos, por veç episoda të fortë, me një gjenialitet primitiv kanë bashkuem e kanë dá argumenta, kanë ndrruem e kan shtuem emna, kanë bjerrë e gjymtue pjesë të rândsishme*”<sup>241</sup>. Prekja e bërë në dobi të unitetit dhe të bukurisë artistike të teksteve është plotësimi i një teksti me fragmentet më të arritura estetikisht dhe më interesantet për nga veprimi i heronjve, të marra nga motërzimet që kanë të njëjtin argument. Pikësynimi i autorëve duket se nuk ka qenë shumësia e teksteve të motërzimeve, por përzgjedhja e teksteve më përfaqësuese dhe renditja e tyre sipas një uniteti kuptimor qoftë edhe të largët. Prandaj ngjan se përmbledhjet e botuara më vonë nga autorë të ndryshëm janë vetëm motërzime të këtyre këngëve dhe rrallë janë të reja. Ata shkojnë me mendimin se kemi të bëjmë me një epos unik madje edhe me një veprim tërësor që e përshkon atë si krijim letrar të ngjashëm me epose të tjera: “*Zânat e Orët e vendit, kur shofin, se slavi don me kapërcyem Danubin, kërkajnë njerin, qi me i prî çetës e me bá báll. Në këtë kohë Muji, një çoban prej Klladushe, qi del me kërkue çetave lopët, mbas një rapsodije tjetër del për kaproj, ndeshë në dy djepa e i vên fmijt në gjumë. Zânat, kúr këthehen, i apin si në shpërblim fuqi të madhe e zotsín me mujtë (= Muji) ndër të gjitha luftat e të ndeshunat. Muji at ditë bâhet luftâr; mbledhë çetën e mbas kushtrimit t’Orvet msýn slavët, qi kishin kapërcyem Danubin*”<sup>242</sup>. Për këtë vetëdije dëshmon edhe ndarja e vëllimit në këngë që kanë punë me eposin e *Gjeto Basho Mujit e legjendat, qi s’kanë lidhni me të*.

Studiuesi dhe shkrimtari Ernest Koliqi, autor edhe i një studimi mbi epikën gojore shqiptare lidhur me përzgjedhjen e bërë prej autorëve

<sup>241</sup> *Visaret e kombit. Vëllimi II. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktuem nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. XII.

<sup>242</sup> *Visaret e kombit. Vëllimi II. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktuem nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë 1937, f. XIV.



vlerëson se “Palaj zen një vend kryekreje ndër mbledhës të kangve të popullit t’onë. Vepra e tij si folklorist jo vetëm i a brumosi atij vetë prodhimin letrar, por ndikoi edhe te një tubë poetësh tjerë tue fillue nga Fishta. Më 1924 dolën të botueme në “Hyllin e Dritës” disá rapsodí të Qërthullit të Mujt e të Halilit. Lexuesit me vështrim mâ të hollë letrar kuptuen menjihërë se gjindeshin para një zbulimi me shum randësi. Hijeshija e parafytyrimeve, fuqija shprehëse e atyne kangve popullore të lëshshin pa mend. Si kishin mbetë pa u marrë parasýsh deri mje at mot ato xhevahire të folklorit? Pak e kush mâ përpara i kishte përmendë ashtu shkel e shko, pa u kujtue për bukurin e madhe të tyne. Ndër tjerë Gaspër Jakova Merturi, botoi në *Gramatikën* (2) e vet një rapsodi me titull “*Chéto Bashè Muji*”. Ma von Vinçenz Prennushi, (3) në *Parathânen* e kangve popullore të mbledhuna prej tij, i shtým nga një ndjesí e teprueme atdhetare (qi asokohe, me 1911, ligjohej nga rrethanat e dijtuna), dha një gjikim qi i dënoi në papërfillje (... na duket se janë të përkthye prej slavishtes...) deri sa doli me 1924 Benardini me i përfrue e me i përkambë. Vërtë përmbajtja vinte nga motivet boshnjake, por ato motive endëse në të gjithë Ballkanin, me êmna fatosash e trajta të ndryshme paraqitjesh, tue depërtue në Shqipni, shgatërroheshin n’elemente të para, u shndroreshin në landë amorfë (pa trajtë) dhe u përtrijshin në këndim të lahutarve t’alpeve shqiptare qi nuk njifshin asnjí fjalë të slavishtes”.<sup>243</sup> Në fusnotën 4) në vijim të këtij shkrimi Koliqi shënon, se “*Palaj pohonte se varjantet e rapsodive mâ të gjalla e të kullueta gjindeshin në Curraj t’ Epër. Ai në Palç të Merturit ku kryente detyren e famullitarit kishte disá arkë të vogla plot e përplot me letra e tefterë mbushë me kangë të mbledhuna në krejt Shqipninë e Veriut dhe në një pjesë t’asaj të Mesme. Nuk i kandte me i thânë se disa prej rapsodive tregojshin gjurma të prekjes së tij. E vërteta âsht qi Martesa e Gjeto Basho Mujit (HD, 1923, faqe 40-53), Orët e Mujit (HD, 1924, faqe 103-114), (HD, 1924, faqe 182-185), Martesa e Halilit (HD, 1924, faqe 257-282) u përpunuen prej Palajt. Ai zgjidhte tekstin tekstin mâ të mirë dhe me vargje të përshtatuna varjantesh e plotësonte, tue ndejë në frymë e në ligjirim të lahutarve, pa cenue n’asnjí mënyrë vetvetishmënin gjeniuene. Qindiste indin populluer me fije të ngjyrta marrë prej popullit. Ndêrhymja e tij u përmbante gjithmonë në zgjedhjen e vargjeve të varjanteve. Varjantet ai i thret motërzime*”.<sup>244</sup>

<sup>243</sup> Koliqi, E. “Benardin Palaj dhe një poemth i tij i pakryem”. Rev. “Shejzat”, nr. 5-8 Romë, 1972, f. 154.

<sup>244</sup> Po aty, f. 155; shih edhe Çapaliku, A. Bernardin Palaj. *Jeta dhe veprat*. Gjergj Fishta, Shkodër, 1999, f. 14-24.

Këngët e përzgjedhura në “*Kangë kreshnikësh e legenda*” janë shoqëruar në hyrje me një koment të titulluar: *Argumenti*, ku shpjegohen veprimet kryesore të subjektit të këngës. Këto komente janë me shumë interes për të interpretuar natyrën e heronjve dhe veprimeve që ndodhin në secilën këngë. Tek kënga *Gjeto Basho Muji, Martesa* shpjegohet shkurtimisht subjekti i këngës: “*Nisë 30 agë me mârre nusen në krajllí; i porosité kur të dalin në log të zânave, mos me bâ zhurmë se i shtângojnë. Agët e marrin për frigë ket msim të Mujit; dalin në bjeshkë e s’i gjên gjâ; kah kthehen me grue, ndalen në log e i a ftillojnë kângës. Zânat i shtângojnë, e gruen e marrin me veti. Nëpër fitme të grues, Muji jau dikton fuqin zânave, e me zagarë e gjuetarë jau zên trí dhít e egra. Zânat, tue kjá, bijnë në Jutbinë te Muji, ku lidhin ket kontrakt me shoshojnë: Zânat me i lshue nusen Mujit, e me u kthye jetën agëve të bâm gúr n’ mal, e Muji me i lshue dhít e egra me brina prej dukati, prej të cillave zânat e kishin të tanë fuqin e vet*”. Ndërsa në vijim bëhen disa shënime me rëndësi për cilësitë e qenieve mitike dhe të atyre njerëzore: “*Pikë për t’u vû ré: a) Fuqija e zânave tue hukatë, me shtangue njerzit e me i bâ gúr; b) Fuqija e tyne jashta personës së tyne, në dhi t’egra, me brina prej dukatit; c) Dhelpnija e grues, qi mrrin me rrêjtë deri zânat; ç) besa e lidhun. Shenim: Në ket rapsodi kemi përcaktimin e plotë të zânave qi me pak ndryshim përkon me at kuptim mythologjik të Grekve, që patën për Djanën me dhi për dore*”.<sup>245</sup>

*Argumenti* i kësaj kënge është i ngjashëm me ato të këngëve të tjera. Tek kënga *Martesa e Halilit* në fusnotën e argumentit janë dhënë disa shënime tejet interesante mbi mënyrën e mbledhjes së saj si edhe dukurinë e asimilimit të fiseve shqiptare nga ato sllave përmjet martesave me këta të fundit: “*Kjo rapsodi, e përmbledhun mbas shqyptimit të tre rapsodve të Curraj, mund të quhet, bashkë me martesën e Mujit e me dekën e djalit të tij Homerit, një ndër ma të bukurat e ma delikatet, qi kemi shqip [...] Prej intuicionit psikologjik na mund të nxjerrim edhe një tjetër të vërtetë historjake: mjeti i përpajimit të slavizmit ndër ne nuk kje shpata aq fort sa grueja. Mjafton një shetí ndër male të Vasoviqit, të Palabardhit e të Piprrit, me kuptue, se shka i bâni slavë kta vllazën Hotënsh, Triepshnjësh e Nikajsh: nuk kje tjetër veç njaj mikrob latent, - martesa e përzime me kombsi të hueja, - qi kishte nisë me e dermue familjen ilirjane qysh në kohë të Kotuzit, të Mujit, e Halilit ndër ato fusha të Bosnjës, ku Malcija e Madhe dhe Dukagjini edhe sot lidhë tradicjonin e dyndjes s’vet e ku sot i Boshnjaku, si i Palabardhasi me të Vasoviqasin, këndon njato rapsodi, qi*

<sup>245</sup> *Visaret e kombit. Vëllimi II. Kangë kreshnikësh dhe Legjenda. Mbledhë e redaktuem nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. 1.*

kndon Leka i Malcis s'onë dhe i "Ilirasi" i maleve të Dukagjinit, me ket ndryshim por se njani i kndon trimnit e të parvet shqip e tjetri në gjuhën e atij mizori, qi tue mos mujtë me marrë me luftë fiset ilirjane, i msýni veças; i msýni shpí për shpí, katund në katund, tue terrnue gurët e themelit, nânat ilirjane".<sup>246</sup> Në po këtë shënim heronjtë e eposit krahasohen me heronjtë homerikë dhe ato të eposit gjerman "Nibelungen-Lied" për nga mentaliteti mitik, trimëria dhe guximi, duke theksuar normën bazë të traditës zakonore, besën, e cila i dallon nga heronjtë sllavë, që janë të pabesë. Me mjaft vlerë është edhe shënimi që përshkruan mënyrën e mbledhjes së këngës prej gojës së popullit, në argumentin që përcjell këngën *Gjergj Elez Alia*: "Kështu diktova fjalët e rapsodit të Nikaj. Secili rapsod, para se të kallxon këngën, e ka zakon me kallxue gjatë e gjânë argumentin në mënyrë legende, qi âsht shum herë mâ poetik, se rapsodija vetë. Shka vûna ré në rapsodin plak prej fisit të Nikaj, âsht kta, as me thânë, një frazë prej kallximit të përparshëm. Kângatâr qysh i ri, tekstin e rapsodive e dinte fare mirë për mëndësh. Për t'u theksue âsht edhe ky fakt, se kur marrin lahutën në dorë, e kanë një publik t'interesantshëm, n'atë kohë fantazija e gjallë e tyre i endë rapsodit fort mâ bukur, se kur diktojnë. Un s'pash tjetër rrugë për me shpëtue legendën me gjith poezi, veç me shkruie një herë këngën mandej me i dhânë lahutën e unë me i bâ qortimet".<sup>247</sup> Autorët e shohin me dyshim mendimin që kërkon pas figurës së Gjergj Elez Alisë ngjashmëri me Shën Gjergjin, që paraqitet si mbrojtës i virgjërisë. Sipas tyre: "posë petkut të virytit etnik të burris, Shën Gjergji s'ka kurrëgjja të përbashkët me Gjergjin e legendave. Asht një kreshnik, qi përfytyron trimin burrë e me nderë, e vllân dhe motrën vërte shqiptare"<sup>248</sup>. Ndërsa tek kënga Muji e Behuri, autorët shohin: "... një fotografi e gjallë e shpirtit individualist, të Shqiptarit, qi, në kohën mâ kritiken, decentralizohet, për me mkambë personalitetin e vet të rrezikuem me fitimet e përbashkëta, qi zakonisht i përveshen kreshnikut protagonist. [...] mund të hetohet një dângë e veçantë mbrenda përsionalitetit shqiptar qi âsht: mungesa e solidaritetit në caktimin e relacjoneve të përbashkëta, të nevojshme për trajtimin a krijimin e njëj personaliteti kolektiv, moral, qi të përfaqësojë jo individualitetin e vehtjes por të kombit shqiptar përgjithsisht"<sup>249</sup>.

<sup>246</sup> Po aty, f. 24-25.

<sup>247</sup> *Visaret e kombit*. Vëllimi II. *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktuem nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja "Nikaj", Tiranë, 1937, f. 42 - 43.

<sup>248</sup> Po aty, f. 43.

<sup>249</sup> Po aty, f. 50.

Janë shënuar në pothuaj të gjitha këngët edhe disa *eda*, (këngëtarë/rapsodë) prej të cilëve janë mbledhur ato, si në Malci të Madhe: Pal Buli, Dodë Nikollë Loshi, Palok Ujka, Pal Duli; në Dukagjin Gjergj Pllumbi, Marash Nika i Pecaj; në Mertur: Sokol Martini, në Curraj të Epër: Mirash Gjoni etj. Gjithashtu është cilësuar mënyra e këndimit të këngëve, të cilat shoqëroheshin gjithmonë e vetëm me *lahutë*, e në ndonjë këngë edhe me *sharki*. Autorët e përmbledhjes janë të mendimit se “*mbas rithmit muzikuer të gjitha këngët këndohen pá përjashtim dhetë rrokshe; me sá në deklamacion dalin 9-10 rrokshe përzie shpesh me 8-7 rrokshe. Kangtari rrokot i plotson tue përsritë fjalë, a tue shtue një “tha” a “kqyr”, a tue shti ndërmjet bashktinglloresh a në mbarim të fjalve ndoi e të ngultë si b.f. pevëtë, kendon, dhâne, sot-e, mjesnat-e*”<sup>250</sup>.

## PËRFUNDIM

Pas botimeve sistematike të këngëve të eposit shqiptar të kreshnikëve, të bëra nga revistat e viteve ‘20-‘30, të shekullit të XX, si: “Hylli i Dritës” (1923-1930); “Zana popullore” (1933), “Cirka” (1938), “Leka” (1931-1943); nga vëllimi “Skandërbegu mbas gojdhana” (1926), të M. Sirdanit etj., kolana e botimit “Visaret e kombit”, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në botimin dhe afirmimin këtyre këngëve.

Ky kontribut, i pranishëm sidomos në vëllimet I “Kangë kreshnikësh dhe trimnije” (1937), të përgatitur nga Karl Gurakuqi dhe Filip Fishta, por edhe në vëllimin IV “Kangë trimnije, kreshnikësh ...” (1939), kulmon me përmbledhjen “Kangë kreshnikësh e legjenda”, në vëllimin II (1937), të përgatitur nga B. Palaj dhe D. Kurti, si e para përmbledhje e plotë, që afirmon përfundimisht ekzistencën e këtij eposi tek shqiptarët.

Në këtë punim vihet në dukje roli dhe rëndësia e kontributit të “Visaret e kombit” dhe dijetarëve françeskanë në afirmimin e eposit gojor shqiptar, përmes botimit dhe në disa raste edhe përmes trajtimeve teorike që shoqërojnë këngët e tij. Këto botime dëshmuar përfundimisht ekzistencën e eposit shqiptar dhe shtruan rrugën e kërkimeve për studiuesit e mëvonshëm, por duke ruajtur vlerën e varianteve bazë. Përmes tyre eposi ynë gojor zuri vend përfundimisht në letërsinë dhe kulturën tonë kombëtare, por edhe u afirmua, si pjesë e rëndësishme e epikës gojore ballkanase.

<sup>250</sup> *Visaret e kombit*. Vëllimi II. *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktueme nga At Benardin Palaj dhe At Donat Kurti, Shtypshkroja “Nikaj”, Tiranë, 1937, f. XIII.

**BIBLIOGRAFIA**

- Cirrincione, A. *At Benardin Palaj*. Botime Françeskane, Shkodër, 2005
- Çapaliku, A. *Benardin Palaj, Jeta dhe veprat*. At Gjergj Fishta. Shkodër, 1999.
- Neziri, Z. "Eposi heroik shqiptar nëpër faqet e Hyllit të Dritës". Studime Shqiptare 22, Shkodër 18 dhjetor 2013. Fiorentia, Shkodër 2015.
- Koliqi, E. "Benardin Palaj dhe një poemth i tij i pakryem". Rev. "Shejzat", nr. 5-8 Romë 1972
- Prennushi, V. *Kangë popullore gegnishte*. Sarajevë, 1911.
- Pllumi, At Zef. *Françeskanët e mdhaj*. Tiranë, 2009.
- Sirdani, At M. Skanderbegu mbas gojëdhanash. Ribot. Botime Françeskane, Shkodër 2008. Sirdani, P. M. *Hylli i Dritës*, nr. 3-7, 1939.
- Sirdani, D. Aleksander. *Hylli i Dritës*, nr 6-8, XIX/ 1943
- Sejko, V. *Mbi elemente të përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*. Bargjini, Tiranë 2002.
- Revista *Hylli i Dritës*, Shkodër, 1924-1941.
- *Visaret e kombit*. Vëllimi II. *Kangë kreshnikësh dhe Legjenda*. Mbledhë e redaktuem nga At B. Palaj dhe At D. Kurti, Shtypshkroja "Nikaj", Tiranë 1937.
- *Visaret e Kombit*. Vëllimi I. *Kangë kreshnikësh dhe trimnije*. (Prej folklorës së botueme). Zgjedhë e komentuem nga Prof. Karl Gurakuqi e Prof. Filip Fishta. Shtypshkroja Nikaj, Tiranë, 1937.
- *Visaret e Kombit VII. Folklorë II, Nder malet tona*. Kërkime të A't Gjon Karmës S.J. ndër male të Veriut. Shtypshkroja "Zoja e papërlyeme". Shkodër, 1940.
- *Visaret e Kombit VIII. Folklorë III*. Shkodër, Shtypshkroja "Zoja e papërlyeme". 1940 XVIII.

**The "Visaret e kombit" and the Franciscan scholars for the affirmation of the Albanian epos of the Kreshniks**

**ABSTRACT**

After the systematic editions of the Albanian epic songs published by the magazines of the 1920s and 1930s, such as: *Hylli i Dritës* (1923-1930); *Zana Popullore* (1933), *Cirka* (1938), *Leka* (1931-1943) and *Skanderbegu mas gojdhanash* (1926) of M. Sirdani, the publication of "*Visaret e Kombit*", has made a significant contribution to and affirmation of these songs.

We can find this important contribution especially in the volumes of *Kangë kreshnikësh dhe trimnije* (1937), prepared by Karl Gurakuqi and Filip Fishta, but also in volume IV "*Kangë trimnije, kreshnikësh ...*" (1939) culminates in "*Kangë kreshnikësh e legjenda*", in volume II (1937),

prepared by B. Palaj and D. Kurti, as the first full written work, which finally affirms the existence of epic songs among Albanians.

This paper highlights the role and importance of the contribution of "*Visaret e Kombit*" and the Franciscan school in the affirmation of the Albanian epos, through the publication and in some cases through the theoretical approaches accompanying these songs.

**Gëzim PUKA****DRAMA DHE TEATRI I STEFAN ÇAPALIKUT SI  
DIALOG PLOT NDRIÇIM E IDENTITET**

Në diskutimin për dramën dhe teatrin përvijohen hapësira të ndryshme të një veprimtarie që përmbledh së bashku reflektime dhe analiza, shërbime dhe shkrime. Teatri duhet të përcaktohet si një veprimtari e qartë prioritare. Ai lidhet me shoqërinë, për më tepër me publikun tonë, i cili është i vendosur, i sigurtë për rolin dhe ritualin e tij. Përmes funksionit të tij të patjetërsueshëm estetik dhe edukativ, nuk duhet reshtur së provuari dhe së kërkuari informacione eksperimentale, duke mos shpresuar thjesht tek një teatër që ka hedhur spirancën, së paku në dukje, tek rregullat strikte. Nuk është më një mister, në ditët e sotme quajmë teatër një tërësi krijimesh të llojeve të ndryshme për nga pikënisja, për metodën, për kompozicionin, për rolin që u jepet interpretuesve, që shpesh janë shkrimtarë të teatrit apo regjisorë në kuptimin tradicional, për aftësinë e të vënit në lidhje të arteve të ndryshme, për hapjen e artit ndaj realitetit, për të nxitur marrëdhënie të ndryshme mes një publiku të diferencuar. Nuk bëhet më fjalë për të rrëfyer me nivele të caktuara thellësie të njëjtin akt, të fiksuar përmes një konvencionit artistik dhe social që bashkëndajmë, apo për të kuptuar veçoritë e subjekteve që na ripropozon zhanri. Detyra jonë sot vështirësohet. Instrumentet e vëzhgimit duhet të përpunohen, në momentin që teatri nuk është më i mbështetur vetëm tek fuqia burimore e tekstit dramatik. Hapësirat e shfaqjeve, praktikat dhe lidhjet janë shtuar. Teatri shpreh paradigmat dhe urgjencat e epokës në të cilën jeton, si rrjedhojë vështrimi ynë duhet të zgjerohet.

Një vështrim i tillë duhet ta përshtatë vështrimin kolorit, jo vetëm në pranimin e një ndërdisiplinariteti të shpërndarë, por edhe në vlerësimin intuitiv dhe analitik, që në të njëjtën kohë është i aftë të individualizojë vlerën teatrale edhe pse mund të mos përkojë plotësisht me identitetin e llojit dhe mund të njihet mbi të gjitha si një ekstrem lëvizshmërie i përvojës teatrale. Përmes një fjale tashmë të bërë një aksiomë, do të mundeshim të përkufizonim karakteristikën e kësaj përzierje jo të pastër tek aftësia për ta bërë pikëvështrimin aq endacak sa e kërkon objekti teatral, dhe jo ta shpërndajmë pa asnjë lloj kompleksi faji drejt fragmentarizmave apo banalitetëve të përvojave të veçanta të artistëve.

Stefan Çapaliku është tashmë një zë origjinal në historinë e dramës shqipe dhe shkruan në frymën e një angazhimi dhe preokupimi, duke trajtuar anë të veçanta të realitetit dhe të pozitës paradoksale të njeriut në të. Artikulli sjell në optikën e lexuesit disa vështrime për disa pjesë teatrale të viteve të fundit të këtij autori bashkëkohor.

### **Për Montagët dhe Kapuletët e Urës së Bunës**

Jo shumë kohë më parë në skenën e teatrit “Migjeni” u shfaq për spektatorin shkodran “Romeo dhe Zhulieta”, në fakt jo sipas Shekspirit, siç reklamohet në poster, por sipas Stefan Çapalikut. Me një prolog tejet origjinal, nuk projektoshin në dy këndet e skenës as Montagët dhe as Kapuletët e tekstit shekspirian, por gabelët dhe magjypët, të cilët i lidh një urë, ajo e Bunës.

Drama zinte fill nga një konflikt i vjetër i lagjeve rome të Shkodrës, që ndodhen në brigjet e Bunës. Prej kësaj marrëdhënieje armiqësore, ata nuk bëjnë krushqi me njëri-tjetrin. Ky kontekst i tërheq vëmendjen Çapalikut, për të rimarrë një tekst tragjik. Teatri i këtij autori, edhe në këtë rast, nuk ka një çelës leximi univok dhe racional. Teknika groteske funksionon tek ai si metaforë e gjendjeve sociale, që lidhen me historinë e qytetit. Zonat e hijes apo të periferisë gjejnë vend dhe paraqiten në teatrin e tij, i cili nuk e fsheh dot konfuzionin e njeriut të lirë. Duke u thelluar në universin e magjypëve me moton e Balzakut: “*Nëse do të jesh me të vërtetë universal, fol për katundin tënd*”, ai gjen aktorët e tij, që janë romë të vërtetë, gjysmë analfabetë, të cilët dramaturgu i ka njohur direkt në lagjet më “të vjetra” të Shkodrës. Këtyre “aktorëve” ai u mëson tekstin e Shekspirit dhe i shndërron në Montagë dhe Kapuletë, që lëvizin në skenën e teatrit “Migjeni” me gërneta, lodra e gazel. Për analogji me autorin dhe regjisorin Emir Kusturica, nuk ka në skenën e Çapalikut as të mirë e as të këqij. Të gjithë personazhet e tij jetojnë në kontekst pagan. Kështu teksti i kësaj tragjedia të famshme të Shekspirit imitohet ose përcillet ironikisht përmes një trupe, që i ngjan shijes së regjisorit të shquar ballkanas, Emir Kusturicës. Qëllimisht autori përziën veprimin skenik, që i referohet tekstit origjinal, me reportazhe filmike, që projektojnë jetën e varfër të lagjeve periferike të Shkodrës. Duket sikur ai nuk qëndron në atmosferën tragjike të veprës. Me ndërhyrjet autoriale në tekst dhe në skenë, spektatorit të zakonshëm i transmetohet kredoja ironike autoriale, e cila për hir të së vërtetës, duhet thënë se është sa tragjike, aq edhe komike. Grotesku i këtij



spektakli i përket atij krahu që i afrohet së qeshurës, por që zhvillohet edhe në drejtim të seriozes, madje dhe tragjikes.

Prezenca e monitorëve që paraqesin realitete varfërie dhe konfliktesh të një natyre televizive dhe prezenca e një narratori, që zëvendëson korin e tekstit origjinal shekspirian, shpreh në njëfarë mënyre ironikisht edhe vetë krizën e dramës si gjini. Një komedi, ku monitorët bëjnë të mundur rrjedhën e ngjarjes, nuk është një komedi e vërtetë. Zhvillimi i veprimit nuk përcaktohet nga konfrontimi ndërvetor i personazheve origjinale shekspiriane, por nga tensioni që prodhon realiteti në monitor së bashku me lojën ironike të këtij teksti në skenë. Diku pas këtij tensioni, fshihet uni epik apo firma autoriale e Çapalikut.

Pasqyrimi i dyfishtë i jetës së trishtë në monitor dhe i lojës komike të një tragjedie në skenë, përbën një gjetje estetike. Kjo përzierje e trajtuar në këtë lojë dramatike përjetohet nga spektatori si diçka krejt normale, sepse realizohet mbi një skenë apo shtrat grotesk, ku bashkohen të pabashkueshmet. Në këtë lojë dramatike, janë aq të lidhura dukuritë komike dhe ato tragjike, sa që është e vështirë të përcaktosh ku mbaron njëra dhe ku fillon tjetra. Organizimit të elementeve të kësaj vepre i prin mendimi, i cili është futur dhe strukturuar brenda saj duke i siguruar qëndrueshmëri. Montazhi i një dyzimi, siç është dialogu dhe veprimi skenik shekspirian, me kronikat në monitor, është rrjedhojë e një mendimi të vetëm. Mejerhold thekson: *“Gjithkund veprat e Shekspirit vihen në skenë jashtëzakonisht dobët. Shekspiri ende pret një shfaqje të vërtetë.”* Teksti i Shekspirit i flet kujtdo, madje edhe romëve ballkanas. Është e qartë se *“Romeo dhe Zhulieta”* e Stefan Çapalikut nuk është shfaqja e vërtetë e dialogut shekspirian. Shfaqja në teatrin e Shkodrës tentoi të shkaktojë një luhatje të qëndrimit të spektatorëve. Strategjia autoriale e ndien si absolutisht të domosdoshme zhvillimin ironik të karaktereve të tragjedisë së njohur. Intriga e kësaj tragjedie të famshme ka gjasa që të kuptohet edhe në mënyrë të pazakontë apo zbavitëse. Kjo performancë teatrale argëtoi, por edhe tronditi shikuesin. Kësaj vepre të shkruar qëmoti, dramaturgu-regjisor i dha jetë *“evgjitore”*, duke e shkëputur kështu nga pika e vdekur e njohjes rutinore.

### **“Provat gjenerale të një vdekje të paralajmëruar”, teatër i njëmendtë .**

“Provat gjenerale të një vdekje të paralajmëruar” është një tjetër shfaqje që ka firmën autoriale dhe regjisoriale të Stefan Çapalikut. Kjo dramë me një nisje të pazakontë, u paraqit për sytë e spektatorit, si krijim që lind *“këtu”* dhe *“tani”* nga një regjisor (Maestro) dhe disa aktorë të ulur

në rreshtin e parë të platesë, së bashku me spektatorët. Me një lloj “djallëzie” pirandeliane, Çapaliku kësaj radhe na propozon “teatër në teatër”, por kahu i zgjedhur nuk është ai i “gjashtë personazheve në kërkim të autorit”, por është ai i aktorëve realë dhe regjisorit në kërkim të personazheve të trilluar, por jo dhe aq. Që në fillim aktorët nguten të na sigurojnë se historisë së shpikur, që po ngjitet dhe po provohet në këtë skenë, i mungon finalja.

*“Aktori IX: Më duhet t’jua kujtoj prapë se e kemi ende të papunuar skenën e fundit. Skenën time.*

*Regjisori: E di... e di... Pa merak. Skenën e fundit do ta punojmë në fund. Rri pa merak. Po. Atëherë... Vazhdojmë!”*

Një çelje ironike për një shfaqje me sipar të hapur. Hapësira e ngjarjes vjen në skenë si jehonë dëgjimore përmes një kori ndërmjetësues rrëfimtar. Mënyra me të cilën një autor trajton hapësirën, provon përgjithësisht domethënie të një estetike të veçantë të veprës. Hapësirën dramatike e formon vetë lexuesi-spektator. Ajo i përket veprës dramatike përmes didaskalive apo remarkave autoriale (fjalët e autorit për skenën dhe lëvizjet e aktorëve), të cilat spektatori në këtë shfaqje i dëgjon të deklamuara nga personazhet, që disa herë shndërrohen në kor.

*“Kori: Ngjarjet zhvillohen në një shtëpi te madhe, dykatëshe, që gjendet as në fshat dhe as në qytet. Është shtëpia e dikurshme e familjes. Këtu kanë vdekur të gjithë. Në të jeton Xhelal Dridha, vetëm. Adi dhe Ana e përdorin shpesh për fundjava. Shtëpia është e mobiluar në stilin e vjetër dhe konservator. Ngjarjet zhvillohen në dhomën e madhe të ndenjes. Ka dy dritare”.*

Më shumë sesa skenografinë, strategjia e këtij autori shfrytëzon mendjen e spektatorit për të ndërtuar aty simbolikisht këtë hapësirë dramatike imagjinare. Analiza e vendeve dhe e vendosjeve në një dramë krijon një ide më të qartë mbi personazhet, veprimet e tyre, por edhe mbi atmosferën e përgjithshme. Kështu tek kjo dramë si një sfond efektiv për veprimin vjen atmosfera e ankthshme, e cila theksohet nga errësira ose boshllëku përmes të cilave ndihmohen pjesërisht, por edhe vështirësohet receptimi i kuptimit të dramës dhe të personazheve. Më tepër se funksionimi si një sfond i thjeshtë apo krijimi i një atmosfere të caktuar, mund të thuhet se këto hapësira bëhen hapësira simbolike, pasi ato synojnë drejt niveleve të tjera të të kuptuarit në tekst. Strategjia autoriale luan me ndenjëset e banjove, me tavolinën e varur prej xhami, me pijet në epruveta dhe makinën qepëse shekullore. Vetëm kështu reflektohet “çrregullimi”, në

të cilin personazhet e gjejnë veten që në fillim. Në këtë shfaqje që zhvillohet në tri nivele dhe hapësira, veprimi dramatik dhe rrëfimi skenik, shkëmbehen pa u përplasur njëri me tjetrin, në saje të një rregullsie që përpiqet ta mbajë regjisorin (Maestro), i cili është ulur në mes të spektatorëve. Poetika e tekstit dhe poetika e shfaqjes nyjëtohet rreth personazhit Xhelal Dridha, një ish-rreshter burgu, tashmë në agoni të vdekjes. Nusja dhe i biri e presin me ankth këtë vdekje, ndërsa Doktorin i përditëson për gjendjen e pashpresë. Një rrobaqepës me arna, që e ka njohur gjithë jetën Xhelal Dridhën, ngutet t'i qepë kostumin e fundit, ndërsa i huaji, austriaku që ka ardhur së bashku me të dashurën e tij, kërkon ta asistojë në rrëfimin e fundit. Rreshteri Xhelal Dridha (xhelati që të fuste të dridhurat), po kërkon një prift që të rrëfëhet, kurse Luli përfaqësues i agjencisë funerale gajaset së qeshuri. Ky është niveli i skenës ku aktorët janë ngjitur dhe po kërkojnë t'i mishërojnë personazhet.

Më përpara, jo tamam në paraskenë, qëndrojnë të ulur dy personazhe si fantazma: motër e vëlla. Ata rrëfejnë me zërat e tyre në sinkron një histori. Kështu rrëfimi dhe veprimi janë ndarë. I pari ndodh në sallë, ndërsa i dyti në skenë. Përmes një diskursi që të rrëqeth, shpërmdahet në të gjithë hapësirën e sallës, në plate dhe amfiteatër, ose thënë ndryshe në hapësirën e spektatorit, historia e një familjeje të përgjakur në dy breza prej personazhit që po jep shpirt në skenë.

Xhelal Dridha në fillim i ka arrestuar dhe mbytur babain, pastaj i ka internuar së bashku me nënën e tyre. Në fund i vrau vëlla e motër kur po tentonin të arratiseshin.

*“Kori: Vendosa të arratisem. I thashë sime motre dhe ajo përherë të parë më tregoi se ky kishte qenë urdhri i babës sonë. Po, tha ajo. Atë natë ai e kish urdhëruar se duhej të ikte. Si mua. Si mua-tha ajo. Me sy. Me sy. Ecëm në këmbë. Fshehtas zogjve dhe pemëve. Arritëm në buzë të ujit të atij lumi që na ndante nga liria. Vura motrën përpara. Ajo duhej të notonte dy metra para meje. Duhej të prisnim të ikte hëna që të kalonim në anën tjetër. E kishim gjetur më në fund atë natë të errët pus dhe me shi. Ajo arriti të dilte matanë. Kurse mua Xhelal Dridha më vrau me një plumb të vetëm, sapo po dilja në bregun tjetër të lumit. Ishte një plumb mbas koke”.*

Ajo që filloi si lojë ironike, papritur po bëhet diçka serioze. Në të gjitha thëniet e sinkronizuara të personazheve viktimat duket njeriu i topitur, të cilit i është vrarë liria, madje edhe vizioni për lirinë. Në skenën vepruese të personazheve, Çapaliku nuk ngurron të nxisë atë që forma dramatike tradicionale premtan: të përfshijë spektatorin, të lejojë ndenjat, të krijojë emocione. Kështu që spektatori zhytet brenda veprimit dhe i nënshtrohet ndikimit.

Tjetër gjë ndodh në sallën e narracionit të personazheve, ku forma e një teatri epik e bën spektatorin vëzhgues, i stimulon veprimin, i krijon nocione duke e tensionuar në raport me historinë që po rrëfëhet, duke luajtur shpesh me kujtesën e tij në saje të cinizmit të përdorur. Në këtë tekst lexohet edhe një aspiratë brehtiane, për ta angazhuar pak teatrin qoftë edhe me gjetjet që të kujtojnë Arturo Ui-në, siç është fjalimi i të huajit (austriakut), mbi ndenjësën e banjos apo barku i shterpëzuar i nuses së djalit, që nuk do të prodhojë më kurrë pasardhës të tipit Dridha. I biri, nusja, Doktor, rrobaqepësi, Luli, Polici, i huaji dhe e dashura e tij, pra të gjithë personazhet i bashkon pritja e ankthshme për vdekjen e Xhelal Dridhës, i cili i ka të gjitha modalitetet. Ai do të vdesë, mund të vdesë, duhet të vdesë, por nuk di se si të vdesë. Kështu edhe vdekja bëhet “objekti me vlerë”, që do t’i mbyllte hesapet për këtë personazh. Por ajo nuk ndodh.

**“Xhelali:** *(Duke thirrur me forcë regjisorin)* Maestro! Maestro! Maestro!

*Askush nuk kthen përgjigje*

Maestro! Ku je? Është skena e fundit... Jam mirë kështu?

*Heshtje*

Maestro!

Ku je?

Dil pra. Vetë më premtove... Ku je?

*Heshtje*

Si të vdes?

Ku?

Këtu përpara? Në avanskenë?

Maestro! Si të vdes?

*Heshtje*

*(I kthehet spektatorit)* Të ketë ikur?! T’ia ketë mbathur edhe ai?!

Si vdiset?

Më thoni ju. Si vdiset?

Si do ju pëlqente që të vdes?!

*Duke u ngritur nga karroca dhe duke hequr xhaketën e rolit*

Këtu askush nuk të tregon se si vdiset.

Kulmi!”

Është kjo arsyeja pse ai ka nevojë për Maestro, pasi ka mbetur aty në skenë lakuriq, pa kostumin e rrobaqepësit, me duar dhe ballë të përgjakur. Qenia e tij në këtë dramë, ashtu si tek “Tiranozauri” i Kasëm Trebeshinës, më shumë sesa ekzistencën si subjekt, përlij ekzistencën e tij si iluzion apo ide të tiranisë. Qëllimisht nuk ka në këtë shfaqje referenca specifike kohore,

si për të shmangur historicizmin deri në shkallën zero dhe për të na dhënë një kohë abstrakte. Veç ama, një vepër e tillë ku është e qëllimshme mungesa e shenjave dhe e treguesve historikë, të bën të mendosh se në këtë shfaqje jo vetëm që nuk nënvleftësohet historia, domethënë e kaluara diktatoriale shqiptare, por kujdes se brenda saj mund të përfshihet edhe e tashmja. Me njëfarë ironie mungesa e referentit kohor historik e shënon aktualitetin dhe kohën e tashme.

Duket se Stefan Çapaliku si autor i dramës ende nuk e ka ndarë mendjen se nga duhet të anojë peshorja e letërsisë që ai prodhon, nga ana e “embëlsisë” (dulce) apo “nevojës për t’i shërbyer njerëzve” (utile). Për mendimin tonë edhe në qofshin në ekuilibër, kjo nuk i prish asnjë punë një teksti dhe spektakli të ngritur me shijen e lirisë.

Shfaqja “Provat gjenerale të një vdekje të paralajmëruar” më shumë sesa trill, ishte teatër i njëmendtë. Çapaliku “autor drame” ngjan se po heq dorë nga ky lloj përcaktori dhe po gjen më fisnik emrin “shkrimtar i teatrit”. Edhe me këtë pjesë ai dëshmoi që këtë art me dy kohë (tekst dramatik dhe spektakël dramatik), po e kthen në një art me një kohë, atë skenës, duke marrë vetë përsipër zgjidhjen regjisoriale.

### **Si ta shohim shfaqjen e Stefan Çapalikut “Danimarka-Toka jonë”**

“Danimarka-Toka jonë” është një tjetër spektakël i Stefan Çapalikut, që u përcoll me mjaft interes nga spektatori. Përmes një montazhi ironik postmodern janë pranë një kryevepër e letërsisë botërore, “Hamleti” i Shekspirit, dhe një nga prodhimet me të njohura në sistemin tonë letrar, “Toka jonë” e Kolë Jakovës. Dialogjizmi ironik i këtyre teksteve të njohura, por me diferencë të madhe potenciale është vënë në një kontekst tjetër ironik, atë të disa aktorëve të një teatri provincial që gjendet në zgrip ekzistencial.

Narratorja Drejtoreshë e teatrit dhe Mjeshtri-regjisor, ftojnë në skenë disa aktorë që po provojnë skenat e një shfaqjeje soc-realiste, e cila është bërë pjesë qendrore e dramaturgjisë shqiptare. Përtej velarit të ulur riprodhohet një skenë e stereotipizuar e kësaj drame. Disa pode të vjetëruara, të ngritura vertikalisht dhe ca rrangullina projektorësh përbëjnë hapësirën skenike të kësaj drame. Në këtë hapësirë zhvillohet një dialog aktorësh apo *dramatis personae* të lodhur, që përziejnë mes tyre replikat e pjesës me replikat e tekstit burimor dhe tekstit autorial.

Mjeshtri regjisor paralajmëron situatën urgjente për daljen e premierës. Strategjia autoriale e Çapalikut ka preferuar t’u ndërmendë një pjesë origjinale të dramës “Toka jonë”: një Murrash, një Tuç, një Loke, një

Lekë, një File, një Vatë dhe një Met, përmes disa personazheve që nuk janë gjë tjetër veçse aktorë – ushtarë, propagandues të një ideologjie në rënie. Në këtë fokus po luhet një tjetër dramë, ajo e vetë aktorëve që ekzistojnë në një kohë, kur kohët po ndryshojnë. Në pushimin e provave zëri i stërnjohur i një folëseje radiofonike transmeton se erdhi koha e pluralizmit politik. Kjo thyerje e madhe shkakton plasaritje të pariparueshme tek trupa-kolektiv teatror, e cila është mësuar të mendojë kolektivisht. Erdhi koha e re kur mund të vihet në skenë edhe “Hamleti” i Shekspirit. Provat nuk duhet ndalur, paralajmëron Drejtoresha, por teksti duhet të pasqyrojë nevojat dhe ndryshimet e kohës. Aktorja, Filja, ajo më e reja, papritur ka një vokacion, një ndriçim mendjeje, për t’iu referuar një teksti shekspirian, për të luajtur Ofelinë.

Uni autorial, mbase i fshehur aty diku pas Mjeshtrit-regjisor, duket se tani shpërthen me mllef duke parë se si disa aktorë që gjithë jetën kanë luajtur “role katundarësh”, befas bëhen ëndrrimtarë për role të mëdha. Tani gjithçka ka filluar. Cila dramë do të luhet në skenë?! “Halmeti”, “Toka jonë” apo drama e aktorëve të këtij teatri, të cilët çuditërisht luajnë me emrat e tyre. Kjo është komedia e dramatikës.

*“Meqenëse Hamleti është një intelektual me kokën mbi libra si dhe një personazh që u del në ëndërr të gjithë aktorëve dhe regjisorëve teatralë, gjendja e tij normale s’është gjë tjetër veçse një pasiguri ekstreme”<sup>251</sup>, - shkruan Harold Bloom.*

Është diçka krejt e panatyrshme të refuzosh identifikimin më Hamletin, sidomos nëse ke prirje intelektuale. Por këtë e di veç Mjeshtri, ndërsa aktorët ata lexuesit e nivelit të parë nguten të gjejnë përkimet e fabulës së dy teksteve të mëdha, duke i montuar me njëri-tjetrin, për të shpëtuar çfarë mund të shpëtojë nga teksti i parë, i cili sipas tyre mund të qëndrojë fare mirë përkrah të dytit. Nga një barrelë me mbishkrimin “Djepi i kulturës”, klishe e nyjëtuar deri në neveri për qytetin e aktorëve, dalin veshjet e reja të shfaqjes montazh.

Kronikat mediatike e paraqitën këtë shfaqje si dramë sociale e një trupe teatrore. Stefan Çapaliku kërkon të paraqesë dramatikisht kushtet ekonomiko-politike nën sundimin e të cilave ka rënë jeta individuale. Ai ka për detyrë të paraqesë faktorët që i kanë rrënjët më tej se një situatë e veçantë apo një fakt i veçantë, të cilat edhe i sundon. Të paraqesësh dramatikisht të gjithë këtë kërkon një punë paraprake; transformimin e kushteve të marra në konsideratë në një aktualizim ndërnjerëzor, domethënë kthimin dhe zgjidhjen e procesit historik në plan estetik, të cilin

<sup>251</sup> Harold, Bloom: *Si dhe përse të lexojmë*, f. 218.

do të duhej pikërisht ta pasqyrojë. Të transformosh kushtëzimin e jashtëm në aktualizim ndërnjerëzor do të thotë të paraqesësh apo të shpallësh një veprim që aktualizon kushtet e jashtme. Ky montazh origjinal tekstesh dramatike është i destinuar të ndërmjetësojë mes tematikës sociale dhe formës dramatike të paracaktuar, prandaj edhe paraqitet problematik si nga pikëpamja tematike, ashtu edhe ajo formale. A ishte kjo një dramë sociale, një komedi apo tragjikomedi?!

Kjo dramë qëllimisht provokon dhe kontraston në çdo aspekt me kërkesën e formës dramatike. Personazhet përfaqësojnë mijëra njerëz që jetojnë në kushte të ngjashme, gjendja e tyre përfaqëson njëfarë uniformiteti të kushtëzuar nga faktorë ekonomikë. Fati i tyre shërben si model, është një mjet paraqitjeje e dëshmie jo vetëm i objektivitetit, i cili e kapërcen veprën, por edhe e një subjekti paraqitës që është mbi të, unin e autorit.

Kjo shfaqje u pa si dramë e teatrit, por në fakt është diçka më shumë, është tragjikomedia e intelektualit idealist, i cili ka mbetur aty në skenën shqiptare, pa aktorë, pa tekst dhe pa asgjë. Ja pse Stefan Çapaliku befaso i njëherë me dramën e titulluar “Danimarka-Toka jonë”.

### **“Një zjarrfikës në oborrin e teatrit” - një apologji për teatrin bashkëkohor**

Shfaqja më e fundit eksperimentale e Stefan Çapalikut “Një zjarrfikës në oborrin e teatrit” vjen si komedi e verdhë. Duke marrë shkas nga spektaklet interaktive është ideuar një formulë teatrale jashtëzakonisht intriguese dhe argëtuesë, që mund të përmblihet në termin “teatri i verdhë interaktiv”. Formula e teatrit të verdhë është: Dedektivi është spektatori. Po çfarë krimi po hetohet?!

Po hetohet krimi që po bën njëmendësia (realiteti) kundrejt teatrit në bashkëkohësinë tonë. Bëhet fjalë për të rrëfyer me nivele të ndryshme thellësie të njëjtin akt, të fiksuar përmes një konvencionit artistik dhe social, që bashkëndajmë, apo për të kuptuar veçoritë e subjekteve që na ripropozon kriza ku ka hyrë mediumi i skenës. Detyra e të apasionuarve dhe spektatorit të këtij arti sot vështirësohet. Instrumentet e vëzhgimit duhet të përpunohen, në momentin që teatri nuk është më i mbështetur vetëm tek fuqia burimore e tekstit dramatik. Hapësirat e shfaqjeve, praktikat dhe lidhjet janë shtuar. Teatri i verdhë ndërveprues është ai lloj teatri që tenton të hedhë poshtë barrierën tradicionale që ndan platenë dhe skenën, spektatorin dhe aktorët. Publiku është ndarë nga një pod në plate dhe ngjan se do të ftohet të hetojë në fund të shfaqjes, si dhe pse ndodhi vdekja në

skenë. Një karakteristikë e këtij lloj teatri është se momentet e interaktivitetit nuk e ndërpresin narrativën. Spektatorëve u është dhënë një rol, pasi në momentin që spektakli zë fill, edhe publiku tërhiqet në kohën dhe hapësirën në të cilën zhvillohet veprimi skenik. Çdo spektator në një lloj të tillë teatri ndërveprues, nuk është më një spektator pasiv, por është pjesë përbërëse e historisë.

Nga platforma regjisoriale do të citonim:

*Duket në pamje të parë se kemi të bëjmë me dy kampe të gjendura në dy vende të ndryshme veprimi: Kampi i Aktoreve dhe kampi i teatrit që përbëhet nga: Aleksis - aktor në prag pensioni, Aureli-aktor, Aida-aktore, Antonipunëtor skene dhe Aurora-grimiere. Në shfaqje të gjithë këto personazhe do jenë të ndërtuar mbi parimin estetik të eksteriorizimit të qenies. Planet e dyta vijne e marrin jetë në format e fshehjes së qëllimit dhe të maskimit të veprimit. Nuk do të ketë lojë, do të ketë interpretim. Do të interpretohen disa premisa tekstuale që çojnë gradualisht drejt asgjësimit të ngjarjes kryesore. Shumë ngjarje më të vogla a miningjarje do të mbesin të hapura si ftesa për bashkëpunim a bashkëinterpretim me spektatorin”.*

Linjë kryesore e veprimit është edhe ajo e aktoreve së dyzuar që ka luajtur në teatër gjithë jetën. Pranë saj është shërbëtori besnik, Arturoja. Memoria e saj zbërthehet përmes disa teksteve të bartura nga tragjedi të mëdha të antikitetit apo shekspiriane, që artikulohej për të provokuar spektatorin. Linja e dytë janë aktorët dhe punëtorët e teatrit, që kanë dalë në podin e ngritur në mes të platesë. Në skenë po vihet prapaskena. Eksperimenti po vijon të provokojë. Aktorët lëvizin shumë me trupin, por përsërisin të njëjtin tekst.

Në fakt, kjo komedi është drama e aktorëve që kanë humbur identitetin e tyre dhe nuk e dinë më se si të përkufizohet. Kriza e tyre nuk është çështje emri, nuk është çështje fjalësh apo formulash. Është imazhi për vetveten, që tashmë i duket i panjohur ose që po i shkon drejt errësimit dhe ngatërimit, duke u zbehur në një seri mundësisht të tjera. Është një vetëdijësim gjithnjë e më tragjik vetëkritik për punën e tyre dhe fuqinë e dikurshme të këtij profesioni për shoqërinë. Në këtë hapësirë në dukje të komedisë së verdhë, në fakt, po ndërtohet edhe teatri total. Strategjia e dramaturgut përdor si mjet të ashtuquajturin teatër total, që prodhon një lloj sinergjie përmes ndërmjetësimit të kërcimit, këngës, si një teatër që kërkon të zbulojë vetë kuptimin e tij më të thellë që përmbledhet në komunikimin artistik. Duke hequr dorë nga disa kode dhe konvencione të përgjithshme, teatri total i Çapalikut përvesh disa veçori duke i tejkaluar kufijtë e fjalës së shkruar, e cila disa herë kalon në plan të dytë në krahasim me lëvizshmërinë dhe veprimin e aktorëve në skenë.



Kështu na zbulohet natyra shumëdimensionale e veprës, në të cilën muzika e ofruar nga një miniorkestër shfaqet si pjesë e ndërfaqur bukur dhe jo si aksesori i thjeshtë, duke i dhënë jetë një “akti total” të një aktoreje që nuk identifikohet më me një personazh, por sjell në skenë aftësinë më të thellë dhe vetjake interpretative.

Nuk është më “teatër në teatër”, por është teatër me teatrin. Diskursi në skenën/prapaskenë ka të njëjtën kryefjalë: Teatri ka marrë fund; teatri gjatë diktaturës; kush ka qenë më parë teatri apo Ministria e Brendshme; teatri u mbush me spiunë; teatrin në demokraci nuk e mbyllin, por ai është kthyer në një institucion grotesk; le ta djegim teatrin!.

Thjeshtëzimi i shenjave të shpie në zmadhimin e efekteve dhe mund të thuhet se teatri është edhe ky, një shkëputje e fortë një zgjidhje e papritur me efekte tingëllore e pamore. Një klarinetë shëtitëse që të ngjeth mishtë. Por këto goditje të papritura të regjisorit janë vetëm ngjarje që tregojnë realizmin e pashmangshëm që rrjedh nga imazhet e stereotipizuara, por që në njëfarë mënyre tradhtojnë ambiguitetin e teatrit, i cili duke qenë trill i zbuluar, gjithmonë i referohet një tjetri, një tjetër gjëje, që është gjithashtu e ndryshme nga ajo që duket, diçkaje të zhvendosur, të larguar, që na kujton gjithmonë natyrën e tij iluzioniste. Në brendësi të kësaj loje dukjesh, fjalët janë të vetmet gjëra të vërteta, sepse bartin arsye, pasion, dhembje.

*“Sezoni mbaroi. Tenja ka hyrë në karriget e teatrit. I dëgjoni kërrkërret? Pah, çfarë kori spontan dhe improvizues! Monoton dhe monokron. I shëmtuar dhe i mrekullueshëm. Askush s’e di me saktësi se kur është dita e fillimit të punës së këtij kori makabër. Dikur e dezinfektonin teatrin natën e mbarimit të sezonit. Tani askush nuk kujdeset më për këtë. Shpesh më duket se spektatorët do shemben përdhe me gjithë karriget e tyre dhe s’do mund të lëvizin më prej andej prej të qeshurave historike. Atyre do i merret fryma nga të qeshurat dhe do vdesin të gjithë një e nga një. Do vdesin pa e ditur sepse..., domethënë pa një arsye të shëndoshë”.*

Mbi kokat e aktorëve dhe spektatorëve një glob i madh ndryshon ndriçimin herë si hënë dhe herë si diell. Shumësisë së fjalëve që vijnë përmes diskursit plot jehonë të korit të aktorëve dhe punëtorëve të teatrit, i shoqërizohen simbolikisht disa flluska sapuni. Pika kulmore, klimax-i i shfaqjes, teatrit i duhet vënë zjarri. Këtë zjarrvënie vetjet vepruese të komedisë ia propozojnë Zjarrfikësit, personazhit tashmë të stereotipizuar joneskian, që është aty gjithmonë në kërkim të një zjarri që duhet shuar. Në

finale Aktorja kërkon të ridimensionohet duke tentuar për një herë të vetme të heqë maskën.

*“Unë jam maska.*

*Uf... Unë po vdes.*

*Ju lutem... Ma hiqni maskën, ma hiqni ju lutem. Ju që qeshni hajdeni, ecni..., ecni e ma hiqni. Ju lutem! Dua të vdes si njeri... Më në fund...Më në fund dua të luaj një rol që s’e luajta kurrë. Dua të luaj veten”*

Aktorja e dyzuar shembet përdhe e vdekur. Globi ndriçues bie mbi pod duke shtypur nën të Arturon, shërbëtorin e Aktores, i cili prezantohet së fundmi si një kritik teatri. Simbolika është e qartë, kritika teatrale më shumë e trullosur sesa e dekorajuar, është një bashkësi arkaike dhe moderniste. Kush ka dëshirë që ta praktikojë, duhet ta bëjë nxënien e saj duke u endur ndërmjet një trashëgimie të pluhurosur dhe nevojës për të gjetur rrugë të reja, në njërën anë e pa dalje, mes vetmisë e nevojës për krahasim dhe solidaritet, duke provuar që t’i ndryshojë gjërat. Kritika nuk mund të kufizohet thjesht tek kronika apo polemika kundër këtij “Teatri modern”, që po transformon një traditë që është e shtrirë në shumë shekuj. Kritika duhet të pozicionohet. Në shumë raste ajo zgjedh të ndjekë regjisorin në luftën e tij për të rivendosur ose për të ruajtur të ri artin skenik, për ta bërë atë të aftë që të thotë diçka përsëri për botën e bashkëkohësisë, për të rinovuar vetë strukturat dhe hapësirat ku prodhohet shfaqjet.

## **PËRFUNDIM**

Stefan Çapaliku po vijon të provokojë në teatrin shqiptar të mijëvjeçarit të tretë me këtë kredo artistike. Pena e këtij autori është tashmë e identifikueshme përsa i përket gjinisë dramatike dhe e plotëson veten me gjetje të efektshme në teksturën skenike. Studiuesi Besim Rexhaj, në librin e tij “Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore”, e përshkruan këtë autor si një krijues me një kërshëri të gjerë, si një artist që krijimin e ka vokacion të njëmendtë jetësor”.<sup>252</sup>

<sup>252</sup> Shih: Rexhaj Besim, *Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008 (poetika, tipologjia, periodizmi)*, Vëll. II, Prishtinë, 2009, f. 205.

Do të shtonim se drama dhe performanca e këtij autori nuk ka hequr dorë nga teatri, prandaj deklarimi i gjallërisë dhe individualizimi i vitalitetit, duhet bërë në përshtatje me aftësinë për të dialoguar pa kompromis me forma të tjera artistike, por pa e humbur ndriçimin dhe identitetin. Por mbi të gjitha skena duhet të vazhdojë t'i përkasë tekstit të mirë letrar të bukur në llojin e vet.

#### REFERENCA

- BLOOM, Harold: *Si dhe përse të lexojmë*, Shtëpia botuese “Dudaj”, Tiranë, 2008, 309 f.
- PAPAGJONI, Josif: *Teatri dhe dramaturgjia shqiptare*, Shtëpia botuese universitare, Tiranë, 2011, 360 f.
- REXHAJ, Besim: *Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008 (poetika, tipologjia, periodizmi)*, Vëll. II, Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2009, 344 f.
- SHEKSPIR, Uiliam: *Hamleti, princ i Danimarkës*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2005, 264 f.

### **Drama and theater of Stefan Çapaliku as a dialogue full of illumination and identity**

#### *ABSTRACT*

This article points out that the contemporary playwright Stefan Çapaliku still continues provoking the Albanian theater in the third millennium with a prominent artistic credo. The reviewed works indicate that how this author writes is already identifiable as far as dramatic genre is concerned and complements himself with effective finding in stage texture. Through this work this author is described as a writer with a wide-ranging curiosity, as an artist that creates a true vocation of life.

It can be added that the drama and the performance of this author did not give up on the theater, so the declaration of liveliness and the individualization of vitality should be made in accordance with the ability

to uncompromisingly dialogue with other artistic forms but without losing its illumination and identity. The article argues that such examples show that the scene should continue to belong to a fine literary text of its own kind.

Ndoj MHILLI

**DRAMA “LOJA E MBASDREKËS” E M. CAMAJT  
DHE NOVELA “GJAKU” E E. KOLIQIT:  
AFRI DHE DALLIME**

*-N'incidentin e nxânsavet na shohim një ves e një virtyt. Të parin që â ndjesia e shpagimit, prirja e gjak-marrjes, duhet t'a shrrânjosim prej shpirtit të kalamâjve, pse dâmtton kombin e po faron fiset malsore. Duhet qysh në vogjlî t'u a mbushim mënden, t'u a ngulim në zëmër se â një trup, një barabarizëm. [...] - Prirjen e gjakmarrjes duhet m'e bâ të zhduket prej shpirtnave të njomë, më sa që ato të besës, të burrnís, të mikpritjes etj. Lypet me i forcue tue dhânë një drejtim të mbarë, sepse shpesh edhe këto cilësí të mira Shqiptari i vên në shërbim të një qëllimi të mbrapsht.*<sup>253</sup>

Këto virtyte, qëllime a bindje i mishëron edhe Gjormi te drama L. M, i cili kërkon të zbulojë rrënjët e së keqes dhe t'i çrrënjosë ato. Qëllimin e tij e shpreh hapur në bashkëbisedim me Bjeshkën:

Gjormi: Vërtet janë ngjarje të idhëta ato që due të ndëgjoj e të përshkruej. Unë dëshiroj të zbuloj rranjët e së keqes, për t'u çelë sytë të gjithëve se gjakmarrja ashtë plagë, zezonë e përhershme!<sup>254</sup>

Mirëpo, në këtë dialog dhe në qendër të veprimeve dramatike te drama L. M në ndryshim nga novela *Gjaku* e Koliqit, ku vihet theksi te gjakmarrja, në rastin e Camajt theksohet më shumë aspekti i degjenerimit të Kanunit që çon në zezonë, dhe te vrasjet për shpagim, të cilat Kanuni i dënon a ndëshkon:

Bjeshka: S'ka ma gjakmarrje kënde, por shpagim. Në vend të vriten burrat e malësisë, i djegin arën anmikut të vet, natën për hanë. *Shënon me gisht.* Këtu ashtë mënia, këtu ashtë plaga që po thue ti e jo në grykën e pushkës.<sup>255</sup>

Të njëjtin qëndrim me Gjormin te L. M mban edhe Gjyqtari, i cili shprehet:

<sup>253</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Botimet Buzuku, Shtypur në shtypshkronjën “Timegate”, Prishtinë, 2003, f. 29.

<sup>254</sup> Martin Camaj. *Drama*. Përgatiti për botim Bardhyl Demiraj, Sh. Botuese “Onufri” Tiranë, 2012, f. 31.

<sup>255</sup> Po aty, f. 31.

Gjyqtari: Problemi im ashtë tjetër: për të çrrajos në thelb doket e vjetra, nuk i zgjedh fort mjetet. E këto doke kush i mbanë në kambë? Burrat që këndohen në kangë trimash, si Zeka! Këtij, gjaja ma e vogël që mund t'i bante, ishte një proces.<sup>256</sup>

Artikulimi i Gjyqtarit të nxit të bësh një krahasim me rrëfimin që bën personazhi, Doda te Novela *Gjaku*:

Unë jam i mëndimit qi, ndër shkolla fillore nemos, duhet të marrim para sÿsh prirjet e mira e të kqija qi ç' do kalamâ shqiptar ka trashigüe, bashkë me gjak prej të parve. Mbi to duhet të punojmë, tue u përpjekë me shrranjosë të këqijat e me drejtue përdorimin e të mirave kah një qëllim njerzuer.<sup>257</sup>

Me sa duket në rastet e nënvizuara më sipër kemi të bëjmë me një element intertekstual, pra me referimin në mungesë, *aluziv*, megjithëse mund të jetë krejt e rastësishme kjo marrëdhënie ndërmjet teksteve, megjithatë është tematika a fryma e përgjithshme e të dyja teksteve që e sendërton këtë përqsje mes tyre.

Edhe Doda te novela *Gjaku* sikurse Gjormi ka si qëllim diagnostifikimin e psikikës dhe të mendësisë shqiptare, për të parë se ku çalon, e se si mund të ndryshohet - emancipohet ajo:

Mbas kthimit n'atdhë, kontaktet e shpeshta me klasat e ndryshme të popullit, konstatimi i padijes së mëndershme qi kapërthente mënt e shumicës, dëshiri që me i vjeftë disi vëndit të vet, e bânë me dalë prej asaj kulle fildishi ku e kishin ndrÿ studimet e gjata. U orjentue e i vÿni vetes një qëllim: me studjue, me dashunÿ e me kujdes, psiken shqiptare për me gjetë mandej mjetet mâ të shpejta të qytetnimit. E kishte nisë me bâ diagnozën e smundjeve të shpirtit shqiptar për me zgjedhë, mâ vonë, mjekimet mâ të fuqishme. Donte, po, donte shumë punë me bâ, por...<sup>258</sup>

Në rastet që përmendëm më sipër (të nënvizuara) nga të dyja tekstet, duket se kemi të bëjmë me atë që Natali Piazhe te *Poetika e intertekstualitetit* e quan një pikëtakim i përpiktë dhe mjaft i vogël apo një lidhje e dobët e parandjerë ndërmjet teksteve, të cilës është mjaft e vështirë t'i jepet një formë, pra një përcaktim përfundimtar<sup>259</sup>. Ne mendojmë se këtë lidhje a marrëdhënie vështirë të përcaktueshme në terma konkret e mundëson tematika e përbashkët që shtrihet në thellësi të teksteve,

<sup>256</sup> Martin Camaj. *Drama*. Përgatiti për botim Bardhyl Demiraj, Sh. Botuese "Onufri" Tiranë, 2012, f. 111.

<sup>257</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit, f. 27-28.

<sup>258</sup> Po aty, f. 45.

<sup>259</sup> Nathalie Piégay - Grosio. *Poetika e intertekstualitetit, Hyrje në intertekstualitet*. Përktheu: Urim Mërguti, Sh. Botuese "Parnas", Prishtinë 2011, f. 15.

megjithëse trajtohet, sendërtohet në mënyra, madje dhe gjini të ndryshme letrare.

Duhet shtuar këtu se, ky aspekt apo kjo përjasje krahasuese mes dy teksteve është element intertekstual. Pra, mund të themi se estetikës a teorisë së intertekstualitetit duhet t'i shtojmë si aspekt të saj in të domosdoshëm teoritë, a nocionet e letërsisë krahasues – kooperativiste, madje mund të themi se ajo lind si rezultat i krahasimit mes dy teksteve, apo si pasojë e vendosjes së marrëdhënieve të dukshme a të padukshme mes veprave letrare.

Personazhi i Dodës dhe Gjormit ngjasojnë dhe ndryshojnë në disa pika mes tyre: të dy kanë si qëllim emancipimin e shoqërisë, të dy dëshirojnë të zbulojnë rrënjët e së keqes, gjakmarrjes, vrasjeve për shpagim, degjenerimit të Kanunit, të dy vijnë nga një vend tjetër, njëri nga malësia në qytet, Doda, dhe tjetri nga qyteti, rikthehet te vendi i të parëve të tij, Gjormi, dhe kërkon të njohë problematikat e hakmarrjes, shpagimit, gjakmarrjes apo zezonave si ajo e Përronit të Mbyllë, për t'u çelë shtë shoqërisë, komunitetit se ku qëndron e keqja dhe ligësia; ndryshojnë në mes tyre për shkak se njërit i kanë vrarë gjyshin para një shekulli, Gjormit, ndërsa tjetrit i kanë vra vëllain, Dodës, i cili, i shtytur nga ambienti dhe mendësia e tij nxitet, detyrohet të vrasë për të marrë gjakun e të vëllait, Zekës. Përfundimi i Gjormit është optimist, së paku në aspektin personal, ndërsa përfundimi i Dodës është tragjik, dhe fatal, sepse nën presionin e opinionit të komunitetit ku jeton, detyrohet të vrasë gjakësin e të vëllait, e për këtë përfundon në burg, pra i shkatërrohen ëndrrat, dashuria, synimet dhe karriera. Nga sa thamë kuptohet se personazhi i Koliqit, Doda është mburjtur me nota të forta dramatike dhe tragjike, sidomos, që në momentin kur i vritet i vëllai, Zeka. Ndërsa Gjormi nuk karakterizohet as nga dramaciteti i lartë e as nga filli i tragjicitetit jetësor, duke qenë se, është dorëjashtë në ndodhinë dhe ngjarjet e Përronit të Mbyllë. Personazhin – karakterin e Dodës e ka realizuar me mjaft mjeshtëri Koliqi, sidomos sa i përket sendërtimit të aspektit psikologjik të tij, aq sa të krijon përfytyrimin se je përpara një personi real – malësori, e jo një figure letrare.

Gjithsesi, ndryshe nga novela *Gjaku* e Koliqit, e cila ka në qendër të subjektit të saj gjakmarrjen, te drama L. M gjendja paraqitet më e përkeqësuar e më e rrezikshme sesa te novela *Gjaku*, sepse tashmë situata e përballjes mes ligjit dhe *Kanunit* mes strukturave të vjetra dhe të reja, ku secili prej tyre zbehet, degradon, pra *Kanuni* ka degjeneruar e si pasojë pjellin zezona të vjetra e të reja, pa mundur t'u vihet dot fre vrasjeve për shpagim, që janë edhe më gjakderdhëse se ato për gjakmarrje që parashohin doket dhe zakonet ndër malësorë a ndër shqiptarë.

Gjormi: Teza ime ashtë: degjenerimi i kanunit çon në zezonë. *Gjyqtarit*. Struktura e vjetër ligjore në kundërshtim me rendin e ri, apo zëvendësimi vetëm i pjesshëm i Kanunit nga ligji ndërkombëtar kushtëzon zvetënimin e njenit apo të tjetrit ligj.<sup>260</sup>

Pra, nëse të novela *Gjaku* e Koliqit vrasjet mes dy fiseve kryhen për gjakmarrje dhe simbas rregullave kanunore te drama L. M e Camajt vrasjet kryhen për shpagim, në fshehtësi, në pabesi, në moh, në një rast mortor, pra në shkeleje të plotë të normave Kanunore, etike, morale dhe njerëzore. Nga ana tjetër te drama L. M ligji dhe *Kanuni* vihen në përballje e trajtohen me nota të forta komike, ironike, sarkastike dhe groteske, pra vihen në lojë, qeshen e përtallen që të dy, veçanërisht ligji dhe institucionet shtetërore. Kurse te novela *Gjaku* ligji dhe mosveprimi i institucioneve ligjzbatuese trajtohen jo pa nota ironie thumbuese që shkon drejt sarkazmës. Është pikërisht mosveprimi i institucioneve shtetërore dhe shoqërore që shpian drejt vrasjes së pashmangshme Dodën, madje të krijohet përfytyrimi sikur e kryen vrasjen edhe në shenjë revolte që ka ndaj tyre. Pra, Koliqi më shumë se te normat kanunore e vë theksin te shoqëria e kryesisht te paaftësia e institucioneve për të vepruar kundër fenomenit të gjakmarrjes, megjithatë edhe doket a normat kanunore nuk mbeten pa u stigmatizuar te novela *Gjaku*.

-Kam mujtë me ikë... U dorëzova pse due me pasë ndëshkimin për faj qi kam bâ e për me diftue para gjyqit se fajtorë mâ të mëdhâj në këtë vrasë, jeni ju, autoritetet!<sup>261</sup>

Ajo që të bie në sy është se ndeshim përdorimin e emrit Zekë te të dy autorët – tekstet që po marrim në analizë, megjithëse te L. M Zeka nuk vritet, siç ndodh me personazhin e novelës *Gjaku* të Koliqit, por përkundrazi është vrasës i paskrupullt. Mirëpo, është e qartë se te novela *Gjaku* emrit të personazhit nuk i vishet ajo aureolë konotative dhe denotative që ka te L. M, ku emri nga pikëpamja simbolike është i barasvlershëm me zezonë. Koliqi shumë më herët se Camajt e sheh gjakmarrjen të pashmangshme si pasojë e mendësive dokësore të futura thellë në subkoshiencën, psiken, mendësinë dhe shpirtin e shqiptarit nëpërmjet normave dhe kodeve të caktuara morale nga shoqëria që e rrethon.

Ç’do kalamâ shqiptar, në shpirtin e njomë të tij, ndër sa tjera, ushqen dy ndiesí qi janë karakteristike në gjithë popullin t’onë: ndiesín e shpagimit dhe atë të besës.<sup>262</sup>

<sup>260</sup> Martin Camaj. *Drama*. Vep., cit, f. 75.

<sup>261</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit., f. 59.



Mirëpo, duhet të shtojmë këtu se virtyti i besës te drama L. M, i mishëruar gjoja në karakterin e Zekës ka rënë, madje është nëpërkëmbur, sepse, ai vret në moh, pra në pabesi. Nëpërmjet këtyre elementeve, normave kanunore dhe etike që shkelen te drama L. M, Camaj sendërton linjën e çmitizimit, gjë që nuk e ndeshim te novela Gjaku e Koliqit.

Ndërsa, Camaj e sheh transformimin e shoqërisë sonë më të mundshëm, megjithëse jo pa nota pesimiste, madje fataliste. Camaj sikurse edhe Koliqi aspiratën për të ndryshuar dhe transformuar shoqërinë e sheh te brezi i ri i të shkolluarve, të mishëruar në karakterin Gjormi, ndërsa më herët Koliqi këtë aspiratë e mishëronte te personazhi i mësuesit, Dodës të arsimuar në perëndim. Ky i fundit si pasojë e shtytjeve të forta të familjes<sup>263</sup>, të shoqërisë dhe opinionit që e rrethonte, megjithëse ishte kundër hakmarrjes a gjakmarrjes, të cilën e quan jo rastësisht vrasje<sup>264</sup> në çfarë do lloj situate, “detyrohet” të kryejë vrasjen, pra të marrë gjakun e të vëllait, Zekës. Nën presionin e opinionit publik, të familjarëve të tij dhe mos veprimit të ligjit/shtetit, megjithëse brenda vetes orvatet t’i kundërshtojë<sup>265</sup>, në një moment kthese, të papritur, detyrohet të braktisë vlerat dhe pikëpamjet e tija morale, pikërisht në momentin kur opinionin i masës dhe mos veprimi i ligjit ia del ta thyejë zellin e tij, për të ndryshuar dhe tjetërsuar brezin e ri me mendësi të reja, si: falja, ligji, respekti i ndërsjellë e jo dhuna, shpagimi a hakmarrja.

-Fetejt – vazhdoi Malësori – nuk ruhen asnji fije. Nji punë ksi soji, në male t’ona, pasha Zotin s’ka ndodhë deri në sod. Vritet djali e gjaksi na del e na bân qejf: livron arët e veta, lëshon dhent në kullosë pa i hî ferrë në kâmbë. Po të kallëzoj, plaku tash të des shpejt prej idhnimit. – Po gjëndarmëri a s’ka n’ato ana a? Malësori hapi syt, i çuditun. Nji shprehje talljeje i u përshkue, si vetima, nëpër ta. Bâni: gjëndarmërija? Po ça ka me i bâ? Sa merr m’u afrue, Fetajve u shkon haberi tu shpia e gjaksi largohet nji

<sup>262</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit., f. 28.

<sup>263</sup> - mirë, apë, por shkolla â nji borxh qi do të kryhet... Plaku kishte heshtë, kishte thithë me forcë tymin e cigares e kishte thënë mbas nji copet: Ai borxhi qi po thue mos të bâjë me qitë mbas shpine nji borxh mâ të madh qi ke. [...]. – Mirë, shko: udhambarë të kjoftë. Por... nji amanet due me t’a lânë: në mos të pastë zhburrnue krejt shkolla, mos e lën pa krye at borxh i ke... Po aty, f. 37.

<sup>264</sup> - Gjaksuer nuk âsht ai që qet pushk për erz!, *i thotë nëna e Nushës, megjithatë ai i përgjigjet* – Gjakësorë janë të gjithë ata qi derdhin gjak njerit... po aty, f. 50.

<sup>265</sup> Mâ trimni âsht me mujtë shkaset e këqija të gjakut e me hypë sypri gjykimeve të gabueshme t’ambjentit për me ndëgjue zânet e kullueta të ndërgjegjes, se sa me vrâ nji njeri... po aty, f. 46.

sahat rrugë nëpër mal. Ulet prap, porsa kalon. Â tue bâ kokrrën e qejfit! Ka ndeshë...<sup>266</sup>

Më tej nën shtytjen e ambientit që e rrethon, Doda ndërmendime shprehet:

Të tânë janë çue kundra meje... Bajraku murmuron tue thënë se deri më sod s'ka pasë pjestar qit ë ketë lânë gjak me hup... Apa â në short me mu sëmue prej idhnimit e ndoshta më nâm në zëmër të vet si djalë të bastardhuem... Don Shtjefni nuk më foli asnjë fjalë qi me m'a shtue qindresën... Drandosi i â mbushë mëndja se un s'bari kore e se do t'a bâj me doemos një punë... Të tânë kundra meje... Kurrkush s'm'a thotë një fjalë qi me m'a përtri fuqin e vullnetit.<sup>267</sup>

Megjithatë, personazhi i Camajt, Gjormi, juristi i ri ia del ta thyejë opinionin e masës, duke falur gjakun e gjyshit të vrarë prej Zekës në ndodhin e Përronit të Mbyllë. Nga ana tjetër edhe Mjeku, megjithëse i pashkolluar te drama L. M është kundër gjakmarrjes, pavarësisht se nuk ka pasur guximin të dalë hapur kundër normave zakonore dhe opinionit të masës:

Gjyqtari: Përse ke heshtue deri sot për atë që na kallzove rreth Përonit të Mbyllë?

Mjeku: Si të kisha tregue se kam qenë aty dhe e di se kush ma ka mbytë tim atë, do të më ish dashë ta vras Zekën për gjak...

Gjormi: Për çka e ke lanë pa ja marr gjakun t'yt et?

Zeka: Frika, frika! Dihet se mjekut nuk i ka lindë në zemër trimina! Dy-tri herë kam dashë t'i thom: kërkoje gjakun tek unë.

Gjormi: As unë nuk due t'ia marr gjakun gjyshit. Por askush nuk e ka ndalë mjekun të baj një trimni tjetër, të dalë ballafaqas e të thotë: nuk due shpagim e të ndjek doket e shëmtueme të tjera kohëve. *Kundërshtim në grupin e njerëzve.*<sup>268</sup>

Gjyqtari: A e sheh? Masa ka tjera mendime.

Gjormi: Masa në këtë rast ashtë kundër Zekës.

Kasapi: E kundër faljes së gjakut! []

Mjeku: [...]. Një njeri i cili vetëm ka vrojto, pa e çue dorën në armë mizore, si u kullon gjaku brijësh të plagosurve si atë ditë në Përronin e

<sup>266</sup> Po aty, f. 39.

<sup>267</sup> Mâ trimni âsht me mujtë shkaset e këqija të gjakut e me hypë syfri gjykimeve të gabueshme t'ambjentit për me ndëgjue zânet e kullueta të ndërgjegjes, se sa me vrâ një njeri..., f. 54.

<sup>268</sup> Krhs. Gjormi: Se e çaj unë kokën se kush ma ka vra gjyshin shekullin e kaluem!. Martin Camaj. *Drama*. Vep., cit, f. 20

Mbyllë, e megjithatë ka zemër e shpirt njerëzor me ba gjaqe tjera, mbas asaj dite, ai do zhdukë, të vritet po në këtë qast prej dorës së kasapit.<sup>269</sup>

Pra nga nënteksti i veprës lihet të kuptohet se fenomeni i gjakmarrjes apo shmangia e zezonave të tilla si ajo e Përronit të Mbyllë mund të shmanget vetëm nëpërmjet arsimimit dhe edukimit të brezit të ri, si dhe nëpërmjet ndërjegjësimit të individit dhe shoqërisë.

Camaj dhe Koliqi në një pikë mbajnë thujse të njëjtin qëndrim, e kjo ilustron në artikulet e ngjashme që bëjnë personazhet, Doda dhe Nusha te novela Gjaku: "Vetëm kultura i bân njerëz"<sup>270</sup>, si dhe Gjormi e Mjeku te drama L. M: "për të na ardhë era njeri, erë molle, po due me thanë, që t'i marrim vesh ligjet tueja, duhet të kalojmë të gjithë nëpër fambrikën e shkollës e të dijes"<sup>271</sup>.

Në rastet e nënvizuara më sipër përsëri kemi të bëjmë me një referim në mungesë, aluzion. Megjithëse në këtë rast shprehim bindjen se me shumë gjasa konvergimi mes dy teksteve është krejt rastësor, dhe vjen si rezultat i frymës së përgjithshme të teksteve në fjalë, apo bindjeve personale të Koliqit dhe Camajt. Nusha në fakt fjalinë e mësipërme e shqipton me frikë, thujse si mërmërimë, sepse Koliqi e quan fenomenin (ndjesinë e shpagimit dhe hakmarrjes) panshqiptarë, kurse Camaj thujse e ngushton disi shtrirjen gjeografike të fenomenit (vrasjeve për shpagim, hakmarrjes a gjakmarrjes), duke e lokalizuar fenomenin në visin e Përtej Drinit – pra në malësitë e Shqipërisë Veriore.

Mjafton një moment për të tronditur, madje shkatërruar lumturinë dhe çdo gjë që kishte ndërtuar dhe ëndërruar Doda me Nushën, pikërisht vrasja e të vëllait Zekës nga armiqtë e vjetër të tyre Fetejt:

-Ç'â zâni lum miku? – pyeti me shqetësim: Malësori përgjigji, me zâ t'ultë, tue i shtrî dorën: - Kjoshti vetë e tjetër e keqe mos të gjetët. Zeka ka dekë. Fetejt, anmiqt e vjetër të tyne, i kishin vrá vllán at ditë në mëngjes.<sup>272</sup>

Po ashtu edhe për Zekën te L. M një moment, pra ngjarjet e Përronit të Mbyllë në një farë mënyre e tjetërsojnë dhe shkatërrojnë dashur pa dashur atë, megjithëse ia ka dalë të mbijetojë, duke përdorur pabesinë, vrasjet në moh, dhe petkun e lypsarit.

Te drama L. M në qendër të subjektit dramatik është shtresëzimi i një serie gjakmarrjesh dhe vrasjesh për shpagim, kurse te novela *Gjaku* në

<sup>269</sup> Po aty, f. 97-100.

<sup>270</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit, f. 27.

<sup>271</sup> Martin Camaj. *Drama*. Vep., cit, f. 61.

<sup>272</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit, f. 35.

qendër të rrëfimit a subjektit letrar është historia gjakmarrjeve ndërmjet dy familjeve a fiseve, pra familjes së Dodës dhe Fetejve.

Filli tragjik i jetës i përshkon fund e krye të dyja tekstet që kemi marrë në shqyrtim dhe që jemi përpjekur t'i krahasojmë në një qasje analizues, aq sa të krijohet përfytyrimi se njëra vepër të shëmbëllen tjetrën sa i përket frymës së përgjithshme të veprave, sigurisht në disa aspekte, jo në tërësinë e tyre. Gjë që përligjet në artikulumet e personazheve. Sa i përket këtij aspekti te novela *Gjaku* narratori na rrëfen:

Gjaku i tij, - gjaku i trrashiguem prej etënve luftarë qi s'kishin gëzue kurr një ças paqe, gjatë qindvjetëve të turbullta, - kishte et butësije, nevojë pushimi. I dukej se gjindej, tashmâ, jashta rrymës së mëndershme qi përllan jetën e Malsorve ndër gjaqe, ndër kryengritje, ndër luftime bajrak me bajrak; e njehte veten të projtun n'at oâzi të njomë e të ndritëshëm dashunije.<sup>273</sup>

Ndërsa te drama L. M, thuajse me të njëjtat nota tragjike Zeka na rrëfen:

Zeka: Edhe lules së kuqe ia ngjitëm emnin "lule gjaku". Sa mote kaluen, pesëdhjetë, the ti? Kështu na kanë kalue vjetet tue u grindë si derra ndër veti, njëqind e pesëdhjetë, treqind e ma shumë.<sup>274</sup>

Kësisoj të krijohet përfytyrimi sikur Gjormi përfundon rrugën e nisur nga Doda, thënë ndryshe nxënësi, Camaj përfundon rrugën e nisur nga mësuesi, Koliqi aq më tepër po të kemi parasysh faktin se Koliqi e ka quajtur novelën *Gjaku* një ndër kryeveprat e tij. Megjithëse në forma, ide, linja, trajta e gjini të ndryshme letrare. Në këtë logjikë me sa duket ka të drejtë Julia Kristieva, e cila kur flet për intertekstualitetin, thekson se "autorët nuk i krijojnë tekstet nga mendimet/idetë e tyre origjinale, por më tepër i përpilojnë nga tekstet që kanë ekzistuar më parë"<sup>275</sup>, pra Camajt novela *Gjaku* e Koliqit, elementet dokësorë – Kanunore dhe shënime mbi lëndën i kanë shërbyer po të përdorim një term të Gerard Genette (Zherar Zhenet) si hipotekst, të cilin e përkufizon te *Palimpsest si: "Hipertekstualiteti përkufizon çdo marrëdhënie e cila lidh një teks B (hiperteksti) me një tekst A (hipoteksti), nga i cili ai rrjedh; ky hipertekstualitet dërgon tek një marrëdhënie jo përfshirjeje, por shartimi"<sup>276</sup> dhe parateksti – paratekstualiteti, i cili "dërgon tek çdo*

<sup>273</sup> Ernest Koliqi. *Hija e maleve*. Vep., cit, f. 33.

<sup>274</sup> Martin Camaj. *Drama*. Vep., cit, f. 14.

<sup>275</sup> G. Allen. *Intertextuality*. "Routledge", London- New York, 2000, p. 35.

<sup>276</sup> Nathalie Piégay – Grosio. *Poetika e intertekstualitetit, Hyrje në intertekstualitet*. Vep., cit, f. 25.

*marrëdhënie që një tekst mban me paratekstin e tij*<sup>277</sup>, për sendërtimin e dramës L. M.

Duhet të shtojmë këtu se këto elemente që i vendosëm në qasje krahasuese mes dy veprave disa prej tyre i përkasin poetikës së intertekstualitetit.

Po t'i referohemi klasifikimit që bën teoricieni francez Laurent Jenny (Laurent Xheni) disa vepra janë plotësisht intertekstuale, të cilat ngërthejnë në vetvete imitim, parodinë, montazhin, ngjitjen etj., dhe nga ana tjetër ka vepra ku lidhjet intertekstuale nuk paraqesin rëndësi parësore<sup>278</sup>. Nisur nga kjo mund të themi me bindje të plotë se tekste dramatike të Camajt i përkasin rastit të fundit, në qoftë se i marrim si të mirëqena rastet që sollëm - analizuam si dukuri intertekstuale. Në rastin tonë, *“interteksti nuk është i përbërë nga një ndërfaqje e përcaktuar e një teksti në një tekst tjetër”*<sup>279</sup>, por një përjasje deri diku tematikash, siç është ajo e gjakmarrjes, e mbi të gjitha devijimesh a *rishkrimesh*, si: linja e çmitizimit, vrasjet për shpagim, elementet komike dhe groteske, metateksti, metadrama etj., pra, *“hamendësime për ngjashmëri”*.<sup>280</sup> Nga sa thamë, duket se Camaj po të përdorim një term të Claude Levi-Straus (Klod Levi-Stros) të cilin e shpreh te *Mendimi i Egër, bubërron*<sup>281</sup>, e thënë kjo jo në kuptimin plezhorativ të fjalës, por në kuptimin që përdor një sërë mjeshtrësh, *veglash* çfarëdo, dhe që është i aftë të kryejë me ta një sërë detyrash të cilat ia ngarkon puna e krijuesit. Pra, siç shprehet Tzvetan Todorov: *“arti nuk është riprodhim i një “realiteti”, ai nuk e pason atë duke e imituar; ai kërkon cilësi krejt të ndryshme dhe të qenët “autentik”, madje mund të dëmtojë [...] në fushën e artit, asgjë nuk është paraprake për veprën, nuk është origjinë e saj; vet vepra e artit është origjinale, e vetmja gjë parësore është dytësorja”*<sup>282</sup> sepse *“qysh nga çasti kur dikush shkruan, ai nuk i qëndron më “besnik” tekstit të parë”*.<sup>283</sup>

Fundja mund të themi pa frikë se, marrëdhëniet e afrisë a ngjashmërisë mes teksteve letrare apo mes miteve, përrallave, legjendave sidomos brenda llojit është po aq e lashtë ndoshta sa vetë njerëzimi, pra që

<sup>277</sup> Po aty, f. 23. Shih për më shumë po aty, si dhe te Gérard Genette. *Seuils* (Pragje). France, Le Seuil 1985.

<sup>278</sup> G. Allen. *Intertextuality*. Ibidem, f. 113.

<sup>279</sup> Nathalie Piégay – Grosio. *Poetika e intertekstualitetit, Hyrje në intertekstualitet*. Vep., cit, f. 19.

<sup>280</sup> Po aty, f. 19.

<sup>281</sup> Claude Lévi - Straus. *La Pensée sauvage, La science du concret*. Plon, 1962.

<sup>282</sup> Tzvetan Todorov. *Poetika e prozës*. Përkthyen: Gjovalin Kola dhe Anton Papeleka, Panteon, Shtëpia e librit, Tiranë, 2000, f. 99.

<sup>283</sup> Po aty, f. 53.

nga rrëfimet e para totemike, mitike apo te veprat e para të dokumentuara si *Epi i Gilgameshit* apo *Iliada* e Homerit. Dihet se edhe këto tekste i referohen një tradite pararendëse gojore a shkrimore qoftë ajo, pra iu drejtohen miteve a disa miteve njëkohësisht, e kjo në një farë mënyre po ta shohim hollë-hollë mund të quhet marrëdhënie ndërtekstuale, ndërjgjinore, transtekstuale, pra intertekstuale apo si do që ta pagëzojmë, aq më tepër po t'i referohemi pohimit që bën Roland Barthes (Roland Bart) i cili te *Teksti, teoria e*, shkruan: “koncepti i intertekstit është ajo çka i sjellë teorisë së tekstit vëllimin e shoqërueshmërisë: është tërë gjuha, e përparme dhe bashkëkohore, ajo që vjen tek teksti jo nëpërmjet një lidhjeje të drejtpërdrejtë të vrojtueshme, një imitimi të vullnetshëm, por nëpërmjet një shpërhapjeje”.<sup>284</sup> Vladimir Prop dhe studiues të tjerë të përrallës, miteve a legjendave kanë vërejtur jo rastësisht struktura të ngjashme mes përrallave, a miteve të ndryshme, së paku sa i përket konstruktit, por edhe në tematika e motive sidomos në formulat hyrëse, si: *na ishte një herë një kohë; na ishte njëherë një djalë*, etj.<sup>285</sup> Pra, popuj të ndryshëm kanë përralla të ngjashme me njëri-tjetrin në struktura apo disa elemente strukturore të ndërtimit të tyre, si dhe në motive, në një farë mënyre po ta shohim hollë-hollë edhe kjo dukuri është një farë intertekstualiteti. Nga sa thamë duket se intertekstualiteti ka qenë gjithmonë aty si dukuri letrare, thjesht shekujt e fundit e kanë pagëzuar, apo e kanë shndërruar në model të pastër shkrimor – poetik. Deri këtu asgjë e re nën këtë diell.

## BIBLIOGRAFIA

- Arjeta Ferlushka. *Pasqyrat e postmodernizmit*. Sh. Botuese “Onufri”, Tiranë, 2012.
- G. Allen. *Intertextuality*. “Routledge”, London- Neë York, 2000.
- Laurent Jenney. *La stratégie de la forme*, Poétique, nr. 27, 1976.
- Linda Hutcheon. *A poetics of postmodernism*. Routledge, London-Neë York, 1988.
- Martin Camaj. *Drama*. Përgatiti për botim Bardhyl Demiraj, Sh. Botuese “Onufri” Tiranë 2012.
- Nathalie Piégay – Grosio. *Poetika e intertekstualitetit, Hyrje në intertekstualitet*. Përktheu: Urim Mërguti, Sh. Botuese “Parnas”, Prishtinë, 2011.

<sup>284</sup> Roland Barthes. *Texte, théorie du*. Në: Encyclopedia universalis, 1973. Cituar simbas Nathalie Piégay – Grosio. *Poetika e intertekstualitetit, Hyrje në intertekstualitet*. Vep cit, f. 45.

<sup>285</sup> Vladimir Propp. *Morfologjia e përrallës*. Përktheu: Agron Tufa, Sh. Botuese “Pika pa sipërfaqe”, Tiranë, f. 100-136.

- Tzvetan Todorov. *Poetika e prozës*. Përkthyen: Gjovalin Kola dhe Anton Papleka, Panteon, Shtëpia e librit, Tiranë, 2000.
- Umberto Eko. *Për letërsinë*. Sh. Botuese “Dituria”, Tiranë, 2007.
- Vladimir Propp. *Morfologjia e përrallës*. Përktheu: Agron Tufa, Sh. Botuese “Pika pa sipërfaqe”, Tiranë.

### **Drama “Play of afternoon” M. Camaj’s and novels “Blood” of E. Koliqi: affinities and differences**

#### ***ABSTRACT***

In this article we will try to point out some affinities and differences between novel Koliqi’s *Blood* and the drama of Camaj’s *Play of afternoon*, as well as some elements of intersexuality - the reference in absentia - aluziv.

Martin Camaj in the drama L. M through the character of Gjorm attempts to transform the society, as well Koliqi to the novel *Gjaku*, who through the teacher Dodës tries to emancipate the environment in which he lives, perhaps the son of the same area as Gjormi, a man educated in the West, who becomes a prey/victims to canonical norms and legacies, thus encouraged and in a way forced to take the blood of his brother, Zeka, as a consequence of the morality that surrounds him, although he did not want bloodshed, even at school trying to teach children with concepts that contradict revenge or blood feud.

In the center of the dramatic actions of the drama L. M, unlike the Koliqi’s novel *Blood*, where the emphasis on blood feud is emphasized, in the case of Camaj the emphasis is on the aspect of the Kanun's degradation that leads to the rebellion, and the retribution killings, which the Kanun condemns or punishes.

Doda novels of *Blood* as Gjorm aims to diagnose the Albanian psyche and mentality, to see where sputters, how it can be changed - emancipate it.

The drama L. M at the center of the dramatic subject is the stratification of a series of blood feuds and revenge killings, while the novel *Blood* at the center of the story or the literary subject is the blood feud story between the two families or tribes, namely Dodë’s and Fetejve's family.

The tragic genesis/yarn of life runs through/pervedes both the texts we have considered and which we have tried to compare in an analytical approach so as to create the imagination that one act resembles the other in

terms of the general spirit of the works, of course in some aspects, not in their entirety.



Rokin DABERDAKU

## INSTITUCIONET QEVERISËSE NË QYTETET SHQIPTARE, GJATË MESJETËS

Termi “institucion“ ka një shumësi kuptimesh. Edhe prejardhja e tij etiologjike (lat, *institutio*-vendim, rregull, zakon, urdhër për të krijuar), tregon në të njëjtën kohë, veprimin dhe pasojën e krijimit<sup>286</sup>. Në pikëpamje të strukturës shoqërore e të organizimit politik, në Shqipërinë mesjetare ndesheshin dy lloje qytetesh, 1.qytetet e llojit italo-dalmatin dhe 2. ato të tipit bizantin. Që të dyja këto gëzonin një traditë të gjatë vetëqeverisëse, bartëse e së cilës ishin fillimisht një grup familjesh, që shquheshin për pasuri, prona e pushtet<sup>287</sup>. Gjatë gjithë periudhës së sundimit bizantin apo të sundimeve të tjera të huaja, të drejtat sovraane mbi qytetet i përkisnin kryezotit, që sipas rastit mund të ishte perandori bizantin, mbreti serb, mbreti i Napolit apo Republika e Venedikut. Këta e ushtronin sovranitetin nëpërmjet zyrtarëve të caktuar enkas prej tyre dhe që ishin njëherësh komandantë të ushtrisë dhe gjykatës. Në vitin 1166 në Krujë funksione të tilla kryheshin nga një *prior*, kurse në Durrës nga një *proteuon* (të dyja përkthehen “i pari,,). Në shek. XIII Ulqini dhe Tivari kishin në krye një *kont*. Në periudhën e fundit të sundimit serb të Stefan Dushanit (1332-1355) mjaft qytete kishin në krye *sebastin ose qefalinë*, që u korrespondojnë ofiqeve napolitane e veneciane të kontit e kapitenit (të shek.XIII-XIV). Në kohën e sundimit të despotëve serbë Llazareviçë (1421-1443), në Drisht, në Tivar e në Novobërdë kryezoti përfaqësohej nga *vojvoda*<sup>288</sup>.

Me shembjen e Perandorisë Serbe të Stefan Dushanit (1355), mjaft nga qytetet ranë në dorë të krerëve feudalë shqiptarë: Balsha (Shkodra, Drishti, Tivari, Vlora), Zaharia (Deja), Dukagjini (Lezha), Topia (Durrësi dhe Kruja), Gropajt (Ohri, Dibra), Muzaka (Berati, Kosturi), Zenebishi (Gjirokastra, Parga), Shpata (Arta) etj<sup>289</sup>. Në qytete, si Drisht, Shas e diçka më përpara në Prizren, pushteti laik ushtrohej në mënyrë të pazakontë nga

<sup>286</sup> A. Anastasi, “Historia e Institucioneve“. Tiranë, 2004. SHBLU, f. 11.

<sup>287</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Instituti i Historisë. “Historia e Popullit Shqiptar” I, Tiranë, Toena, 2002, f. 264.

<sup>288</sup> Po aty.

<sup>289</sup> Drmilan Shufflai. *Historia e Shqiptarëve të Veriut*. Prishtinë, 2009, Nositi, f. 29-35.

peshkopi i qytetit. Venediku solli një nomenklaturë të re në qeverisjen e qyteteve shqiptare pas vitit 1392, kur ai u bë zot i tyre. Në Durrës u vu të qeveriste bail-kapiteni, në Shkodër kont-kapiteni, kurse në Tivar e në Drisht qeveritari venecian quhej *podesta*. Gjithsesi, në kohën e sundimeve të huaja, posti i qeveritarit u besojë në ndonjë rast edhe vendasve. Kështu, më 1251 konti i Drishtit ishte një fisnik vendas; po përfaqësues i parisë lokale ishte me 1266 edhe kapiteni i Durrësit, Andre Vrana, që ishte caktuar në atë post nga kryezoti i radhës, mbreti Manfred Hohenshtaufen i Siçilisë. Përgjithësisht, sundimtarët e huaj përpiqeshin të fitonin simpatinë e parisë dhe të popullsisë së qyteteve, duke u përpjekur të harmonizonin interesat e veta me interesat dhe ndjeshmëritë e vendasve. Një nga lëshimet themelore, që kryezotë të ndryshëm u detyruan t'u bënin qyteteve shqiptare, ishte njohja deri në një farë shkalle e kuadrit juridik e institucional, që përbente thelbin e autonomisë tradicionale të tyre. Në Durrës e Vlorë e gjetkë dëshmohet mbijetesa e bashkësisë së qytetarëve (*universitas, comunitas*), që ishte forma më e gjerë e organizimit qytetar. Ishin pikërisht banorët e qyteteve me statusin e qytetarit, që në një ditë të caktuar të vitit mbledheshin dhe zgjidhnin nëpunësit komunalë. Në Shkodër mbledhja e qytetarëve bëhej ditën e Shën Markut, me 25 Prill, ku këmbanat thërrisnin popullin, ipeshkvin dhe 4 fisnikët të cilët bënin përzgjedhjen, e 3 gjyqtarëve, e 8 këshilltarëve dhe e 2 financierëve të komunës. Mandati i tyre ishte për një vit. Gjykatësit, këshilltarët, financierët bashkë me më të shquarit e qytetarëve (*boni Homines*) ishin anëtarët e një asambleje më të ngushtë, Këshillit komunal, thënë ndryshe qeveria e qytetit. Ky këshill kishte detyrë të zgjidhte një radhë nëpunësish, mes të cilëve *noterët* dhe sekretarit të gjyqit (kancelarët = *cancellarius*).<sup>290</sup> Ndër detyrat kryesore të Këshillit ishin; mbikëqyrja e rregulloreve të ndërtimeve, vendosja e gjobave për kundravajtje të ndryshme, jepnin lejet për eksportimin e ushqimeve, kontrollonin regjistrat doganorë si dhe u jepnin udhëzimet nëpunësve të përmbarimit. Gjykatësit e qytetit ishin njëkohësisht jo vetëm drejtuesit e sistemit juridik, por edhe një autoritet ekzekutiv me kompetenca të gjera në ushtri, ekonomi dhe administratë. Noterët në të shumtën e rasteve zgjidheshin me kombësi të huaj, për të shtuar shkallën e besueshmërisë së tyre. Për këtë qëllim, noterët rekrutoheshin jo rrallë edhe nga radhët e klerit. Në Durrës dualizmi kulturor-fetar pasqyrohej edhe në ekzistencën paralele të dy noteriave: noterë që i përpunonin aktet e tyre në latinisht dhe ata që i përpunonin në greqishten bizantine. Në Vlorë, si në

<sup>290</sup> F.Cordignano.Catastoveneto di Scutari e Rgistrum Concessionum 1416-1417, vëll II. Romë 1842-44.Tolmezzo, f. 234.

sundimin bizantin e serb, ashtu edhe në kohën e sundimit të Balshajve (1371-1418), ndër postet më të rëndësishme komunale ishte ai i *admiralit*, që tradicionalisht mbulohej nga një fisnik vendas. E njëjta gjë ndodhte në Durrës me postin e *protontinit*. Si admiral i ashtu edhe protontini, ishin komandantë të flotës së qytetit<sup>291</sup>.

Kaktimi i vulës së qytetit, i njësive të matjes e të peshave, ishin disa nga prerogativat kryesore të organeve bashkiake. Çdo qytet kishte vulën, masat e peshat e veta. Një nëpunës i posaçëm ishte i caktuar që çdo muaj të verifikonte saktësinë e tyre. Në Durrës masat dhe peshat e autorizuara mbanin vulën e qytetit. Statutet e Shkodrës parashikonin dënime të rënda për ata që përdornin masa peshe të falsifikuara. Në Durrës vula e qytetit vihej edhe mbi thasët e kripës, prodhimi i së cilës ishte monopol i bashkisë. Në Shkodër letrat që mbanin vulën e qytetit (*charta sigillata*) kishin vlerën e dokumentit autentik, njëlloj si aktet noteriale<sup>292</sup>.

Statutet ishin shprehja më e lartë e organizimit komunal të qyteteve shqiptare në mesjetë. Ato përmbledhnin akte normative që rregullonin në tërësinë e tyre organizimin dhe funksionimin e qytetit dhe marrëdhëniet midis qytetarëve, midis tyre dhe shtetit, midis vetë qytetit dhe ambientit rrethues. Nga të dhënat e deritanishme del se me statute ishin të pajisura Shkodra, Drishti, Durrësi, Tivari e Ulqini. Statutet e Durrësit u nxorën jashtë përdorimit dhe humbën gjatë sundimit të Topiajve në qytet (1368-1392). Disa vite pas kalimit të qytetit nën sundimin e Vendikut, më 1398-n, u gjetën 35 kapituj të këtyre statuteve, që ruheshin në kuvendin françeskan të qytetit<sup>293</sup>.

Statutet e Drishtit, të quajtura “Statutet dhe urdhëresat e kapitullit të kishës katedrale të Drishtit”, pasqyrojnë jetën e një qyteti. Titulli origjinal është “Statuta et ordinations capituli ecclesiae Chatedralis Drivastum”, që në përkthimin e shqipes së sotme, do të thuhet: “Statutet dhe rregullat/urdhëresat/ e ndara në kapituj të kishës katedrale të Drishtit” dorëshkrimi i të cilit ruhet në Bibliotekën Mbretërore të Danimarkës dhe mban datën 12 janar 1468, është shkruar nga kanoniku dhe noteri i Tivarit Simon Dromasys, i cili ka kopjuar tekstin e zyrtarizuar të vitit 1464, sikurse gjendej në librin e noterit dhe kanonikut të Durrësit Gjon Mauro. Në këtë kohë Pal Ëngjëlli ishte ndarë nga jeta, por konfirmimin ai e kishte bërë katër vjet më parë, duke zbatuar një urdhëresë papnore dhe duke certifikuar tekstin e shkruar nga kanoniku i Durrësit Mauro, i cili kryente dhe

<sup>291</sup> F.Cordignano.Catastoveneto di Scutari e Rgistrum Concessionum 1416-1417, vëll II. Romë 1842-44.Tolmezzo, f. 246.

<sup>292</sup> O.J.Schmitt. Arbëria Venedike 1392-1479. Tiranë, 2007, f. 414.

<sup>293</sup> Historia e popullit shqiptar....vep e cit, f. 265.

funksionin e sekretarit të arqipeshkvit të Durrësit, Pal Ëngjëllit. Në vitin 1456 Papa Kalisti III, i dha pëlqimin ipeshkvit të Sapës, Gjergjit, për reforimin e Statuteve të Drishtit, por vdekja e Papës Kalisti III, dhe e Ipeshkvit Gjergj në vitin 1459, bëri që ky zyrtarizim të mos njihej. Ndërkohë Papa Piu që pasoj Kalistin e III, mori disa lutje me shkrim nga autoritetet e katedrales së Drishtit që ky Statut të zyrtarizohej. Për këtë qëllim Papa Piu ngarkoi Pal Ëngjëllin dhe kryegjakonin e Shkodrës, domenikanin Manuel, që të vërtetonin nëse reformimi i mëparshëm i statuteve kishte nevojë për plotësime. Njohja zyrtare e vlefshmërisë juridike të tyre, në trajtën e reformuar, u bë me 21 nëntor 1464, në manastirin bendiktin të Shën Theodorit, në praninë e Pal Ëngjëllit, domenikanit Manuel, të fisnikut Gjergj Topia dhe të bujarëve e klerikëve të tjerë të krahinës. Vetëm fakti që kisha e Drishtit, në pragun e rrënimit të qytetit nga ushtria osmane, kishte statusin e një kishe katedrale, që përmendet qysh në titull të dorëshkrimit, dëshmon për një shkallë të lartë urbanizimi të qytetit dhe të rrethinave, të cilat në organizimin e atëhershëm kishtar, përbënin një dioqezë më vete. Si statut katedraleje është i vetmi në qytetet e bregdetit shqiptar, që e bën tepër të rrallë dhe njëkohësisht mjaft të rëndësishëm për historinë e krishtëritimit në Shqipëri. Ky statut është edhe unikal, pasi dy pushtetet si ai kishtar dhe shekullar ndodheshin në duart e peshkopit të qytetit. Ekzistenca e një statuti të tillë tregon se në Shqipëri, kishte qytete-komuna, të cilat ishin të organizuar sipas modelit të qytet-komunave të ngjashme të Evropës dhe nga ana tjetër, e drejta kanonike kishtarë zhvillohej duke u përshtatur me të drejtën dhe traditën vendase. Nderimi i shenjtorëve, kalendari i të kremteve dhe vëllazëritë tregojnë për rolin qendror që luante besimi në qerthullin e jetës qytetare. Zhvillimi i kushtetutave qytetare të Arbërisë ishte i ngadaltë në krahasim me Dalmacinë për të mos thënë pastaj me Italinë, kështu që kleri dhe kisha në Arbëri gëzonin një pozicion që ishte shumë më i rëndësishëm se ai i klerikëve dalamtë dhe italianë në komunat e tyre përkatëse. Pushteti i kishës mbështetej mbi kolona të ndryshme: në radhë të parë kisha ishte një shprehje e dukshme e besimit dhe pikë referimi për besimtarët. Më tej prezenca e saj në një shoqëri që thujse nuk e njihte shkrimin, përfaqësonte jo vetëm një forcë kishtarë, por edhe një pushtet shpirtëror: klerikët, sidomos ato me ofiqe të larta, kishin një arsimim relativisht të mirë, ndaj ishin mjaft të përshtatshëm për të formuluar të drejtën dhe interesat e komunës.

*Statutet e shumë të përshtatshmit qytet të Shkodrës.*

Zbulimi i statuteve të Shkodrës, përbën një ngjarje të një rëndësie të veçantë për historinë e popullit shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti për

historinë e qytetit tonë. Gjysma e dytë e shek. XIV do të shënojë një kthesë të madhe në lëmin fetar për Shkodrën, pasi Balshajt për të mos pasur asnjë lidhje fetare me Serbët u kthyen nga ortodoksë në katolikë. Kjo përbën një nga periudhat ku Shkodra njeh një shkallë zhvillimi si qytet-komunë autonome mesjetare. Pikërisht kjo shkallë zhvillimi dëshmohej me gjetjen në arkivat veneciane të Statuteve të Shkodrës Mesjetare, të cilat janë të hartuara sipas modeleve të qyteteve, si: Venecia, Milano, Ankona dhe përmbajnë parime perëndimore. Statutet, të cilat janë shkruar nga vitet 1300-1330 dhe kanë funksionuar deri në vitin 1479, ishin një dukuri e qytetit të organizuar në formën e tij më të lartë, në formën e komunës, pra e qytetit që vetëqeverisej nga ligjet dhe institucionet e veta, të zgjedhura nga asambleja e qytetarëve të lirë. Statutet e shumë të përshtirshmit qytet të Shkodrës, të cilat dolën në dritë në sajë të kërkimeve në Archivio Civico Correr Venezia, nga studiuesja e apasionuar dhe mikeshja e Shqipërisë, profesoresha Lucia Nadin, së bashku me G.B.Pellegrini, O.J.Schmid dhe Gherardo Ortalli<sup>294</sup> sollën në ditët tona një qytetërim që ndonëse llogaritet 7 shekuj me parë, gjithnjë do të mbetet një model i vyer i organizimit shoqëror. Libri përmban 279 nene statutore të qytetit të Shkodrës, ku 268 janë krerë ose nene origjinale dhe 11 krerë janë shtesë. Te 268 krerët i përkasin dhjetëvjeçarit të parë të shek.XIII, ndërsa 11 krerët e tjerë janë shtesa të viteve 1392-1479. Statutet u zbuluan nga një shqyrtim i kujdesshëm i të dhënave bibliografike të Leone Fontanes, në punimin e tij të vitit 1907, “Bibliografia statutaria”. Ndonëse objekt i studimit të tij ishin statutet e komunave italiane të shek. XIV, në një zë bibliografik shënohej; “Scutari (Albania) Statuto di Scutari. Ms. Museo Civico Correr Venezia”. Pas një pune të lodhshme katërvjeçare, që lidhej me shqyrtimin me kujdes të çdo flete, gjurmuesit arritën në konkluzionin se kishim të bënim me një “monument të Shqipërisë mesjetare” siç do të shprehej Oliver Schmid. Madje, do të shprehej Gherardo Ortalli, këtu kemi të bëjmë me një realitet shqiptar që do të shërbente si burim lëndor për historinë e brigjeve të Adriatikut, lidhjeve të tyre me Venedikun, si dhe të marrëdhënieve që ekzistonin midis komunave të rajonit dalmatin,<sup>295</sup>.

Tek sa i hedhim një vështrim librit, mendja na shkon tek një zbulim tjetër i rëndësishëm i kryer në vitin 1853 nga J.G.Han jo në arkiva, por në “zemër të maleve”, ku njoftonte se në zonat e Shqipërisë Veriore ishte ende në fuqi një “kanun popullor” me ermin “Kanuni i Lek Dukagjinit”.

<sup>294</sup> Lucia Nadin. *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XIV me shtesat deri me 1469*. Onufri, 2010.

<sup>295</sup> Po aty, f. 28.

Ndonëse të dy zbulimet flasin për kode mesjetare, njëri i ruajtur përmes shkrimit dhe tjetri në formë gojore, statutet e Shkodrës përfaqësojnë tekstin më të vjeter legjislativ të prodhuar në territorin shqiptar deri më sot. Statutet tregojnë se “vend i shqiptarëve” dhe i “kulturës së maleve”, shpeshherë të përdorura me keqdashje nga të huajt, nuk i kanë munguar as qendrat e zhvilluara urbane dhe as komunat bashkëkohore. Zbulimi i statuteve është një dëshmi e shtresëzimit të kulturave civilizuese të cilat kanë kaluar përmes traditave shekullore.

Statutet në fjalë, janë në dorëshkrim. Ato janë shkruar në 40 fletë nga Marin Dulciku<sup>296</sup>, që ndonëse jo krejtësisht e sigurt, mendohet të jetë sllav. Marin Dulciku në rolin e një transkriptuesi dhe shkruesi të statuteve pohon të ketë kopjuar origjinalin e hershëm (rreth vitit 1346), që ndodhej në Arkivat e Këshillit të të Dhjetëve të qytetit lavdiplotë të Venedikut. Ndonëse dorëshkrimi i Dulcikut nuk është i datuar, profesoresha Nadin e percakton atë të shek. XVI, pra të një periudhe të mëvonshme, pas rënies së Shkodrës në duart e turqve në vitin 1479, duke u bazuar në grafikun e



përdorur dhe në emblemen e qytetit të punuar në akuarel që u paraprin statuteve<sup>297</sup>. Emblema e qytetit e zbukuruar nga njëra pjesë prej një shqiptarje të zezë triumfuese (shenja perandorake e Romës), risjell të kaluarën e lavdishme të qytetit gjatë viteve të mesjetës, ndërsa pjesa tjetër e simbolikës në të majtë, paraqet një qenush në pozicion skllavërues, që mban në gojë një koc, që është i shoqëruar nga një zbukurim në të cilin shkruhet FATIS CEDO (i nënshtrohem fatit), që simbolizon rënien e Shkodrës nën pushtimin turk. Statutet e Shkodrës siç vërehet edhe nga studiuesit, janë shkruar nën

ndikimin e komunitetit shqiptar që ishte vendosur në lagunën venedikase që

<sup>296</sup> Lidhur me këtë temë mbetet themelor studimi: A. Ducellier “*La façade maritime de L’Albanie au moyen age. Durazzo et Valona du XIau XV siècle*”, Selanik, 1981.

<sup>297</sup> Një paraqitje e parë e dorëshkrimit u bë në kuadrin e organizimit të një kuvendi, për të nderuar Carlo Tagliavini-n në Shkodër, në dhjetor të vitit 1996; citoj referencat e L-Nadin.Za, *Sugli antichi statuti di Scutari*, në vëllimin, *Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Shkodër, 1997.

në vitet 1442 dhe që u forcuan pas viteve 1500 ku arritën të krijojnë “shkollën shqiptare”, një shkollë e arteve të mjeshtërisë që rivalizonte shkollën dalmate të krijuar aty<sup>298</sup>.

Hartimi i Statuteve të Shkodrës është i lidhur me pushtimin serb të qytetit. Ato janë një përpjekje e qytetit për të ruajtur autonominë dhe në të njëjtën kohë janë pjesë e pandarë e statuteve të qyteteve të zonës dalmatine. Statuti i Shkodrës përbëhet nga 278 “Capituli”, të cilët janë të renditur në bazë të përmbajtjes sipas blloqesh tematike. Pas disa kapitujve hyrës që kanë të bëjnë me të drejtën shtetërore, vijon një radhë e gjatë dispozitash për ndërtimin e shtëpisë, pronësinë dhe qiratë e shtëpive, mbajtja e mullinjve, furrave dhe tavernave. Një pjesë e dytë përmban përcaktime lidhur me punën në ara, në vreshta dhe në pemtore. Pastaj vijon kapitulli kushtetutës së mirëfilltë të qytetit së bashku me asamblenë popullore, këshillin, gjykatësit dhe procedurat gjyqësore, pozita juridike e klerikëve dhe ipeshkvit. Mjaft të hollësishëm janë paragrafët në lidhje mbi të drejtën civile dhe atë penale.

Studiuesit vërejnë se midis statuteve të Shkodrës dhe të Kotorrit ka ngjashmëri në pak nene. Statuti i Kotorrit i vitit 1300, mund të ketë ndikuar në statutin e Shkodrës, por jo në atë masë sa statutet e Shkodrës të kenë ndikuar në statutet e Budvës dhe në Zakonikun e Stefan Dushanit. Sipas studiuesve, statutet e Budvës të viteve 1349-1351, janë ndërtuar sipas modelit të Shkodrës, ku mjaft kapituj të statuteve janë pasqyruar përgjithësisht<sup>299</sup>. Po kështu edhe Zakoniku serb, ka qenë i ndikuar nga statutet e Shkodrës, duke e kthyer atë si një model të fuqishëm legjislativ për të gjithë rajonin. Statutet sipas G.B Pellegrini, janë të shkruara në gjuhën Veneto-veneciane dhe dialekti i përdorur është dalmato-jugor ose siç njihet ndryshe “labeatico”. Këto statute shërbenin si një garanci e rëndësishme apo kushtetutë për një jetë normale të komunitetit kristian të qytetit të Shkodrës.

---

<sup>298</sup> Statutet ... ..vep e cit, f. 114-115.

<sup>299</sup> A. Pertusi, Per la storia di Dulcigno nei secoli XIV-XV e dei suoi statute cittadini, në “Studi Veneziani”, nr. 15, viti 1973, f. 231-271.

**Governmental Institutions of Albanian Countries  
During the Medieval period**

***ABSTRACT***

The Albanian historiography, the traditional one and the actual one have discussed and still discuss that until the period of European Renaissance, urban communities had reached and preserved a constant level of development toward the other communities beyond the Adriatic. This synchrony of mental and physical development of Albanian territory during the period of Arberesh tribes' contact with Europe and more closely to the Adriatic basin, was a high privilege to the national tradition as a whole. One of the most important facts that prove the involvement of Albanian territory in this big era, which was characterised as "the era of European humanism" and was fully preceded by two centuries of Persian Classical Renaissance, is the existence of traditional statutes of these countries. Churches were considered as basic acts of public rights, and the regulation of the local life for a considerable amount of Albanian countries of pre-osman and middle-ages period. These statutes prove a developing phase of social life and these statutes express the increasing role of common elements i.e secular and religious, in the administration of provinces of Arberesh tribes especially of those who were mostly exposed toward the influence of a relation along the coastal line of Albania. A century ago, from the foreign Albanologues, in the historical and ethnographical Albanian publications, there was no lack of attention in the studying of Kanun's Rights post-medieval meanwhile statutes were not so much mentioned or were totally avoided. There were two or three skipping sentences which were contradictory from one text to another.



Anelmo SPAHIJA

## LUFTËRAT TURKO-MALAZEZE DHE RAJONI I SHKODRËS (1852-1856)

### Hyrje

#### 1. Sistemi tradicional osman i rekrutimit në zonat kufitare dhe ngritja e Malit të Zi.

Në luftërat turko-malazeze Shkodra dhe hinterlandi i saj luante një rol të rëndësishëm, pasi vetë fronti i luftimeve shtrihej në kufijtë veriorë të sanxhakut të Shkodrës. Rekrutimi ushtarak tradicional osman realizohej përmes bajraqeve, që përfshinin njësi administrative apo komunitare lokale, shpeshherë autonome në krye të të cilave qëndronte bajraktari apo flamurtari, i cili në këmbim të privilegjeve dhe të drejtave që i garantoheshin komunitetit që ai drejtonte, duhej t'i përgjigjej thirrjes së Portës së Lartë për luftë, duke rekrutuar burrat e aftë për luftë në krahinë. Për sa i përket qytetit të Shkodrës, ky i fundit në shek. XVIII-XIX ndahej në 14 bajraqe, që përfshinin secilën lagje të qytetit: Tophanë, Rus i Madh, Rus i vogël, Ndocej, Parrucë, Perash i Vogël, Perash i Madh, Dudas, Ajasëm, Bahçallek, Qafë, Kuç, Tepe, Bërdicë. Lufta shpallej me anë të një dekreti të sulltanit dhe lajmërohej zakonisht me tre të shtëna topi në kala. Pas lajmërimit bajraktarët vraponin pranë xhamive të lagjeve të tyre ku hapeshin flamujt që i kishin të dorëzuar nga shteti osman. Të gjithë ata që ishin ishin të aftë për luftë ishin të detyruar të mblidheshin nën flamurin e bajraktarit të tyre. Ata të cilët ishin të paaftë për armë ose të sëmurë paguanin një shumë të hollash, që quhej “bedel”, të cilën ia dorëzonin pleqësisë së lagjes. Me të hollat e bedelëve transportoheshin municionet e ushqimet e ushtrisë vullnetare. Në sheshin e betejës të gjithë bajraqet do të mbanin rendin e caktuar. Barjak i parë në Shkodër deri me ardhjen në fuqi të Bushatlinjve ishte Tabaku, më pas u caktua Tophana. Ndërkohë që në malësi vendin e parë e zinte Gruda<sup>300</sup>. Një rëndësi të veçantë për sanxhakun e Shkodrës kishte kalaja e Shpuzës, 14 km në veri të Podgoricës, pikë e fortifikuar që mbronte rrugën Padgoricë-Shkodër, e po ashtu ishte pika e grumbullimit nga ku niseshin ekspeditat ndëshkuese ndaj Malit të Zi.

<sup>300</sup> Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet* (Vëllimi I), Rozafa, Shkodër, 2015, f. 64-45.

Për sa i përket Malit të Zi, ky i fundit deri në gjysmën e dytë të shek. XVII nuk përmendet për një rol të rëndësishëm politik. Pas vendosjes së pushtimit osman në 1499-n fiset malazeze u vendosën nën autoritetin e manastirit të Cetinës në malin Lovçen. Duke filluar nga shek. XVIII, ky post u mbajt nga një pjesëtar i familjes së Petroviçëve, që i përkiste bashkësisë fisnore të Njægushit. Mali i Zi doli si faktor në skenën politike në periudhën e luftës së Lidhjes së Shenjtë (Austri, Venedik, Poloni), 1683-1699, kundër Perandorisë Osmane, e më pas në luftërat e tjera që bënë Venediku dhe Rusia e Pjetrit të Madh. Në këto luftëra bashkësitë fisnore të Malit të Zi, së bashku me ato të Shqipërisë Veriore ngritën krye dhe luftuan në anën e shteteve kristiane. Kjo i dha mundësi Malit të Zi që për herë të parë të shfaqej si faktor në arenën ndërkombëtare. Këtu ndikuan gjithashtu edhe marrëdhëniet e ngushta të vendosura me Venedikun dhe Rusinë. Venediku vendosi për njëfarë kohe edhe një lloj protektorati mbi Cetinën, ku imponoi në vitin 1717 vendosjen e një guvernatori, që do të caktohej nga familja e Radojiçëve, dhe do të ushtronte pushtetin politik përkrah peshkopit. Pas dobësimit të fuqisë politike të Venedikut në gjysmën e parë të shek. XVIII, Mali i Zi vendosi marrëdhënie të ngushta politike me Rusinë. Afirmimi i Malit të Zi erdhi sidomos pas luftërave me Karamahmut pashën e Shkodrës, i cili donte t'i zgjeronte sundimet e tij edhe në territoret e Malit të Zi në vitet 1787-1796. Në këto vite Austria dhe Rusia ishin të angazhuara në luftërat e koalicionit evropian kundër Francës revolucionare, kështu që Mali i Zi dukej i izoluar në planin diplomatik, gjë që nxiti më tej pashain e Shkodrës për fushatën e tij. Mirëpo, malazetët rezistuan dhe e mundën Karamahmut pashën në betejën e Krusit, ku gjeti vdekjen edhe pashai shkodran. Pas kësaj, Mali i Zi aneksoi krahinën e Bërdës e cila kontrollohej nga bashkësitë Piperi dhe Bjellopavloviç<sup>301</sup>. Një rol të rëndësishëm, Mali i Zi i udhëhequr nga Pjetri I, luajti në luftërat napoleoniane duke mbajtur anën e Rosisë, madje në vitin 1806 arriti të marrë nga francezët përkohësisht Kotorrin dhe Budvën, të cilat u detyrua t'i lëshonte pas Traktatit të Tilsitit. Një periudhë zhvillimi dhe konsolidimi shënon gjysma e parë e shek. XIX, ku familja e Petroviçëve, e cila zotëronte gjithnjë postin e peshkopit arriti të suprimojë përfundimisht postin e guvernatorit, duke përqendruar në duart e saj të gjithë pushtetin fetar dhe laik. Zhvillime të rëndësishme shënuan hartimi i një kodi ligjor dhe vendosja e një gjykate qendrore. Gjatë sundimit të Pjetrit II u forcuan edhe më tej marrëdhëniet me Rusinë, e cila subvenciononte të gjitha pagat dhe shpenzimet shtetërore. Në vitet 1831-1832, kur Porta e Lartë ishte në

<sup>301</sup> Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, Përpjekja, Tiranë, 1999, f. 89-93.

vështirësi për shkak të luftërave me Mehmet Aliun e Egjiptit, Pjetri II filloi sulmin në perëndim drejt Shpuzës dhe Podgoricës e në lindje drejt Grahovos. Megjithëse nuk arriti t'i mbante këto territore, në vitin 1842 u arrit marrëveshja që Grahovoja të shpallej si territor neutral, gjë mjaft me rëndësi kjo për sigurimin e kufijve lindorë të Malit të Zi. Kështu për një periudhë prej një shekulli e gjysmë, Mali i Zi megjithse de jure ishte akoma i nënshtruar ndaj Portës së Lartë kishte arritur të zgjeronte territoret e tij nga një hapësirë gjysmë autonome rreth Cetinës dhe Lovçenit, nga territori në jug të Grahovos në veri e deri në afërsi të liqenit të Shkodrës në jug, e nga territoret e Bërdës në Lindje deri në afërsi të Kotorrit<sup>302</sup>. Do të ishin pikërisht pasardhësit të Pjetrit II, Danilloja dhe princi Nikolla ata që do t'i shfrytëzonin fitoret e paraardhësve të tyre për një ofensivë të ngadaltë, por të përhershme drejt territoreve osmane.

### 1. Lufta turko-malazeze e viteve 1852-1853

Marrëdhëniet turko-malazeze u acaruan sërish në vitin 1852 me shpërthimin e kryengritjeve në Hercegovinë. Në kuadër të reformave të Tanzimatit që synonin një centralizim të mëtejshëm me qëllim rritjen e efikasitetit administrativ dhe ushtarak të strukturave shtetërore osmane, Hercegovina u integrua në vilajetin e Bosnjës. Ndërkohë, gjenerali turk Omar pasha vendosi çarmatimin e popullsisë vendase, gjë që i nxiti krahinat e Grahovos, Banjanit dhe Drobnjacit të refuzonin të paguanin haraçet tradicionale. Kjo çoi për rrjedhojë në ndërmarrjen e një fushate ndëshkuese në dhjetor të vitit 1852 nga ana e Omar pashës. Krahinat hercegovinase ku shpërtheu kryengritja shtiheshin në afërsi me kufijtë veriorë të Malit të Zi, e pikërisht vendosja e ushtrisë osmane së një territori të tillë kufitar do të përbënte kërcënim për Malin e Zi. Nga ana tjetër, princi Danillo shikonte në kryengritjen serbe të Hercegovinës një mundësi për të dobësuar Perandorinë Osmane e për të zgjeruar më tej territoret malazeze. Prandaj, Mali i Zi i shpalli luftë Portës së Lartë dhe ndërhyri në territoret e sipërpërmendura në favor të kryengritësve.

Veprimtarinë ushtarake të kësaj periudhe mund ta hulumtojmë përmes relacioneve të konsullit austriak të Shkodrës, Belarini, i cili i dërgonte rregullisht Vjenës njoftime në lidhje me frontin e luftës, sidomos në sanxhakun e Shkodrës. Me shpërthimin e luftës, përveç ushtrisë së përhershme të modernizuar pas reformave të Mahmutit II dhe atyre të Tanzimatit, vazhdonin të funksiononin edhe repartet e vullnetarëve redifë, të rekrutuar sipas bajraqeve siç e shpjeguam më lart. Në krye të trupave të

---

<sup>302</sup> Barbara Jelavich... f. 234-240.

rregullta ishte vetë Omer pasha me një ushtri prej 20000 ushtarësh, ndërkohë që në krye të trupave të parregullta të grumbulluara në Shkodër (nga Toskëria, bajraçet e malësisë dhe të qytetit) ishte Osman pasha, veziri i Shkodrës që do të sulmonte kufijtë jugorë të Malit të Zi drejt bashkësive fisnore të Kuçit dhe të Bërdës. Pjesa tjetër e trupave të parregullta ishin të përqendruara në Tivar nën komandën e Selim beut, komandantit të garnizonit të qytetit. Gjithsej trupat e parregullta arrinin në 10000 veta, që tregon se pavarësisht reformave për modernizimin e ushtrisë, përsëri ushtria osmane mbeti një ushtri e bazuar tek rekrutimi tradicional<sup>303</sup>. Shpeshherë këto trupa të parregullta kishin probleme të theksuara disiplinore gjë që e detyronte Omer pashën të kthente pas mjaft prej tyre:

*“Seraskieri prej kampit të Shpuzës e të Bjellopavllloviçit ktheu prapa rreth 3000 shqiptarë shkodranë e malësorë, turq e katolikë për arsye se nuk tregoheshin të bindur ndaj urdhrave të tij, si zakonisht me trupat e parregullta shqiptare që në mënyrë tekanjoze digjen të sulmojnë armikun nga lakmia e plaçkitjes, kurse Omer pasha kërkon në kamp bindjen më të verbër”.*<sup>304</sup>

Qëllimi i osmanëve ishte goditja ndaj Malit të Zi me ushtrinë e Omer pashës nga fronti i Shpuzës drejt Bjellopavllloviçit dhe Bërdës. Për këtë shpresohet tek qëndrimi i dyzuar që mbanin fiset e Kuçit dhe të Piperit, të cilët herë mbanin anën e Malit të Zi e herë atë të osmanëve. Gjatë viteve të fundit të sundimit të Pjetrit II, marrëdhëniet e tyre me Malin e Zi ishin përkeqësuar pasi Cetina, në kuadrin e reformave centralizuese dhe modernizuese kishte vendosur marrjen e taksave edhe ndaj këtyre bashkësive fisnore. Ndërkohë që në rajonet e Hercegovinës, armata e Bosnjës, pasi të thyente kryengritësit dhe repartet malazeze të bashkuara me to, duhej pastaj të marshonte drejt jugut për t'u bashkuar me ushtrinë e Omer pashës për t'i dhënë goditjen përfundimtare Malit të Zi, një rajoni që për dy shekuj me radhë i kishte shkaktuar telashe të vazhdueshme Portës së Lartë. Menjëherë pas kësaj do të shfuqizohej organizimi i mëparshëm me një administratë të vetme dhe me princin e vendosur rishtaz. Vendi do të copëtohej në komuna të veçanta secila me pleqësinë e vet në krye, ndërkohë që secili rreth malazez do të ketë si përfaqësues të vet një funksionar turk të vendosur në Shkodër dhe Mostar për t'i përfaqësuar pranë vezirit. Po ashtu do të vendosej edhe mbledhja e rregullt e taksave. Kjo përbënte skenarin e luftës dhe të pasluftës sipas Omer pashës.

<sup>303</sup> Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, dosja “1853-1857, 277, f. 77, Belarini-Ministrisë së shquar, 7 janar 1853.

<sup>304</sup> Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, dosja “1853-1857”, f. 274, Belarini- Ministrisë së shquar, 24 janar 1853.

Aksionet osmane filluan që në janar të vitit 1853 me marshimin e Omer pashës nga Shpuza drejt Bjellopavloviçit ku fillimisht u dërgua një repart prej 2000 shqiptarësh për të plaçkitur Marinoviçin. Më pas ushtria osmane, me një raport 10/1 me malazezët arriti të pastrojë rrugën drejt Bjellopalloviçit. Sulme të tjera pati me 14 janar kur 6000-7000 ushtarë turq, duke përfituar nga fakti se pjesa më e madhe e ushtrisë malazeze ndodhej në frontin hercegovinas, hynë në fshatrat malazeze të Kukurit, Limnjanit dhe Bjellpavloviçit, të cilat i plaçkitën para se të largoheshin. Konsulli austriak, Belarini përshkruan rezistencën e rreth njëqind trupave të mbetura malazezeze, mes tyre edhe gra e vajza të cilët luftuan për gjashtë orë, para se fshatrat e tyre të digjeshin e të plaçkiteshin. Pas kësaj u nënshtrua plotësisht Piperi, krerët e të cilit u dërguan si pengje në Shkodër. Po kështu, mjaft prej krerëve të Bjellopavloviçit e shpallën veten raja të Portës. Tashmë Omer pasha priste ushtrinë e Bosnjës e cila do të nënshtronte kryengritjen e do të bashkohej me ushtrinë e tij për t'u futur drejtpërdrejt në territoret e Malit të Zi. Më tej përmendet edhe mbërritja në front e rreth 200 redifëve nga Shqipëria e Mesme<sup>305</sup>.

Një moment kthese për luftën shënoi beteja e Godinjës, ku ushtria e rekrutëve të Selim beut marshoi nga Tivari drejt veriut për të zhbllokuar rrugën që shpinte drejt Cetinës. Mirëpo këtu ushtria malazeze arriti të dalë triumfuese duke i detyruar turqit të tërhiqen<sup>306</sup>. Një faktor tjetër në favor të Malit të Zi ishte edhe ndërhyrja ndërkombëtare. Megjithëse Omer pasha përpiqej të bindte majorin austriak Kalik se vendosja nën kontrollin osman të Malit të Zi nuk do të cënonte kufijtë me Austrinë, për të cilën do të përbënte problem forcimi i pozitave osmane në Ballkanin Perëndimor<sup>307</sup>. Po kështu, Rusia që njihej si një aleat tradicional i Malit të Zi, nuk do të pranonte që të likuidohej nga osmanët ky territor. Prandaj në shkurt u formua një komision i përbashkët austro-rus që do të ndërmjetësonte në negociatat për armëpushimin mes palëve. Komisioni obligoi tërheqjen e trupave osmane nga territori i Malit të Zi, ndërkohë që vija kufitare do të rikthehej në gjendjen fillestare. U nënshkrua gjithashtu edhe një protokoll që përcaktonte formalitetet e shkëmbimit të pengjeve etj.<sup>308</sup> Megjithatë, as ndërhyrja ndërkombëtare nuk i dha fund tensioneve kufitare. Ndërkohë që ushtria osmane po tërhiqej, u sulmua nga fiset e Piperit, të cilat zunë disa robër si dhe plaçkitën territoret përreth Podgoricës.

<sup>305</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 14 janar 1853, f. 277.

<sup>306</sup> Po aty, Belarini- Ministrisë së shquar, 23 shkurt 1853, f. 271-272.

<sup>307</sup> Po aty, Belarini-Ministrisë së shquar, 16 shkurt 1853, f. 272-273.

<sup>308</sup> Po aty, Belarini-Ministrisë së shquar, 2 mars 1853, f. 269-270.

## 2. Lufta e Krimesë dhe konflikti turko-malazez.

Armëpushimi turko-malazez zgjati jo më shumë se në fundin e vitit 1853. Në korrik të vitit 1853 shpërtheu Lufta e Krimesë (1853-1856) mes Ruisë nga njëra anë dhe Turqisë, në krah të së cilës u rreshtuan Franca dhe Britania e Madhe. Këto dy të fundit e shihnin si kërcënim ndikimin rus në Ballkan, dhe daljen e Ruisë në Mesdhe përmes vendosjes nën kontroll të Stambollit. Shpërthimi i luftës u shoqërua me trazira edhe në Gadishullin Ballkanik, pasi menjëherë Mali i Zi mbajti anën e Ruisë, ndërkohë që në territoret e Thesalisë e Thesprotisë shpërthyen kryengritjet greke. Prandaj në tetor të vitit 1853 edhe në sanxhakun e Shkodrës filloi mobilizimi për luftë. Urdhrat për mobilizim iu dërguan nga Stambolli vezirit të Shkodrës, si dhe komandantëve kufitarë të Tivarit dhe të Moraçës. Në Shkodër thirrja për mobilizim ushtarak lajmërohej përmes tri të shtënave me top nga kalaja e qytetit. Në këtë rast lufta kundër Malit të Zi do të zhvillohej përmes ushtrisë së parregullt të rekrutëve, pasi pjesa më e madhe e ushtrisë së rregullt ndodhej në frontet e Krimesë e të Danubit duke luftuar kundër ushtrive ruse.

Të parët që sulmuan ishin turqit të cilët ndërmorën raprezalje në zonën e Vasojeviçit të Bërdës, ku u dogjën disa shtëpi e u morën si pengje edhe mjaft gra e vajza që u dërguan në Gjakovë. Ndërkohë ushtria turke prej 10000 vetash ishte e përqendruar në Guci nga ku do të drejtoheshin sulmet e tjera ndaj Vasojeviçit. Konsulli austriak Belarini ngulmonte që Ballplatzi të ngulmonte pranë Portës së Lartë që të hiqte dorë prej sulmeve ndaj Malit të Zi, e po ashtu edhe tek princi Danilo që të mos kalonte në raprezalje, pasi gjithnjë qëndronte rreziku i një ndërhyrjeje franceze në favor të Portës<sup>309</sup>. Anglia dhe Franca në këtë periudhë mbanin gjithnjë anën e Portës së Lartë. Do të ishte pikërisht konsulli anglez Bonati, i cili do të mblidhte krerët kryesorë katolikë e ortodoksë të Shkodrës për t'i bërë të ditur se *“ishte ngarkuar prej qeverisë angleze t’iu kujtojë besnikërinë kundrejt sulltanit dhe të mos u vënë veshin ndikimeve për kryengritje...”*<sup>310</sup>. Po kështu edhe vizita e konsullit francez në Prizren do të pritej me shumë nderime (21 të shtëna me top) nga ana e autoriteteve osmane.

Megjithatë malazezët do të reagonin pas sulmit ndaj Vasojeviçit, në maj 1854-s me sulmin ndaj karvaneve osmane në rajonin kufitar të Shpuzës, si dhe në rrethet kufitare të Moraçës, ku rreth 400 malazezë

<sup>309</sup>Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 14 mars 1854, f. 265-266.

<sup>310</sup>Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 26 maj 1854, f. 264.

sulmuan rekrutët shqiptarë në vendin e quajtur Ura e Vezirit në afërsi të Velaberdes.

Megjithatë ushtria turke arriti ta nënshtrohte Vasojeviçin në shkurt të vitit 1855, pasi edhe malazezët i kishin braktisur pozicionet në frontin e Gucisë, duke u përqendruar në frontin e Shpuzës. Me një ushtri prej rreth 700-800 trupash, delegati i qeverisë lokale dhe majori i trupave ushtarake hynë në Vasojeviq ku morën edhe pengje. Në një situatë të tillë vasojeviçasit pranuan të paguanin edhe taksat e prapambetura prej 5 vjetëve Portës së Lartë. Pas sulmit Osman ndaj Vasojeviçit, nuk shënohen ngjarje të reja në frontin malazez të luftës, pasi për Portën prioritet tashmë merr fronti i Krimesë. Një faktor tjetër që ngadalësoi operacionet ushtarake drejt Malit të Zi ishin dhe problematikat e brendshme që u shfaqën në sanxhakun e Shkodrës gjatë viteve 1854-1856.

Ndërkohë në vitet 1854-1855 situata e brendshme në Shkodër përkeqësohet. Duke qenë se Shkodra përfaqësoonte një qendër të rëndësishme ku do të grumbulloheshin ushtritë osmanë, si problem kryesor në kohë lufte ishte problemi i strehimit të 12000 trupave të rregullta të Omer pashës, të cilat fillimisht u strehuan në lagjet e Tabakëve e të Bahçallëkut, por për shkak se këto vende ndodhen në vendin e bashkimit të Drinit dhe Bunës, nuk i plotësonin kushtet shëndetësore e higjienike për strehimin e një numri aq të madh ushtarësh. Prandaj, kampi ushtarak u zhvendos drejt veriut të qytetit në Fushën e Shtojit. *“Ajri atje është i pastër dhe ka sheshe të lira për stërvitje ushtarake, dhe është shumë afër ujit të rrjedhshëm dhe në pozicion të mirë të Drinasës”*.<sup>311</sup> Për sa i përket furnizimeve ushqimore për mbajtjen e ushtrisë, drithërat vinin nga Prizreni dhe nga vilajeti i Selanikut. Vendosja e ushtrisë së rregullt në qytet përbente një faktor pështjellimi, sidomos për popullsinë e krishterë të qytetit, pasi një pjesë e ushtarëve do të strehoheshin në lagjen kristiane Sarreq.

### **3. Trazirat sociale në Shkodër dhe rivaliteti austro-francez**

Gjendja e luftës permanente me Malin e Zi u shoqërua kështu edhe me pakënaqësi nga ana e popullsisë, sidomos e vegjëlisë shkodrane, e cila ishte kundër eksportimit të drithit në një situatë lufte ku rezervat e ushqimit ishin të pakta, e për pasojë kjo sillte edhe rritjen e çmimeve. Një arsye tjetër që çoi në zemërimin e vegjëlisë ishte detyrimi i popullsisë për të mbajtur me ushqime rreth 20 mijë ushtarët që ndodheshin në kufirin turko-malazez. Prandaj në gusht të vitit 1854 vegjëlja e Shkodrës, pa dallim feje ngriti

<sup>311</sup> Po aty, Belarini- Ministrisë së shquar, 28 nëntor 1855, f. 233-234.

krye. Kryengritësve, të cilët plaçkitën Pazarin dhe hapën depot e ushqimit, u printe sheh Shamia.<sup>312</sup> Kryengritja përbënte problem për autoritetet osmane në dy plane. *Së pari*, prishej kohezioni dhe stabiliteti social në sanxhakun e Shkodrës, në kufijtë e të cilit ndodhej fronti i luftimeve me Malin e Zi. *Së dyti*, kryengritja kishte gjasa të çonte në një përkeqësim të marrëdhënieve me Perandorinë Austriake. Kryesisht drithi që eksportohej, ndaj të cilit protestonte vegjëlja e Shkodrës, shkonte drejt zotërimeve habsburge. Nga ana tjetër gjatë ditëve të trazirave u plaçkit edhe dyqani i shtetasit austriak Xhorxh Brankoviç. Për rrjedhojë autoritetet osmane u treguan të gatshme të pranenin një ndërhyrje të trupave austriake për të paqësuar kryengritësit. Për t'i dhënë fund kryengritjes, me këshillat e austriakëve dhe konsullit francez, Porta e Lartë vendosi largimin e Osman pashës si guvernator të Shkodrës dhe zëvendësimin e tij me Reshit pashën.<sup>313</sup>

Një moment tjetër të dëmtimit të marrëdhënieve të Portës me Austro-Hungarinë shënuan konfliktet fetare që shpërthyen në Shkodër e në Podgoricë në maj-qershor 1856. Ortodoksët e Podgoricës kishin filluar ta rrethonin portën e hyrjes së kishës, duke ndërtuar mure rreth shyllave të drunjtave që mbanin çatinë. Kjo u vlerësua si fyerje dhe tejkalim i të drejtave nga krerët myslimanë të qytetit, të cilët nxitën popullin në kryengritje, e cila përfundoi me shkatërrimin e mureve rrethues të kishës ortodokse dhe plaçkitjen e saj. Konsuli Borovicka i kërkonte Ballplatzit një ndërhyrje të shpejtë tek autoritetet osmane, e cila do të bënte të mundur “*që simpatitë e theksuara të popullsisë sllave të provincave otomane për një fuqi tjetër të madhe evropiane (Rusia apo Franca) t'i drejtojnë kah Austria, e cila herët a vonë është e thirrur prej provanisë të përmbushë një mision të madh në këto vende*”<sup>314</sup>. Ai i kërkoi Atta pashës dënimin e komandantit të garnizonit të qytetit, Halil agës, që nuk kishte qenë i aftë të ndalte veprimet e turmave, e po kështu edhe të krerëve të tjerë të revoltës.

Edhe më e rënduar paraqitej situata në Shkodër, ku kundërshtimet për ndërtimin e seminarit jezuit u rishfaqën sërish. Përpjekjet e para për ndërtimin e seminarit kishin filluar në vitin 1843, por duke parë reagimin e krerëve vendas monsinjor Basili kishte pranuar rrënimin e tij. Jezuitët filluan përpjekjet përsëri me mbështetjen e papës dhe të Perandorit austriak, për vendosjen e seminarit në një shtëpi të vjetër shkodrane, së cilës filluan t'i ndërtojnë edhe një shtesë. Mirëpo, kjo nxiti sërish një kundërreagim nga

<sup>312</sup> ASHSH, *Historia e popullit shqiptar* II, Toena, Tiranë, 2002, f. 115-116.

<sup>313</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 16-21 gusht 1854, f. 253-256.

<sup>314</sup> Po aty, Belarini- Ministrisë së shquar, 3 qershor 1856, f. 215.



ana e popullsisë myslimane. Në krye të lëvizjes qëndronin krerë vendas, si: Hamza agë Kazazi, Hysen beu, Hasan Hoti etj. Për të evituar gjakderdhjen konsulli austriak propozoi që për tri ditët e Bajramit të pezulloheshin ndërtimet. Ai gjithashtu do t'i bënte të qartë Atta pashës, guvernatorit të qytetit si dhe Hamza agës se çdo reagim i dhunshëm ndaj ndërtimit të seminarit do të shkaktonte një ndërhyrje të Austrisë. Megjithatë përplasjet nuk u shmangën, pasi në ditët e para të qershorit, rreth 200 veta u shfaqën para seminarit duke tentuar të prishin murin. U desh edhe njëherë ndërhyrja e konsullit austriak Borovicka që turma të shpërndahej. Pas një aktiviteti të gjerë diplomatik dhe presionit që ushtroi flota austriake përmes bllokadës në bregdetin Durrës-Tivar, u arrit një kompromis mes austriakëve dhe Atta pashës që shtesa që po ndërtohej nga jezuitët të rrënohej me punëtorë të dërguar nga vetë autoritetet osmane, ndërkohë që seminari mund të ndërtohej gjithsesi brenda hapësirës së ndërtesës së vjetër. Sipas Borovickës përgjegjës për ngjarjet e ndodhura ishte edhe vetë Atta pasha, i cili edhe pse formalisht nuk kishte shfaqur kundërshtim ndaj ndërtimit të seminarit, ishte treguar mjaft i dobët dhe i pavendosur ndaj revoltës dhe krerëve të saj. Në këtë qëndrim të pavendosur të guvernatorit Osman luanin rol edhe ndikimi që kishin tek ai konsullatat aqleze e sidomos ato franceze të cilat ishin të interesuara për një dobësim të rolit të Austrisë si mbrojtëse e popullsisë katolike<sup>315</sup>.

Në këtë periudhë kemi edhe përpjekjet e Francës për të shtrirë influencën kulturore e politike drejt Lindjes. Kjo politikë lidhet së pari me ambiciet imperialiste të vetë sundimitarit francez, perandorit Napoleoni III, i cili synonte që ashtu si xhaxhai i tij, t'i rikthente Francës edhe njëherë shkëlqimin perandorak. Këto synime përputheshin edhe më tej me situatën e krijuar nga Lufta e Krimesë, ku Franca paraqitej si aleate e Perandorisë Osmane. Një rol energjik në këtë aspekt luajti konsulli francez Ekard (Hecquard), i cili zhvillonte aktivitetin e tij në sanxhaqet e Shkodrës e të Prizrenit, duke zhvilluar takime e ceremoniale me autoritetet osmane apo duke ndërmjetësuar në konfliktin turko-malazet. Në prill të vitit 1855, ai do të vizitonte Malin e Zi për të vendosur lidhje me princin Danilo. Qëllimi i francezëve ishin që ta shkëpusnin Malin e Zi nga ndikimi rus, edhe të forconin aty ndikimin politik e kulturor të Francës. Ekard do të përpiquej të bindte princin malazet të ndalte sulmet ndaj territoreve osmane, duke arritur të merrte në fund edhe vetë miratimin e Danilos.<sup>316</sup> Një vit më vonë

<sup>315</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 14 qershor 1856, f. 200-212/ 17 qershor 1856, f. 197-200, mbi bllokadën e flotës austriake.

<sup>316</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 12 prill 1855, f. 235-236.

Ekard do ta vizitonte sërish Cetinën së bashku me dy delegatë të tjerë të qeverisë franceze. Qëllimi ishte vendosja e lidhjeve kulturore e arsimore mes Francës dhe Malit të Zi, gjë që do të mundësohej përmes futjes së edukatorëve e mësuesve francezë. Këto përpjekje nuk shiheshin me sy të mirë nga Austria, e cila e perceptonte si të rrezikshme shtrirjen e ndikimit francez në Perandorinë Osmane dhe në Mal të Zi, shtete me të cilat kufizohej drejtpërdrejt. Kjo vihet re në letrën që konsulli austriak Belarini i dërgonte këshilltarit të mëkëmbësisë në Kotor (zotërim austriak), ku pasi pasqyrohet aktiviteti i funksionarëve francezë jepen sugjerime për ta penguar veprimtarinë e tyre: *“...mendoj se është me vend të pengohet brenda mundësive çdo veprim i konsullatës së Francës në Mal të Zi, e cila kërkon të futet pranë princit Danilo dhe është duke e arritur qëllimin...”*<sup>317</sup> Po kështu këshillohet *“t’i tërhiqet vëmendja pricrit Danilo”* në lidhje me përpjekjet për vendosjen e mësuesve francezë në Cetinë.

Edhe më ngulmues paraqitet aktiviteti i funksionarëve francezë në sanxhakun e Shkodrës. Në dhjetor të vitit 1855, komandanti i skuadronit francez Lyver zbarkoi në Ulqin së bashku me adjutantët e tij dhe udhëtoi më tej drejt Durrësit, ku synohej të hapej një konsullatë franceze. Më tej ai së bashku me konsullin Ekard vizitoi Shkodrën, ku Teofik beu, komandant i përkohshëm i Shkodrës organizoi një pritje madhështore me njëmbëdhjetë të shtëna topi nga kalaja e qytetit. Gjithashtu Ekard shpërndante dhurata për kishën e Tivarit dhe për ipeshkvin Dodmasej të Pultit.<sup>318</sup> Ndër të tjera komandanti Lyven kishte ardhur me mision për të rekrutuar ndihmës për ushtrinë franceze që luftonte në Krime kundër Rusisë. Kushtet e rekrutimit vlerësoheshin si mjaft të favorshme edhe për popullsinë lokale, me paga që varionin nga 81 deri në 105 franga në muaj. Ndër kushtet e rekrutimit komanda franceze vinte në dukje se individët e rekrutuar përjashtoheshin nga çdo luftim dhe nuk do të përballeshin me rreziqet e luftës. Ata do të rekrutoheshin si punëtorë të shpurës ushtarake franceze në Krime. Konsulli austriak përshkruan përshtypjet që krijojnë në qytet paradat e ushtarëve francezë: *“Pamja e ushtarëve francezë në Shkodër, të cilët nuk ishin parë kurrë këtu, shëtitja e komisarëve francez të paraprirë prej një reshteri francez në kalë, duke pasur gjithnjë në dorë një shtizë me flamurin francez, ushtimi i lodrës në Shkodër krahas flamurit trengjyresh ka bërë bujë këtu, dhe emri francez admirohet, duke paguar kaq bujarisht përcjellës të*

<sup>317</sup> Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, F. Arkivi i Vjenës, dosja “1853-1857, Belarini-Këshilltarit të mëkëmbësisë në Kotorr, 12 prill 1856, f. 219-220.

<sup>318</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini - Ministrisë së shquar, 7 dhjetor 1855, f. 231-232.

*thjeshtë me racione që do të qëndronin fare mirë në tryezën e një zotërie*<sup>319</sup>.

Një përpjekje tjetër për shtrirjen e influencës franceze në këtë periudhë shënonte edhe vizita e Armando Baschet, me mision nga ministri francez i arsimit, në prill të vitit 1856. Qëllimi i Baschet ishte të kundërpeshonte ndikimin austriak në fushën e arsimit, sidomos në seminarët katolike, duke vendosur aty mësuesit dhe priftërinjtë francezë. Këto përpjekje do të shqetësonin austriakët të cilët deri në ato çaste, përmes kultusprotektoratit kishin edhe monopolin e influencës mbi seminarët katolike, të cilat shpeshherë subvencionoheshin prej vetë perandorit habsburg. Kjo vihet re edhe në raportet e konsullit Belarini, i cili menjëherë merr masat për t'i penguar këto përpjekje pranë shkollave katolike, duke komunikuar edhe me imzot Bogdanoviçin për të mos lejuar veprimtarinë e francezëve në atë dioqezë. Ndër të tjera ai propozonte kryrjen e një marrëveshjeje me ipeshkvin vendas për caktimin e një shume vjetore prej 1200 florinjsh për të paguar mësuesit austriakë në shkollat e Shkodrës, *“dhe duke pasur mësues austriakë të mos jetë nevoja për mësues francezë”*<sup>320</sup>.

E tillë ishte situata politike në rajonin e Shkodrës dhe në zonat kufitare mes Perandorisë Osmane dhe Malit të Zi. Në këto zona kemi një nënshtrim formal të fiseve të Vasojeviçit, megjithatë Mali i Zi arriti t'i qëndronte sulmeve osmane, e po kështu zonat e fortifikuara osmane të Shpuzës mundën t'i rezistonin sulmeve sporadike malazeze. Mali i Zi doli pa asnjë përfitim territorial, juridik apo politik nga Traktati i Parisit (princi Danil, megjithëse kishte mbajtur anën e Ruisë në konflikt, shpresonte shumë tek një përkrahje franceze për njohjen e pavarësisë së vendit). Pikërisht kjo do të nxisë më tej luftërat që do të pasojnë. Me mjaft rëndësi është edhe qëndrimi i fuqive të mëdha dhe rivaliteti mes tyre për këto rajone. Nga njëra anë kemi Austrinë, e cila tashmë i kishte konsoliduar pozitat e saj në Shqipërinë Veriore, e nga ana tjetër shfaqjen e interesimit francez që synon të depërtojë drejt Orientit. Megjithatë ky imperializëm francez, me rënien e perandorisë dhe shpalljen e Republikës (1871), do t'i përqendrojë ambiciet e tij kryesisht në territoret afrikane apo ato të Azisë së Lartë.

#### BIBLIOGRAFIA

- Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet* (Vëllimi I), Rozafa, Shkodër, 2015.
- Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, Përpjekja, Tiranë, 1999.

<sup>319</sup> Po aty, 14 dhjetorit 1855, f. 230-231.

<sup>320</sup> Arkivi i Muzeut..., Belarini- Ministrisë së shquar, 7 prill 1856, fl. 221-222.

- ASHSH, *Historia e Popullit Shqiptar* II, Toena, Tiranë, 2002.

**Burime Arkivore**

- Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, Fondi: Arkivi i Vjenës, Dosja: 1853-1857.

**Turko-Montenegrin wars and the region of Shkodra(1852-1856)*****ABSTRACT***

This article aims to highlight the role of the albanian factor in the Turkish-Montenegrin wars of 1852-1853 and those developed during the years of the Crimean War (1853-1854). During this period, there was no albanian national autonomous attitude, so the Albanian factor appears divided, on one side were the tribes of Kuçi and Palabardhi who hold the side of Montenegro and on the other side the bajraks and the redifs recruited according to the traditional ottoman system of recruitment in the sanxhak of Shkodra and in the other provinces of Albania. Omer Pasha's Ottoman campaign would successfully reach the inner regions of Montenegro, Berda and Vasojeviç, thus demonstrating the increasing of the Ottoman army's efficiency after its modernization after Tanzimat's reforms, with the creation of the permanent army. However, ottoman progress will be stopped by the intervention of Russia and the Austrian Empire, which could not accept further Ottoman progress near its borders, and was also forced to maintain a pro-Russian stance after the aid that Russia had given to them for the repression of the 1848-1849 revolutions. Subsequently, the Turkish-Montenegrin conflict will reopen with the outbreak of the Crimean War, where Montenegro was on the side of its traditional ally, the Russian Empire. Secondly, the article deals with aspects of the internal situation in the city of Shkodra during the Crimean War, related to the social turmoil that erupted in 1854-1856, where we can mention the Sheh Shamia revolt, the revolt of the fanatics led by Hamz agë Kazazi against the construction of the Catholic seminary etc., and their consequences in the relations of the Ottoman Empire with Austria. Finally, during these years, it is important to mention the appearance of the Austro-French rivalry in Shkodra, linked to the growth of the activity of the french functionaries in Shkodra, which violated the austrian monopoly on the cult protectorate, education etc., as well as efforts to get recruits from Shkodra to Crimea, where the french were facing the russian army.

Sokol AXHEMI

## **IMPAKTE TË BURIMEVE TË ENERGJISË NË ZHVILLIMIN E POPULLSISË SË SHQIPËRISË DHE ELEMENTEVE SOCIALE TË SAJ (1990-2016)**

### *Hyrje*

Tematikat që kanë të bëjnë me raportet ndërmjet burimeve të energjisë, teknologjisë mjedisore dhe popullsisë paraqiten mjaft të rëndësishme në ditët e sotme. Disiplina të ndryshme shkencore dhe autorë të shumtë gjithnjë e më shumë po tentojnë të orientojnë hulumtimet e tyre drejt tematikave të mësipërme. Mjaft tituj artikujsh shkencorë, librash e monografish, kanë në fokus të tyre marrëdhëniet ndërmjet burimeve të energjisë, teknologjive gjithnjë e më të reja mjedisore, të cilat po njohin zgjerim dhe përhapje në hapësira të ndryshme gjeografike. Tematikave të tilla po u kushtohet vëmendje e veçantë edhe nga organizatorët e mjaft eventeve shkencore akademike nga fushat e energjisë, mjedisit, sociale etj.

Gjithnjë e më intensivisht edhe gjeografët po përfshihen në studimet shkencore me fokus burimet e energjisë, teknologjitë e reja mjedisore dhe raportet në mes tyre. Në mënyrë të veçantë janë mjaft të evidentuara për rolin e madh që raportet në mes tyre luajnë në vete jetesën e popullsisë dhe elementet e veçanta sociale të saj. Sidomos vëmendja po orientohet drejt ndikimeve të energjisë së rinovueshme dhe impaktit të saj në popullsi dhe hapësirën gjeografike.

Në këtë artikull janë bërë përpjekje nga ana jonë për të paraqitur pikërisht raportin ndërmjet burimeve të energjisë dhe teknologjisë mjedisore të aplikuar në Shqipëri gjatë periudhës 1990 - 2016. Një raport i tillë është orientuar nga ana e analizës sonë shkencore duke iu referuar impakteve që ajo paraqet në popullsinë e Shqipërisë dhe elementeve sociale të saj. Artikulli shkencor është i ndarë në disa çështje të ndryshme, të cilat analizohen në mënyrë të detajuar. Së pari, paraqiten burimet e energjisë në Shqipëri duke evidentuar burimet ujore dhe rolin e tyre si burim i rëndësishëm energjie. Njëkohësisht, analizë e detajuar, u është kushtuar edhe burimeve të tjera të energjisë, duke iu referuar burimeve minerare, si: nafta, burimeve drusore, etj.

Kemi evidentuar në materialin tonë shkencor një rol gjithnjë e në rritje që po merr energjia e rinovuar në Shqipëri. Ndonëse me ritme jo

shumë të larta, energjia e rinovuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të stabilizuar po gjeneron forma dhe dimensione nga më të ndryshme në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë kemi paraqitur një përhapje gjithnjë e në rritje të energjisë së përftuar nëpërmjet aplikimit të teknologjive të reja si ato të paneleve diellore, duke dhënë njëkohësisht edhe shpërndarjen e tyre gjeografike. Në mënyrë të veçantë mjaft të shprehura ato paraqiten në zonat tona turistike, kryesisht rajonet bregdetare.

Një çështje tjetër e trajtuar në mënyrë të detajuar është edhe ajo që lidhet me elementet mjedisore dhe teknologjitë bashkëkohore në këtë drejtim në Shqipërinë e viteve 1990-2016. Mjedisi, ruajtja dhe mbrojtja e tij, e hapësirës gjeografike të Shqipërisë, zhvillimit të qëndrueshëm të saj. Politikat mjedisore dhe sociale në funksion të dinamikës së hapësirës gjeografike të Shqipërisë janë disa nga nënçështjet, të cilat gjejnë trajtim shkencor në material.

Mjaft interesante dhe risi në punimin shkencor mbart çështja që është fokusuar tek impaktet që luajnë burimet e energjisë dhe teknologjitë mjedisore në popullsinë e Shqipërisë dhe elementet sociale të saj. Roli i këtyre burimeve të energjisë gjen shprehje në ndikimin që luan në mirëqenien e popullsinë, evolucionin e jetës sociale të saj, dimensionet e punësimit, koston e jetesës dhe të banimit, mënyrën optimale të të jetuarit etj. Me mjaft interes paraqiten edhe analizat referuar rolit të këtyre burimeve të energjisë në zhvillimet ekonomike të Shqipërisë në periudhën 1990-2016. Elemente të tilla sociale kanë shumë ndikim në jetesën e popullsisë, duke krijuar premisa të rëndësishme për një analizë shkencore të tipareve sociale të saj, që lidhen me një element mjaft të rëndësishëm që janë burimet e energjisë dhe raportet me mjedisin.

Në përfundim të materialit shkencor autori ka dalë në disa konkluzione të rëndësishme në lidhje me këtë fokus shkencor. Njëkohësisht jepen edhe disa rekomandime të rëndësishme, sidomos në drejtim të eficensës së përdorimit të burimeve të energjisë, energjisë së rinovuar etj. Gjithashtu materiali mbart një sërë tabelash, grafikësh, fotosh ilustrative.

### **Burimet e energjisë në Shqipëri. Aplikimi i teknologjive të reja mjedisore**

Shqipëria paraqitet si një ndër vendet me burime energjie të rëndësishme. Një gjë e tillë është e ndikuar nga prania e burimeve të shumta hidrike, burimeve minerare ndër të cilat mund të evidentojmë ato të naftës, qymyrgurit etj. Njëkohësisht, për një vlerë të konsiderueshme në kuadrin e burimeve të energjisë, vlejnë të përmenden edhe pasuritë e

shumta pyjore, numri i ditëve me diell, kapacitetet e pashfrytëzuara eolike, energjia gjeotermale etj. Tërësia e këtyre burimeve bën të mundur daljen në konkluzionin se burimet e energjisë në Shqipëri paraqiten mjaft optimale për ta paraqitur vendin tonë si bartëse kompetitive e energjisë. Megjithatë vlerësojmë se në këtë kuadër nevojitet një analizë më e thellë dhe e detajuar për të parë shkallën e përdorimit të tyre, eficensën, shkallën e shfrytëzueshmërisë, kapacitetet bartëse etj.

Burimet hidrike paraqiten ndër më kryesoret në kuadrin e burimeve të energjisë në Shqipëri. Një gjë e tillë është e ndikuar dukshëm edhe nga resurset natyrore me të cilat karakterizohet Shqipëria. Në mënyrë të veçantë pasuria hidrografike, klimatike dhe e relievit kanë bërë të mundur një zhvillim intensiv të përfuturit të energjisë nga burimet ujore. Sidomos mjaft evidente paraqitet sasia e reshjeve si burim i rëndësishëm furnizues për rrjetin hidrografik të Shqipërisë. Sasia e konsiderueshme e tyre, lidhur ngusht me larminë e rënies së tyre (në formën e shiut dhe borës), kanë ndikuar në krijimin e një rrjeti hidrografik mjaft të pasur, duke rritur dhe favorizuar potencialisht mundësinë e shfrytëzimit të tyre për prodhimin e energjisë. Sidomos, mjaft qartë në këtë drejtim, shfaqen sistemet lumore të Drinit, Matit, Bisticës, Devollit, Vjosës. Më poshtë po paraqesim një tabelë përmbledhëse në lidhje me sasinë mesatare periodike të reshjeve për një periudhë shumëvjeçare.

### **Sasia mesatare vjetore e reshjeve për periudhën 30- vjeçare 1950 – 1981.**

Shkodër	Durrës	Tiranë	Elbasan	Fier	Vlorë	Gjirokastrë	Tropojë	Korçë
2065	963	1273	1209	986	957	1928	2105	789

**Tabela Nr.1 Burimi.Gjeografia Fizike e Shqipërisë 1994.**

Tashmë janë të pranishme një numër i konsiderueshëm hidrocentralesh të mëdhenj me norma atë larta shfrytëzimi të energjisë. Si të tillë mund të përmendim atë të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës, Ulzës, Shkopetit, Bisticës etj. Energjia e përfutur prej tyre luan një rol gati tërësor në furnizimin me energji të popullsisë dhe industrisë në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë kaskada e Drinit me shtrirjen e hidrocentraleve të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës, Ashtës, me kapacitetet prodhuese që realizon, përbën impiantin më të rëndësishëm të shfrytëzimit energjitik në Shqipëri.

Duhet evidentuar fakti se në mënyrë të veçantë gjatë periudhës 1990-2016 ka ardhur gjithnjë e në rritje edhe kontributi i rëndësishëm, i mjaft hidrocentraleve të vegjël, realizuar nga investitorë të ndryshëm

privatë shqiptarë dhe të huaj. Ndikimi i tyre në bilancin e përgjithshëm të përftimit të energjisë njih rritje nga njëri vit në tjetrin. Ndërtimi i tyre në rrjedhjet e lumenjeve e përrrenjve të ndryshëm të Shqipërisë gjatë periudhës së tranzicionit ka ndikuar së tepërmi edhe në jetën ekonomike e sociale të fshatrave e qyteteve të ndryshme të vendit.

Ndër burimet e energjisë nga drejtimi mineral vlerësojmë rolin aktiv që kanë luajtur aplikimi i shfrytëzimit nga nafta dhe burimet e qymyrgurit, ndonëse duhet të vlerësojmë se në dallim nga prodhimi i naftës ai i qymyrgurit ka rënie të konsiderueshme të nxjerrjes dhe përftimit nga ky burim mineral. Qendrat kryesore të nxjerrjes dhe përpunimit (jocilësor) të naftës në kuadrin e shpërndarjes gjeografike janë në zonën e Patos - Marinzës, Ballshit. Shfrytëzimi i kapaciteteve bartëse të nëntokës shqiptare po njih edhe një rritje të interesit të investitorëve të huaj, kryesisht atij kanadez, të cilët nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të konsorciumeve të rëndësishme nxjerrëse të naftës, kanë rritur mundësitë e përdorimit efektiv të saj. Një burim i tillë mineral në shfrytëzim si burim energjie ka gjetur aplikim në zona të ndryshme të vendit.

Shqipëria dallohet edhe për pasuri të mëdha pyjore në numër dhe lloje. Shfrytëzimi i tyre paraqet një dallim të rëndësishëm ndërmjet periudhave të ndryshme të zhvillimit të vendit. Ndonëse deri në fillimin e viteve 1990 kemi pasur një shfrytëzim të kontrolluar të tyre, shoqëruar me rinovimin e pyjeve, periudha nga 1990 e deri me 2016, është karakterizuar nga tipar tjetër karakteristik. Tashmë në përgjithësi një pjesë e konsiderueshme e tyre iu dhanë në pronësi ekonomive private, ku investitorë të ndryshëm shfrytëzuan pa kriter pasurinë pyjore, duke mos i dhenë rëndësinë e duhur rinovimit të tyre. Një gjë e tillë ka çuar në shkatërrimin e pyjeve të ndryshme në zonat e Kelmendit në Malësinë e Madhe në Shqipërinë Veriore, në dëmtimin e konsiderueshëm të pyjeve të Lurës në zonat e Dibrës, Mirditës dhe Burrelit, në shkatërrimin e mjaft sipërfaqeve pyjore në Librazhd, Peshkopi, Ersekë, Korçë etj.

Krahas këtyre burimeve të energjisë tashmë të njohura në kuadrin e zhvillimit energjistik të Shqipërisë, periudha 1990-2016, u shoqërua nga një risi mjaft interesante. Gjithnjë e më tepër në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës sociogjeografike të Shqipërisë, vihen re tendenca drejt aplikimit të teknologjive të avancuara në kuadrin e energjisë së rinovuar. Në mënyrë të veçantë gradualisht evidentohen përpjekje të studiuesve dhe investitorëve të ndryshëm të aplikonin teknologji të reja edhe në kuadrin e ruajtjes dhe mbrotjes së mjedisit. Kështu që këto tendenca të reja në drejtim të hulumtimit dhe aplikimit për burime të reja energjie patën edhe një këndvështrim tjetër për t'i realizuar, duke ruajtur



mjedisin dhe ambientin gjeografik. Në këtë mënyrë do të orientohet edhe një numër i konsiderueshëm aktivitetesh shkencore dhe hulumtuese kërkimore në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në mënyrë të veçantë intensifikimi i tyre fillon që të bëhet realitet pas viteve 2000 kur u ndërmorën edhe një sërë hapash të rëndësishëm politikash strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë brenda tyre edhe tendencën për gjenerimin e burimeve të reja të energjisë, me fokus energjinë e rinovuar.

Këtu vëmendja u përqendrua në mënyrë të veçantë në energjinë e përftuar nga burimet hidrike, energjia diellore, energjia gjeotermale, eolike dhe mbetjeve blegtorale. Një risi e tillë u ndikua sidomos lidhur ngusht me premisat favorizuese në aspektet e kushteve natyrore të vendit tonë, sidomos të numrit të ditëve me diell, sasisë së reshjeve atmosferike, veprimtarisë së erës dhe kushteve favorizuese gjeotermale dhe zhvillimit bujqësor-blegtoral.

Nga pikëpamja e burimeve hidrike Shqipëria dallohet për sasinë e reshjeve atmosferike gjithëvjetore. Kushtet klimatike dhe ato hidrografike duke u kombinuar me veçoritë e relievave dhe atyre gjeomorfologjike, bënë të mundur që për një periudhë të shkurtër kohore të realizoheshin një numër i konsiderueshëm hidrocentralesh të vegjël, të cilët nga njëri vit në tjetrin, pasuruan kapacitetet hidrike të energjisë së prodhuar nga ujërat. Në kuadrin e shpërndarjes gjeografike ato i gjejmë të përhapura kryesisht në Shqipërinë Veriore dhe Verilindore, në njësitë administrative të Malësisë së Madhe, Shkodrës, Pukës, Kukësit, Dibrës, Mirditës etj.

Energjia diellore në kuadrin e energjisë së rinovuar gjithnjë e më tepër po njihet aplikimin e vet si burim energjie në Shqipëri. Ndonëse jo me ritmet e duhura, nga njëri vit në tjetrin, evidentohet prania e saj në pjesë të ndryshme administrative të Shqipërisë. Përhapja dhe zgjerimi në vazhdimësi i saj është i lidhur ngusht edhe me kushtet favorizuese që njësitë e ndryshme administrative të Shqipërisë prezantojnë si potenciale të tyre. Numri i ditëve me diell në mënyrë të veçantë në pjesën perëndimore dhe jugore të Shqipërisë luhet në 200-250 ditë duke favorizuar në këtë mënyrë mundësitë për përftimin e energjisë diellore, si burim energjie.

### Zgjatja mesatare e diellzimit në orë mesatare 25 vjeçare, sipas muajve të vitit 1956 – 1980

Rajonet	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Totali
Shkodër	116	117	167	189	248	292	342	306	246	188	110	105	2443
Tiranë	125	124	163	190	258	297	350	328	257	207	124	100	2530
Elbasan	129	130	161	186	242	277	328	314	243	207	131	112	2460
Fier	136	144	188	228	292	309	391	362	208	228	145	120	2141
Vlorë	131	138	170	220	281	324	370	344	270	218	140	119	2734
Korçë	102	122	155	187	239	279	332	307	230	185	122	95	2355
Kukës	61	87	128	162	220	262	312	287	206	149	75	51	2000

**Tabela Nr.2 Burimi Gjeografia Fizike e Shqipërisë.Tiranë A.Sh.Shqipërisë Q.S.GJ. 1994**  
Numri i ditëve me diell

Rajonet	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Shkodër	22	21	26	27	29	30	31	31	29	29	24	21
Tiranë	24	23	27	28	29	30	31	31	29	29	24	21
Fier	26	25	28	29	30	30	31	31	30	30	26	25
Korçë	24	24	28	28	30	30	31	31	29	29	28	23
Kukës	17	20	24	26	29	29	31	31	28	26	20	17

**Tabela Nr.3 Burimi.Gjeografia Fizike e Shqipërisë. A.Sh.Shqipërisë. QSGJ. Tiranë, 1994.**

Një situatë e tillë ka bërë të mundur që nga mjaft investitorë privatë të futen dhe të zgjerojnë në vazhdimësi aplikimin e paneleve diellore për përfitim të energjisë. Sodomos mjaft të përhapura këto panele diellore i kemi në zonat turistike bregdetare, si: Durrës, Vlorë, Sarandë, në rivierën shqiptare etj. Aplikim gjithnjë e në rritje i tyre po vihet re në mënyrë graduale edhe në zonat urbane të Shqipërisë, kryesisht në ato me numër të lartë popullsie, si: Tirana, Durrësi, Vlora, Fieri etj. Interesi gjithnjë e më i shtuar në drejtim të përfitimit të energjisë diellore nëpërmjet aplikimit të vendosjes së paneleve diellore konfirmohet edhe nga fakti i hapjes dhe zgjerimit të mjaft pikave tregtare që tregtojnë një larmi produktesh të tipeve të paneleve diellore.

Vitet e fundit evidentojmë një rritje të interesit edhe për energjinë gjeotermale. Një numër studiuesish, kanë bërë të mundur në bashkëpunim me biznesin, aplikimin e teknologjive të përparuara në funksion të përfitimit të kësaj lloji energjie. Në saj të përfitimit kemi praninë e saj në sistemin ngrohës - ftohës në ish - Pallatin e Kulturës në Tiranë, në një shkollë të Ersekës etj. Madje studiues të ndryshëm kanë paraqitur një

platformë kombëtare për gjenerimin dhe mundësinë e aplikimit për përtimin e energjisë gjeotermale, lidhur ngusht me kushtet favorizuese të territorit shqiptar.

### **Impaktet e burimeve të energjisë në popullsinë e Shqipërisë dhe elementet sociale të saj**

Impaktet që burimet e energjisë kanë luajtur në popullsinë shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit kanë qenë të shumta dhe multidimensionale. Impaktet e tyre kanë qenë shumë të ndjeshme si në drejtim të jetës dhe aktivitetit ekonomik të tyre, ashtu edhe në elementet sociale të saj, lidhur ngusht me punësimin, mirëqenien, standardet dhe kushtet e jetesës. Një ndikim të konsiderueshëm ato patën gjatë evolucionit dhe zhvillimit të tyre në vendet dhe funksionet sociale, grupet sociale, në kuadrin e hapësirës sociojeografike të Shqipërisë.

Burimet e energjisë kanë qënë shtysat kryesore ndikuese në zhvillimet ekonomike të sektorëve të ndryshëm. Ato ishin premisë e rëndësishme zhvillimi për atë pjesë të industrisë që i rezistoi zhvillimeve dhe strukturës ekonomike të Shqipërisë së tranzicionit. Nëse nuk do të kishte ekzistuar furnizimi me energji, mjaft degë të ekonomisë do të kishin kaluar në kolaps, duke sjellë pasoja shqetësuese të pallogaritshme për ekonominë e dobët shqiptare. Megjithatë duhet të evidentojmë faktin së në mënyrë sporadike në disa sektorë, si metalurgji dhe industri të rëndë, në disa raste mugesha apo kufizimi i energjisë është bërë shkak për humbje të shumta financiare dhe ato të karakterit social. Një gjë e tillë është ndjerë si nga investitorët shqiptarë, ashtu edhe ata të huaj, duke pasur ndikimin e tyre edhe në krijimin e impakteve negative sociale në popullsi. Në mënyrë të veçantë ato kanë qenë të shprehura në sistemin e industrisë së rëndë në rajonet e Elbasanit, Matit, ku janë vërejtur shkurtime të vendeve të punës në grupin social të punëtorëve të profesioneve të ndryshme, uljen e pagave dhe të ardhurave për një pjesë tjetër të punëtorëve, të ardhurave më të pakta në sistemin fiskal etj.

Me shfrytëzimin e këtyre burimeve të larmishme të energjisë në Shqipëri është e lidhur edhe mundësia e punësimit të njerëzve, duke ndikuar në këtë mënyrë në shtimin e të ardhurave të popullsisë së njësive administrative të ndryshme. Punësimi i tyre paraqitet i shprehur direkt në institucionet dhe sektorët energjitikë, minerare dhe pyjore, por edhe në kuadrin e aktiviteteve të tjera ekonomike që kanë lidhje të ngushta me burimet e energjisë. Ndërtimi i burimeve të reja të energjisë, aplikimi i teknologjive të reja në përfitim të reja të burimeve të energjisë, studimi dhe distribuimi i tyre, është shoqëruar edhe me hapjen dhe

gjenerimin e vendeve të reja të punës. Situata të tilla i kemi në njësitë administrative të Pukës, Kukësit, Tropojës, Korçës, Dibrës etj.

Ndërtimi i njësive të reja ekonomike të burimeve të energjisë, sidomos të hidrocentraleve të ndryshme gjatë periudhës 1990 – 2016, është shoqëruar edhe me një gjallërim të vazhdueshëm të jetës sociale dhe ekonomike të hapësirave sociogjeografike të ndryshme të Shqipërisë Veriore, Verilindore, Jugore e Juglindore. Impakte të rëndësishme ka shoqëruar edhe gjallërimi i aktiviteteve të tjera ekonomike, sidomos i bizneseve të ndryshme, llojeve të ndryshme të turizmit, bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë së këtyre njësive administrative, kryesisht rurale.

Njëkohësisht ka ndikuar dukshëm edhe në rritjen e interesit të zhvillimit të turizmit të këtyre njësive administrative të vogla, kryesisht rurale, lidhur ngusht me panorama piktoreske dhe ofertën turistike joshëse të tyre. Si hapësira të tilla sociogjeografike mjaft interesante me impakte të rëndësishme zhvillimi paraqiten ato të Vermoshit, Razmës, Thethit, Lurës, Bogës, Valbonës, etj. Popullsia lokale e këtyre njësive administrative ka pësuar ndryshime të rëndësishme në elementet e zhvillimit ekonomik dhe social të saj.

Situata të tilla sociale dhe ekonomike krijuan impakte të rëndësishme pozitive për popullsinë e këtyre njësive administrative duke defavorizuar procesin e migrimit, i cili kishte qenë mjaft aktiv deri në fillimin e viteve 2010, duke bërë që mjaft prej këtyre njësive të depopulloheshin. Tashmë shihej qartë një mundësi për jetë aktive ekonomike dhe sociale që orientoheshin nga mundësia e zhvillimit të këtyre degëve të ekonomisë, që punësonin njerëzit dhe krijonin të ardhura për veten dhe familjet e tyre. Madje duhet evidentuar fakti se në mjaft prej këtyre njësive administrative, ndikuar nga rritja e interesit ekonomik dhe vënia në efikasitet e këtyre pasurive natyrore kryesisht turistike, kombinuar me kushtet dhe standardet që krijuan burimet e energjisë, kemi kthimin e mjaft banorëve vendas nga emigrimi në vendet e ndryshme evropiane dhe SHBA. Sidomos, situata të tilla, i kemi në rajonet e Thethit dhe të Valbonës.

Në kuadrin e shfrytëzimit të burimeve të energjisë kemi lindjen dhe zhvillimin e vendeve të reja sociale dhe pasurimin e funksioneve sociale respektive. Lindja dhe zhvillimi i industrive energjitike, minerare dhe sektorit të pyjeve, ka bërë të mundur lindjen dhe zhvillimin e mjaft fshatrave dhe qyteteve të ndryshme në Shqipëri. Si të tilla mund të përmendim sidomos ato të Fierzës, Komait, Ballshit, Kuçovës, Bisticës, Ulzës, Selenicës, Memaliajt, Kelmendit, Steblevës etj. Gjithnjë e më tepër kemi praninë e vendeve të reja sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit,

argëtimit dhe pushtetit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në grupet e ndryshme sociale, pjesë e popullsisë lokale të këtyre njësive administrative të krijuara.

Prandaj edhe sot në kuadrin e zhvillimit të njësive të ndryshme administrative, pjesë përbërëse e zhvillimeve në sektorin e burimeve të energjisë, janë shtëpitë e llojeve e dimensioneve të larmishme, palate banimi, servise, nyje të ndryshme prodhimi e shërbimesh, dyqane e qendra tregëtare, bare e restorante, pallate sporti e stadiume, teatro e kinema, salla lojërash të përmasave të ndryshme, të cilat konfirmojnë praninë e vendeve sociale të reja, në të cilat popullsia e këtyre njësive administrative realizon jetën e saj sociale.

Ky pasurim i jetës sociale të tyre është shoqëruar me lindjen dhe zhvillimin e funksioneve të reja sociale. Pasurimi i funksioneve sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit dhe argëtimit është mjaft evident në kuadrin e shpërndarjes gjeografike, sipas burimeve specifike të energjisë. Kemi praninë e profesioneve të reja si ato të minatorit, teknikut të minierave, inxhinierëve të ndryshëm, si hidroteknike, atyre të minierave, të pyjeve, të drurit etj., teknikëve të mesëm në shërbim të hidrocentraleve, minierave e pyjeve. Tërësia e këtyre funksioneve të reja sociale u shoqërua edhe me hapjen e mjaft shkollave të ndryshme profesionale, sipas sektorëve të burimeve të energjisë, në të cilat u vendos popullsia e re në moshë. Një gjë e tillë u shoqërua edhe me hapjen e kurseve të shumta të kualifikimit, sipas degëve përkatëse të burimeve energjitike, si në Shkodër, Tropojë, Tiranë, Durrës, Korçë, Mat etj.

### **Konkluzione**

Nga shqyrtimi i materialit të mësipërm arrijmë në disa konkluzione të rëndësishme në lidhje me burimet e energjisë në Shqipëri dhe impakti i tyre në popullsinë e vendit tonë dhe elementet sociale të saj.

*Së pari*, Shqipëria karakterizohet nga një pasuri e konsiderueshme burimesh energjie. Këto burime janë mjaft të shprehura në kuadrin e burimeve hidrike, minerare, pasurisë pyjore etj. Tërësia e këtyre burimeve të energjisë paraqitet mjaft diverse në kuadrin e shpërndarjes gjeografike në njësitë e ndryshme administrative të Shqipërisë.

*Së dyti*, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm kemi gjenerimin e burimeve të reja të eneregjisë në kuadrin e energjisë së rinovuar. Ndonëse me ritme modeste vihen re tendenca të pranisë së energjisë së rinovuar të përftuar nga panelet diellore, lënda drusore, mbetjet blegtorale dhe energjia gjeotermale. Vlerësojmë se nga njëri vit në tjetrin, vihet re rritje e përdorimit dhe e aplikimit të teknologjive të reja mjedisore

*Së treti*, tërësia e këtyre burimeve të energjisë ka shërbyer në vazhdimësi si impakt i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Një gjë e tillë është e shprehur në mënyrë konkrete në praninë e një numri të rëndësishëm vendesh sociale të prodhimit, si një numër i konsiderueshëm objektesh ekonomike me rëndësi kombëtare për Shqipërinë, si hidrocentralet, minierat, pyjet e shumta etj. Vlen të theksohet shpërndarja gjeografike e tyre në njësitë e ndryshme administrative.

*Së katërti*, hapësira sociogjeografike e Shqipërisë gjatë periudhës 1990 – 2016, karakterizohet nga impakte të rëndësishme të burimeve të energjisë në funksion të zhvillimit të popullsisë dhe elementeve sociale të saj. Në mënyrë të veçantë vlerësojmë pasurimin e vendeve sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit, argëtimit në njësi të ndryshme administrative të Shqipërisë. Ky pasurim në vende sociale ka intensifikuar edhe zhvillime të tjera të shprehura në fushën e bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë, agroturizmit, llojeve të ndryshme të ekonomisë turistike etj. Mjaft i shprehur një impakt i tillë social paraqitet në zonat e Thethit, Valbonës, Bogës, Lurës etj.

*Së pesti*, impakti social në popullsi shprehet edhe në larminë e pasurimit të funksioneve sociale, pjesë e grupeve sociale të lidhura ngusht me popullsinë e këtyre njësive administrative ku vihen re zhvillime të rëndësishme në kuadrin e shfrytëzimit dhe vënies në eficensë të burimeve të energjisë. Lindën dhe u zhvilluan profesione të reja, u hapën vende të reja pune duke mundësuar punësimin e banorëve të këtyre zonave, u rritën të ardhurat, mirëqenia e jetesës së popullsisë etj.

#### LITERATURA:

1. Axhemi, Sokol (2000): Touristic economy, priority for economic development of Shkodra, s region (co-author) International conference “ Economic potencial of Shkodra” Shkodër.
2. Axhemi, Sokol (2004): Morphologia and morfometria of Nikaj-Curraj river. Shkodra, s University, Scientific Bulletines. Natural sciences series.
3. Axhemi, Sokol (2014): Some considerations about renewable energy in Albania. Impacts to population. International ARW, Vilnius, Lituania, november.
4. Frashëri. A & Kodhelaj. N. (2014): *Burimet e energjisë gjeotermale në Shqipëri dhe platforma për shfrytëzimin e saj*. Studim, Tiranë.
5. Hanxhari, Romeo (2011): *Politikat e mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal*. Analizë teorike, Tiranë.
6. Sheme, Selman (2006): *Gjeografia e industrisë*. Tekst mësimor universitar, Tiranë.

7. Ziu, Trifon (2009): *Gjeografia e rregullimit të territorit*. Tekst mësimor universitar, Tiranë.
8. Grup autorësh (1991): *Gjeografia fizike e Shqipërisë* (Pjesa e parë) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë.
9. Grup autorësh: *Gjeografia fizike e Shqipërisë* (Pjesa e dytë).
10. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë, 1991.
11. Talani, Rifat (1999): *Morfometria e pellgjeve ujëmbledhës në Alpet e Shqipërisë*. Universiteti i Shkodrës, Monografi, Shkodër, 1999.
12. Talani, Rifat (1999): *Gjeologjia e përgjithshme*. Tekst mësimor universitar, Universiteti i Shkodrës, Shkodër.

### **Impact of energy resources on the development of Albania's population and its social elements (1990-2016)**

#### ***ABSTRACT***

Topics dealing with relations between sources of energy, environmental technology and population appear quite important nowadays. Various scientific disciplines and many authors are increasingly tendencies to orient their research to the above topics. Many scientific articles, books and monographs have their focus on the relationship between energy sources, technologies new increasingly environment, which are experiencing expansion and dissemination in different sociogeographic spaces. These topics are particular attention paid to the quite the organizers of academic scientific events fields of energy, environment, population, social, etc.

In this article attempts have been made by us to represent the relationship between energy sources and environmental technologies applied in Albania during the period 1990-2016. Such a report is oriented by our scientific analysis referred potential impacts it presents in the Albanian population and its social elements. Scientific article is divided into several different issues, which are analyzed in detail. First of all presented Albania's energy resources by identifying water resources and their role as an important source of energy. Detailed analysis simultaneously been given the other sources of energy mineral resources referred to as oil, timber resources, etc.

Quite interesting and innovative scientific paper carries on the issue that is focused on the impacts that play energy sources and environmental technologies in the Albanian population and its social elements. The role of these energy sources in the impact gene expression plays in the welfare of

the population, the evolution of its social life, the dimensions of employment, cost of living and housing, optimal way of living, etc.

**Key words:** environmental technologies, energy resources, population



Flora GJONI, Ermal MLIKA

## GLOBALIZIMI DHE VENDI QË ZË SHQIPËRIA NË KËTË PROCES. NDRYSHIMET STRUKTURE QË KA PËSUAR EKONOMIA E VENDIT TONË GJATË TRANZICIONIT

**Globalizimi, proces bashkëkohor, përfitimet prej tij dhe vendi i Shqipërisë në të**

Globalizimi është bërë sot kryefjala e zhvillimeve mbarëbotërore në shumë aspekte, proces që presupozon integrimin e ekonomive, kulturave dhe qasje të të gjithë vendeve ndaj tregjeve botërore. Nga ky proces më shumë përfitime kanë vendet më të zhvilluara, sepse janë ato që determinojnë sot tregjet ndërkombëtare.

Globalizimi, si proces transformimi i ekonomisë botërore sot, jo vetëm ka rritur relacionet ndërshtetërore, por ka ndikuar edhe në strukturimet ekonomike të hapësirave gjeografike. Konsekuencë e këtij procesi, është lehtësimi i komunikimeve ndërmjet tyre.

Banka Botërore, këtë proces e përkufizon në këtë mënyrë: *“Globalizimi është një fenomen, dimensionet ekonomike të të cilit përfshijnë rritje të qarkullimit të tregut, kapitalit dhe informacionit, po aq sa edhe lëvizjen e lirë të individëve përtej kufijve”*.<sup>321</sup>

Procesi i globalizimit ka efektet e veta në rritjen e fluksit të shkëmbimeve të mallrave, njerëzve, informacionit, teknologjisë etj. Përkrahësit e flaktë të këtij procesi thonë se ai ndihmon vendet në zhvillim, duke u integruar me vendet e industrializuara. Ky proces integruet duket më tepër në rritjen e punësimit dhe përparimeve teknologjike. Në këto të fundit ekonomitë aziatike janë nënvizuar shpeshherë si shembuj të suksesit të globalizimit. Për disa shtete, siç është rasti i vendeve me ekonomi të brishta, ky proces ka pasur edhe efekte negative e për pasojë edhe i kanë vuajtur këto të fundit.

Dimensionet dhe vlerat e globalizimit janë shumëplanëshe, veçanërisht ato shihen në disa aspekte:

---

<sup>321</sup> Prof. as. dr. Andri Koxhaj, Grida Duma MPA *“Shqipëria përballë realitetit të një ekonomie globale”*, Ekonomia e biznesi nr. 1(15) 2004, faqe 61.

- Rritjen ekonomike e sociale;
- Rritjen e mirëqenies së popullsisë për vendet e integruara në këtë proces;
- Zhvillime nga proceset e shkëmbimeve të ideve e informacionit;
- Në aspekt institucional stimulon sisteme demokratike, etj.

Globalizimi sot është shndërruar në një proces të pashmangshëm, sepse e dikton vetë procesi i konkurrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare, por edhe efektet pozitive që ka pasur për shtetet pjesë e tij.

Ekonomia shqiptare aktualisht, mbetet një “sektor tregu” për ekonominë botërore të integruar e konkurruese. *“Kjo është e lidhur me atë që vendi ynë akoma është në statet e para të marrëdhënieve reciproke me vendet e tjera dhe që momentalisht janë të konkretizuara më tepër në fushën e tregtisë dhe jo shumë në hallkat e zinxhirit kompleks të globalizimit (shkëmbim i burimeve ekonomike, teknologjike, financiare dhe humane”*.<sup>322</sup>

Ky proces shumëdimensional ngërthen në vete shpresën e integritimit të vendit tonë në të gjitha aspektet e zhvillimeve të tij. Gjetja e zgjidhjeve të zgjuara në aspekt të zhvillimeve ekonomike dhe strukturimeve të duhura, mbështetur tek potencialet ekonomike e humane të vendit tonë, do të sjellë edhe përfitime të shumanshme. Përfshirja e ekonomisë shqiptare, në parametrat e ekonomisë globale, në mënyrë institucionale zë fill me anëtarësimin e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë. Politikat aktuale sektoriale, pavarësisht nga modifikimet që mund t’i jenë bërë gjithë këtij rrugëtimi të gjatë të tranzicionit, kanë si vizion përfundimtar, anëtarësimin në BE, duke e shndërruar vendin tonë pjesë integrale të procesit të globalizimit.

Reformimet shumëdimensionale të ndodhura në këto vite tranzicioni ekonomik, politik e social, detyrimisht kanë lënë gjurmë edhe në ecurinë e strukturimeve ekonomike të vendit tonë. Vetë procesi i globalizimit nga ana e tij ka ndikuar në këto strukturime që ka pësuar ekonomia shqiptare gjatë tranzicionit

### **Ndryshimet strukturore të ndodhura në ekonominë e vendit tonë gjatë tranzicionit**

Ekonomia botërore, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim, po ballafaqohet me dukuri të tilla të reja, të cilat prezantojnë qartë ndryshime strukturore të saj. Statet e zhvillimit të ekonomisë globale sot

<sup>322</sup> Prof. as. dr. Andri Koxhaj, Grida Duma M.P.A, “Shqipëria përballë realitetit të një ekonomie globale” Ekonomia e Biznesi nr. 1(15) 2004, faqe 59.

flasin për terciarizim të saj. “Sektori terciar aktualisht po bëhet dominues pothuajse në shumë vende të botës, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, ku në tërësinë e bizneseve sot, ekzistojnë rreth 2.5 milion firma shërbimi tregtare sot në botë, shifër kjo 6 herë më e lartë se numri i firmave të prodhimit”.<sup>323</sup>

Sektori terciar po bëhet dominues në ekonominë e shumë vendeve të botës, dhe është shndërruar në fenomen bashkëkohor. Këtë konstatim na e tregojnë edhe *reguesit statistikorë*, si përsa i përket punësimit, ashtu edhe subjekteve sipas aktiviteteve që operojnë në këtë sektor. Nga ecuria e zhvillimit të tij në shumicën e vendeve të zhvilluara, konstatojmë se në të janë të punësuar më shumë se 60 %<sup>324</sup> e popullsisë aktive.

Një fenomen tjetër i evidentuar në këto zhvillime dhe strukturime të reja ekonomike të ekonomisë globale të ndodhura që nga fundi i shekullit të kaluar e në vazhdimësi, është edhe *shumëllojshmëria* me të cilën na shfaqet dega e *shërbimeve*. Kjo, nga njëra anë është pasojë e kërkesave gjithnjë në rritje nga ana e popullsisë për to, ndërsa nga ana tjetër shprehin edhe rritjen e mirëqenies së saj.

Në analizën e sektorëve të ekonomisë, dhe të peshës së tyre në krijimin e PBB-së, jemi mbështetur në klasifikimin dhe statistikat e INSTAT-it<sup>325</sup> për këtë sektor. Mbështetur tek përcaktimi i bërë për tre sektorët e ekonomisë nga ky institucion, analiza e sektorit terciar, është bërë duke pasur parasysh tipizimin e dhënë prej tij, në dy lloj shërbimesh: shërbime tregtare e jotregtare. INSTAT-i ka përcaktuar që: *sektori terciar është aktivitetet që nuk prodhon të mira materiale direkte, që gjithashtu ndahet në shërbime tregtare e jotregtare*<sup>326</sup>. Në *shërbimet tregtare* të këtij sektori, përfshihen: tregtia, transporti, turizmi e disa shërbime të lidhura me to, ndërkohë që në *shërbimet jotregtare* përfshihen: edukimi, administrata publike, mbrojtja, policia, shëndeti publik<sup>327</sup> etj..

Nisur nga struktura e degëve e nëndegëve të tre sektorëve të ekonomisë, si dhe çfarë realizojnë ato gjatë procesit të prodhimit, konstatojmë se, *sektori terciar përfshin ato aktivitete, të cilat prodhojnë mallra e produkte për konsum final në shërbim të konsumatorit*. Krahasuar me sektorin primar e sekondar, sektori terciar prezantohet me një strukturë shumë më heterogjene, ku produktiviteti midis shërbimeve është i

<sup>323</sup> Bushati, S., Kruja, D., Sokoli, J. “Aktivitetet terciare dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e rajonit”. Seminari “Zhvillimi ekonomik i rajonit në Shkodër”, Tetor, 2003,

<sup>324</sup> Po aty.

<sup>325</sup> INSTAT, 1993-2001.

<sup>326</sup> INSTAT, 1999.

<sup>327</sup> INSTAT, 1999.

ndryshëm. Shërbimet tregtare kanë një materializim më të shprehur dhe produktivitet të lartë në ekonomi, krahasuar me shërbimet jotregtare. Heterogjeniteti me të cilën prezantohen këto shërbime, kërkon edhe krahe të shumë pune, duke krijuar premisa për një punësim të mirë të popullsisë në moshën e punës.

Standardi jetësor i popullsisë në vendet e zhvilluara është në rritje të vazhdueshme, e lidhur kjo me të ardhurat më të larta dhe sidomos me cilësinë e shërbimeve. Veçohen këtu shërbimet jotregtare, të cilat bëhen tërheqëse për të gjitha shtresat e shoqërisë. Në të tilla nivele kërkesash, mendojmë se ka arritur edhe popullsia e vendit tonë gjatë tranzicionit. Kjo përbën një arsye më shumë, pse në politikat shtetërore i është dhënë prioritet zhvillimit të sektorit terciar.

Zhvillimi i hovshëm i sektorit terciar në vendin tonë, është karakteristikë e tranzicionit ekonomik. Gjatë sistemit të zhvillimit të ekonomisë së planifikuar, ky sektor jo vetëm ishte pak i prezantuar, por edhe kishte një peshë shumë të ulët në PBB-në e përgjithshme. Duke pasur parasysh strategjinë e zhvillimit të këtij sistemi dhe të modelit të projektuar të tipit sovjetik, në këtë sektor përparësi iu dha vetëm disa shërbimeve jotregtare (arsim, mbrojtje e shëndetësi). Në të njëjtën kohë, shërbimet tregtare gjatë këtij sistemi ishin me strukturë të pakët degësh dhe që karakterizoheshin nga produktivitet më i ulët, se sa ato jotregtare.

Spektori terciar, ka një specifikë shumë dalluese nga sektorët e tjerë, sepse më shumë se çdo sektor tjetër, është i lidhur me *mirëqenien e popullsisë*. Kjo, përbën edhe sfidën e zhvillimeve të sotme, si dhe efektivitetin e politikave sektoriale të elitave shtetërore në botë, por edhe në vendin tonë, të cilat nga ana e tyre i kanë dhënë vlerësimin e duhur këtij sektori, krahas sektorëve të tjerë.

***Pse degët e sektorit terciar kanë marrë prioritet në ekonominë e vendit tonë?***


Janë të shumta arsyet, pse degët e sektorit terciar, qofshin ato tregtare e jotregtare, janë dominuese në statistikat ekonomike shqiptare e shkodrane, si përsa i përket punësimit, ashtu edhe subjekteve sipas aktiviteteve. Ndër faktorët kryesorë përmendim:

- Shërbimet tregtare e jotregtare janë degë, të cilat për t'u materializuar, nuk kërkojnë kapitale në sasi të madhe dhe sigurojnë të ardhura të shpejta;
- Shërbimet tregtare dhe jotregtare janë më të përshtatshme ndaj ndryshueshmërisë së tregut. Ndryshimet që ndodhin në ekonominë e tregut të lirë dhe përshtatshmëria ndaj tij, më shumë janë të evidentuara në degët e këtij sektori dhe nuk i gjejmë tek të tjerat;

- Periudha e tranzicionit shqiptar, e për rrjedhojë edhe atij shkodran, ka treguar që këto biznese paraqiten si më të konsoliduarat, kundrejt bizneseve që operojnë në sektorët e tjerë;
- Ato janë degë, të cilat kanë dominuar gjithë tranzicionin ekonomik shqiptar;
- Degët e këtij sektori, krijojnë mundësi për vende të reja pune, kryesisht punëve të vogla, me konsekuenca pozitive në punësimin e popullsisë etj..

***Si paraqitet struktura e degëve të sektorit terciar dhe roli i tyre në ekonominë e vendit tonë?***

Dinamika dhe ecuria e këtij sektori gjatë tranzicionit del nga vlerësimi që i kemi bërë shërbimeve terciare në treguesin e punësimit, si dhe shpërndarjes së subjekteve sipas aktiviteteve. Nga të dhënat e INSTAT-it, kemi arritur të krijojmë një perceptim të saktë mbi rolin e shërbimeve terciare në punësimin e popullsisë në moshën e punës. Sipas tipizimit të këtyre shërbimeve, panorama e peshës aktuale të *treguesit të punësimit brenda sektorit terciar, prezanton një* pabarazi statistikore në procesin e punësimit midis tyre. Kjo shihet qartë edhe në grafikun si më poshtë vijon:<sup>328</sup>



*Grafiku nr 1: Të punësuar sipas shërbimeve të sektorit terciar.*

Shërbimet jotregtare, të cilat janë të lidhura me arsimin, shëndetësinë, policinë, shoqatat joqeveritare, institucionet kulturore dhe shërbime të tjera, kanë një përqendrim shumë më të madh të të punësuarve të sektorit terciar, në rreth 60% . Kjo tregon se këto biznese kanë krijuar një mundësi shumë të mirë në zgjidhjen e këtij problemi social, në Shqipëri.

<sup>328</sup>INSTAT, 2012 , “Të punësuarit sipas aktiviteteve në vendin tonë”.

Nga ana e tyre, ndikimi i drejtpërdrejtë i këtyre shërbimeve është në rritjen e standardit jetësor dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë.

Shpjegimi i peshës më të madhe të shërbimeve jotregtare në punësimin e popullsisë, është konsekuencë e shumë faktorëve, ku po radhisim më të rëndësishmit:

- Shumëllojshmërinë e këtyre shërbimeve gjatë tranzicionit;
- Nevojat e ekonomisë për të tilla biznese;
- Janë më të qëndrueshmet në ndryshimet e tregut gjatë tranzicionit;
- Janë pasojë e kërkesës për standard të lartë të popullsisë, i cili është i lidhur më shumë se çdo gjë me këto shërbime, e sidomos të shërbimeve komunitare;
- Janë biznese, që aplikojnë të rejat teknologjike në veprimtaritë e tyre, duke u profilizuar e kompjuterizuar më tepër, sesa degët e tjera, etj...

Me një dinamikë krejt tjetër prezantohen këto shërbime në *shpërndarjen e subjekteve* sipas aktiviteteve. Kjo strukturë është e ndryshme midis shërbimeve tregtare e jotregtare, ku në të parën kemi përqendrimin më të madh të subjekteve, me rreth 82% dhe në të dytat, vetëm 18% të subjekteve të sektorit terciar.<sup>329</sup>



Grafiku nr 2: Shpërndarja e subjekteve në shërbimet terciare, në vitin 2012.

<sup>329</sup> INSTAT, 2012, "Regjistri i Përgjithshëm i Ndërmarrjeve aktive në Shqipëri".

Paraqitja grafike flet qartë, jo vetëm për peshën e madhe të shërbimeve tregtare në këtë tregues, por edhe për efektivitetin e investimeve në degët e tyre, të cilat në masën dërrmuese e kanë justifikuar veten. Gjithashtu, numri më i lartë i subjekteve në këto shërbime, flet për mbizotërim të bizneseve shumë të vogla në nivel mikrondërmarrjesh me madhësi 1-9 punëtorë.

### **Politikat e reja sektoriale dhe veçoritë e zhvillimit dhe strukturimit të ekonomisë shqiptare në fazën e tranzicionit.**

Momentalisht, Shqipëria është futur në dekadën e tretë të tranzicionit ekonomik, ku kanë ndodhur ndryshime të mëdha në shumë aspekte të jetës politike, ekonomike e sociale të saj. Këto ndryshime janë pasuar me ndikime në të gjithë aktorët e shoqërisë shqiptare, e për pasojë edhe në ekonominë e tij. Një ndër këto është edhe strukturimi i ri, që pësoi ekonomia në nivel kombëtar e rajonal. Të gjitha ndryshimet e ndodhura në këtë aspekt gjatë tranzicionit, janë të lidhura me ndryshimet e politikave shtetërore ndaj zhvillimit të tre sektorëve.

Përvoja shqiptare, pavarësisht nga progresi i realizuar në këto vite tranzicioni në aspekt të zhvillimit ekonomik, dëshmon për një tranzicion problematik, i cili është shoqëruar me shumë pasoja në aspekt të zhvillimit të tij.

Politikat e zhvillimit sektorial të ekonomisë shqiptare gjatë tranzicionit ekonomik, sollën si domosdoshmëri ndryshimin e tyre. Deri në vitet '90, ekonomia mbështetej tek sektori sekondar e primar, e cila prodhonte më shumë mjete prodhimi, se sa mallra konsumi. *Eksperiencia në përcaktimin e strategjive dhe modeleve të zhvillimit ekonomik kapitalist ishte fare e vogël, si pasojë e mbylljes së skajshme 50-vjeçare.*<sup>330</sup> Sot, kur e gjithë ekonomia botërore është shndërruar në ekonomi shërbimi, edhe në vendin tonë një strukturim i tillë u bë i domosdoshëm, lidhur me kërkesat në rritje të popullsisë dhe nevojës për ndryshim të ekonomisë. Ky ndryshim cilësor i strukturës, është i lidhur me atë që këto degë të sektorit të shërbimeve, kanë ndikime të drejtpërdrejta në mirëqenien e popullsisë. Duke u mbështetur tek përvoja e vendeve, në të cilat ndryshimet strukturore sollën rimëkëmbjen ekonomike të tyre, edhe vendi ynë i dha përparësi sektorit terciar. Degët e tij arritën të kapërcenin krizën e ndryshimit të sistemeve dhe për rimëkëmbjen e tyre, këto degë kërkonin kapital financiar të vogël. *Mekanizmat e instalimit të institucioneve të ekonomisë së tregut të lirë kanë kaluar faza dhe vështirësi të shumta. Të ardhur pas një "urie" për*

<sup>330</sup> Raporti i zhvillimit njerëzor në Shqipëri 1998, faqe 19.

*mallra e shërbime, konsumatori shqiptar iu gëzua vetëm të drejtës së tij për të konsumuar, pa arritur të prodhojë.*<sup>331</sup>

Rritja e vazhdueshme e kërkesave të konsumatorit shqiptar për mallra dhe shërbime të ndryshme të prodhuara nga sektori terciar, u diktuan në:

- Zgjidhjen e problemeve që lidhen me punësimin, problematikë e cila gjen një farë zgjidhje nga zhvillimi i harmonizuar i tre sektorëve të ekonomisë, por veçanërisht atij terciar. Është ky sektor, që krijon shumë vende pune në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë;
- Rritjen e interes të kapitalit të huaj dhe konkretizimi me investime në këtë sektor, krahas me atë sekondar e primar;
- Tendencën rritëse të ekonomisë shqiptare në këtë fazë, e cila është drejtpërsëdrejti e lidhur me zvogëlimin e treguesit të inflacionit, etj...

Reformat e reja ekonomike të zbatuara në aspekt të instalimit të këtij modeli, projeksioni i së cilës ka qenë i gjatë, kanë qenë pasojë e politikave të reja sektoriale të aplikuara pas viteve '90. Këto politika janë të lidhura me të gjitha transformimet e shoqërisë shqiptare në aspektin politik dhe ekonomik, por edhe me ndryshimet demografike e sociale të saj.

Ndërmarrja e këtyre politikave të reja sektoriale nga ana e shtetit shqiptar, u diktuan nga shumë faktorë të jashtëm e të brendshëm, nga të cilët veçojmë:

- Përvojën e vendeve të zhvilluara dhe strukturimet e reja, që pësuan ekonominë e tyre pas LIIB, e sidomos në periudhën e Globalizimit.
- Kësaj i shtohet edhe përvoja e vendeve, që dolën nga të njëjtat modele zhvillimi ekonomik, por me zhvillime më intensive e me procese më të përshpejtuara në aspekt të integritimit në BE.
- Prioritetin që mori ky sektor nga ana e shtetit në krahasim me sektorët e tjerë, për shkak të mbijetesës ndaj krizave e stanjacioneve të ekonomisë shqiptare gjatë gjithë tranzicionit të tejzgjatur;
- Ndryshimet demografike të ndodhura gjatë kësaj faze dhe që lidhen me lëvizjet migrative të brendshme e të jashtme, u pasuan me urbanizim masiv dhe kaotik. Ky urbanizim në përmasa të larta, imponoi jo vetëm politika të reja në aspektin demografik, por dhe ndryshimin e politikave që lidhen me një punësim sa më të mirë të popullsisë, e cila ndryshoi mjedisin jetësor. Në këtë mënyrë shteti

<sup>331</sup> **Prof.dr.Ceku Bardhyl, Ceribashi Elda** "Teoritë e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbrojtja e tij në Shqipëri" *Ekonomia e Biznesi* 1 (15) 2004, faqe 24.



favorizoi degët, që siguruan zgjidhje të kësaj problematike. Punë të vogla dhe pa shpenzime të mëdha, krijohen më tepër nga shërbimet terciare, se sa nga sektorët e tjerë etj...

Modelet e politikave sektoriale të aplikuara në vendin tonë në tranzicion, nuk kanë qenë shumë eficiente, gjë që përbën edhe një arsye më shumë në tejzgjatjen e kësaj faze në Shqipëri. Mosefikasiteti i tyre është i lidhur me disa faktorë, ku ndër to përmendim:

- Mungesën e një modeli të qartë ekonomik, gjë që ka sjellë zgjatjen e kësaj faze;
- Moszgjidhjen e problemit të pronës, ku prona është ajo që përcakton tregun e jo tregu pronën. Kjo përbën edhe elementin bazë të funksionimit të ekonomisë së tregut të lirë kapitalist;
- Dështimet dhe ndryshimet e herëpashershme të elitave në pushtet në aspekt të politikave sektoriale, shkak ky i tejzgjatjes së tranzicionit. Shtojmë këtu edhe konfliktualitetin politik, i cili ka sjellë vonesa në proceset integruuese evropiane në aspekt të anëtarësimit etj...

Zhvillimi i sotëm ekonomik i vendit tonë është pasojë e këtyre politikave sektoriale të aplikuara në këto dy dekada, të cilat kanë synuar vendosjen e disa përparësive social-ekonomike si prioritete zhvillimi. Mirëpo, një vend që mbështetet vetëm tek një degë, ose edhe në një sektor, është i destinuar të preket nga kriza, qofshin këto të brendshme, por edhe të importuara nga jashtë. Politikave sektoriale, që të jenë të efekshme, duhet të kenë prioritare relacionet sektoriale të ndërsjellta të tre sektorëve kryesorë të ekonomisë. Vetëm atëherë, ato do të ndikojnë dhe stimulojnë rritjen ekonomike. *Politikat që marrin në konsideratë tërësinë e sektorëve, janë më efektive se sa ato që e shohin sektorë specifike si iniciues të zhvillimit.*<sup>332</sup>

Pavarësisht se vendi ynë, por edhe vendet të tjera me nivel të ulët zhvillimi në ekonomitë e tyre, pasqyrojnë potenciale në rritje dhe që janë të reflektuara tek treguesit në vlera pozitive të saj, ato mbeten shtete me nivel të ulët ekonomik. Kjo është e lidhur me atë, që efikasiteti i politikave sektoriale duhet të ketë si objekt final, mirëqenien e popullsisë. Kjo situatë e rritjes ekonomike gjatë tranzicionit në vlera pozitive, nuk ka sjellë një gjë të tillë për popullsinë e vendit tonë.

Mirëqenia është e lidhur me disa aspekte të zhvillimit ekonomik, që i sigurojnë popullsisë ushqim të mirë e cilësor, kujdes shëndetësor, por edhe nivel të lartë arsimor. Këta tregues të mirëqenies janë të lidhur

---

<sup>332</sup> Ciceri, B., Strefani, E. *Ekonomitë në tranzicion dhe politikave stimuluuese*, Ekonomia e Biznesit(15)2004, faqe 40.

drejtpërsëdrejti me investimet shtetërore, të cilat duhet të konsiderohen dhe të merren parasysh nga çdo politikë sektoriale. Shërbimet kryesore që ndikojnë në rritjen e mirëqenies, janë të lidhura më shumë me degët e sektorit terciar, i cili nuk mund të funksionojë pa harmonizimin e veprimtarisë së tij me atë të sektorëve të tjerë.

### **REKOMANDIME**

- Terciarizimi i ekonomisë, nuk do të thotë lënie pas dore i sektorëve të tjerë, përkundrazi nga një zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm i të tre sektorëve, varet edhe suksesi i sektorit terciar;
- Zhvillimi i degëve të sektorit terciar, e veçanërisht i shërbimeve tregtare, nuk mund të kuptohet pa sektorin primar dhe sekondar, duke krijuar një raport të drejtë midis prodhimeve të të mirave materiale e shërbimeve të lidhura me to;
- Suksesi i reformave ekonomike dhe përfshirja e vendit tonë me të gjitha atributet në ekonominë globale varet nga stabiliteti politik dhe social;
- Dinamizmi dhe qëndrueshmëria e zhvillimit të sektorit terciar në të ardhmen, harmonizuar me zhvillimin edhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë, krijon premisa të sigurt për punësimin e popullsisë aktive, e cila pavarësisht nga ndryshimet e elitave politike do të gjejë tek ky sektor garanci të sigurt punësimi.

**LITERATURA**

- Bushati, S. Kruja, D., Sokoli, J. “Aktivitetet terciare dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e Rajonit”. Seminari “Zhvillimi ekonomik i rajonit Shkodër”, Tetor, 2003.
- Prof. as. dr. Andri Koxhaj, Grida Duma M.P.A “Shqipëria përballë realitetit të një ekonomie globale”, Ekonomia e biznesi nr. 1(15) 2004.
- Ciceri, B., Strefani, E. “Ekonomitë në tranzicion dhe politikat stimuluese”, Ekonomia e Biznesi1(15) 2004.
- Raporti i zhvillimit njerëzor në Shqipëri 1998.
- Prof.dr. Ceku Bardhyl, Ceribashi Elda “Teoritë e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbrojtja e tij në Shqipëri”, Ekonomia e Biznesi 1(15) 2004.
- INSTAT, 2012 “Të punësuarit sipas aktiviteteve në vendin tonë”.
- INSTAT, 2012, “Regjistri i Përgjithshëm i Ndërmarrjeve aktive në Shqipëri”.

**Globalization and the place of Albania. Structural changes that  
Albanian economy has undergone during transition**

***ABSTRACT***

This paper aims to present the role of globalization in the transformation of global economy, especially in our country economy after the change of systems. New economic structuration processes during transition aimed to involve all the economic system in the liberalization processes of market economy trade and the worldwide relations. Actually Albania economy remains a “*market sector*” for the global integrated and competitive economy.

After the 90s the Albanian society was involved in all dimensional significant changes. Because of the transition from a centralized and commanded economy to a free market one there emerged the need to turn from the public property into the private one. This transition was oriented from a wide complex of economic, political and social factors. Their interaction affected the change of the proportion of the three economy sectors in the GDP and resulted in the lead of the tertiary sector as a priority.

The role of the tertiary sector is combined and harmonized with the development of the other economy sectors, primary and secondary ones. It is also affected by other natural, geographic, socio-demographic and political factors which influence its progress.

***Key words:*** economic transition, tertiary sector, commercial services, noncommercial services

**Isida HOXHA**

## **RIPREZANTIMI I GRUAS NË DISKURSION MEDIATIK, MARS, 2017**

### *Hyrje*

Steriotipet gjinore në shoqërinë shqiptare janë të pranishme si rrjedhojë e një sërë faktorësh. Konteksti historik përta i përket traditës dhe kulturës përgjatë viteve është një tregues për dallimet dhe steriotipet gjinore. Pa analizuar gjatë periudhat historike të mëparshme, mjafton të përmendim perceptimin e përgjithshëm mbi rolin e gruas si një qenie jo e barabartë me gjininë tjetër, kundrejt së cilës kishin të drejta të pakufishme familjarët si babai apo burri. Me vendosjen e sistemit komunist u ndërtua imazhi i gruas/burrë e cila paraqitej si një forcë e barabartë me seksin tjetër, të paktën nga ana sipërfaqësore. Në Shqipëri, ashtu si në vendet e tjera të ish- bllokut të lindjes, vitet 1990 janë vite të cilat lidhen me ndryshime politike, pasi pas një periudhe gati 50- vjeçare kemi kalimin e sistemit nga një sistem komunist në një sistem demokratik. Ky shndërrim politik padyshim që do të reflektonte dhe do të jepte pasoja në të gjitha fushat, si ekonomike, sociale etj. Shoqëria me gjithë dëshirën e madhe për liri dhe demokraci u gjet e papërgatitur, pasi paradigma të rëndësishme u shembën. Një situatë e tillë tranzicioni do të prekte të gjithë aktorët e shoqërisë në forma dhe mënyra të ndryshme, por në këtë punim me interes për ne është roli dhe pozicioni i gruas. Ndryshimi i sistemit politik riaktivizoi edhe njëherë diferencën e madhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet përta i përket dallimeve gjinore. Në këtë kontekst, kur studiojmë rolin e gruas në Shqipëri, patjetër që hasemi me diskriminim, steriotipe ekzistuese tek anëtarët e shoqërisë. Në këtë punim na intereson të kuptojmë rolin e medias si përforcuese apo si kundërshtuese e steriotipeve, përta i përket punës që ajo bën në lidhje me riprezantimin e gruas në diskursin e saj.

### **Metodologji, analiza e diskursit**

Në këtë artikull studiohet riprezantimi i gruas në median e shkruar të pavarur, gjatë dy javëve të para të marsit, të vitit 2017. Përzgjedhja e materialit është bërë duke analizuar gazetat e përditshme që i përkasin shtypit të shkruar të pavarur. Përzgjedhja e datave nuk ka një preferencë të

veçantë, pasi është e rastësishme. Për t'u kthyer përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura, pasi është përcaktuar harku kohor i përzgjedhur, studiohet mbulimi mediatik duke u bazuar tek riprezantimi i gruas. Burimet e studimit janë gazetat: "Panorama", "Gazeta Shqiptare", "Shekulli", "Mapo", të cilat janë gazeta me shtrirje kombëtarë dhe kanë një peshë të rëndësishme në shtypin e shkruar.

Teoria e përzgjedhur për realizimin e këtij studimi është teoria e kornizimit mediatik. Qasja kryesore e kësaj teorie është e lidhur me teorinë e përcaktimit të axhendës, pasi të dyja mbështeten tek rëndësia që luan media përsa i përket formësimit të opinionit publik, duke e orientuar mbi atë se për çfarë duhet të mendojë. Ndarja mes këtyre dy teorive qëndron tek elaborimi që i bëri Goffman (1974) dhe teoricienë të tjerë duke përfshirë edhe ato që studiojnë barazinë gjinore dhe diskursin. Media jo vetëm na tregon se për çfarë të mendojmë, por edhe si të mendojmë, nëpërmjet përzgjedhjes që bën gazetari gjatë procesit të punës. Mënyra se si lajmet ndërtohen dhe i paraqiten publikut, influencon në zgjedhjet që ky i fundit do të bëjë, pasi mesazhet e përcjella kanë forcë të influencojnë në mënyrën se si njerëzit duhet të mendojnë rreth një ngjarje apo çështje.

Metodologjia e përdorur është analiza e diskursit e cila i referohet qasjes së Fairclough dhe Van Dijk. Sipas Fairclough "*analiza e diskursit bazohet në supozimin se gjuha është një pjesë e pashndërrueshme e jetës shoqërore, e ndërlidhur në mënyrë dialektike me elementët e tjerë të jetës shoqërore, kështu që analiza sociale dhe kërkimore duhet të marrë parasysh gjuhën*". (2003:2)

Sipas qasjes së Van Dijk studimi i rolit të diskursit midis elementëve të tjerë, duhet të përfshijë patjetër edhe studimin e temave, pasi personifikojnë "...shprehin informacionin më të rëndësishëm të një diskursi..." (Wodak, Meyer 2001:102) Riprezantimi i gruas në diskursin mediatik në funksion të tematikave të trajtuara në harkun kohor të përzgjedhur, na lejon të ndërtojmë një tipologji studimore sipas kategorive gazetareske, si: gazetaria politike, kronika e zezë, gazetaria rozë, kulturë.

Diskursi studiohet duke iu referuar klasifikimit që Halliday (1994) bën në lidhje me funksionet e gjuhës. Sipas tij gjuha kryen tri funksione njëherësh duke iu referuar funksionit konceptual, ndërpersonal dhe tekstual. Tek funksioni konceptual gazetari shpreh me anë të gjuhës eksperiencat dhe përvojat e veta të brendshme përsa i përket ngjarjeve që lidhen me realitetin. Mjetet më të rëndësishme të këtij funksioni të përzgjedhura për studimin janë leksiku dhe transitiviteti. Sipas Mills "*studimi i transitivitetit është i lidhur me mënyrën se si veprimet janë riprezantuar, çfarë lloj veprimesh shfaqen në tekst, kush i bën ato dhe mbi kë ato*

*bëhen*”(1995:143-144) Transitiviteti është mjeti më i mirë i riprezantimit pasi lidhet me mundësitë dhe opurtunitetet që gazetari mund të përdorë për të ndërtuar diskursin duke iu referuar pjesëmarrësve si dhe rolit që ata luajnë në proces. Elementi më i rëndësishëm këtu është evidentimi që çdo tekst lidhet me përzgjedhjen që bën gazetari, pasi ekzistojnë forma të ndryshme për të riprezantuar një ngjarje duke pasur parasysh foljet e përdorura. Gjithashtu duke iu referuar leksikut mund të përdoren strategji të ndryshme për të emërtuar aktorët e përfshirë në proces.

### **Diskursi mediatik dhe barazia gjinore**

Në analizën e diskursit duhet të theksojmë që gjuha në gazetari ka një forcë të madhe, pasi ajo influencon shoqërinë në të cilën vepron. *“Gazetaria ka efekte shoqërore; përmes forcës së saj për të formuar çështjet e axhendave dhe diskutimin publik, ajo mund të rifytojë besimet; ajo mund të formojë opinionet e njerëzve jo vetëm në botë, por edhe vendin e tyre dhe rolin në botë; ose nëse ajo nuk formon opinionet tuaja në një çështje të caktuar ajo mund të influencojë sadopak mbi mendimet tuaja”*. (Richardson 2007: 13)

Riprezantimi gjinor është një tematikë e cila ka ngjallur interes në studimet mbi median. Studime të ndryshme mbi gjuhën e përzgjedhur në diskurs tregojnë se dallimet gjinore ndërtohen përmes diskursit, ose ndryshe përmes gjuhës në përdorim. Diskursi mund të ndikojnë në krijimin e roleve dhe stereotipeve gjinore. Këtu mund t’i referohemi qasjes së Butler i cili thekson që *“dallimet gjinore krijohen nga njerëzit”* (Butler, 1990) Stereotipet gjinore lidhen me perceptimin e anëtarëve të një shoqërie si pasojë e kulturës që mbizotëron në atë shoqëri. Stereotipet që shoqërojnë gruan lidhen me klasifikimin e saj si grup më i dobët, emocional, më e pafuqishme, irracionale, seksi etj. Këto stereotipe ekzistuese bëhen pjesë e diskursit mediatik nëpërmjet riprezantimit të ngjarjeve. Mbulimi mediatik nuk është një reflektim i realitetit, pasi një sërë faktorësh influencojnë deri tek faza e fundit, kur teksti është i gatshëm për t’u konsumuar nga publiku. *“Lajmi është një riprezantim i botës në gjuhë...lajmi është një riprezantim në kuptimin e ndërtimit; ai nuk është një reflektim i lirë i “fakteve”*” (Fowler, 1991: 4) Diskursi në media shërben për të prezantuar dhe riprodhuar këto stereotipe, në funksion të ideologjive ekzistuese, *“të cilat mund të kontribuojnë në ndërtimin, ruajtjen dhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore të pushtetit, dominimit dhe përjashtimit”* (Fairclough, 2003:9)

### **Analizë: Riprezantimi në diskursin mediatik**

Identifikimi i temave në diskursin mediatik për objektin e studimit është fillesa e kësaj analize, pasi temat luajnë një rol të rëndësishëm. Në varësi të temave të analizuara gjatë periudhës së marrë në studim kemi ndërtuar një tipologji studimore sipas kategorive gazetareske të evidentuara, si: gazetaria politike, kronika e zezë, gazetaria rozë, kulturë. Secila prej tyre shfaq karakteristikat përkatëse të cilat shërbejnë për t'i kthyer përgjigje, pyetjeve kërkimore të ngritura në këtë artikull.

### **Riprezantimi i gruas në politikë**

Roli i gruas në Shqipëri mbetet në parametra jo të balancuar në qoftë se e krahasojmë me pozicionin e burrit në shoqëri. Problematika të shumta që lidhen me dallimet gjinore shfaqen në shoqërinë shqiptare, pasi shpeshherë gruaja stereotipizohet. Këto stereotipe shfaqen edhe në jetën politike, përse i përket jo vetëm pjesëmarrjes, por edhe rëndësisë që ka në vendimmarrje gjinia mashkullore në raport me gjininë femërore. Në kontekstin shqiptar, ku një faktor të rëndësishëm luan edhe sfondi historik si përforcues i dallimeve gjinore, janë propozuar dhe miratuar ligje për të mundësuar krijimin e një atmosfere më favorizuese për gratë. Ligji i cili pati mjaft diskutime duke e parë nga dy këndvështrime të ndryshme, pro dhe kundër, ishte ai i përfaqësimit të grave në kuotat e 30% në listat e partive politike. Në vende si Shqipëria implementimi i një detyrimi të tillë është një strategji për të rritur numrin e grave deputete, të cilat nuk përfaqësohen në nivelet e duhura. Vendosija e kuotave solli rritjen e numrit të deputeteve pas vitit 2008, edhe pse u shoqërua me strategji të cilat nuk favorizuan respektimin e 30%. Vendosija poshtë në renditje e grave kandidate për deputete apo kërkesa për refuzimin e mandatit nga ana e tyre, ishin strategji të përdorura nga partitë politike dhe liderët e tyre.

Në këtë kategori, gratë riprezantohen si përfaqësuese të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare. Pjesë e diskursit mediatik janë artikuj të tillë, si: “Kreu i PD-së i përgjigjet shefes së BE-së: Zgjedhjet, kusht për anëtarësimin. Vetingu hap negociatat? Basha-Mogherini: Bullshit”(Madani 2017:3); “Ligjshmëria e ONM, diplomatët tri orë me Calavera”(2017:3); “Nishani-Mogherini: Të shmangjet politizimi i reformës në drejtësi”(2017: 11); “Calavera i përgjigjet Vasilit: Roli i OMN parashikohet në Kushtetutë” (2017:7); “Felaj: Institucionet e drejtësisë nuk ngrihen pa u bërë vetingu”(2017:3); “Gjermani: Legalizim 100 mijë objekteve”(Manjani 2017:8); “Bregu pajtohet me Bashën, luan negociatoren” (2017:11)



Një element për t'u theksuar është rëndësia që merr ngjarja kur i referohet gruas si përfaqësuese e politikës ndërkombëtare në raport krahasues me riprezantimin e gruas në politikën shqiptare. Kjo vjen si rrjedhojë e kontekstit politik shqiptar dhe rolin e institucioneve dhe organizmave të huaj, në përmirësimin e klimës politike vendase.

Në këtë kategori shfaqen dhe liderët e forcave politike ku në kuadër të datës 8 mars e cila njihet si dita e gruas, bëjnë thirrje për barazi gjinore, apo premtime si “*Çlirojmë nga barra e sakrificës të gjitha nënat shqiptare*”. (2017:6)

Një event i përzgjedhur për t'u kthyer në lajm është pritja që Linda Rama organizoi me gazetarë, deputetë, përfaqësuese të shoqërisë civile, me rastin e 8 marsit. Mbititulli i këtij artikulli formulohet duke përcaktuar pozicionin e saj si bashkëshorte “*Rrëfimi i bashkëshortes së kryeministrit: Ç'më tha Zaho sot*” (2017:6)

### **Kronika e zezë**

Analiza e riprezantimit të gruas në diskursin mediatik, për periudhën e marrë në studim, tregon që kategoria që dominon është kronika e zezë. Rezulton një dominim i artikujve që lidhen me abuzime të formave të ndryshme, si fizike, psikologjike, të cilat përshkallëzohen deri në vrasje apo vetëvrasje të grave. Megjithë përpjekjet e bëra nga institucionet përkatëse për hartimin e politikave dhe strategjive për barazi gjinore dhe kundër dhunës, problematikat vazhdojnë të jenë aktuale. Një krahasim shifrash tregon që situata nuk ka ardhur duke u përmirësuar, përkundrazi. Statistikat për vitin 2016 tregojnë që pavarësisht se është rritur numri i kërkesave për divorc është ulur numri i kërkesave për urdhër mbrojtjeje, krahasuar me 2015-ën. Kjo situatë përmbysset në tremujorin e parë të vitit 2017, pasi numri i urdhrit mbrojtës ka ardhur duke u rritur “*janë 127 kërkesa për lëshim urdhër mbrojtje të menjëhershme dhe 64 të tjera*” (Çuka 2017:6-7)

Tituj të tillë, si: babai djeg me ujë të nxehtë vajzën; ndërhyri për të na ndarë, po më dhunonte burri; hedh nga shkallët gruan shtatzënë; vajza ime i dha fund jetës për shkak të dhunës nga bashkëshorti; sherri për një femër, plagosen me thikë dy 24 vjeçarë; vetëhelmohet studentja; Fatbardha vrau të shoqin e helmoi veten; si u mbyt me qese e moshuara etj., janë pjesë përbërëse e rëndësishme e axhendës mediatike. Këto ngjarje kërkojnë mbulim mediatik, por këtu një rol luan edhe mënyra se si media përzgjedh për të raportuar duke iu referuar vlefshmërisë apo rëndësisë së lajmit, pasi “*lajmi nuk është thjesht se çfarë ka ndodhur, por ajo çfarë prezantohet si e vlefshme dhe e rëndësishme për të qenë 'lajm'*”. (Fowler 1991:13)

Mënyra e përzgjedhur për mbulim mediatik është përfshirja e këtyre ngjarjeve/ lajmeve tek kronika e zezë, kur mund të trajtohen jo vetëm sipas kësaj kategorie. Me pushtetin e saj media mund të influencojë pozitivisht përmes mesazheve sensibilizuese nga ekspertë dhe autoritete, nëse lajme të tilla trajtohen edhe si probleme sociale, por diçka e tillë nuk ndodh.

Një problematikë tjetër e evidentuar gjatë analizës është mediatizimi i viktimës edhe atëherë kur duhet t'i sigurohet anonimati, shpesh për efekt sensacioni. Kodi Etik Shqiptar (2006) ka të përcaktuar mënyrën e raportimit, i cili duhet të marrë parasysh nevojën për të mbrojtur të miturit. Në artikullin "*Konflikti në familje, babai djeg me ujë të nxehtë vajzën 14 vjeçe. Nëna: ndërhyri për të na ndarë, po më dhunonte burri*" (Haxhiaj 2017:15) bëhen publike midis të tjerash emri i vajzës, mosha e saj minorene, emri i shkollës, si dhe klasa ku studion.

### **Gazetaria rozë**

Gazetaria rozë në qendër të vëmendjes ka shfaqje, spektakël, e cila nga ana përmbajtësore për t'u realizuar kërkon që gazetari të investigojë gjatë procesit të punës. Krahasimi me tabloide dhe modele perëndimore tregon për një ndarje qëndrimesh të vetë gazetarëve. Njëra palë nuk sheh ndryshime krahasuese, ndërsa tjetra klasifikon si problematike përdorimin e shpifjeve, trillimeve, në dëm të mbrojtjes së privatësisë. Pavarësisht faktit se kush ka të drejtë, interes për këtë artikull shfaq diskursi në funksion të riprezantimit të gruas, për të kuptuar nëse media transmeton dhe përforcon stereotipet gjinore. Karakteristika kryesore e faqeve rozë si pjesë përbërëse e gazetarisë prezanton një standard shoqëror të mbështetur tek bukuria, fiziku, paraqitja e jashtme ku theksohet seksualiteti, stili i jetesës, të shprehura përmes diskursit apo imazheve foto. Në funksion të këtyre karakteristikave prodhohet një diskurs ku dominon riprezantimi i grave në krahasim me gjininë tjetër, duke zënë vendin kryesor përse i përket axhendës mediatike në këtë kategori.

Fuqia e diskursit në krijimin dhe ruajtjen e ideologjive ekzistuese, sipas kategorizimeve të individëve në grupe të caktuara, është e madhe. Një ndër atributet kryesore që i adresohen grave, duke i kategorizuar si një grup, është ai që lidhet me emërtimin seksi. Në funksion të forcuar mund të sjellim disa nga artikujt e publikuara gjatë periudhës së marrë në studim: "*Greta dhe Eni Koçi, të bukurat që u bënë seksi me kalimin e viteve*" (2017:14) "*Jeta luksoze e vajzës seksi të Eli Farës, Marina i çmend të gjithë me veshjet markë dhe udhëtimet e shtrenjta*"(2017:15) "*Gjyste Vulaj: Pse vendosa të vij si një balerinë seksi klubesh*"(2017:17) Përsosmëria fizike, pamja e jashtme seksi, janë imazhe që serviren në diskursin mediatik

dhe që përforcojnë stereotipet e krijuara nga shoqëria për gratë, duke përjashtuar individin dhe duke përfshirë grupin, si kategorizim me atributet e sipërmendura. Në funksion të efekteve që prodhon përdorimi gjuhësor seksist, mund të studiohen sjelljet, qëndrimet e shoqërisë si rrjedhojë e modelit mediatik të prezantuar në gazetarinë rozë.

### **Riprezantimi simbolik, kulturë**

Analiza e riprezantimit të gruas në diskursin mediatik, për periudhën e marrë në studim, tregon një riprezantim simbolik në këtë kategori. Riprezantimi simbolik i gruas studiohet përmes tematikave dhe mënyrës së ndërtimit të diskursit. Artikujt e publikuar në “Gazetën Shqiptare” dhe “Mapo”, kanë si subjekt gratë, të cilat prezantohen në rolin e bashkëshortes dhe bijës. Artikulli i parë i referohet rrëfimit të Brikena Çabej në kuadër të takimeve letrare të organizuar nga Beti Njuma dhe Alda Bardhyli. Në këtë rast Brikena bëhet pjesë e diskursit mediatik si vajza e Eqerem Çabej “*Jeta ime me babanë, si u njoh me nënën dhe raporti me Hoxhën*” (2017:12)

Artikujt e tjerë paraqesin të njëjtat karakteristika, pasi kemi gruan të prezantuar si bashkëshorte të Gaqo Çakos dhe të Martin Camaj “*E shoqja Luiza Papa: Nuk jam penduar për sakrificat*” (Nikolli 2017:12) dhe “*Stinë e re për Martin Camaj*” (2017:13) Gratë bëhen pjesë e diskursit mediatik përmes lidhjeve familjare të tyre, në këtë kategori.

Data 8 mars shënon një domethënie të rëndësishme për gratë, për të drejtat dhe kërkesat e tyre. Në aktivitetin e organizuar nga Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi në bashkëpunim me shoqatën “Gruaja tek Gruaja”, përmes një kolane fotografike sillen histori të grave shkodrane të cilat kanë kontribuar në fusha të ndryshme, si: Marie Kraja, Luçie Miloti, Marie Çoba, Kushe Micja, Naile Hoxha etj. Artikulli “*Gratë e Shkodrës, Tringë Smajli, shqiptarja e zbulimit ushtarako-politik të 1900-ës*” (Nikolli 2017: 13) është një ndër artikujt më me vlerë për karakteristikat e grave të cilat paraqiten në një tjetër këndvështrim, në funksion të kontributit të tyre ndër vite, si: lufëtare, artiste, sportiste etj.

### **Leksiku dhe transitiviteti**

Leksiku është një ndër mjetet kryesore të identifikuar në funksionin konceptual të gjuhës. Mënyra se si gazetarët vendosin të emërtojnë aktorët e përfshirë në ngjarje ka një domethënie, pasi nuk është e paqëllimshme. Gazetari mund të përdorë emërtime të ndryshme në funksion të karakteristikave që shfaqen si pjesë e kategorive sociale përkatëse. Kjo lidhet me përfshirjen në një kategori të caktuar, duke

injuar përfshirjen në një tip tjetër kategorie, gjatë ndërtimit të tekstit, për të përshkruar një individ. Reisigl and Wodak (2001) gjatë punës së tyre i kanë quajtur opsionet e emërtimeve në tekst ‘strategji referuese’, përzgjedhja e të cilave në një formë dhe jo në një tjetër mund të ketë qëllime të ndryshme. Këto strategji na lejojnë të kuptojmë mënyrën se si gratë e përfshira në diskursin mediatik, riprezantohen. Emërtimi i tyre në politikë konsiston kryesisht në përdorimin e këtyre fjalëve: shefe, ambasadore, përfaqësuese e lartë, nënkryetare, ministre. Kronika e zezë është kategoria që dominon në raport me riprezantimin e gruas në diskursin mediatik, ku përdoren emërtime të tilla si vajza, bashkëshortja, e moshuara, femër etj. Përforsimi i leksikut dhe strategjive referuese në kronikën e zezë, realizohet përmes procesit si element i transitivitetit, i cili është i lidhur ngusht me përdorimin e foljeve. Me interes për këtë studim është identifikimi i tyre, pa u ndalë në klasifikime të mëtejshme. Foljet e përdorura gjatë ndërtimit të teksteve fokusohen kryesisht tek: mbyt, djeg, dhunon, hedh, godet, vetëhelmohe, vret, helmoi.

Në gazetarinë rozë riprezantimi i grave arrihet përmes emërtimeve vajza seksi, balerinë seksi, të bukurat, seksi. Në dallim nga gazetaria rozë ku gruaja dominon në raport me gjininë tjetër, në tematikat që lidhen me kulturën ajo vjen përmes emërtimeve, si: bija, bashkëshortja, vajza, zonjat.

Studimi i leksikut dhe i strategjive referuese (pjesë e transitivitetit) përsa i përket aktorëve të përshirë në diskurs përforcon karakteristikat steriotipizuese të këtij target-grupi, “*në funksion të paradigmave ideologjike në diskurs të cilat i caktojnë gruas një status special, devijant në disa apektë*”. (Fowler1991:97)

### **Konkluzione**

Axhenda mediatike dominohet me artikuj që përfshihen në kronikën e zezë gjatë riprezantimit të gruas, e cila përforcon steriotipet e krijuara në shoqërinë tonë. Ngjarjet e përzgjedhura për t’u kthyer në lajme janë ngjarje që lidhen me vrasje, vetëvrasje apo dhunë të formave të ndryshme. Diskursi mediatik ndërtohet duke i grupuar këto lajme vetëm në kronikën e zezë (shpesh të sensacionalizuara) dhe duke përjashtuar përfshirjen e tyre tek tematika sociale, e cila do të prodhonte të tjera mesazhe.

Në gazetarinë rozë prodhohet një diskurs ku dominon riprezantimi i grave në krahasim me gjininë tjetër. Diskursi mediatik prezanton një standard shoqëror të mbështetur tek bukuria, fiziku, paraqitja e jashtme ku theksohet seksualiteti dhe stili i jetesës.

Tematikat dhe ndërtimi i diskursit në hapësirën që zë kultura, sjellin një riprezantim simbolik të grave, pasi ato bëhen pjesë e diskursit përmes lidhjeve të tyre familjare, si bijë apo bashkëshorte e një figure të shquar. Diskursi mediatik në riprezantimin e gruas përforcon karakteristikat stereotipizuese të gruas. Stereotipet që shoqërojnë gruan lidhen me kategorizimin e saj si grup më i dobët, emocional, më e pafuqishme, irracionale, dipendente etj.

#### LITERATURA

- Butler, R. (1990): *Gender trouble: Feminism and the subversion of identity*. New York: Routledge
- Fairclough, N. (2003): *Analysing discourse, Textual analysis for social research*. London: Routledge
- Fowler, R. (1991): *Language in the news*. London: Routledge
- Goffman, E. (1974): *Frame analysis, An essay on the organization of experience*, New York, NY et al: Harper&Row
- Halliday, M.A.K (1994): *An introduction to functional grammar* (2<sup>nd</sup> ed.). London: Edward Arnold
- Mills, S. (1995): *Feminist stylistic*. London: Routledge
- Reisigl, M. & Wodak, R. (2001): *Discourse and Discrimination: Rhetorics of racism and anti-semitism*, London: Routledge
- Richardson, J. (2007): *Analysing newspapers, An approach from critical discourse analysis* New York: Palgrave Macmillan
- Wodak, R. & Meyer, M. (2001): *Methods of Critical Discourse Analysis*, London: Sage Publications

[http://w.w.wosce.org/sq/albania/21235/Kodi Etik i Medias Shqiptare](http://w.w.wosce.org/sq/albania/21235/Kodi%20Etik%20i%20Medias%20Shqiptare)

#### Gazeta:

“Basha: Shkollat të hapura deri në 16:00 Çlirojmë nga barra e sakrificës të gjitha nënat shqiptare”, *Panorama* 9.3.2017, f.6.

“Bregu pajtohet me Bashën, luan negociatoren”, *Shekulli* 2.3.2017, f. 11.

“Calavera i përgjigjet Vasilit: Roli i OMN parashikohet në Kushtetutë”, *Mapo* 11-12.3.2017, f. 7.

Çuka, Alma, “Janë 127 kërkesa për lëshim urdhër mbrojtjeje të menjëhershme dhe 64 të tjera”, *Shekulli* 8.3.2017, f. 6-7.

“Felaj: Institucionet e drejtësisë nuk ngrihen pa u bërë vetingu”, *Gazeta Shqiptare* 7.3.2017, f. 3.

Manjani, Ornela, “Gjermani: Legalizim 100 mijë objekteve”, *Shekulli* 2.3.2017, f. 8.

“Greta dhe Eni Koçi, të bukurat që u bënë seksi me kalimin e viteve”, *Panorama* 11.3.2017, f. 14.

“Gjyste Vulaj: Pse vendosa të vij si një balerinë seksi klubesh”, *Panorama* 11.3.2017, f. 17.

Haxhiaj, Klodiana “Konflikti në familje, babai djeg me ujë të nxehtë vajzën 14 vjece. Nëna: ndërhyri për të na ndarë, po më dhunonte burri”, *Gazeta Shqiptare* 1.3.2017, f. 15 .

“Jeta luksoze e vajzës seksi të Eli Farës, Marina i çmend të gjithë me veshjet markë dhe udhëtimet e shtrenjta”, *Panorama* 11.3.2017, f.15.

“Lista e zezë e vetingut, Lu e Vlahutin Ligjshmëria e ONM, diplomatët tri orë me Calavera”, *Gazeta Shqiptare* 1.3.2017, f. 3.

Madani, Valentina, “Kreu i PD-së i përgjigjet shefes së BE-së: Zgjedhjet, kusht për anëtarësimin Vetingu hap negociatat? Basha-Mogherini: Bullshit”, *Gazeta Shqiptare* 5.3.2017, f. 3.

“Nishani- Mogherini: Të shmanget politizimi i reformës në drejtësi” Shekulli 2.3.2017 f.11  
“Rrëfimi i bashkëshortes së Kryeministrit: Ç’më tha sot Zaho”, *Panorama* 9.3.2017, f.6.

### **Representation of the women in the mediadiscourse, march 2017**

#### ***ABSTRACT***

This article analyses independent written press discourse toward women representation in Albania. Gender disparities in our society are still present even though there are done many initiatives from local and foreign authorities in order to eliminate it. In this context media can and should have a positive role because of its power to expand the information quickly and to a wide audience in a very short time. This doesn't mean that the audience which takes these messages will decode them in the same way, because of the numerous factors which influence, but despite this media can direct the audience in what to think. In communication sciences something like that is legitimated through Agenda Setting's theory which during its elaboration in Framing theory admits not only public orienting in what to think about but also how to think about. Research questions of this study are: How are represented women in the independent written press in Albania? Are society stereotypes reinforced by the press? The used methodology is discourse analyse for the studied period.

## RECENSION

### JUSTIN RROTA, “*GJUHA E SHKRUEME ASE VËREJTJE GRAMATIKORE*”

Atë Justin Rrota ishte një gjuhëtar me emër që shquhej për potencialin shkencor, me kontribute të veçanta në fushën e gjuhësisë. Një ndër veprat e rëndësishme në dorëshkrim që për shumë kohë mbeti pa botuar titullohet “*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*”.<sup>1</sup>

#### *Trajtat e shqipes ase Morfologjia* ( f.179-450)

*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore* hartuar në vitet '50 të shekullit të kaluar, mbeti në dorëshkrim në sirtarët e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë prej afro gjysmë shekulli. Ajo, pa dritën e botimit afro gjysmë shekulli pas vdekjes së autorit, më 2006, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Biblioteka françeskane “Atë Gjergj Fishta”, Kolona e botimeve françeskanë, Botime françeskane, Shkodër, 2006, me redaksi: prof. Emil Lafe, prof. Enver Hysa, prof. David Luka.

Vepra ka 612 faqe, e ndarë në gjashtë pjesë:

1. Burimi i shqipes (Leksikologji) 2. Tingujt e shqipes (Fonologji) 3. Trajatat e shqipes (Morfologji) 4. Fjalja e shqipes (Sintaksë) 5. Të përbamit e fjalëve (Etimologjia) 6. Lavruesit e shqipes (Albanologjia).

Ndonëse ajo është shkruar shumë kohë më parë, redaksia e botimit në parathënie thekson se ajo “*nuk ka ndërhyrë në pikëpamjet e autorit për disa çështje të ndryshme shkencore, megjithëse sot gjuhësia shqiptare u ka dhënë një zgjidhje tjetër më të mbështetur. Vepra e Justin Rrotës i përket kohës kur u shkrua dhe përpjekja e tij shkencore duhet vlerësuar brenda caqeve të asaj kohe.*”<sup>2</sup>

Ky botim rrok disa disiplina gjuhësore, disa prej të cilave janë të njohura prej lexuesit, si sintaksa etj.

Në këtë shkrim jemi ndalur vetëm në pjesën e tretë “*Trajtat e shqipes ase morfologjia*” që zë më shumë se 1/3 e këtij botimi ( f.179-450). Rrota ka përshkruar me shumë hollësi veçoritë dhe kategoritë gramatikore të pjesëve të ligjëratës, shoqëruar në shumë raste me mendimin personal të autorit diku të drejta, por në disa raste edhe të stërzgjatura. Ai konstaton dhe bën propozimet përkatëse, ndonëse jo gjithnjë janë të realizueshme nga

vetë gjuha, pavarësisht sa janë të drejta. Kështu disa prej tyre nuk kanë pasur jehonën e dëshiruar.

Struktura e veprës nuk është e njëjtë me gramatikat e hartuara para Rrotës. Në shumicën e rasteve e nis me shembujt, pastaj jep rregullat, por jo gjithnjë, pasi ka raste që e fillon me sqarime teorike.

Problemet morfologjike nuk janë trajtuar në mënyrë të veçantë, në ndonjë tekst të mëparshëm nga Rrota. Edhe në tri botimet e sintaksës së Rrotës nuk jep ndonjë gjë konkrete për këtë çështje. Kështu në Sintaksin e vitit 1942 si shtojcë shënon ndryshimet tipike ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes, ndërsa në botimin e vitit 1943 në parathënie sqaron se “*orthografisht kemi pranuem shumë sende, ndër të cillat, jo aq pse na e mbushën mendën, por vetëm për hir të bashkimit na u duk se mund të lëshojmë pë nëmose deri që me një vendim zyrtar të caktohen definivisht.*”<sup>3</sup> Në fund bën një shtojcë të dytë, që e titullon “*Rreth orthografisë së përdorun*”. Në nëntë paragrafë sqaron autori, sipas bindjes së tij, se çfarë rregullash drejtshkrimore kishte zbatuar në këtë botim. Në kopertinën prapa nën titullin “*Nji gjykim mbi botimin e parë të kësaj veprë*” shënohet: “*At J.Rrota, një ndër shkencëtarët më të mdhâj që kemi në lâmbën e gjuhësisë, i cilli para pak muejve botoi këtë libër, që simbas të dâmit të zakonshëm, kishte me përbâ pjesën e dytë të gramatikës, ndërsa âsht paralajmue të vûemit në shtyp të pjesës së parë morfologjisë me titullin “Gramatika e gjuhës shqipe”*”<sup>4</sup> Edhe M.Domi e cek këtë problem në nekrologjinë për J.Rrotën kur thekson se në vitet e fundit të jetës i mbledhi shënimet dhe vëzhgimet për morfologjinë, me të cilat hartoi një morfologji të gjuhës shqipe, që i shtoi edhe disa disiplina të tjera gjuhësore. Vetëm kaq.<sup>5</sup> I vetmi botim nga fusha e morfologjisë, kryesisht me karakter historik është libri “*Analyzimi i rasavet t’ëmnit e zhvillimi historik i tynve*”.

Rrota është origjinal dhe, për mendimin tim, ai nuk ka pasur parasysh botimet gramatikore, gjë që shihet në strukturimin e veprës.

\* \* \*

Pjesa e tretë e kësaj monografie titullohet “*Trajtat e shqipes ase Morfologjia*”, që lexuesi njihet për herë të parë, pasi ajo pa dritën e botimit vetëm në vitin 2006. Disa nga kriteret që ka ndjekur autori për hartimin e kësaj pjese e informon lexuesin në parathënien që shoqëron dorëshkrimin. Sipas autorit, kjo vepër paraqitet “*ma fort normative.*” Kjo pasqyrohet më shumë ndër vërejtjet praktike. Ilustrimet teorike janë marrë nga gjuha e gjallë e popullit, duke mënjanuar shembujt e huazuar nga gjuhët e tjera. Autori këshillon që gramatologu duhet të mbledhë të gjitha trajtat



gramatikore që përdoren qoftë edhe me karakter dialektor brenda dhe jashtë Shqipërisë.

J.Rrota hyn menjëherë në temë dhe me një stil të qartë përcakton se sa pjesë ligjerate ka gjuha shqipe, që për Rrotën janë dhjetë, të ndara në *të lakueshme* gjashtë dhe *të palakueshme* katër. Si pjesë të ligjeratës pranon edhe nyjën, por nuk shënon pjesëzën.

Për emrin, me të cilin fillon përshkrimin e pjesëve të ligjeratës jep fillimisht përkufizimin dhe pastaj veçoritë e tij, të ndara në emra të përgjithshëm dhe të përveçëm, shoqëruar me vërejtje drejtshkrimore dhe më pas jep të dhëna të tjera të përfshira në vërejtje, si ç'janë emrat përmbledhës. Si të tillë pranon edhe ata emra që përdoren në numrin shumës, si: *popull, ushtri* etj. Trajton emrat konkretë që ai i quan *të landët* dhe abstraktë, *të palandët*. Në vërejtje përfshin edhe çështje të fjalëformimit, duke u ndalur në fjalët e përbëra. Theksojmë se, sipas Rrotës, shqipja ka dy gjini për vetat dhe frymorët sipas seksit: mashkullorë dhe femërorë. Në vërejtje trajton edhe gjininë asnjane, duke sqaruar se cilët emra në shqipe merren në këtë gjini. Ai është i mendimit se sendet e pajetë nuk duhet të përfshihen as në gjininë mashkullore, as në femërore, por si në gjuhët evropiane në atë asnjane. Diskuton edhe për çështje me karakter dialektor, si është rasti i dygjinisë. Rrota si për emrin, ashtu edhe për pjesët e tjera të ligjeratës jep mjaft të dhëna, të cilat i kalojnë caqet e këtij libri. Kështu për emrat *e përplotë* (substantiva abundantia) që i konsideron ata të cilët përdoren aty-këtu dy gjinish, prandaj kanë edhe dy lakime, jepen 58 vërejtje me karakter interpretimi apo sugjerimi. Këto e rëndojmë në disa vise monografinë.

Shumë hollësi jep për shumësin e emrave dhe në veçanti për rasat e emrit. Për autorin dy rasat gjinorja dhe dhanorja, duke qenë se kanë të njëjtën mbaresë nuk duhet të merren si dy rasa. Të njëjtën vërejtje bën edhe për rasën thirrore që për autorin nuk duhet të figurojë. Vërejtje bën edhe për rasën vendore. E quan të pakuptimtë përdorimin e rrjedhës së pashquar *mish lepri* etj., që për autorin duhet përdoret në trajtë të shquar. Kështu vazhdon edhe me disa trajta të tjera të përdorimit të rasave të emrit. Kur Rrota jep pasqyren e lakimit të emrave, që kanë mbaresa të njëjta, ato i grupon. Kështu për gjininë mashkullore në të pashquarën njëjës jep dy forma ndryshimi: 1. *em. kall. thirr*, 2. *gjin. dhan. rrjedh.*, ndërsa për të shquarën njëjës jep tri forma: 1. *em. thirr*, 2. *gjin. dhan. rrjedh.* 3. *kall*. Pastaj jep edhe pasqyra për dy gjinitë e tjera, si dhe për numrin shumës. Rrota gjinore-dhanoren në shumësin e shquar, e përdor me mbaresën –t: *pusavet, punëvet*. Ai vazhdon me trajtimin e çështjeve të tjera që kanë lidhje me veçoritë e emrit, si: *Emna të mangët* (nomina defektiva). Janë emrat që

përdoren vetëm në numrin njëjës apo në shumës; *emra zvoqlues*, të cilët përdoren me prapashtesat: *-kë, -th* dhe *-zë*.

Një trajtim të gjerë u ka bërë edhe nyjave të shqipes. Citojmë nga Rrota: “*Nejet ase artikujt, këto grimca parazite, të cilat kanë nderin të njehen në rendin e pjesëve të ligjeratës; këto thërrime, sado që nuk kanë jetë në vete, luejnë por një rol fort me randsi, kur i ngjiten para a mbas emnit, për t’a shque a për t’a lidhë me emna të tjerë.*”<sup>18</sup> Ai i ka ndarë nyjat në *të lidhura* dhe *të këputura*, jep origjinën e tyre dhe pastaj në 15 vërejtje bën sqarime sipas bindjes së autorit për këto nyja, qoftë me karakter dialektor, por duke dhënë edhe prirjen e tyre në shqipen e asaj kohe. Janë vërejtje të hollësishme, disa prej të cilave paraqesin interes edhe sot.

Mbiemrin e pranon *të nryejshëm* dhe *pa nyje*. Jep shumë hollësi për veçoritë e tyre qoftë edhe me karakter dialektor apo drejtshkrimor. Pas një informacioni të shkurtër për lakimin e mbiemrave, ndalet te shkallët e mbiemrit, duke pranuar: shkallën pohore, krahasore dhe eprore (sipërore, T.O.). Autori vazhdon me sqarime për shkallët gjithnjë duke e ilustruar me shembuj. Rrota pastaj bën një ndarje të tillë: mbiemra *diftues, të pacaktuem, pronarë, numrorë, rendorë* etj. Si gjithnjë bën sqarime përkatëse.

Numërorët i ndan në *themelorë* dhe *rreshtorë*, shoqëruar me sqarimet përkatëse me karakter gramatikor, drejtshkrimor dhe dialektor. Përemrit i ka dhënë një vend të gjerë prej 54 faqesh. Fillimisht jep 6 përemra, të cilët, sipas Rrotës, përdoren si përemra, por edhe si mbiemra (substantivisht e adjektivisht), duke lënë jashtë përemrin *vetvetor* dhe atë *reciprok*. Në vazhdim përshkruan tetë: 1.përemnat *vetorë* 2.përemni *bredhtuer* (P.refleksiv) 3. përemnat *diftorë* 4. përemnat *pronorë* 5. përemnat *pyetës* 6. përemnat *lidhorë* 7. përemnat *e pacaktuem ase të pakufishëm* 8. përemni *reciprok*. Në kapitullin e përemrave ka përfshirë si zë më vete edhe *ndajfoljet përemërore*.

Për përemrin *vetor*, pas përkufizimit dhe disa sqarimeve për të, jep lakimin e tij në tri vetat njëjës dhe shumës, fillimisht pa trajtat trajtat e shkurtra dhe pa a-në nistore, pasi në vetën e tretë njëjës dhe shumës i përdor pa a-në. Pranon për këtë vetë trajtat e vjetra dhe jo ato analogjike. Trajtat e shkurtra i veçon, duke i quajtur grimcat e përemrave *vetorë*. Vazhdon me formimin e trajtave të bashkuara, duke i shkruar me apostrof trajtat *më +e* dhe *të+e = m’a* dhe *t’a*, që tradita e mëvonshme gramatikore i përdori pa apostrof. Jep përdorimin e trajtave të shkurtra dhe të bashkuara si trajta proklitike dhe enklitike. Bën sqarime me karakter etimologjik, drejtshkrimor dhe dialektor, duke iu referuar edhe albanologëve G.Majerit dhe H.Pedersenit.

Përemri vetvetor, sipas autorit, e ka origjinën tek emri. Lakimin e tij e nis nga rasa gjinore *i, e vetes* ase *i,e vedit*. Nuk e ka rasën emërore, por edhe mund të përdoret, si: Ra *vetja (vedja)* e më këputi. Rasa kallëzore përdoret e shoqëruar me parafjalë. Autori bën vërejtje, duke dhënë edhe versionin e tij për trajtat *vetiu(t), vetëvetiu(t), i vet, vetë*. Rrota e trajton si çështje më vete pjesëzën përemrore *u* që përdoret në foljet e formës joveprore, që autori e quan *grimcë përemnore refleksive*. Shënon se kur përdoret si trajtë proklitike dhe enklitike.

Përemnat dëftorë. Si përemra dëftorë autori pranon *ky, ai* me kategoritë përkatëse. Këta përemra, si dhe ndajfoljet përgjegjëse gegërishtja i përforcon me fjalëzat *nje* dhe *qe: njeky... njajo, qeky..., qajo* etj. Autori diskuton edhe për trajta të tjera "*qai, qatê, qesajt, kyne, kêtene, tijnaj, kësajnaj*" etj. Rrota të gjinisë asnjansë merr përemrat dëftorë: *këta, ata*, kur dihet se ajo në praktikën e sotme gjuhësore nuk përdoret. Gjithashtu kur jep lakimin e përemrave dëftorë në rasën rrjedhore njëjës dhe shumës jep trajtat e vjetra dhe jo ato analogjike me rasën dhanore.

Si përemra dëftorë autori pranon edhe: *i, e, të tillë, këtillë, atillë*. I merr si përemra *kaqë* dhe *aqë*, të cilët lakohen sipas Rrotës, por përdoren edhe si ndajfolje. Autori diskuton edhe për fjalën *i,e, të njajtë (njëjtë)* që e konsideron neologjizëm.

Përemrat pronorë. Ata përdoren si përemra dhe si mbiemra. Autori i ndan në tri grupe sipas strukturës:

1. *pronorë të panyjshëm: im, yt, ynë* etj. 2. *pronorë të nyejshëm* (si mbiemra): *e, të mi, mija; e, të, tu, tua, i, e, të vet* etj. 3. *në pronorë të rrjedhur prej gjinore sh së përemrit të vetës së tretë: i, e tij, i, e saj, i, e tyne*.

Pastaj trajton përemrat pronorë vetorë, përemrat pronorë vetvetor dhe ata që shoqërojnë emra të farefisnisë. Autori bën shumë vërejtje për përemrat pronorë, trajtimin, gabimet e tjerë. "*Në qoftë se ekziston në ndonjë gjuhë një anarkí në lamën e gramatikës, këjo ekziston në gjuhën shqipe ndër përemrat pronorë*"<sup>6</sup> - thekson Rrota. Dhe për këtë shpjegon se cilat janë arsyet e kësaj anarkie, duke akuzuar shkrimtarët e deri diku edhe gramatikanët. Dhe numëron tre faktorë: a). "*nuk u studjuen mirë shkrimtarët e vjetër; b. nuk u bâ një studjim krahasues i trajtavet të ndryshme të nëndjalektevet; c. së mbramit, në vështirësín e madhe që paraqesin përemnat pronorë, tue qenë këta një diçka siu generis në gramatologjín shqipe.*"<sup>7</sup>

Ai nuk mjaftohet me konstatime, por rreshton edhe gabimet që janë bërë me përemrat pronorë, duke i korrigjuar ato. Rrota pastaj ndalet te rruga që do të ishte më e drejta për të zgjidhur këtë problem kaq të ndërlikuar.

Përsëri i mëshon idesë së tij për të studiuar autorët e vjetër, trajtat që përdorin ato, që janë ende sot të gjalla e të përdorura në nëndialektet e veriut. Kështu Pedersen konstatoi se mbaresat e emnave e të mbiemrave, si dhe ato të quajturit artikuj nuk janë tjetër vetëm përemni vetuer i vetës së tretë ase përemni dëftuer, i vënë re së pari nga Boppi e pastaj nga Pekmezi. Në këtë rast Rrota vlerëson veprën e Ndre Mjedës për përemrat pronorë të botuar në vitin 1934, ndonëse edhe ajo ka ndonjë të metë, por ky studim “*mbetë një gur themelit i përhershëm në këtë pikë*”<sup>20</sup> për problemin që diskutohet. Në vazhdim ndalet për formimin e përemrave pronorë të dy vetave të para që, sipas Rrotës, janë formuar nga përemri vetor i vetës së tretë (trajta e plotë) e prej trajtave të shkurtra të përemrit vetor.

Është një trajtim i hollësishëm i parë jo vetëm në rrafshin sinkronik, por edhe diakronik e dialektor. Vërejtjet janë të shumta, gjë që shqyrtimi i tyre do të përbënte një studim më vete, pasi shumë trajta të përemrave pronorë janë kapërcyer në shqipen e sotme. Kjo shihet edhe kur autori jep pasqyrën e lakimit të përemrave pronorë duke i marrë në bashkëvajtje me emrin ose të emëruar.

Përemrat pyetës. Në përemrat pyetës shënon edhe ndonjë me karakter dialektor, si: *qish*. Jep veçoritë e secilit përemër pyetës, ndonëse disa sugjerime apo konstatime nuk janë të drejta. Përemrin pyetës *se* e merr të gjinisë asnjë. Si rasë rrjedhore të përemrit *sa* merr *sash*, kur këtë trajtë nuk e ndeshim as në shkrimet e kohës së Rrotës. Kështu mund të diskutohet edhe për çështje të tjera.

Shënon përemrat lidhorë të cilët janë të mirëfilltë ose përemrat pyetës të përdorur si lidhorë. Jep veçoritë e përemrave lidhorë të mirëfilltë, që (*qi*) dhe *i cili* dhe më pas *kush*, *çka*, *sa* dhe *qish*, të cilët zberthehen në përemër lidhor dhe dëftor, gjë që trajtohen edhe sot në gramatikat tona. Trajton edhe rastin *ku*, *kah*, sipas autorit, mund të zërë vendin e përemrave lidhorë, pa përcaktuar se ato janë ndajfolje lidhore, e dyta edhe parafjalë.

Një trajtim të hollësishëm i bën përemrit të pacaktuar ase të pakufishëm. Fillimisht sqaron se këta përemra për disa karakterizohen si përemra të pacaktuar cilësie dhe sasië, për të tjerë sipas përmbajtjes. Rrota i përshkruan sipas përmbajtjes, duke u ndalur së pari te fjalëza *një*, veçoritë e saj dhe përngjitja më fjalëza të tjera. Një vend të gjerë u ka kushtuar edhe disa përemrave që, sipas strukturës, janë të përngjitur. Si edhe më parë, autori i referohet përdorimeve nga autorët e vjetër dhe si dëgjohen disa prej tyre në të folmet dialektore. Rreth disa përemrave të pacaktuar është çështja që trajton së fundi Rrota e veçanërisht për përemrit *kush* e përemrat e tjerë që janë formuar nga ky përemër etj.

Përemri reciprok. Rrota e veçon këtë përemër, i cili tregon frymorë ose sende ndërmjet të cilëve vendosen marrëdhënie të ndërsjellta. Këtu autori ka përfshirë *njëni-tjetrit*, *shoqi-shoqit* me kategoritë përkatëse. Ai është mjaftuar vetëm me këto dy përemra, ndonëse sot ata përfshihen jo si grup më vete, por në përemrat e pacaktuar që tregojnë në mënyrë të pacaktuar frymorë ose sende, që veprojnë në mënyrë të ndërsjellte. Në këtë kapitull ka trajtuar edhe ndajfoljet përemërore, ku janë përfshirë edhe fjalë që nuk shërbejnë si ndajfolje përemërore, por si ndajfolje të mirëfillta. Pas përfundimit të përemrave një trajtim të veçantë u ka kushtuar vërejtjeve të disa formave përemërore.

Vendin më të gjerë ia ka kushtuar foljes, që zë më shumë se 100 faqe (327-433). Si nëntitull shënon: A. Natyra, trajtat (diateza). Fillimisht jep përcaktimin e foljes dhe më pas ndalet te foljet vetore të cilat mund të jenë *kaluese* që tregojnë një veprim që bie mbi një kundrinë të drejtë dhe *pakaluese* ato folje që tregojnë një veprim që bën kryefjala “*por nuk vret në një kundrinë të drejtë.*” Pastaj ato i ndan në *vepruese* (aktive) kur kryefjala bën një vepër, *pësuese* (pasive) kur kryefjala pëson një veprim të kryer prej të tjerëve, *bredhtore* (refleksive) kur veprimi i kryer nga kryefjala bie mbi atë që kryen. Këto folje ndahen në *bredhtorë të vërtetë*, që kur kthehen në trajtën veprorë marrin si rrethanor përemrin vetvetor veten dhe në *bredhtorë pësuesë* kur folja e kësaj diateze nuk mund të marrin përemrin veten, që sot trajtohen si mesore. Vazhdon autori duke përfshirë edhe *bredhtorë reciprokë*, kur folja tregon një veprim që kryhet ndërmjet dy a më shumë kryefjalësh.

Foljet *pakaluese* bëhen pësore vetëm në vetën e tretë njëjës dhe trajtohen si folje pavetore, si jetoj që nuk mund të thuhet jetohem. Autori dallon se disa folje *veprorë* pakaluese, si: *jetoj, des* etj. quhen edhe *verba neutra* ase *asnjansë*, pasi nuk janë as veprorë, as pësore.

Rrota vazhdon me përdorimin e foljeve me reksione të ndryshme sipas diatezave. Sqaron se foljet mund të jenë pavetore kur shënojnë fenomene atmosferike, por në një kuptim më të gjerë ata që tregojnë një ndodhje apo një gjasë etj. si: *duhet, lypet mjafton* etj. ose ndërtime me emra ose mbiemra që shoqërohen me foljen ndihmëse *kam* ose *jam*, si: *Asht e vërtetë...ka gjasë..nuk të vjen mirë* etj. Gjithashtu si folje pavetore merren edhe ato folje që nuk mund të marrin një kryefjalë, si: *Kështu po flitet, më bâhet se po del moti, dihet se* etj. Autori nuk i dallon foljet njëvetore nga ato pavetore.

Shkurtimisht analizon foljet nga pikëpamja e prejardhjes duke i ndarë në të thjeshta ose të parme (primitiva), duke mos bërë dallimin e këtyre dy koncepteve gjuhësore dhe të prejardhura (derivate) që i quan edhe

*verba denominativa*. Këto folje të prejardhura vijnë nga emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët dhe nga ndajfoljet. Për të gjithë këto folje ka vënë në parentezë temën fjalëformuese të tyre, por në mjaft fjalë ajo sot është e diskutueshme. Gjithshtu autori nuk shënon foljet që vijnë nga vetë foljet dhe nga ndonjë pjesë tjetër e ligjeratës. Ai e barazon temën e fjalës me rënjen.

Rrota pranon këto mënyra të foljes, duke sqaruar se çkupton me secilën prej tyre: 1. M.diftore 2. m.urdhënore 3. m.lidhore 4. m.dëshirore 5. m.habitore 6. m.kushtore.

Trajton si çështje të veçantë kur këto mënyra përdoren në trajtën mohore.

Format e pashtjelluara ( i quan *mënyrët e pakufijores*) i konsideron trajta emnore të foljes ku dallon: *infinitivi, participi dhe gjerundi*, duke theksuar fillimisht anën formale që ato nuk kanë një trajtë sintetike, që ne e kemi humbur, ashtu si disa gjuhë ballkanike, si: bullgarishtja, rumanishtja etj. Kështu për Rrotën nuk duhet kuptuar vetëm pjesorja e shkuar, gjë që nuk të krijon bindje. Paskajorja (infinitivi) ndërtohet me fjalëzën *me* për gegënishten *me dashtë* dhe me *për të* për toskënishten *për të dashur*. Autori bën ndonjë sqarim për përdorimin e infinitivit. Ai thekson se gegërishtja e përdor së tepërmi këtë trajtë, ndërsa toskërishtja e ka zëvendësuar me lidhoren, por “*për unifikimin e gjuhës është mirë të lëshojnë për të dyja palët: gegënishtja tue e rrallue përdorimin dhe toskënishtja tue shtie do më tepër në punë infinitivin*”.<sup>9</sup>

Vazhdon me pjesoren ku jep fillimisht prapashtesat me të cilat ajo formohet, duke veçuar edhe ata të toskërishtes. Ndalet në ato folje që dalin me temë në bashkëtingëlloret l, ll, r, rr dhe që marrin prapashtesën -ë : *folë, dalë, sjellë, vjelë, marrë etj*. Pastaj jep pjesoret me prapashtesa të tjera, përdorimin e tyre dhe mendimin e tij. Bën shumë vërejtje, për përdorime të gabuara, kthimin e saj me anë të nyjës në mbiemër, krahasuar edhe me toskërishten. Rrota pranon pjesoren e tashme që, sipas autorit, është një trajtë e shkurtër pa mbaresë. Pjesores së shkuar i shtohet prapashtesa -s për gjininë mashkullore dhe -se për gjininë femërore: *shkues, rrues, kujtues, djegës, shkuese, lypse, xanse etj*. Pjesorja e shkuar, sipas Rrotës, ka kuptim pësues, ndërsa pjesorja e tashme ka kuptim aktiv, që thirret emër veprues, por kur përdoret në gjininë femërore shënon emër vegle a sendi : *fshesë, lidhsë, mjelsë, shtisë etj*. Autori vazhdon me vërejtje të tjera,

Edhe përcjelloren (gjerundi) e quan mënyrë që ndërtohet me pjesëzën *tue* geg. dhe *duke* tosk. dhe ka dy kohë të tashmen (*tue shkruë*) dhe të kaluemen (*tue pasë shkruë*). Formën joveprore të gjerundivit e përdor me fjalëzat *për të, për t'u: Æshtë për t'u mbajtë mend, s'qe për t'i*

*marrë për të keq .Ka dy kohë të tashmen dhe të kaluemen: tue luejtë e tue qeshë (përcj. e tashme); tue i pasë thanë (përcj.e kalueme)*

Përcjellorja mund të shoqërohet nga folja ndihmëse jam që tregon një veprim në zhvillim e sipër: *Jam tue shkruie* një letër.

Foljet në shqipen zgjedhohen, sipas Rrotës duke ndërruar mbaresat sipas mënyrës, kohës vetës dhe numrit. Ata i ndan në dy grupe:

1 *Verba të fortë* që nuk pësojnë ndryshime fonetike gjatë zgjedhimit dhe  
2. *Verba të ligshhtë* që pësojnë ndryshime fonetike gjatë fleksionit të tyre. Rrota pranon të tashmen të kaluemen dhe të ardhshmen. Diftorja i ka të gjitha kohët, ndërsa mënyrat e tjera nuk i kanë të gjitha. Për dëftoren rendit: 1. e tashmja 2. e pakryemja 3. auristi 4. e përtejkaluemja (= e kryera e tejshkuar) 5. e kaluemja ase e kryemja I, 6. e kaluemja II 7. e tejkaluemja(=më se e kryera) 8. e ardhshmja që autori jep dy konstrukte : *kam me* (për të) *shkue, do të shkoj* 9. *e paraardhshmja* (= e ardhshmja e përparme). Këto folje i ndan në të thjeshta dhe të përbbame. Jep kuptimin kryesor të secilës kohë, por shënon edhe shumë vërejtje për to. Foljet *eja, ejani; hajt, hajtni; hajde hajdeni* janë trajta pasthirmash, të parat nga latinishtja, të dytat nga turqishtja. Të dytat pranohen si pasthirmma, të parat jo. Gjithashtu autori edhe për foljet që në të pakryerën dalin me temë në të dhe marrin mbaresën *e*. Ai kërkon që këto folje të shkruhen me *-tt* dhe jo me *-st*: *shetitte, porositte* etj,

Folja ka dy numra dhe tri veta për njëjësën dhe shumësin.

Jep zgjedhimin e foljes ndihmëse që i quan *ndihmëtare*: *jam e kam* për të gjitha mënyrat, por duke shënuar si ç' shkruan Rrota vetëm ato që janë të përdorshme. Në emërtimin e kohëve nuk mban të njëjtin qëndrim. Autori i ka kufizuar trajtat e ngushta dialektore dhe përpiqet të japë ato të mbarë shqipes, si: *jemi, kemi, ishe, ishte, kishe, kishte, (ji), jini, kij, kini*; pjesore e tashme *qenës, pasës*, e kaluemja *qenë, pasë* (qenun, pasun) etj.

Foljet i ndan në 4 klasë dhe secilën klasë në dy degë, mbështetur në temën e së tashmes, auristit dhe pjesores së shkuar, me përjashtim të tri foljeve në *-mi* (*jam, kam e thom*):

Klasa I përfshin foljet që mbarojnë me temë në bashkëtingëllore, me përjashtim të foljeve që dalin me *-të*, që në të tashmen dalin me *-s* : *voztë - vozis, shetitë-shetis*.

Dega I përfshin foljet që dalin me bashkëtingëllore dhe përkojnë me auristin dhe pjesoren e së shkuarës: *lagi, laga, lagë* etj.

Dega II përfshin foljet që dalin me bashkëtingëllore, të cilat kanë në temë – *ie-* apo *-e* dhe në të kryeren e thjeshtë e kthejnë në *o*: *bredhi-bredha, djegidogja*.

Pastaj autori bën disa sqarime për zgjedhimin e këtyre foljeve.

Klasa II përfshin foljet që dalin në *-t*, të cilat në vetën e parë marrin mbaresën *-s*: *mas, matë, masim, matni, masin* etj.

Dega 1 përfshin foljet që e kanë të njëjtën temë me të kryerën e thjeshtë: *këpus-këputa* etj.

Dega 2 përfshin foljet me *-s* që në të kryerën e thjeshtë pësojnë fenomenin e metafonisë : *vras, vret, vritni, vrasim*.

Klasa III përfshin foljet që dalin me temë në zanore, por në të tashmen e dëftores marrin mbaresën *-j*,

Dega 1 përfshin foljet të cilat kanë në trup ose në fund një zanore të gjatë fundore: *gjej, flej, fryj* etj.

Dega 2 përfshin pjesën më të madhe të foljeve që dalin me *-aj (laj), -ej (blej), -iej (ziej) -oj (bashkoj)* etj.

Klasa IV përfshin foljet e parregullta.

Dega 1 përfshin foljet që dalin me zanore të gjatë hundore: *lâ-lashë, lanë* etj.

Dega 2 përfshin foljet që dalin me zanore të gjatë johundore apo me diftong: *di-dita, shpie-shpjeva* etj.

Pastaj autori jep pasqyra të zgjedhimit të foljeve në të gjitha mënyrat, përfshirë edhe foljet e pashtjelluara, shoqëruar me shumë vërejtje, të përdorimit të tyre qoftë edhe dialektore, shoqëruar me sqarime shkencore.

Autori vazhdon me ndërtimet e formave joveprore me anë mbaresash, por këtu tërheq vëmendjen se në të pakryerën krahas mbaresave *esha, eshe* etj , në gegërisht e ndeshim edhe me pjesëzës u. Edhe forma të tjera ndërtohen me pjesëzën u. Kjo pjesëz në mënyrën urdhërore vendoset në fund të foljes, si *hiqu*. Në trajtën mohore ajo paravendoset *mos u ligsho*. Ndërsa kohët e përbëra ndërtohen me anë të foljeve ndihmëse *kam* e *jam*. Rrota jep pasqyra të zgjedhimit të foljeve joveprore të të gjitha mënyrave. Sqaron pastaj se cilat folje quhen pavetore, sipas konceptit të tij, ç'është auristi sigmatik etj.

Ndalet në disa veçori të përdorimit të disa trajtave të foljeve të mënyrave të ndryshme.

Si çështje të veçantë ka analizuar formimin e foljeve të prejardhura, si edhe ato pavetore, duke u ndalur në shurdhimin e parashtesave.

E mbyll kapitullin e foljeve, duke dhënë një listë prej 21 foljesh në pjesore që i emërton *të mangëta* (=të parregullta), *të forta* (=ata që pësojnë ndryshime fonetike) a *të parregullta*. Jep ndryshimin e tyre në kohë dhe mënyra të ndryshme.<sup>10</sup>

37 faqe u ka kushtuar pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës (f.413-450).



**Parafjala.** Pas përkufizimit dhe disa veçorive të tyre, i klasifikon sipas kriterit sintaksor.

1. Të rasës emërore shënon: *te, tu, tek tuk* duke bërë sqarimet përkatëse për secilën prej tyre. Ndalet edhe në përdorimin e parafjalës *kah* për gegërishten dhe *nga* për toskërishten. Duke qenë se shqipja ka specifikë të përdorë edhe parafjalë për rasën emërore, që nuk e ndeshim në gjuhët e tjera, për autorin kjo është një *casus rectus*, që duhet kuptuar kështu: *Shetita kahë Zalli i Kirit d.m.th. shetita andej kahë është Zalli i Kirit.*

2. Parafjalë të rasës dëshmore (=kallëzore) a vendore: *me, mbë, mbi, përmbi*. Këtu përfshin edhe: *mi, më, përmi, për, ndër, nën*, si dhe pjesëzat *djeri(deri), gjeri* që zakonisht shoqërohet me parafjalën.

3. Parafjalët e rasës rrjedhore (gjinore ?): *para, përpara*, por edhe *prej, mbas, tej* që për Rrotën sot marrin më shumë gjinoren; gjithashtu edhe: *pas, mbas, prapa, mbrapa, ith(pas), kundra, kundruell, përtej, tej etj.* Për parafjalën *prej* jep edhe kuptimet e saj. E mbyll trajtimin e kësaj pjese të ligjeratës duke shënuar si çështje të veçantë vërejtje rreth disa përdorimeve të parafjalëve. Vërejtje ka bërë edhe gjatë trajtimit të secilës parafjalë si për origjinën ashtu edhe përdorimin e tyre.

**Lidhëza.** Pas përkufizimit Rrota lidhëzat i ndan: *njërendore* (koordinate) dhe *nënrendore* (subordinate), *të thjeshta* dhe *të përbëra*. (Autori i konsideron të përbëra lidhëzat e përngjitura). Tërheq vëmendjen se e njëjta lidhëz mund të përdoret jo vetëm në një funksion sintaksor e për këtë duhet një kujdes i veçantë. Autori bën vërejtje edhe për përdorimin e drejtë të tyre, duke i treguar konkretisht. Gjithashtu bën vërejtje drejtshkrimore për disa lidhëza dhe për përdorimin dialektor të tyre.

**Ndajfolja.** Një vend të gjerë i ka kushtuar ndajfoljes, që pas një trajtimi të shkurtër të veçorive të ndajfoljes, përmes vërejtjeve që rrokin 55 të tilla, autori bën sqarimet përkatëse, përdorimet dialektore, origjinën etj. Për Rrotën shumica e ndajfoljeve janë cilësorë, për nga struktura janë *të thjeshta* ose *të përbëme*. Shënon emrat që përdoren si ndajfolje, kryesisht të rasës rrjedhore. si: *motit, heret, faret* etj. nga mbiemrat *i mirë-mirë, i shkurtë-shkurt*. Ndalet te shkallët e ndajfoljes që për autorin janë tri të tilla, që ndërtohen me ndajfoljet *mâ, mâ fort, mâ pak, aqë..sa, shum, fort* etj. Sipas kuptimit ato i ndan në ndajfolje : *vendi, kohe, mënyre, sasi, dyshimit*. Në vërejtjet e shumta që bën Rrota, jep shpjegime rreth përdorimit dhe drejtshkrimit të tyre, përdorimet dialektore etj., ndonëse ka çështje që dija e sotme i ka kapërcyer.

**Pasthirrma.** E mbyll trajtimin e foljeve me pasthirrmën. I ndan sipas strukturës në *të thjeshta* dhe *të përbame*, por edhe *shprehje*. Pastaj ai i analizon duke shënuar sipas kuptimit të tyre, pasi e njëjta pasthirrmë, mund të shprehë ndjenja të ndryshme në varësi të kontekstit dhe intonacionit. Shënon gjithashtu tingullimitimet (autori i quan *zane onomatopejke*) që janë riprodhime britmash, tingujsh, zëra të sendeve dhe objekteve të ndryshme të botës sonë, qoftë të njerëzve, kafshëve dhe shpendëve apo edhe dukuri atmosferike. Njëkohësisht disa kanë vlerë olofrastike, si: *po*, *jo*, *qe* etj.

Së fundi ndalet te pasthirrma *hingne* që e ndeshim te Buzuku dhe që autori e ka trajtuar gjërësisht, në artikullin “*Pasthirrma buzukjane “hinje” dhe pjesëzën toskënishte “tuke”*”.

\* \* \*

Rreth terminologjisë gramatikore të përdorur te pjesa e tretë “*Trajtat e shqipes ase morfologjia*”.

Atë Justin Rrota si gramatikan i mirëfilltë, ndonëse ishte zotërues i disa gjuhëve të gjalla dhe të vdekura, përgjithësisht parapëlqente një terminologji shqipe që disa prej këtyre termave i ndeshim edhe në gramatikat e paraardhësve.

Autori për pjesët e ligjeratës jep termin e njohur shqip, ndërsa në parantezë emërtimin latin.

Çfarë kriteri ndoqi Rrota për përdorimin e termave? Autori nuk ka qenë konsekuent për këtë problem.

Së pari përdor vetëm termat shqip. Po shënojmë disa prej tyre, si: *gjinia mashkullore, femërore, shumësi i emrave, origjina e nyjeve, shkallët e mbiemrit, përemrat vetorë, diftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, e tashmja, e tashmja lidhore, dishrorja, kushtorja* etj.

Së dyti, autori ka krijuar edhe vetë disa terma shqip, por duke qenë të paqarta për lexuesin jep në parantezë termin latin si: emra të *landët* (konkret), *të palandët* (abstakt), emna të *mangët* (nomina defectiva), emna të *përplotë* (nomina abundantia), *përemni bredhtuer* (pronomen reflexivum), *folje kaluese* (transitive), *pakaluese* (intransitive), *pësuese* (pasive), *mënyra e pakufi* (infiniti), *trajtimi i dëshrores dhe i kushtores* (Optativi dhe kondicionali).

Së treti, përziën trajtat shqipe me ato latine ose e kundërta, si: lakimi i substantivit, mënyrat mohuese të verbit, *zgjedhimi i verbave, kohët e verbit, verba të fortë dhe verba të lightë, verbat frazeologjike* etj.

\* \* \*

*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore* është një vepër e madhe për kohën kur e hartoi Justin Rrota. Ai “ka bërë përpjekje për të pasqyruar të plotë sistemin e gjuhës shqipe në tërësinë e tij, shoqëruar me vështrime informuese e vlerësuese rreth historisë së studimeve në fushat e trajtuara”.<sup>11</sup>

J.Rrota, kur e ka shkruar veprën, ka qenë në një gjendje të rënduar nga sëmundja. Ashtu i sforcuar nga shëndeti ka pranuar dhe i ka mirëpritur çdo vërejtje me karakter shkencor që i bënte Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë, të cilat me shumë vullnet i ka realizuar. Në një letër që i dërgon K. Çefës, më 29.01.1962 e njofton, në mes të tjerash se “*më ka ardhë parmbaramit edhe një shtëllungë dorëshkrimesh të ashtuqejtunës ‘Gjuhë e shkrueme’. Tashti, qyshë dje, kam plasë me i qortuem. Dësh Zoti e i krevë së qortuemit*”.<sup>12</sup> Kështu vepra ka kaluar së rishikuarit nga ana e J.Rrotës, ndonëse ka qenë një dorëshkrim i vëllimshëm, por që nuk e pa dritën e botimit sa që gjallë autori.

Edhe në këtë vepër flet për gjuhën unike të folur, e cila, sipas autorit, “do të vijë prej vedit”, problem që e ka trajtuar edhe në shkrimin “*Rreth problemit të gjuhës letrare*”<sup>13</sup> Ai avancoi në pikëpamjen e tij, duke kërkuar që “*të mendojmë e punojmë për unifikimin e gjuhës së shkrueme*”. Shpreh optimizmin e tij se “*kësaj mund t’ia dalim, kësaj do t’ia dalim*”. E mbyll këtë çështje duke deklaruar : “*Gjuha mandej mos të harrojmë, është si njajo pema e njomë dhe e kërthndeztë(= e harlisur), e cila, si vjet për vjet, shkon tue u përtri gjethësh e degësh. Duem të thomi me kaqë se gjuha është një lamë e haptë e e çelunë për gjithken ; edhe se nuk ka mbarim kurr punimi i saj*”.<sup>14</sup>

\* \* \*

Pjesa e veprës “*Morfologjia*” ka vlerë për nivelin e saj, kur dihet se në atë kohë ishin botuar në gjuhën shqipe disa gramatika. Edhe në këtë vepër shihet erudicioni shkencor i autorit, i një intelektualit të formuar, i cili ka ditur t’i kapërcejë të dhënat e gramatikave të mëparshme. Dhe të lexosh më vëmendje gjithë informacionin me karakter morfologjik që jep për çdo temë në formë vërejtjesh, do të bindesh se kemi të bëjmë me një gjuhëtar të thellë që mund të zbulosh elemente të reja, disa prej të cilave kanë vlerë edhe sot që ka arritur dhe në disa raste do të paraqesë edhe prirjen e shqipes në atë periudhë, kur e shkroi veprën.

J.Rrota, më të vërtetë shkroi një vepër, mbështetur në shqipen e asaj kohe, por e gërsheton edhe me konsiderata historike dhe dialektore.

Gjykimin rreth kësaj vepre që po analizojmë duhet ta japim mbështetur në dijet e asaj kohe, kur mendohet se ajo mund të jetë përgatitur 75 vjet më parë.

Autori pjesën e morfologjisë e ka rënduar me sqarimet e shumta që janë bërë në ato 270 faqe, me 558 vërejtje, të cilat, disa prej tyre, mund të ishin përfshirë në trajtimin teorik të temave, disa edhe mund të thjeshtësoheshin ose të grupoheshin, ndonëse autori ka qenë i ndërgjegjshëm për një veprim të tillë, pasi edhe veprës i ka vënë titullin “*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*”.

Pavarësisht nga ndonjë të metë, e cila mund të përliqet me arritjet gjuhësore të asaj kohe kur është shkruar vepra, me shëndetin e tij shumë të dobët, pasi ishte i paralizuar, kur e kishte të vështirë të lëvizte për të hulumtuar në biblioteka dhe në arkiva, megjithatë vepra mbetet një thesar shumë i vyer në fushën e historisë së gramatikave të gjuhës shqipe.

#### REFERENCA

1. *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Shkodër, 2006, 612 f. , botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Bibliotekës françeskane “*At Gjergj Fishta*”.
2. Po ai, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Shkodër, 2006, Parathënia e Redaksisë, f.9.
3. Po ai, *Syntaxa e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1943, Dy fjalë rreth këtij botimi të dytë, f.XI-XII.
4. Po ai, po aty, kopertina prapa.
5. M.Domi, *Justin Rrota*, “*Studime filologjike*”, 1965, nr.1, f.220.
6. At J. Rrota, *Gjuha shkrueme...* f.240.
7. Po ai, po aty, f. 290.
8. Po ai, po aty, f. 291.
9. Po ai, po aty, f. 337
10. Po ai po aty, ... f. 408-412. Listim alfabetik i verbavet të mangët, të fortë a të parregullët. Shënon këto folje: 1. *ardhë* 2. *dhânë* 3. *dalë* 4. *dhashë* 5. *dijtë* 6. *drashtë* 7. *hangrë* 8. *huajtë* 9. *lanë* 10. *luejtë* 11. *marrë* 12. *njohtë* 13. *pa* 14. *prû* 15. *rrahë* 16. *shpie* 17. *vleftë* 18. *xanë* 19. *xî* 1. *zanë* 21. *zie*.
11. Po ai, po aty, Parathënia e Redaksisë, f.8.
12. Po ai, po aty, f.599.
13. J. Rrota, *Rreth problemit të gjuhës letrare*, “*Hylli i Dritës*”, Shkodër, 1931, nr. 3.
14. Po ai, *Gjuha e shkrueme...* f.13


Tomor Osmani

## RECENSION

### NJË JETË NË SHËRBIM TË DIJES

*“Rezultate të kërkimeve të prof. Luçia Nadin të 20 viteve të fundit për Shqipërinë e Shkodrën, nga shekulli XV-XVIII”*

Prof. **Lucia Nadin** lindi në Venecia (Itali), përfundoi studimet e larta në Universitetin e Padovas, ku edhe u doktorua në fushë të Italianistikës, në vitin 1987. Punoj si mësuese e letërsisë në shkollë të



mesme dhe në të njëjtën kohë ka kryer aktivitet akademik si mësime dhe si kërkuese shkencore pranë Universitetit të Padovës, ku për vite me radhë dhe mësime lëndën *Filologji mesjetare dhe humanistike*.

Për pesë vite me radhë, nga viti 1995 deri në vitin 2000, i qëlloi ta kalojë një pjesë të jetës së saj në Shqipëri, ku ka shërbyer në funksione diplomatike, kulturore, por edhe si mësime dhe duke mbajtur pozicionin e lektore pranë Fakultetit të Gjuhëve të huaja, në Universitetin e Tiranës, pastaj edhe të Këshilltares

Kulturore të ambasadorit italian në Shqipëri, si dhe të drejtueses së Institutit Italian të Kulturës.

Ka botuar vepra shkencore në fushë të letërsisë italiane dhe të kulturës veneciane, kryesisht të periudhës kohore ndërmjet viteve '300 - '900. Ndërkohë që gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri dhe pas hulumtimeve të gjata në bibliotekat e arkivat veneciane i lindi interesi të merret edhe me studimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Venedikut, duke arritur rezultate të rëndësishme.

Është e mirënjohur në rrethet shkencore kryesisht si hulumtuuese e zellshme e vlerave, e dëshmiave dhe e dokumentacionit historik të marrëdhënieve e të lidhjeve të hershme miqësore, kulturore, tregtare e politike të shqiptarëve me Italinë dhe italianët, në mënyrë të veçantë e lidhjeve të afërta midis Shkodrës dhe Venedikut.

Siç thotë prof. Lucia Nadin në hyrjen e librit të saj “Shqipëria e rigjetur”, *“hulumtimi është gjithmonë fryt i një procesi të gjatë, të*

*gjithanshëm e të mundimshëm; herë-herë ndonjë rezultat fatlum vjen si dhuratë e fatit, por më shpesh si kurorëzim i një pune prej murgu për gjetjen dhe bashkimin në një të tërë të një morie copëzash, në dukje pa lidhje mes tyre”.*

Si një qëmtuese plot durim e pasion ajo është marrë me studimin e një periudhe tepër të vështirë për popullin shqiptar, që përkon me zhvillimet historike ndërmjet vitit 1479 (rënies së qytetit të Shkodrës nën pushtimin osman) dhe vitit 1552, duke rindërtuar veç të tjerash edhe dukurinë e emigrimit shqiptar në krahinën e Venetos. Autorja ka nënvizuar se para pushtimit otoman Shkodra (ndërmjet viteve 1396 e deri më 1479) ndodhej nën zotërimin venecian, dhe përbënte një pikë-çelës për tregtinë me Venedikun. Shkodra, thekson ajo, përbënte një pikë strategjike dhe ishte një qendër e rëndësishme e kryqëzimit të trafikeve të Ballkanit.

Si specialiste e historisë mesjetare Nadin vërejti raporte shumëplanëshe shqiptaro - italiane në jetën shoqërore, kulturore, artistike dhe shpirtërore, veçanërisht midis Venedikut dhe Shkodrës.


Prof. Luçia, e pajisur me një pasion e përkushtim i pazakontë, pjesë të interesave të saj shkencore e diturake, ka pasur hulumtimin në biblioteka e arkiva, duke zbuluar mjaft dokumente, që përbëjnë prova të sigurt se në Shqipëri ka pasur një qytetërim të lashtë, çka dëshmon për rrënjët mesdhetare dhe evropiane të artit, të kulturës, të fesë, të traditave shqiptare, të jetës kulturore dhe të asaj materiale, etike dhe shpirtërore – si dhe lidhjet e shumta që kanë ekzistuar që në kohë të hershme midis dy brigjeve të Adriatikut.

E gjithë kjo botë e jashtëzakonshme zbulimesh e gjetjesh të provuara e të konfirmuara nga historia është pasqyruar në formën e analizave të specializuara e të thelluara në botimet e shumta të prof. Nadin, në monografi, libra apo në artikuj studimorë të publikuar në revista prestigjioze me emër dhe reputacion ndërkombëtar.

Ajo është autore botimesh me vlerë, të cilat janë fryte të një pune shumëvjeçare e të mundimshme, si:

1. *“Venecia dhe Shqipëria. Gjurmë të lidhjeve të lashta”*, Venecia, Agfol, 1995;
2. *“Migrimi dhe integrimi. Rasti i shqiptarëve në Venecia”* (1479-1552), Romë, Bulzoni, 2008;
3. *“Statutet e Shkodrës, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469”*, Tiranë, “Onufri”, 2002;
4. *“Shqipëria e rigjetur. Zbulime të pranisë shqiptare në kulturën dhe artin e viteve 1500 të Veneto-s”*, Tiranë, “Onufri”, 2012;

5. “Venecia dhe Shqipëria. Një histori e takimeve dhe lidhjeve shekullore”, Rajoni Veneto, Grafika Antiga, Crocetta del Montello (TV), 2014.



Një nga veprat më me vlerë ishte “Statutet e Shkodrës, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469”. Mbase kishte zbuluar në fondin e dorëshkrimeve të bibliotekës së Museo Correr të Venecias statutet e Shkodrës (më 1995), Lucia Nadin përgatiti botimin kritik të tyre, duke i rikthyer Shqipërisë një faqe themelore të historisë së saj. “Statutet e Shkodrës” janë një përmbledhje ligjesh e normash juridike që kanë rregulluar jetën e qytetit të Shkodrës nga vitet 1330, kur janë shkruar, deri në vitin 1479, kohë kur u pushtua nga turqit osmanë. **Janë dëshmia e parë e shkruar e së drejtës pozitive autoktone.** Janë pra, një lloj “kushtetute”, që përmban njëherësh norma të së drejtës publike, të asaj penale dhe civile.

**Ato janë** konsideruar si një "monument" i historisë mesjetare të Shqipërisë" dhe, siç thotë studiuesi e përkthyesi i tyre, prof. Pëllumb Xhufi, përfaqësojnë jo vetëm një fakt shkencor e kulturor, por edhe një moment të jashtëzakonshëm edukativ.

Prof. Nadin në studimet e saj është marrë edhe me mërgimin e klerikëve katolikë në tokat e Republikës së Përndritur mes shekujve XV dhe XVI, sidomos në lidhje me porositjen e veprave të artit e po kështu ka studiuar edhe traditën ikonografike të Skënderbeut në varkat e doxhëve në Venecia dhe ciklin e afreskeve të Paolo Veronese-s në kishën e San Sebastiano-s në Venecia. Si fryt i studimeve të thelluara të saj dhe si rezultat i një analize të përkorë shkencore të ciklit të afreskeve të Paolo Veronese-s në kishën e San Sebastiano-s në Venecia, në revistën e njohur shkencore, letrare dhe artistike "Ateneo Veneto", botohen artikujt e saj:

- "Sugjerim për një interpretim të ri të pikturave të Paolo Veronese-s në Kishën e Shën Sebastianit në Venecia: Skënderbeg, Miles Christi dhe Kisha e Shqipërisë"<sup>333</sup>

- "Kisha e Shën Sebastianit në Venecia, Paolo Veronezi, ndërlikimet shqiptare: një histori për t'u rishkruar"<sup>334</sup>.

Në këta artikuj bëhet një analizë e thellë e vlerave artistike, simbolike dhe historike të afreskeve të njërit prej monumenteve më të shquara të Rilindjes italiane të Venecias: Kishës së Shën Sebastianit. Në të vërtetë, në këtë kishë, që përbën një shembull të rrallë në llojin e saj, të gjitha zbulimet mbajnë nënshkrimin e një artisti të vetëm: Paolo Caliari, i njohur si "Il Veronese" - një nga përfaqësuesit më të shquar të pikturës venedikase të shekullit XVI. Aty, në një nga tri hapësirat ovale të tavanit të saj, është një afresk që përshkruan historitë biblike të Esterit dhe të Mardokut. Në qendër të afreskut paraqitet një flamur i kuq me një shqiponjë të zezë. Shumë studiues arti këtë flamur e kishin konsideruar si flamurin e Asburgëve. Ishte prof. Nadin që në mënyrë bindëse argumentoi se flamuri asburgas nuk kishte pasur asnjëherë një sfond të kuq, por të çelur. Në tezën e saj ajo niset nga fakti i provuar se ai flamur i përket Skënderbeut, është flamuri i Kastriotëve, ashtu siç ishte përshkruar nga Marin Barleti, më pas, i mbështetur edhe nga Konica, më 1908-n. Është po ai flamur që u valëvit me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912.

Kisha e Shën Sebastianit, figura e Skënderbeut, Shqipëria dhe krishtërimi

<sup>333</sup> "Ateneo Veneto" CXC VIII, seria e tretë 10/II (2011).

<sup>334</sup> "Ateneo Veneto", CC, seria e tretë 12/II, 2013.





Kisha e shqiptarëve në Venecia me pikturën e flamurit të Kastriotëve

përmbledhin disa prej fakteve kryesore të këtyre viteve.

Me të drejtë studiuesi Gjovalin Shkurtaj thekson se veç të tjerash prof. Lucia Nadin është e shquar edhe si mike e shqiptarëve, mbështetëse dhe ndihmëtare e palodhur e të gjithë albanologëve dhe e studiuesve shqiptarë: gjuhëtarë, historianë, kulturologë etj., të cilët i njohu gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri apo pati lidhje të ngushta bashkëpunimi me ta.

Prof. Nadin vjen sot para nesh për të prezantuar pjesë të punës dhe të arritjeve të saj më të fundit. Të themi të vërtetën, siç e kanë vërejtur edhe të tjerë para nesh, ajo vazhdon të ngjallë në të njëjtën kohë kureshtje dhe admirim të veçantë për pasionin me të cilin i mbledh të dhënat, i analizon, i studion dhe i publikon, duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në trajtimin e temave me interes e rëndësi të pazakontë për Shqipërinë dhe shqiptarët, e në veçanti për qytetin tonë, Shkodrën.

Për rreth 20 vite punë hulumtuese, kërkimore e shkencore në arkiva e biblioteka kushtuar Shqipërisë, për një hark kohor që përfshin periudhën ndërmjet shek. XV dhe shek. XVIII, ajo ka bërë objekt të analizës së saj të hollësishme ngjarje dhe figura të rëndësishme që kanë të bëjnë me Shkodrën dhe marrëdhëniet e saj me Venecian. Kjo pjesë e hulumtimeve të saj nis me vitin 1474, me rrethimet e Shkodrës dhe me jehonën e këtyre ngjarjeve në epopenë popullore veneciane.

Viti 1478, të cilin Nadin e quan “*stina e emigrimit të madh*” në Venecia, sjell në vëmendjen e këtyre kërkimeve humanistin dhe historianin e njohur Marin Barleti, i cili, pas vdekjes së Skënderbeut dhe rënies së Shkodrës, mërgoi në Venedik.

Komuniteti shqiptar në Venecia, shkolla dhe kushtetuta e parë (1442-1448), janë disa prej sythave që do të zgjerohen nga historia e njohur përgjatë punës së saj kërkimore. Po kështu, objekt i interesit të saj shkencor janë bërë vitet 1503-1504, vite në të cilat vendoset paqja në mes

të Venecias dhe turqve, duke i parë shqiptarët si protagonistë në shumë fusha, po të njohur sidomos për qëndresën e tyre.

Nuk i ka shpëtuar vëmendjes së saj edhe fusha e artit. Studiuesja e njohur ndër të tjera na sjell fakte edhe për skulpturën e madhe prej druri të krijuar nga duart e Paolo Campsas, të birit të Aleksandrit nga Shkodra, që konsiderohet si skulptori më i madh i drurit Venedikut Rilindjes.

Me mjaft interes janë trajtimet e saj për historinë e shqipes dhe të shqiptarëve në mesin e viteve '500. Albanologia italiane ka bërë objekt hulumtimi Buzukun dhe "Mesharin" i tij, i cili sipas saj është botuar në Venecia. Po kështu vëmendje të veçantë i kushton Pjetër Bogdanit dhe marrëdhënieve të tij me Venecian, të dokumentuara kryesisht përmes relacioneve dhe letrave plot fakte historike me vlerë për Shqipërinë, si dhe shqiptarët e marrëdhëniet midis dy popujve tanë në dy anët e Adriatikut.

Duke pasur parasysh kontributin e veçantë të saj në të mirë të shkencës shqiptare në përgjithësi, dhe ndihmesën e saj të veçantë për evidentimin e pasqyrimin e vlerave qytetare, historike e kulturore, si dhe ndikimin e saj në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve midis Shkodrës dhe Venedikut, Këshilli i Bashkisë Shkodër, në vitin 2010, i ka akorduar asaj titullin "Qytetare nderi" e Shkodrës.

Në vitin 2015 Presidenti i Republikës Bujar Nishani e ka dekoruar albanologjen, studiuesen, historianen dhe shkrimtaren e shquar italiane, Lucia Nadin, me Dekoraten "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", me këtë motivacion:

*"Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm shkencor dhe promovues në zbulimin e rrënjëve dhe lidhjeve europiane të Shqipërisë gjatë kohës së Republikës së Venedikut, për veprimtarinë e saj të paçmuar akademike dhe pedagogjike në fushën e albanologjisë, për shpirtin e saj altruist dhe angazhimin e drejtpërdrejtë në forcimin e lidhjeve kulturore e akademike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Italiane".*

Artan Haxhi, Mimoza Priku

## RECENSION

### I. LUMI I MELODISË

(Shënime për librin “Danub”, të autorit Klaudio Magris, sjellë në shqip nga përkthyesja Alma Hafizi)

Sa herë që ndodhem përballë një pune të tillë, aq serioze, ndërkulturore, më tingëllon në vesh invokacioni me të cilin klerikët e hapin çdo fjalim fetar apo laik. Pra, është lavdia ndaj Zotit. Natyrisht që kjo lavdi e ka vendin kudo e nga të gjithë ne dhe është si lutja rutinë para sofrës. Në raste të tilla bëj këtë lutje: *“Lavdi gjuhës shqipe, që është garantja dhe mbajtësja e peshës kulturore të të gjitha kryeveprave letrare të botës! Bekuar qoftë gjithë arsenalit i saj komunikues e shprehës, utilitar e artistik që na mundëson të ulemi në tryezën e gjerë të artit botëror të letërsisë”*.

Me të drejtë nobelisti meksikan Oktavio Paz e quan përkthimin e një veprë në një gjuhë të caktuar “kombëtarizim” dhe e konsideron këtë akt kulturor po kaq të rëndësishëm sa edhe krijimin e një veprë letrare në atë gjuhë. Veç kësaj, përkthimi i letërsisë artistike, si pjesë shumë e rëndësishme dhe një nga domenet bazë të letërsisë dhe komunikimit të ndërsjellë të saj; është edhe një sakrificë, përvujtëni dhe vetmi individuale për artistët e fjalës që i kushtohen kësaj rruge.

Vepra “Danub”, që është sjellë në shqip nga përkthyesja tashmë e njohur Alma Hafizi, është një pasurim i mëtejshëm i kulturës sonë, në marrëdhënien e saj me letërsinë botërore.

Së pari, autori i këtij libri është Klaudio Magris, një shkrimtar shumë i rëndësishëm bashkëkohor, me një erudicion olimpik. Një lloj Borghesi evropian, me një talent dhe origjinalitet tashmë të njohur, por edhe me një dimension filozofik të pazakontë. Kjo vepër, ku autori shpalos mistikën, misterin dhe mitologjinë e Danubit, si një nga logos-et më madhështore të historisë dhe të gjeografisë planetare; apo siç e quan Hölderlini, lumi i melodisë; kjo Rrugë Qumështi e kontinentit evropian

është arketipi dhe teatri i këtij libri që mund të konsiderohet një kryevepër për disa arsye: për informacionin oqeanik, të shtrirë në mënyrë të pakufishme në hapësirë dhe në kohë; për aftësinë vëzhguese dhe depërtimin e thellë të autorit; për aspektin meditues dhe filozofik; për përshkrimet brilante; për portretizimin e personave, të kthyer në personazhe nga ligjet e rrepta dhe të pamëshirshme të kohës; për optikën historike dhe kronotopin e madhërishtme të veprës; për kohezionin në rrokjen e gjithë kësaj telajoje madhështore me një vështrim që mund të quhet vepra ose libri “Danub”; për njohjen e detajuar të kulturave zyrtare e shpirtërore të një hapësire të stërmadhe. Dhe së fundi, për artin e fjalës, elegancën e stilit, origjinalitetin befasues të parashtrimit dhe refleksionet e çuditshme, si dhe në çdo element tjetër të formës.

Mendoj se Danubi historik dhe gjeografia e stërmadhe e udhëtimit të autorit në hapësirë dhe në kohë, aq sa është një realitet fizik, po aq është edhe një realitet transhendent dhe një gjetje gjeniale për të shkarkuar e paraqitur madhështinë e njohjes, forcën e mendimit dhe demonstrimin e shkëlqyer të artit të shkruarit. Pa tentuar t’i hyjmë një analize të thellë të kësaj vepre, mendoj se është vendi të theksojmë disa gjëra për përkthimin e saj. Italishtja ka dy fjalë që janë sinonime të pjesshme, jo të plota, për procesin e sjelljes së një vepre nga një gjuhë në tjetrën: “traduzione” dhe “trasduzione”- pra, përkthim dhe tejktim, gjë që tregon procesin e ndërlikuar, kompleks dhe shumëzërash të një aventure të tillë kulturore. Pra, përveç mikroperacioneve linguistike, si sfida tejet të vështira e thujse të pafundme, artistit që në këtë rast ne i themi përkthyes, dhe sidomos me këtë lloj vepre, i dalin pengesa dhe shtigje të paparashikuara që kanë të bëjnë me arsenale kulturore dhe sfinksat të panjohur dhe shpesh të kapërcyeshëm vetëm me mjete gjuhësore. Dhe në këtë pikë është vendi të shikojmë edhe njëherë rëndësinë e përkthimit dhe të autorëve bilingë në formimin e letërsive dhe kulturave kombëtare. Duke kundruar me admirim traditën e letërsisë sonë në këtë fushë dhe vazhdën e shkëlqyer që na kanë lënë të parët tanë, autorët e mëdhenj shkodranë e më gjerë të përkthimit, si: Gjon Shllaku, Henrik Lacaj, Ndre Mjeda, Lazër Shantoja, Ernest Koliqi, Vehbi Bala etj., mund të vëmë re se përkthyesi është një letrar me një ADN artistik krejt të dallueshëm; me origjinalitet të spikatur si çdo poet apo prozator tjetër.

Në rastin e “Danub”-it, është shpirti, zëri, kultura, butësia, nervi, timbrika, ironia, meditimi dhe erudicioni i përkthyeses Alma Hafizi, që bashkudhëton me të gjitha këto cilësi të spikatura të autorit Klaudio Magris. Në shumicën e rasteve përkthyesit e mirë kanë diçka binjake me autorin dhe shenjat e binjakësisë janë pa fund. Përkthyesja Hafizi e ka njohur e studiuar veprën dhe autorin, së pari në procesin e studimeve doktorale, si një autor dhe opus i denjë për t’u marrë si diskurs themelor studimi të letërsisë së krahasuar, gjë që u materializua në veprën me titull “Letërsia e kufijve”. Procesi i gjatë i kërkimeve çuan në ngjizjen e një vepre, ku janë qasur e pranëvënë autori shqiptar Martin Camaj dhe Klaudio Magris. Kjo i bëri të mundur autores Hafizi të udhëtonte në labirintet e laboratorit krijues të Magris-it, të njihej me teknikat shprehëse, veçoritë e stilit dhe gjithë arsenalin krijues të tij. Pra kemi një njohje të detajuar, një studim të plotë dhe pastaj, e së fundi, përkthimin e veprës. Dhe, përveç njohjes së thellë të gjuhëve dhe aftësive transmetuese e krijuese të autores Hafizi, ky studim dhe njohje e detajuar e veprës përbën edhe misterin e përmbylljes së shkëlqyer të një pune kaq të vështirë.

Me përvojën time të përkthyesit kam konstatuar që sjellja në shqip e kësaj vepre të rëndësishme përbën një rritje intelektuale dhe artistike për autoren e përkthimit. Kam bindjen se ky libër s`mund të klasifikohet me taksonominë tradicionale në asnjë lloj zhanri të vetëm, pra nuk është as letërsi artistike, as eseistike, as letërsi historike, as dokumentare, por ai njëkohësisht është edhe letërsi, edhe eseistike edhe letërsi historike dhe dokumentare. Ai është hiperletërsi, apo ndryshe libër librash.

Kësisoj “Danub” i ka paraqitur përkthyeses sfida të panumërta që janë përballuar nga kultura e saj e gjerë, nga njohja e thellë linguistike dhe nga shfrytëzimi në maksimum i mjeteve shprehëse, duke përballuar sintaksën e ndërlikuar dhe leksikun e pasur. Autorja ka shfrytëzuar jo vetëm gjithë fondin shprehës të gjuhës standarde, por hera-herës i është kthyer edhe kompozitave dhe neologjizmave, kalkeve gjuhësore, fondit leksikor të gegnishtes, sharmit të saj sintaksor: ‘*stjegull, surratpështyrë, fizikplotë “në të lëvdueshmin Zot”*; “*andej pari*” etj.

Përfundimisht mendoj se ardhja në kohë e këtij libri në gjuhën tonë është një kontribut i vyer dhe një pasurim i kulturës sonë letrare.

Zija Vukaj

## JETA SHKENCORE

### KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “SHQIPËRI & HUNGARI – DJE, SOT DHE NESËR”

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Instituti i Studimeve Albanologjike, Ambasada e Republikës së Hungarisë dhe Konsullata e Nderit e Hungarisë në Shkodër, më 18 nëntor 2016, organizuan Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “*Shqipëri & Hungari – Dje, sot dhe nesër*”.

Në fjalën e hapjes rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Adem Bekteshi, pasi uroi mirëseardhjen, theksoi se kjo konferencë e rëndësishme ndërkombëtare zhvillohet në përkujtim të jubileut të 60-vjetorit të Revolucionit Hungarez të vitit 1956. Ai ndër të tjera u shpreh: “*Iu bashkova nismës për organizimin e kësaj konference studimore me temë: “Shqipëria dhe Hungaria – Dje, sot dhe nesër” jo thjesht për ta rikujtuar këtë ngjarje të madhe, por edhe për të theksuar simbolikën që ajo ka jo vetëm për popullin hungarez, por për gjithë popujt e Lindjes, ashtu si dhe për ne shqiptarët. Në këtë kontekst, por edhe duke e aktualizuar mesazhin tim, do të doja t’ju sjell ndër mend se ne shqiptarët, shkodranët dhe veçanërisht Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” kemi një trashëgimi të pasur ndihme dhe bashkëpunimi prej shekujsh me Hungarinë, e cila sidomos në kohëra kur zëri i saj dëgjohej fort, ka pasur një pozicion të spikatur për njohjen e rolit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në histori, kulturë apo vlera të tjera”.*

Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, znj. Voltana Ademi, shprehu bindjen se kjo konferencë do të shërbejë për të përvijuar bashkëpunimin në mes të Shkodrës dhe Hungarisë. Ajo theksoi “*Jam e kënaqur që universitetet hungareze po bashkëpunojnë ngushtësisht me Universitetin e Shkodrës*”.

Konsulli i Nderit i Hungarisë në Shkodër, prof. as. dr. Kliti Hoti, në fjalën e hapjes nënvizoi se ndihet i privilegjuar që ndodhet në këtë mjedis akademik dhe është i lumtur që në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe me Institutin e Studimeve Albanologjike arritëm të organizojmë këtë konferencë ndërkombëtare shkencore, me pjesëmarrjen e specialistëve hungarezë dhe të atyre shqiptarë. Besoj se kjo konferencë, vijoi ai, do të përçojë mesazhe të rëndësishme për marrëdhëniet e Shqipërisë me Hungarinë.

Në përshëndetjen e saj znj. Mimoza Halimi, drejtore e Drejtorisë së Evropës dhe Azisë Qendrore pranë Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, u shpreh se ligjëratat që do të mbahen në këtë konferencë do të përbëjnë një burim të mirë njohurish për të gjithë ne.

Konferenca vijoi sipas programit me seancën *plenare*, ku kumtuan: dr. Márton BÉKÉS: *For Freedom and Independence - The War of the Revolution and freedom of Hungary in 1956*; prof.dr. Artan HAXHI & Prof. dr. Mimoza PRIKU: *Hungaria dhe kontributi i Istavn Shütz në fushën e studimeve albanologjike*; prof.dr.Romeo GURAKUQI: *Kontributi i Austro-Hungarisë në formimin e shtetit shqiptar në Rilindje, shtetformim dhe mbrojtje të kufijve të Shqipërisë Etnike*; dr. Krisztián CSAPLÁR-DEGOVICS: *The 25<sup>th</sup> Anniversary of Albanian Independence and the Hungarians (1937)*; prof. dr. Kurt GOSTENTSCHNIGG: *Thallóczy and Nopcsa-Two leading Austro-Hungarian albanologists competing for symbolic capital*.

Në vazhdim u zhvilluan seancat paralele, ku kumtuan: dr. Tamás PÁLOSFALVI : *Scanderbeg and Huniadi : myth and reality*; prof.dr.Mahir HOTI: *Kontributi i studiuesit hungarez Franc Nopça në gjeoshkencat shqiptare*; dr. Csaba KATONA: *Geraldine Apponyi, the Hungarian queen of all Albanians*; prof. as. dr. Ledia DUSHKU: *Aspektetë politikës austro-hungareze ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Madhe (1914-1918)*; prof. as. dr.Simon LUFË: *Shën Stefani i Hungarisë*; dr. Ferenc POLLMANN: *Misioni i fundit i Baron Nopcsa në Shqipëri (1915/16)*; Peter Kacziba, *Albanian-Hungarian relations during the greek civil war*; dr. Ervis KRYMBI & dr. Dritan RUSTJA: *Studiuesit hungarezë në paraqitjen e hartave të trojeve shqiptare*; dr. Zoltán Péter BAGI: *Giorgio Basta in the service of Rudolf II (1597-1603)*; prof.as.dr.Rokin DABERDAKU: *Franc Nopça – studiuesi pasionant i etnokulturës shqiptare*; prof. as. dr. Rrezarta DRAÇINI: *Studiuesit hungarezë për leksikografinë shqiptare*; dr. Brisena KOPLIKU & dr. Nevila DIBRA: *Shkëmbimet mes Shqipërisë dhe Hungarisë në fushën e arsimit të lartë*; prof. as. dr. Valbona KARAKAÇI: *Mëtim mbi lirinë dhe shkrimtarin - Qasje krahasuese mes Imre Kertes (fituesi i çmimit Nobel, 2002) dhe Kadaresë (çmimi Jeruzalem, 2015)*; prof. as. dr. Arben PRENDI: *Kontributi i Baron Franc Nopçës në mbledhjen e folklorit*; dr. Gëzim PUKA & prof. as. dr. Vincens MARKU: *Jokai Mor - Romancier i hungarez që u magjeps nga personazhet shqiptarë*; dr. Anisa KOSTERI & dr. Zamira SHKRELI: *Vlera gjuhësore e romanit “Djemtë e rrugës Paal” të autorit hungarez F. Molnar*; dr. Eleonóra GÉRA: *The secret life of the Albanian priest Toma Raspassani in Buda*.



### **VEPRIMTARIA SHKENCORE “DITA E DOKTORANTIT”**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike organizuan më 6 mars 2017 veprimtarinë shkencore “DITA E DOKTORANTIT”.

Aktiviteti ishte konceptuar si promovim i punimeve shkencore të studentëve të shkollës doktorale në fushën e gjuhësisë. Në fjalën e tij përshëndetëse Rektori i USH-së, prof. dr. Adem Bektashi, ndër të tjera theksoi rëndësinë që ka shkolla doktorale për një universitet, si cikël i tretë që kompletton studimet. Më tej ai përgëzoi organizatorët për formatin e kësaj veprimtarie dhe për paraqitjen e mirë dhe promovimin që po i bëjnë punës shkencore të doktorantëve.

Veprimtaria u drejtua nga prof. dr. Mimoza Prikë (dekane e Fakultetit të Shkencave Shoqërore), prof. dr. Artan Haxhi (drejtor i Institutit të Studimeve Albanologjike) dhe prof. as. dr. Rrezarta Draçini (përgjegjëse e Departamentit të Gjuhësisë). Sipas programit kumtuam: Karmen LAZRI : *Eufemizmat në gjuhën latine*; Orjeta DUSHI : *Struktura e frazës dhe funksionet e paskajores gege në prozën e At Zef Pllumit*; Arjola HOTI : *Çështje të sistemit emëror në veprat e autorëve të shek XIX (Engjëll Radoja dhe Pashko Pabi)*; Alma GOLEMI: *Roli i disa faktorëve jashtëgjuhësorë me vlerë sociolinguistike në prozën e Koliqit*; Aimir OSMANI: *Dukuri me karakter fonetik në dy veprat e Filip Ndocajt*; Zeki MORINA: *Emrat shpotitës në funksionin patronomik*; Blerina KRAJA: *Rreth formave të pashtjelluara në përmbledhjen “Visaret e Kombit”*; Alma PERVIZI : *Probleme gjuhësore në gazetarinë dhe publicistikën e viteve 1930-1960*; Albana KALOSHI: *Disa funksione të paskajores gege në Ciklin e Kreshnikëve*; Renata SMAÇI: *Elemente dalluese dhe të përbashkëta në sistemin fonetik mes tri veprave: “Kuvendi i Arbërit” (1706), “Gramatika e parë e shqipes në dorëshkrim e vitit 1710” dhe “Gramatika e Da Lecces” (1706).*

### **KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “GJURMIME ALBANOLOGJIKE...”**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike në vijim të veprimtarisë së tyre kërkimore - shkencore, më 2 qershor 2017 organizuan konferencën shkencore kushtuar disa figurave të ndritura të albanologjisë me qëllim që t'i përkujtojnë në përvjetorët e tyre.

Përmes një analize shkencore shumëplanëshe u analizua kontributi shkencor, përpjekjet, sfidat dhe arritjet e autorëve të tillë, si: Mati Logoreci, Preng Doçi, Ndre Mjeda, Bernardin Palaj, Azem Shkreli, Pashko Vasa, Martin Camaj, Dhimitër Kamarda, Injac Zamputi, Arshi Pipa.

Fjala e hapjes u mbajt nga dekania e FSHSH, kurse rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Adem Bektashi, në përshëndetjen e tij theksoi se aktivitete të tilla kanë një vlerë të pamohueshme mbasi jo vetëm përkujtojnë figurat e ndritura të albanologjisë, por edhe pse dëshmojnë se Universiteti i Shkodrës po shndërrohet përherë e më tepër në një qendër të rëndësishme të kërkimit shkencor dhe janë të mirëpritura. Përshëndeti gjithashtu edhe kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, e cila ndër të tjera e vuri theksin tek roli aktiv i Universitetit të Shkodrës në jetën shoqërore, kulturore e shkencore të qytetit, por edhe më gjerë.

Konferenca vijoi me seancën *plenare*, ku kumtuan: Artan HAXHI & Tefë TOPALLI: *Personaliteti i Mati Logorecit dhe kontributi i tij në lëmë të leksikut*; Seit MANSAKU: *Kontributi i Dhimitër Kamardës në fushën e historisë së gjuhës*; Kolec TOPALLI: *Mati Logoreci si leksikograf, Fjalë të rralla me burim të trashëguar; Formime të brendshme të shqipes, Fjalë të huazuara, Krijime onomatopeike, Kuptime të reja fjalësh të mbledhura, Shprehje frazeologjike, Emri etnik arbër*; Aljula JUBANI & Natalina HOTI: *Atë Bernardin Palaj - martirizimi i njeriut dhe i kontributit të tij shkencor*; Kujtim BEVAPI & Abdulla BALLHYSA: *Në 100-vjetorin e udhëtimit të Ndre Mjedës maj 1917 – maj 2017*; Mimoza PRIKU: *Mati Logoreci në faqet e revistës "Cirka"*; Tomor OSMANI: *Mati Logoreci, atdhetari që luftoi për njësimin e shqipes dhe gjuhën e përbashkët*.

Në seancat e *gjuhësisë* kumtuan: Anila OMARI: *Dhimitër Kamarda dhe idetë e tij rilindase për gjuhën letrare shqipe*; Bardhyl DEMIRAJ: *Ndre Logoreci (1830-1892)*; Mimoza KORE: *Mati Logoreci, gjuhëtari i formuar, që u përfshi me guxim në debatin shkencor të kohës për çështjen e gjuhës shqipe*; Imri BADALLAJ: *Kontributi i Martin Camaj në studimin e të folmeve italo-arbëreshe*; Orjeta BAJA: *Fjalët e rralla në "Librin e burgut" të Arshi Pipës*; Merita HYSA: *Shqyrtime socioguilistike në veprën e Arshi Pipës*; Anisa KOSTERI: *Fjalori i bashkimit në vlerësimin e Preng Doçit*; Aida URUÇI: *Mjeshtria e Camajt në ndërtimin e përdorimin e fjalëve të reja*; Fridrik DULAJ & Yllka R. IMERI: *Vlerësime gjuhësore sipas hapësirave ligjërimore në veprën e Martin Camajt*; Evalda PACI: *Njac Zamputi, një historian në shërbim të studimeve mbi letërsinë e gjuhës shqipe*; Rrezarta DRAÇINI: *Variacione semantike në perceptimin e veprave të Mjedës*; Rozana RUSHITI: *Ndërtime njësisish me dy paskajoret*

*gege : me + pjesore dhe për me + pjesore dhe funksionet e tyre me esenë “Shqypnia dhe shqiptarët e Pashko Vasës”;* Florimont GOJANI : *Sintaksa në romanin “Rrathë” e Martin Camaj;* Njazi KAZAZI & Rezearta MURATI, *Ndre Mjeda autor i abetareve shqipe;* Shyhrete MORINA : *Përcjellorja në veprën e Ndre Mjedës;* Erzen KOPERAJ: *Dhimitër Kamarda , kontributi i studiuesit arbëresh në gramatikën historike dhe të historisë së gjuhës shqipe;* Adelajda BAFTIU: *Kontributi i Martin Camajt për sintaksën e shqipes;* Qendresa JAKUPI: *Pikëpamjet e Arshi Pipës për teoritë që u zbatuan gjatë procesit të standartizimit të shqipes;*

Në seancën e *letërsisë* kumtuan: Fatbardha HOXHA: *Identiteti krijues i Pashko Vasës në mes të atdheut dhe botës, prespektiva e leximit;* Alfred ÇAPALIKU: *Paralele mes Salvatore Quasimodos dhe Gasper K. Palit (1916-1942);* Eleni KARAMITRI: *Gramatika shqipe e Martin Camajt në vështrimin e albanologut shqiptaro-amerikan Peter R.Prifti;* Vjollca OSJA: *Disa veçori të stilit në poezinë e Mjedës;* Arben PRENDI: *Ndërthurjet tematike dhe bota e personazheve në dramën e Martin Camajt;* Nikë UKGJINI: *Abat Prengë Doçi, për gjallërimin dhe lulëzimin e Shqipërisë;* Kamber KAMBERI: *Motivi i vdekjes në poezinë e Camajt dhe Shkrelit;* Ermira ALIJA & Zamira SHKRELI: *Qasje dhe propozime didaktike të Mati Logorecit në: “Liber i mesuesit per perdorim t’Abetarit”;* Edelajda CENAJ: *Bernardin Palaj dhe Lef Nosi, një qasje krahasuese;* Rovena VATA: *Kontributi i Martin Camajt në letrarizimin e miteve dhe dokeve të zonës së Dukagjinit në romanin “Rrathë”.*

Në seancën e *historisë* kumtuan: Rokin DABERDAKU & Gjovalin ÇUNI: *Demonstratat e 1981 në Kosovë në optikën e Arshi Pipës;* Paulin MARKU: *Prend Doçi: Roli dhe kontributi i tij në Rilindjen Kombëtare dhe në shoqërinë shqiptare;* Bendis KRAJA: *Dokumentacionet e programeve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare përmes pendës së ideologut Pashko Vasa;* Sereta KOPERAJ: *Injac Zamputi, kontributi i tij në dokumentacionin historik për periudhën e mesjetës;* Isida HOXHA: *Kontributi i Mjedës në çështjen shqiptare.*

#### **VEPRIMTARIA SHKENCORE**

#### **“RISULTATI DEGLI ULTIMI VENT’ANNI DI RICERCA SU ALBANIA E SCUTARI, DAL SECOLO XV AL SECOLO XVIII”**

**(me historianen e njohur italiane, prof. Lucia Nadin)**

Në kuadër të Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit më 24 prill 2017, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike organizuan veprimtarinë me titull “*Risultati degli ultimi*

*vent'anni di ricerca su Albania e Scutari, dal secolo XV al secolo XVIII*' me historianen e njohur italiane Lucia Nadin. Në këtë aktivitet merrnin pjesë rektori i Universitetit të Shkodrës prof. dr. Adem Bekteshi, studiues, pedagogë e studentë, të cilët shfaqën interes për punën e palodhur të kërkueses italiane kushtuar Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Veprimtarinë e hapi dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore prof. dr. Mimoza Prik, e cila në bashkëpunim me drejtorin e Institutit të Studimeve Albanologjike prof. dr. Artan Haxhi kishin përgatitur në mënyrë të përmbledhur një kronologji të kontributit shkencor të studiueses, duke u ndalur në veprat: *“Venecia dhe Shqipëria. Gjurmë të lidhjeve të lashta”* (Venecia, Agfol, 1995); *“Migrimi dhe integrimi. Rasti i shqiptarëve në Venecia”* (1479-1552; Romë, Bulzoni, 2008); *“Statutet e Shkodrës, në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469”* (Tiranë, Onufri, 2002); *“Shqipëria e rigjetur. Zbulime të pranisë shqiptare në kulturën dhe artin e viteve 1500 të Veneto-s”* (Tiranë, Onufri, 2012); *“Venecia dhe Shqipëria. Një histori e takimeve dhe lidhjeve shekullore”* (Rajoni Veneto, Grafika Antiga, Crocetta del Montello (TV), 2014).

Më pas studiuesja italiane Lucia Nadin arriti të përmbliidhte punën e saj voluminoze të 20 viteve, duke i ilustruar me fakte e të dhëna historike të gjitha hulumtimet kushtuar Shqipërisë, Shkodrës e shqiptarëve, duke nisur me vitin 1478, të cilin Nadin e quajti *“stina e emigrimit të madh”* në Venecia. Ndër të tjera ajo solli në vëmendjen e dëgjuesve edhe hulumtimet e saj për humanistin dhe historianin e njohur Marin Barleti. Me mjaft interes u pritën analizat dhe interpretimet e saj për figurën e Skënderbeut, si dhe për vendin e shtypjes së librit të parë të gjuhës shqipe, *“Meshari”* të Gjon Buzukut. Në mënyrë të thukët studiuesja veneciane interpretoi lidhjet shekullore mes Shkodrës dhe Venecias, duke u ndalur në veçanti tek *“Statutet”* e Shkodrës.

### PROMOVIMI I LIBRIT

#### **“PER UNA NUOVA DIDATTICA DELL’ ALBANESE: PROVE DI E-LEARNING E DI LUDOLINGUISTICA”**

**(Seria Albanistica 7, Rende, 2016)**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike organizuan më 10 nëntor 2016 promovimin e librit *“Per una nuova didattica dell’ albanese: prove di e-learning e di ludolinguistica”* (Serie Albanistica 7, Rende 2016) të autorëve F. Altimari, F. Koleci, J.

Kume, M.L. Pignoli, M. Caria, M. Cronin, E. Mascherpa, D. Meringolo, M.G. Palumbo (me një prezantim nga prof. Anthony Mollica).

Veprimtarinë e hapi Dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof. dr. Mimoza Priku, e cila bëri një prezantim të shkurtër të librit.

Zv.rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. as. dr. Ilir Berhani e përgëzoi Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe Institutin e Studimeve Albanologjike për organizimin e kësaj veprimtarie promovuese, që ka përfshirë akademikë, albanologë dhe shumë emra të njohur të fushës. Prof. Anthony Mollica në fjalën e tij e vlerësoi ftesën për të marrë pjesë në këtë veprimtari promovuese dhe theksoi më tej se një fushë e tillë si ludolinguistika ofron një mësim shumë të këndshëm të gjuhës, përmes lojës së fjalëve. Drejtori i Institutit të Studimeve Albanologjike, prof. dr. Artan Haxhi, vuri në dukje kontributin që ka kjo vepër në fushën e didaktikës duke theksuar se ky libër përmes një analize të hollë e të mbështetur shkencore ka dëshmuar qartazi edhe një herë se teknikat e të mësuarit e gjuhës amtare (arbërishten apo shqipen) apo asaj të huaj kanë evoluar, duke u përshtatur me dijen më të përparuar në fushë të gjuhësisë së zbatuar. Libri që kemi sot në dorë është dëshmi e një fakti të tillë, theksoi më tej ai. Prof. as. dr. Rrezarta Draçini diskutoi rreth aspekteve sociolinguistike të librit. Njëra nga bashkautorët e veprës, prof. as. dr. Flora Koleci, u shpreh se libri do të japë rezultate të mira në punën me studentët, sepse metodat e studimit të gjuhëve të huaja nuk mund të anashkalojnë teknologjitë e reja. Në përfundim, një nga autorët dhe ideatori i shumë projekteve për mësimin e arbërishtes, prof. Francesco Altimari, pasi falënderoi Universitetin e Shkodrës për mikpritjen e përhershme dhe për organizimin e një aktiviteti të tillë, theksoi se kjo metodë mësimi e gjuhës është mjaft zbatimëse dhe se *“tradita e pasur e gjuhës së folur arbërisht përshtatet me didaktikën e re dhe na shërben shumë në arealin tonë arbëresh”*. Ai adresoi një falënderim të veçantë edhe për pedagogët shqiptarë që kanë ndihmuar në këtë proces.

## **DRAMA** **“RINOCERONTI”**

Në kuadër të 60-vjetorit të themelimit të Universitetit të Shkodrës *“Luigj Gurakuqi”*, nga studentët e këtij Universiteti u vu në skenë drama *“Rinoceronti”* e autorit Eugjen Jonesko. Drama u shfaq më 29 dhe 30 maj 2017, në teatrin *“Migjeni”*. Ajo u ndoq me vëmendje të veçantë nga pedagogët, studentët, qytetarët shkodranë, si dhe u shoqërua nga një jehonë e gjerë mediatike.

Drama “*Rinoceronti*” është pa dyshim një nga pjesët më të qarta dhe më të shfaqura në skenat evropiane të Eugjen Joneskos, këtij dramaturgu të madh francez me origjinë rumune. Vepra ngrihet si një aktakuzë e fuqishme kundër çdo lloj diktature, e kuqe apo e zezë qoftë, që e katandis njeriun në një hiç, e detyron të tjetërsohet e të bëhet kafshë dhe, nëse dëshiron të mbijetojë, e bën të jetë hipokrit, e zhvesh nga idealet, e kthen dhe e bën një lodër qesharake forcën e logjikës njerëzore. Fjalës njerëzore i heq çdo kuptim dhe e bën njeriun që ta ndiejë veten të vetmuar edhe kur ndodhet në mes të të tjerëve.

Drama pati një pritshmëri të mirë nga spektatori, pasi në esencë ishte humaniste, plot ironi dhe humor, që është shprehje e një epërsie shpirtërore. Ajo përcolli tek spektatori mesazhin e besimit tek njeriu që nuk dorëzohet, duke mbrojtur deri në fund me krenari idealin e tij human. Ideja e saj liberale përkon me idetë universitare që gjithmonë shkojnë kundër totalitarizmave në përgjithësi.

Drama u ideua dhe u realizua nga dr. Gëzim Puka, pedagog i Departamentit të Letërsisë, ndërsa regjia nga Merita Smaja dhe Gëzim Puka. Interpretues sipas roleve ishin studentët: Eduard Hysaj (*Beranzhe*), Lorenc Smajlaj (*Zhani*), Dila Prenga (*Dezi*), Senad Tula (*Dydaridi*), Fatjona Bushaj (znj. *Botard*), Aleksandër Prenga (*logjisjeni*), Ledian Prebibaj (z. *Papijon*), Mark Naçaj (*zotëria plak*), Hymerta Ura (znj. *Bëf*), Xhesika Lika (*amvisa*), Najada Bregu (*dyqanxhesha*), Donald Zefi (*i zoti i kafenesë*), Ersilda Tafili (*kamarierja*).

### BOTIME TË REJA TË UNIVERSITETIT

Këtë vit u vu në qarkullim numri më i ri i kolanës “*Studime shqiptare*”, botim i Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe i Institutit të Studimeve Albanologjike titulluar :


1. ***Shqipëri – Hungari; dje, sot dhe nesër***, nr. 28 i kolanës “*Studime shqiptare*”, “*Fiorentia*”, Shkodër, 2017, ku u përfshinë kumtesat e mbajtura në Konferencën shkencore ndërkombëtare të mbajtur në përkujtim të jubileut të 60-vjetorit të Revolucionit Hungarez të vitit 1956. Vëllimi me ISBN 978-9928-191-74-8 përmban 20 punime dhe ka 197 faqe.




Gjatë kësaj periudhe u botuan:

### Monografi dhe tekste :


1. ÇAPALIKU, Alfred “*Kolë Mirdita (Helena) Jeta dhe vepra*”, enti botues “Gjergj Fishta”, Shkodër, 2015, ISBN 978-9928-161-67-3, 111 faqe.



2. PUKA, Gëzim: “*Albanian authors in search of a “peculiar” drama type*” Shtëpia botuese: Edions Universitaires Européennes ISBN-13:978-3-8416-1825-2; ISBN-10:3841618251; EAN:9783841618252, gjuha e librit: anglisht (italisht). 76 faqe. Botuar më: 27.10.2016, Kategoria : Gjuhë të tjera/ Letërsi të tjera.



3. PUKA, Gëzim: *Në kërkim të një drame “ndryshe”*, Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike (Tiranë), Shtëpia botuese “Diti&Oli”, ISBN: 978-9940-661-18-2, Ulqin, 2017, 244 f.



4. HOTI, Mahir: *“Metodikë e kërkimit shkencor në gjeografi”*, “Fiorentia”, Shkodër, mars 2017, 215 faqe.





**ISSN 2221-6855**

*Doli nga shtypi dhjetor, 2017 – tirazhi 120 kopje –Formati 176 x 250 mm.  
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”*